

**RENDI I DITËS**

*Shqyrtimi administrativ i kërkesës ankimore me nr. 33, datë 7.05.2021; kërkesës ankimore me nr. 41, datë 9.05.2021 dhe kërkesës ankimore me nr. 52 datë 10.05.2021, me objekt “Ndryshimin e vendimit nr. 347, datë 04/05/2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli BELE, Z. Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Z. O.Peto
- **Parti Politike:** PD, PS, LSI
- **Kandidat i propozuar nga zgjedhësit, zoti Kreshnik Merxhani**

**Z. L. Braho:** Mirëmëngjesi! Sot, në datë 12.05.2021, çelim seancën publike të shqyrtimit administrativ për kërkesën ankimore me nr. 33, datë 7.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për integrim; nr. 41, datë 9.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor, Partia Demokratike & Aleanca për Ndryshim; dhe nr. 52 datë 10.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor kandidat i paraqitur nga një grup zgjedhësish, zoti Kreshnik Merxhani. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 347, datë 04/05/2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në mbështetje të neneve 19/1 dhe 123 të Kodit Zgjedhor, ka miratuar tabelën përmbledhëse për rezultatin e arritur nga subjektet zgjedhore të Qarkut

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Gjirokastrë. Së bashku me vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror Zgjedhjeve janë edhe anekset përkatëse ku janë votat për çdo subjekt zgjedhor si dhe votat personale për secilin kandidat të subjekteve zgjedhore. Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit 124 të Kodit Zgjedhor, kanë paraqitur ankim palët që cituam. Në zbatim të nenit 12 të rregullores për funksionimin e KAS-it, në datë 10.05.2021 është hedhur shorti për të përcaktuar relatorin e kërkesave ankimore nr. 33 dhe nr. 41. Ndërkohë që, me datë 11.05.2021, është hedhur shorti për të përcaktuar relatorin për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 52. Respektivisht, për këto kërkesa ankimore u caktuan relatorë anëtarët Ledio Braho, Koli Bele dhe Ilirjan Rusmali. Në seancat e datës 11.05.2021, të cilat ishin seanca të verifikimit paraprak, KAS-i vendosi:

1. pranimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 33, datë 7.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;
2. pranimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 41, datë 9.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor, Partia Demokratike & Aleanca për Ndryshim dhe,
3. pranimin për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 52 datë 10.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor, kandidat i paraqitur nga një grup zgjedhësish, zoti Kreshnik Merxhani. Po në datë 11.05.2021, në zbatim të nenit 132 të Kodit Zgjedhor, KAS-i vendosi shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 33, 41 dhe 52, duke qenë se janë kërkesa ankimore ndaj të njëjtës vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe që kanë të bëjnë me tabelën e rezultateve për Qarkun Gjirokastrë. Atëherë, një pyetje për stafin e administratës së KQZ-së, a ka ndonjë palë tjetër të interesuar që ka depozituar kërkesë në zbatim të nenit 133 të Kodit Zgjedhor?!

**Z. Y. Merkaç:** Po, ka paraqitur kërkesë Partia Socialiste për të marrë pjesë në këtë proces të Qarkut të Gjirokastrës.

*Procesverbal i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Dakord! Faleminderit! Atëherë, palët të bëjnë prezantimin e tyre për secilën kërkesë ankimore! Sipas radhës ju lutem!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, faleminderit i nderuar zoti relator! Të nderuar anëtarë të KAS-it, për kërkesën ankimore me nr. 33, të relatuar nga ana juaj, përfaqësuesi ligjor i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Altin Kaziaj.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar relator, të nderuar anëtarë, për Partinë Demokratike & Koalicioni Aleanca për Ndryshim, përfaqësues i përhershëm dhe përfaqësues me autorizim të posaçëm, Ivi Kaso dhe Marash Logu.

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Përshëndetje i nderuar! Unë përfaqësoj veten, Kreshnik Merxhani, kandidat i pavarur. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Dhe për subjektin e interesuar Partia Socialiste?!

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Eridian Salianji!

**Z. L. Braho:** Dakord! Faleminderit! Ka nga palët apo nga anëtarët e KAS-it ndonjë kërkesë në zbatim të pikës 5 të nenit 135 të Kodit Zgjedhor në lidhje me konflikt interesi, kompetencën e KAS-it, apo tejkalim afati?!

**Përfaqësuesit e Partive politike:** Nuk kemi!

**Z. L. Braho:** Dakord! Mirë, atëherë, në këto kushte, ftojme palët ankimuese sipas radhës, të paraqesin pretendimet e tyre dhe provat ku ata bazojnë kërkesën ankimore në zbatim të nenit 134 të Kodit Zgjedhor. Për ekonomizëm kohor, po bëjmë një marrëveshje që pasi të mbarojë sipas radhës secila nga palët, pretendimet dhe

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

citimet e provave, më tej anëtarët e KAS-it do të vijojnë me pyetjet e tyre për çdo paqartësi.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit i nderuar zoti relator. Lidhur me kërkesën ankimore të relatuar nga ana juaj, Lëvizja Socialiste për Integritet, ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 347, datë 04.05.2021, shpalljen e pavlefshmërisë në zgjedhje në Bashkinë Dropull, të Qarkut Gjirokastrë dhe duke qenë se kjo pavlefshmëri ndikon në rezultatin e shpërndarjes së mandateve në Qarkun Gjirokastrë, shpalljen njëkohësisht të pavlefshme të zgjedhjeve të përgjithshme të Qarkut Gjirokastrë. Në mënyrë të përmbledhur ashtu siç thatë edhe ju, do të relatoj arsyet se përse ky komision duhet të shprehet me një vendim pro pranimit të këtyre kërkesave. Po ashtu si prova materiale të depozituara pranë jush, keni gjithçka për të pasur një objektivitet në vendimmarrjen tuaj. Unë do t'i relatoj ato në vijim. Të nderuar anëtarë të komisionit, siç e kemi parashtruar edhe në kërkesën tonë ankimore, kemi të bëjmë me shkelje të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, për sa i përket pjesës që ka të bëjë me të drejtën kushtetuese për të zgjedhur ose për tu zgjedhur. Kjo shkelje ka ardhur në bazë të një urdhri të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që mban numrin 219, datë 19.04.2021, për vendosjen në karantine 2 javore të shtetasve shqiptarë që vijnë nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut. Në thelb, këtyre shtetasve iu është mohuar e drejta kushtetuese e zgjedhësve shqiptarë me banim jashtë vendit për të ushtruar të drejtën e tyre për tu shprehur lirisht me votë për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021. Paraprakisht kjo masë e propozuar katër ditë përpara datës së zgjedhjeve, është shumë e rëndësishme të theksohet ky fakt, provoj së vendimmarrja e propozuar nga ana e komitetit teknik të ekspertëve, komiteti i cili disa ditë më përpara ka dalë me një komunikatë publike dhe kjo komunikatë publike është marrë nga pjesa e policisë së emigracionit për pjesën e kufirit ku mund të aksesonin qytetarët shqiptarë me

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverballi i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

banim në Greqi ose në Maqedoninë e Veriut, dhe që nga ajo ditë pa u bërë efektive urdhri i ministrit dhe pa hyrë në fletoren zyrtare janë marrë masa ndaluese të kundër ligjshme ndaj qytetarëve, ndërkohë që shumë qytetarë të tjerë, ju i keni edhe të listuar dhe unë do ti vë në dispozicionin tuaj, pasi të paktën në kemi informacion se 500 qytetarë kanë hyrë nga pikat e kalimit të kufirit në jug për të bishtnuar vetë karantinimin sipas urdhrimit të dhënë, dhe për më tepër kanë qenë anëtarë të komisioneve zgjedhore të ngarkuar me detyra zgjedhore për subjektin politik partia Socialiste e Shqipërisë. Kandidati ynë në Qarkun e Gjirokastrës, zoti Vangjel Tavo, ka bërë edhe një kallëzim penal, ka referuar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kallëzim penal me emra të posaçëm të shtetasve shqiptarë të cilët rezultojnë se kishin ardhur pas urdhër ndalimit të MSHMS dhe ishin përfshirë në detyra zgjedhore nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Kjo gjë është shumë e rëndë dhe tregon qartë që ndikimi ka qenë aq i madh dhe orientimi ka qenë politik dhe i qartë për të goditur subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Fakti tjetër është që ka qenë vetë Ministri i Brendshëm, i cili nëpërmjet ushtrimit të tagrave të tij jashtë ligjore, le të themi, ka ndikuar për nxjerrjen e këtij urdhri. Kjo gjë ka sjellë, le të themi, një ulje të ndjeshme të numrit të votuesve sidomos në Bashkinë Dropull, bashki e cila në të gjithë zgjedhjet paraardhëse numëronte deri në 6000 votues, ndërkohë që në zgjedhjet për kuvendin të datës 25 prill 2021, morën pjesë vetëm 2900 e pak votues. Ndërkohë, ju bëj me dije që në brendësi të materialit tonë provues keni edhe statistikat ku LSI, në zgjedhjet paraardhëse rezultoi të ketë qenë forcë e parë në këtë bashki, me 53% të totalit të votave pranë kësaj bashkie. Kjo ka bërë që qytetarët e Dropullit të mos ushtronin të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar, dhe ndikimi ka dhënë pasojat e veta drejtëpërdrejt në mandatin e parë të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në këtë bashki.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Po ashtu kemi vënë në dispozicion material të mjaftueshëm lidhur me institucione të pavarura të këtij shteti, të ngritura me ligj të cilat mbrojnë të drejtat e qytetarëve siç është avokati i popullit i cili rekomandoi me urgjencë anulimin e këtij urdhri të jashtëligjshëm. Po ashtu Presidenti i Republikës ka bërë një tjetër shkresë duke kërkuar duke kërkuar nga institucionet përgjegjëse, Këshilli i Ministrave, Ministria e Shëndetësisë, KQZ-ja; këtë shkresë ua ka dërguar edhe përfaqësive ndërkombëtare duke i vënë në lëvizje ato në mënyrë që të ushtronin presion për një paligjshmëri të ndodhur vetëm 4 ditë përpara zgjedhjeve. Kjo paligjshmëri ka sjellë pasoja shumë të rënda për subjektin tonë politik dhe ka shkaktuar humbjen e mandatit nga përfaqësuesi ynë në atë qark. Në faqen 5, po të shihni, të nderuar anëtarë të KAS-it, janë të gjitha statistikat lidhur me zgjedhjet vendore, me zgjedhjet për kuvendin nga 2012 e në vijim. Janë tregues mjaft të qartë se pse urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219 datë 19.04.2021, ka pasur si qëllim të godasë drejtpërsëdrejti subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Ky fakt reflektohet në rezultatin zgjedhor të sipërcituar shumë qartë. Në vijim të këtij arsytimi edhe vendimi i KSHZ-së është i paligjshëm sipas mendimit tonë dhe sipas dokumenteve të depozituar edhe në cilësinë e provës materiale. Kërkojmë nga ana juaj që ky vendim të priset sepse ndodhemi në kushtet e nenin 160, pika 1, të Kodit Zgjedhor. Po ashtu është fakt i njohur botërisht që jemi në një periudhë pandemie dhe jemi në kushtet e po këtij neni, për shkak se akti i nxjerrë, i ministrit përkatës, ka cënuar vetëm një pjesë të qytetarëve. Atje ku Partia Socialiste ishte më pak e sigurtë, le të themi, ose nuk kishte garanci të mjaftueshme për të marrë ato mandate që fitoi. Drejtpërsëdrejti ky ndikim ka ardhur, të themi, duke sjellë një pasojë negative tek Lëvizja Socialiste për Integrim. Për të mos u zgjatur më tej ne iu kemi vënë në dispozicion emra të qytetarëve shqiptarë të cilët kanë hyrë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar dhe nuk kanë plotësuar pyetësozin e dalë nga ministria përgjegjëse

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

për vetë karantinimin e këtyre personave. Ndërkohë që personat që njihen si mbështetës të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, që jetonin në Greqi ose në Maqedoninë e Veriut, nuk kanë mundur të hyjnë, ose edhe nëse kanë hyrë, janë vetë karantinuar dhe janë ruajtur me policë në banesat e tyre pasi kanë dhënë vendndodhjen e saj. Po ashtu, nëse më lejohet do t'ju vë në dispozicion edhe emra të tjerë dhe kërkoj nga ana juaj, në bazë të nenit 136, pika 1 dhe 2, të merrni në shqyrtim kërkesën tonë lidhur me informacione të mjaftueshme mbi persona që kanë hyrë në pikat e kalimit kufitar të jugut gjatë periudhës së ndalimit në bazë të këtij urdhri, qoftë edhe bazuar në sistemin TIMS, për shkak se e kemi pasur praktikisht të pamundur për të aksesuar sistemin rreth këtyre fakteve. Kjo do të duhet të na tregojë rreth faktit të këtyre personave kundrejt të cilëve në ngremë dyshime të arsyeshme, pasi kanë qenë nëpër komisione zgjedhore si persona të mbështetur dhe propozuar nga Partia Socialiste. Për sa më sipër, ashtu siç paraqitet në ankimin tonë, kemi venë në dispozicion 9 prova me karakter, le të themi, qartësues apo provues, që vëmë në dijeni KAS-in dhe mbështesim pretendimet tona lidhur me këto paligjshmëri, dhe lidhur me atë se pse në kërkojmë që të shpallen zgjedhjet të pavlefshme, fillimisht në Bashkinë Dropull dhe me pas në të gjithë Qarkun Gjirokastër për shkak se ndikojnë në njëra tjetrën dhe ka pasur paligjshmëri dhe nuk i është lejuar qytetarit që të shprehë vullnetin e tij nëpërmjet votës. Për sa më sipër, të nderuar anëtarë të komisionit, kërkojmë ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 347, datë 04/05/2021, shpalljen e pavlefshmërisë në zgjedhje në Bashkinë Dropull, dhe për rrjedhojë në të gjithë Qarkun Gjirokastër. Faleminderit! Në qoftë se mundem këtë provë t'ua depozitoj nëpërmjet përfaqësuesve të administratës.

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Kaziaj! Kjo e fundit është provë që nuk ka qenë e lidhur bashkë me provat e depozituar më parë?!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk ka qenë e bashkëlidhur me të parat pasi kemi mundur ta kemi disa kohë më vonë pasi i kishim depozituar kërkesën ankimore pranë këtij komisioni!

**Z. L. Braho:** Atëherë, sipas jush këto janë persona që kanë hyrë në territorin e Shqipërisë pas vendosjes së urdhrit përkatës?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ekzakt zoti Braho!

**Z. L. Braho:** Dhe me cilin janë mbështetës këta persona?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Këta persona janë mbështetës të Partisë Socialiste, janë pjesë e tyre, për shkak se nga informacionet tona janë rreth 500 persona që kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe mënyrat si janë futur ne nuk i dimë, kanë plotësuar formular apo jo, janë deklaruar apo jo në TIMS, për këtë kërkojmë hetim të thelluar nga ana e komisionit. Ata janë persona që kanë qenë mbështetës të Partisë Socialiste dhe me detyra të posaçme nëpër komisionet zgjedhore, nëpër KQV-të dhe në vendet e numërimit të votave.

**Z. L. Braho:** Dakord! Faleminderit, vazhdojmë me kërkesën tjetër ankimore, nr. 41, të depozituar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike & Aleanca për Ndryshim. Fjalën e keni ju!

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar! Së pari zoti Logu, kolegu im do të bëjë një përshkrim të fakteve dhe provave të cilat në i kemi në themel dhe



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

në thelb të kërkesës tonë ankimore dhe pastaj do të vazhdoj unë me një përmbledhje të tyre në raport me legjislacionin zgjedhor dhe veçanërisht atë penal në Republikën e Shqipërisë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar relator i seancës! Faleminderit të nderuar anëtarë të komisionit! Në datën 25 prill 2021 u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë. Morën pjesë në zgjedhje 48013 votues ose 38.9%. Në datën 26-27 Prill u krye numërimi i votave për subjektet zgjedhore dhe u konstatuan 45696 fletë votimi të rregullta dhe 2317 fletë votimi të pavlefshme, ose e thënë ndryshe rreth 4.8% e totalit të votave. Paraprakisht sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, mandatet në këtë zonë zgjedhore u ndanë si vijon: Partia Demokratike 1 mandat dhe Partia Socialiste 3 mandate. Në datën 4 Maj 2021, me vendimin nr. 347, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit në zonën zgjedhore të Qarkut Gjirokastrë. Duke qenë se jemi të bindur, bazuar në prova dhe fakte të pakundërshtueshme, se periudha parazgjedhore u shoqërua me shkelje të ligjit të cilat cënuan procesin zgjedhor në një masë të atillë që ndikoi drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve, në vijim do të parashtrojmë fakte që mbështesin pikërisht këtë pretendim. Së pari, ankimet tona janë të mbështetura në pesë shtylla kryesore të cilat, vlerësojmë se përbëjnë shkelje të rënda të legjislacionit zgjedhor, akteve nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në atë masë sa përmbushin kushtet e parashtruara në nenin 160 të Kodit Zgjedhor. Shtylla e parë ka të bëjë me blerjen e votës nëpërmjet përdorimit të personave me rekorde të tmerrshme kriminale. Partia Socialiste në Qarkun e Gjirokastrës kishte për drejtues politik ministrin e brendshëm Bledar Çuçi si kandidat për deputet në zgjedhjet e 25 prillit, i renditur i katërti në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Gjirokastrë. Ndërkohë, drejtuesi i fushatës së Partisë Socialiste në Qarkun




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Gjirokastër ishte shtetasi Arianit Arapi, ish shef i policisë i hetuar për lidhje me drogën dhe me bandën famëkeqe të Emiljano Shullazit, i cili në zgjedhjet e 25 prillit ishte gjithashtu drejtues edhe i vetë fushatës së ministrit të brendshëm Bledar Çuçi. Lidhja midis ministrit të brendshëm Bledar Çuçi dhe Arianit Arapit daton që nga viti 2017, kohë kur Çuçi kandidonte si deputet për Qarkun e Gjirokastrës dhe Arapi mbante funksionin e Drejtorit të Policisë të Qarkut Gjirokastër, duke u përfshirë drejtpërdrejtë në manipulimin e procesit zgjedhor në favor të kandidatit të Partisë Socialiste. Sipas informacioneve zyrtare të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Shtetit, ky shtetas ka përdorur në funksionin e tij dhe në bashkëpunim me Andrea Çausi, kushëri i ish-ministrit të brendshëm Sajmir Tahiri, kanë lejuar kultivimin e bimëve narkotike në fshatin Kalivaç të Tepelenës, madje edhe kanë penguar forcat policore vendore për të monitoruar këtë zonë ose për të ushtruar kontrolle sipas ligjit. Ky shtetas së bashku me persona me rekorde të rënda kriminale nga Fushë-Kruja, të lidhur me bandën e Shullazit, i cili gjithashtu, është i njohur për lidhjet e tij të forta me pushtetin si dhe mbështetjen dhe bashkëpunimin e drejtuesin e policisë së qytetit Përmet, Ermir Gerxhani, kanë lejuar kultivimin masiv të bimëve narkotikë edhe në Bashkinë Përmet. Gjatë periudhës 2016-17, këta shtetas kanë kontrolluar korridore të transportimit të narkotikëve nga Tepelena në Vlorë për llogari të bandës së Habilajve, të cilët ishin kushërinj të ish-ministrit të kohës, Sajmir Tahiri. Prokuroria e krimeve të rënda nisi asokohe një hetim për këtë çështje por më vonë u mbyll për shkak të presioneve të ushtruar nga pushteti. Një tjetër person me të kaluar kriminale i cili është përfshirë në procesin zgjedhor në Qarkun Gjirokastër, është edhe vëllai i kryetarit të Partisë Socialiste Tepelenë, Dino Selimi, i cili ka shërbyer si transportues narkotikësh nga zonat malore të Tepelenës në qytetin bregdetar të Vlorës. Sokol Feruni është një tjetër person me rekorde të tmerrshme kriminale për kultivimin e narkotikëve i cili është përfshirë drejtpërdrejt në fushatën

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

e ministrit të brendshëm Bledar Çuçi, dhe ka ndikuar drejtpërdrejtë edhe në emërimet e tjera politike që janë kryer në këtë qark. Ky shtetas në bashkëpunim me vëllain e tij dhe shtetasin Andi Shkurta, janë të njohur për lidhjet e tyre kriminale dhe të përfshirë në skemën kriminale të kultivimit të narkotikëve në zonën e Fushëbardhës, në Gjirokastrë. Për shkak të lidhjeve të mësipërme këta shtetas kanë zbatuar në bashkëpunim një skemë kriminale të blerjes së votës në funksion të maksimizimit të votave për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj. Këto fakte janë konfirmuar edhe sipas burimeve dhe informacioneve zyrtare që vinin asokohe nga shërbimi informativ i shtetit, nga shërbimi i kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Siç edhe të gjithë jeni në dijeni, asokohe kur ministër i Punëve të Brendshme ishte Sajmir Tahiri, prokurorët e Krimeve të Rënda dërguan në gjykatë një pjesë të anëtarëve të këtyre grupeve por shpëtuan Arianit Arapi dhe Ermir Grexhani, të cilët ishin drejtues të policisë, respektivisht, Gjirokastrë dhe Përmet. Në shkurt të 2021-it, Arianit Arapi pasi ishte larguar nga Policia e Shtetit për shkak të lidhjeve të tij me elementë kriminal, u emërua këshilltar i ministrit të brendshëm dhe njëkohësisht drejtues i fushatës së Partisë Socialiste, Qarku Gjirokastrë. Ndërkohë që shtetasi Fatmir Hoxha, u rikthye në Policinë e Shtetit dhe u emërua drejtues i policisë për Gjirokastrën. Të gjithë shtetasit e mësipërm, të nderuar anëtarë të komisionit, janë shtetas të përfshirë drejtpërdrejtë në skema kriminale të blerjes së votës në Qarkun Gjirokastrë. Disa të angazhuar në zonën e Tepelenës, disa të angazhuar në zonën e Përmetit dhe të tjerët në Gjirokastrë kanë bërë të mundur që qoftë nëpërmjet të hollave, të mirave të tjera materiale apo kërcënimeve, presioneve apo frikësimit të votuesve, të ndikojnë drejtpërdrejt në manipulimin e rezultatit të zgjedhjeve. Për këto fakte, gjatë periudhës mars-prill 2021, Partia Demokratike e Shqipërisë ka depozituar 50 kallëzime në SPAK dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve. Nga 50 kallëzime të depozituara në SPAK, 30 prej tyre kanë pasur të bëjnë

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

me rastet flagrante të shitblerjes së votës nga drejtues, përfaqësues apo mbështetës të Partisë Socialiste. Në Qarkun e Gjirokastrës, shitblerja e votave dhe shkelje të tjera flagrante që kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor, janë kryer si pasojë e përfshirjes në fushatë të ish zyrtarëve të policisë së shtetit, të cilët ishin më parë të skeduar për mbjelljen dhe trafikimin e lëndëve narkotike, dhe janë kthyer në detyrë pikërisht nga ministri i brendshëm Bledar Çuçi, i cili ishte edhe kandidat për deputet në këtë qark. Konkretisht rezultoi se në datën 15 prill 2021, Kujtim Monia, kunati i shoferit të Bashkisë Gjirokastrë është shkarkuar nga burgu i Tepelenës për shkelje të rënda penale, por pas përfshirjes në fushatë për Partinë Socialiste ai është emëruar sërish në burgun e Sarandës. Të tjerë persona me rekorde të tmerrshme kriminale dhe të skeduar si Ilirjan Çibini, Bilbil Markri, Oltion Bistri, Perlat Cullaj, Klodian Haruni, Edmond Targaj, Maks Hadëri dhe Ervin Hoxha janë përfshirë drejtpërdrejt në blerje të votave në Qarkun Gjirokastrë. Të nderuar anëtarë të komisionit, shitblerja e votës është një nga problematikat kryesore që u konstatua edhe në deklaratën e gjetjeve dhe rekomandimeve paraprake të misionit ndërkombëtar të vëzhguesve të OSBE/ODIHR. Konkretisht, në raport thuhet se “praktikat gjerësisht të përhapura të shitblerjes së votave vazhduan të përbënin problem. Akuzat për shitblerje votash ishin konstante gjatë fushatës duke treguar se kjo shkelje vazhdoi të përbënte një problem gjerësisht të përhapur”. Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion ka informuar se aktualisht janë më shumë se 30 çështje që po hetohen nga kjo prokurori për rastet e shitblerjes së votës. Nga ana tjetër raporti thekson se “muarëm raportime të besueshme se koordinatorët e fushatës së partive më të mëdha ishin afruar pranë një numri të konsiderueshëm zgjedhësish të komuniteteve rome dhe egjiptiane për t’u blerë votat. OJQ-të rome raportuan se kjo praktike është e zakonshme dhe shumë votues do t’i shisnin votat të shtyrë nga varfëria”. Një tjetër fenomen i evidentuar në Qarkun e Gjirokastrës, sa i përket shitblerjes së votës, është


*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverball i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

pikërisht edhe përfshirja e Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare, Leart Duraj, i cili ishte kandidat me nr. 2 në Qarkun e Gjirokastrës. Ky shtetas i cili në konflikt të pastër interesi, ka përfituar me miliona euro nga viti 2016-2021, pavarësisht, ushtrimit të funksionit të tij, i ka përdorur më vonë këto para dhe funksionin e tij për të manipuluar dhe tjetërsuar vullnetin e qytetarëve, qoftë nëpërmjet blerjes së votave drejtpërdrejt me të holla, apo duke përdorur punësimet masive në drejtorinë e postës shqiptare. Siç edhe e dimë, blerja e votës nuk ndodh vetëm nëpërmjet parave. Neni 78/1 në Kodin Zgjedhor, njeh si raste të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve edhe dhënien e përfitimeve të tjera. Për këtë në kemi depozituar prova se si Këshilli i Ministrave nëpërmjet një sërë vendimesh ka krijuar përfitime për kategori të caktuara qytetarësh, në shkelje të pastër të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe në shkelje të pastër të nenit 3 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator pranë KQZ-së. Konkretisht me vendimin nr. 1044, datë 18.12.2020, qeveria përcaktoi dhënien e një shpërblimi fund viti për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit, dhe pagesa do të përcaktohej nga fondet e detyrueshme të kujdesit shëndetësor për te Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Me vendimin nr. 1076, qeveria vendosi të ndryshojë strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit mjekësorë, duke garantuar për ta paga dhe shpërblime më të larta. Me vendimin nr. 1102, qeveria ka vendosur të akordojë fonde në vlera të ndryshme, rreth 100 milion lekë për kategori të ndryshme të popullsisë rurale nga fondi i posaçëm për bujqësinë. Të gjitha këto provojnë, të nderuar anëtarë të KAS-it, se fondet shtetërore janë përdorur për të manipuluar dhe tjetërsuar vullnetin e qytetarëve. E theksoj këtë sepse edhe në deklaratën paraprake të bërë nga Shefja e Misionit të OSBE/ODIHR, u theksua se më e rëndë se shitblerja e votës ishte fakti se shteti dhe partia u shkrinë në një të vetme, duke i vënë të gjitha asetet dhe burimet shtetërore në përdorim të fushatës elektorale të Partisë Socialiste. Konkretisht për rastet kur shteti u vendos në shërbim

*Zbardhi materialin audio  
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

të partisë, duke përdorur në mënyrë të paligjshme burime shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve, në kemi depozituar 12 prova për Qarkun e Gjirokastrës. Shteti vendosi investime publike në funksion të partisë socialiste për zgjedhjet. Kjo ishte një shkelje e raportuar, denoncuar e kallëzuar nga Partia Demokratike në të paktën 781 raste në të gjithë Shqipërinë. Kryeministri Rama, ministrat, deputetët dhe kryetarët e bashkive, të gjithë këta kryetarë të bashkive të Partisë Socialiste përdorën investime publike për propagandë politike në kundërshtim të qartë me Kodin Zgjedhor dhe akte të tjera normative të nxjerra nga KQZ-ja, përkatësisht, neni 91 i Kodit Zgjedhor, dhe neni 3 i vendimin nr. 9 të vitit 2020. Në të paktën 24 raste, të denoncuar dhe të faktuara, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, deputetët e Partisë Socialiste, Mirela Kumbaro, Bledar Çuçi, Artemis Malo, Kostaq Garo dhe Kiara Dhamo, promovuan investime publike me qëllime të pastra elektorale, këto të realizuara në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve. Përdorimi i burimeve shtetërore për fushatë, të nderuar, u evidentua qartësisht edhe në raportin paraprak të OSBE/ODIHR. Konkretisht misioni shprehet se pavarësisht një kuadri ligjor solid që ndalon shpërdorimin e burimeve administrative, dhe që minimizon avantazhe të partisë në pushtet, ministrat vazhduan të bënin fushatë gjatë angazhimeve zyrtare. Publiciteti, që erdhi si rrjedhojë e kësaj, i dha partisë qeverisëse një avantazh të konsiderueshëm. Ministrat vazhduan me angazhimet e tyre zyrtare gjatë gjithë fushatës. Ata u shfaqen rregullisht në vizita inspektimesh të objekteve kyçe, si në qendrat e vaksinimit me maska në fytyrë, ose me bluza që lexonin "voto nr. 12", numër që përkonte me Partinë Socialiste.


Së dyti, i nderuar, është fenomeni i frikësimit të administratës shtetërore për të mbështetur Partinë Socialiste, edhe ky, një ndalim i pastër i Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Gjatë fushatës elektorale u konstatuan raste të shumta, të cilat janë denoncuar vazhdimisht në organet përkatëse, qoftë në Prokurori, por edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se në të gjitha nivelet e administratës qendrore dhe vendore ishin përfshirë në fushatë duke mbështetur publikisht kandidatët e Partisë Socialiste. Përkatësisht, drejtoritë vendore arsimore drejtoritë vendore të bujqësisë, spitalet rajonale, shkollat e mesme, agjencitë vendore të kadastrës, administratat e policisë dhe burgjeve, gjendja civile, u kthyen gjatë fushatës zgjedhore në shtabe elektorale të Partisë Socialiste. Nëpunësit civilë u vendosën në presion të vazhdueshëm për të mbështetur kandidatët socialistë, në të kundërt do të shkarkoheshin nga detyra. Konkretisht, nëpunësve civilë iu kërkua pjesëmarrje e detyruar në takime elektorale, dorëzimi i listës me votuesit me rreth 30 deri në 50 familjarë, apo miqtë e tyre, dhënia e kartave të identitetit apo e të dhënave të tjera personale, pëlqimi dhe shpërndarja e postimeve në rrjetet sociale të përfaqësuesve të Partisë Socialiste, përfshirja me fushatën derë më derë, dhënia e përfitimeve të ndryshme për simpatizantët e Partisë Socialiste. Nëpunës të niveleve të ulëta dhe të mesme të administratës në Gjirokastrë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë dhe Dropull kanë denoncuar presionin e vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të paraqitur lista me 30 deri në 50 votues për Partinë Socialiste, ose përndryshe do të përballeshin me masa disiplinore. Presioni ndaj nëpunësve publikë dhe detyrimi i tyre për t'u angazhuar në fushatë, u evidentua edhe në raportin paraprak të nxjerrë nga OSBE/ODIHR-i. Konkretisht, misioni shprehet se ofrimi i stimujve dhe presioni i pretenduar ndaj nëpunësve civilë, përbëjnë një problem të rëndësishëm. Së treti, të nderuar, dhe shumë e rëndësishme, janë punësimet masive në administratën publike dhe përdorimi i financave publike për të favorizuar kategori të caktuara, si shkelje e rëndë e ligjit për përfitim politik, me qëllim manipulimin apo tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve. Konkretisht, qeveria

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

nxori nga viti 2017 e në vijim, qeveria ka nxjerrë rreth 28 vendime, duke shtuar numrin e punësimeve në strukturat e qeverisjes qendrore, me 16 mijë e 645 pozicione të reja, me kontrata të përkohshme pune. Përveç kësaj, punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore, saktësisht në kohën para moratoriumit ndaj autorizimit të punësimeve të reja në administratën publike. Sipas INSTAT, midis 3-mujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, punësimi në sektorin publik është rritur me 6%, ose me 10 mijë e 572 persona. Më 24 dhjetor qeveria autorizoi dhe 2 mijë e 472 pozicione të reja, duke e çuar numrin e të punësuarve në vetëm 5 muaj, me rreth 13 mijë punonjës të rinj në administratën publike. Kjo në fakt shpjegohet edhe me rritjen që ndodhi me të dhënat e Thesarit të Shtetit, referuar Ministrisë së Financave, për periudhën janar/prill 2021 janë paguar rreth 63 milionë euro më shumë paga për punonjës me kontrata të përkohshme në administratën publike dhe shoqëritë tregtare, ku pronar 100% është shteti. Por jo vetëm, me qëllim ndikimi në shtresat vulnerabël, bazuar në të dhëna zyrtare të Ministrisë së Financave, rezulton se qeveria ka paguar për ndihmën ekonomike për familjet në nevojë, rreth 3 miliardë lekë, ose 2.5 milionë euro më shumë për periudhën janar/prill 2021, se sa kishte paguar për të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Po në të njëjtën periudhë, nga të dhënat zyrtare të marra pranë Ministrisë së Financave qeveria ka shpërndarë për 6 mijë e 182 persona, paga lufte me një vlerë rreth 2 miliardë lekë. Së katërti, dhe po ashtu shumë e rëndësishme, ishte dhënia masive e lejeve të legalizimit gjatë fushatës elektorale. Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste u shfaqën duke shpërndarë leje legalizimi në aktivitete publike në kundërshtim të qartë me përcaktimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Në të paktën 9 raste, të cilat janë konstatuar dhe denoncuar nga Partia Demokratike, kandidatë për deputetë të Partisë Socialiste, shpërndanë leje legalizimi në periudhën e ndaluar

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
DI.12.05.2021*

nga Kodi Zgjedhor. Në 20 prill u publikua një audio-përgjim, i drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës, Artan Lame, gjatë një takimi me vartësit e tij, ku ky i fundit u kërkon që mos të procedohet më tej, me rreth 100 mijë kërkesa për leje legalizimi të banesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre. Kjo, thotë zoti Lame, pasi refuzimi i dhënies së lejeve të legalizimit do të sillte që këta persona të votonin për opozitën. Në të kundërt, drejtori Lame kërkon që të përshpejtohet procedura për rreth 60 mijë kërkesa për leje legalizimi, të cilat kanë mundësi të mëdha për t'u miratuar, në mënyrë që kjo të përkthehet më pas në mbështetje për Partinë Socialiste. Lëshimi i lejeve të legalizimit për qëllime politike, në favor të Partisë Socialiste u konstatua edhe në raportin paraprak të OSBE/ODIHR-it, përkatësisht në faqen 13 të tij. Më tutje të nderuar, përdorimi i paligjshëm, vjedhja dhe përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale, ishte një shkelje që ndikoi drejtpërdrejt procesin zgjedhor të 25 prillit. Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910 mijë zgjedhësve, që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale, si numri i ID-së, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike, e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e vitit 2021. Ky *database* sipas medias, ishte i instaluar në të gjitha zyrat elektorale të Partisë Socialiste dhe lehtësisht i aksesueshëm për gjithë personelin e shtabeve elektorale të PS-së. Në media më pas, u konfirmua fakti se *database* të tilla, ekzistonin në të gjitha qarqet e Shqipërisë, pra për rrjedhojë edhe në Qarkun e Gjirokastrës. Sipas medias, të dhënat e Partisë Socialiste janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-Albania, për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucionet e tjera shtetërore, për të marrë shërbime nga administrata. Shteti vendosi në dispozicion të partisë, të dhënat e qytetarëve dhe më pas këto të dhëna iu shpërndanë çdo shtabi elektoral, çdo kriminel i të angazhuar në fushatën e Partisë

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Socialiste, për të shantazhuar, intimiduar, kërcënuar qytetarët, pasi ata, shtabi i Partisë Socialiste dinin gjithçka për ta, duke filluar nga të dhënat personale deri tek të dhënat më sensitive. Skandali me të dhënat personale u evidentua qartazi edhe në raportin paraprak të OSBE/ODIHR-it, citoj: “Rrjedhja e të dhënave personale sensitive duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve, përbën shqetësim serioz dhe i bënë zgjedhësit vulnerabël gjatë fushatës”. Përmes një rrjedhjeje informacioni në *domain*-in publik doli një *database* me informacione personale dhe detaje kontakti, për afërsisht 900 mijë qytetarë, që përmbante preferencat e tyre potenciale të votimit. Ekzistenca e kësaj *database*, u konfirmua më pas në mënyrë të pavarur edhe nga vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it. Bashkëbisedues të caktuar, por edhe qytetarë thanë se besonin se përdorimi nga Partia Socialiste i të dhënave personale do ndikonte drejtpërdrejt edhe në vullnetin që më pas këta qytetarë do shprehnin në 25 prill. Po ashtu i nderuar, siç u relatua dhe nga kolegu i Lëvizjes Socialiste për Integrim, një shkelje flagrante e kushtetutës, e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e Kodit Zgjedhor dhe të gjitha akteve të tjera nënligjore, ishte mohimi i të drejtës së emigrantëve për të votuar. Deri në datën 19 prill 2021 nuk ka pasur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm një javë para zgjedhjeve, nxori një vendim, që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo nga Maqedonia e Veriut, të karantinoheshin detyrimisht, për një periudhë 2 javore, e cila përkonte fiks me periudhën kur qytetarët duhet të paraqiteshin në qendrat e votimit për të shprehur vullnetin e tyre. Ky vendim sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it pengonte, së paku 500 mijë zgjedhës shqiptarë, që jetojnë në Greqi apo në Maqedoninë e Veriut, për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë krejtësisht diskriminuuese. Pavarësisht se nenet 24 dhe 25, të Kodit Zgjedhor kanë përcaktuar të drejtën e shtetasve shqiptarë


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

që jetojnë jashtë Shqipërisë, për të votuar aty ku ata jetojnë, administrata zgjedhore nuk bëri asgjë që të garantonte efektivisht këtë të drejtë. Sipas të dhënave të INSTAT-it në vitin 2020, numri i shtetasve shqiptarë, që jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë, është rreth 1.6 milion banorë ose 44% e totalit të popullsisë së Shqipërisë. Pra, rreth mbi 500 mijë emigrantë, me të drejtë zgjedhjeje, iu mohua kategorikisht e drejta për të votuar, për shkak të një vendimi të marrë në kushte krejtësisht të paligjshme, nga Komiteti Teknik i Ekspertëve. Mohimi i së drejtës për të votuar sigurisht që u evidentua edhe në raportin paraprak të OSBE/ODIHR-it, konkretisht misioni shprehet se, megjithëse në Kodin Zgjedhor parashikohet si mundësi, qytetarëve nuk iu ofrua mundësia për të votuar jashtë vendit. Megjithatë votuesit që jetojnë jashtë, mund të kthehen dhe të votojnë në qendrat përkatëse të votimit, në praktikë kjo u pengua nga masat e marra kundër Covid 19. Të ndodhur para një situatë të tillë, ku nëpërmjet një vendimi qeveritar, u shkelet e drejta kushtetuese e votës, mbi 500 mijë zgjedhësve që jetojnë në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut, pjesa dërrmuese e të cilëve ishin për të votuar në Qarkun e Gjirokastrës, Partia Demokratike i kërkoi Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të merrnin masa konkrete për të zgjidhur këtë problem, i cili fatkeqësisht nuk u zgjidh. Kjo vendimmarrje ishte tërësisht politike dhe e diktuar nga qeveria, me qëllim për të mos lejuar ushtrimin e së drejtës kushtetuese të votës nga qytetarët shqiptarë që jetojnë në Maqedoninë e Veriut dhe në Greqi. Fakt është që vetëm një javë pas zgjedhjeve, në datën 3 maj, vendimi i Komitetit Teknik, që kishte vendosur karantinimin e qytetarëve, u shfuqizua, ndërkohë që sipas të dhënave zyrtare që janë vendosur në dispozicion edhe të këtij Komisioni të nderuar, rezulton se gjatë periudhës kur u vendos marrja e masës së karantinimit, nuk ka pasur shtim rastesh, apo rrezik të shtuar nga qytetarët që jetonin në shtetin grek apo në Maqedoninë e Veriut. Një tjetër mohim kategorik i së drejtës për të votuar, ishte mohimi i të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

drejtës së qytetarëve të infektuar me Covid, sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë, rezulton se në datën 25 prill, ishin rreth 23 mijë persona të infektuar. Këtyre personave iu ndalua, iu mohua kategorikisht, e drejta për të votuar, për shkak të pamundësisë për të qenë prezent në qendrat e votimit. Po ashtu të nderuar, është shumë e rëndësishme sepse ka të bëjë edhe me aktivitetin e këtij Komisioni, sesi fakti që fletët e votimit u miratuan në një model me numra dhe pa emra, solli që të kishim numrin më të madh që kemi pasur ndonjëherë të fletëve të votimit të pavlefshme. Konkretisht në datën 31 mars 2021, Komisioneri Shtetëror miratoi fletën e votimit, e cila përmbante logon e partive, emrin e subjektit ose koalicionin zgjedhor, emrin e kryetarit të partisë dhe emrat e kandidatëve për deputetë. Ky vendim i Komisionerit, u ankimua nga Partia Socialiste, e cila kërkoi që fleta e votimit, të ishte vetëm me numra dhe pa emrat e kandidatëve. Ky vendim më pas, mendimi i Komisionerit Shtetëror u ndryshua nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe më pas u la në fuqi edhe nga ana e Kolegjit Zgjedhor. Në fakt, megjithëse në kohën e shkurtër të mbetur në dispozicion nga dita e votimit, KQZ-ja bëri një fushatë sensibilizuese, me mënyrën sesi qytetarët duhet të votonin, që fleta e votimit të ishte e vlefshme, por kjo nuk e uli numrin e votave të pavlefshme, të cilat sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së, arritën në 83 mijë e 28 vota të pavlefshme ose 5% e totalit të numrit të votuesve. Ndërkohë që nga të dhënat zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, votat e pavlefshme në Shqipëri, ishin rreth 2 deri në 3% në të gjitha zgjedhjet e zhvilluara më parë. Ky fakt u evidentua edhe në deklaratën e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake të raportit të OSBE/ODIHR-it ku thuhet: "Fushata e informimit të zgjedhësve ishte e pamjaftueshme, ajo filloi me vonesë, sidomos përsa i përket identifikimit të zgjedhësve dhe konfigurimit të ri të fletës së votimit". Kjo kontribuoi në krijimin e një konfuzioni në ditën e zgjedhjeve. Në datën 28 prill 2021, vetë Komisioneri

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Shtetëror i Zgjedhjeve bëri një deklaratë për shtyp si vijon, “Nëse fleta e votimit do ishte me emra, ndoshta do të ishte ndryshe, por vendimmarrja e KAS-it dhe Kolegjit vlerësoi që informacioni mund të ishte më i thjeshtë për votuesit”. Kemi 83 mijë fletë votimi të pavlefshme, të cilat nëse do përktheheshin në mandate, sipas herësit mesatar që është në Shqipëri, do të ishin rreth 5 deri në 8 mandate. Nga ana tjetër një nga problematikat kryesore të konstatuara...

**Z. L. Braho:** Zoti Logu një moment, më falni për ndërprerjen por për të bërë një sqarim, do e vazhdoni prapë fjalën tuaj. Duke qenë se dje, në seancën e verifikimit paraprak, është lënë që në orën 10:30 të gjykoheshin kërkesat ankimore nr.34 dhe 35, që i përkasin kërkesave ankimore të Lëvizjes Socialiste për Integrim për Qarkun Berat dhe 42 që është kërkesë ankimore e Partisë Demokratike, po për Qarkun Berat, dhe ne ishim të detyruar që të linim një seancë për efekt të nenit 131, të Kodit Zgjedhor, tashmë po deklarojmë që seanca do të shtyhet. Kjo seancë dhe gjithë seancat e tjera vijuese, që vijnë nga ora 11:30 dhe më tej, deri sa të mbarojë shqyrtimi i kësaj seance që është për qarkun Gjirokastrë, ose në momentin që kjo seancë do të pezullohet për një arsye apo për një tjetër, atëherë mund të vijojmë me seancat e tjera. Kështu që ky është një informacion për publikun dhe për palët që pothuajse të gjitha janë këtu. Pra, nuk është se do të zhvillohen tani, por do zhvillohen në një moment tjetër. Faleminderit, mund të vazhdoni zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues! Së fundmi, një nga rastet flagrante që u konstatua si shkelje, ishte dhe votimi më shumë se një herë në qarqet dhe në zona të caktuara, e konkretisht edhe në Qarkun e Gjirokastrës. Një nga risitë që solli në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 prillit ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve, i cili nënkupton identifikimin e zgjedhësit

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi në pajisje dhe përqsja e tyre me bazën elektronike të të dhënave, si dhe regjistrimi në pajisje e shenjave daktiloskopike. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor, u kërkua me forcë nga Partia Demokratike dhe ishte pjesë e konsensusit të arritur nga palët politike, në korrik të 2020-ës. Identifikimi elektronik synonte të eliminonte votimin më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo në qendra të tjera, të eliminonte votimin për të tretët apo votimin familjar. Megjithatë, siç u konstatua edhe në raportin e OSBE/ODIHR-it, për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion, mosrealizimet, auditime të pavarura dhe konsultimet me publikun, pati probleme me vënien në punë të këtyre pajisjeve të operatorëve të kualifikuar, përdorimin, ndërprerjen e energjisë etj. Por gjithsesi, ajo që mbetet problematike është fakti se, nga informacionet e marra nga strukturat e Partisë Demokratike, rezulton se fenomeni i votimit të dyfishtë, votimi për të tretët, apo familjarët, si dhe falsifikimi i identitetit të zgjedhësve, vazhdoi të ishte një problem. Kjo ishte arsyeja edhe pse ne në fakt, një ndër provat që kemi kërkuar të merret, është ajo që u bë publike në datën 6 maj 2021, nga ana e Komisionerit dhe Zëvendëskomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, që aktualisht pas kthimit të pajisjeve të identifikimit elektronik nga qendrat e votimit, është duke u kryer kryqëzimi i të dhënave për të verifikuar raste ku zgjedhës të caktuar kanë votuar në qendra votimi të ndryshme, apo brenda së njëjtës qendër, më shumë se një herë, për familjarët apo për persona të tretë. Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndoshta ishte një përsiatje e gjatë, e të gjitha shkeljeve që kanë ndodhur gjatë kësaj fushate zgjedhore, veçanërisht në Qarkun e Gjirokastrës, por sigurisht dhe shumë të tjera ka në qarqe të tjera, për të cilat do të kemi mundësi të diskutojmë. Por ajo që mund të jetë konkluzioni i të gjitha shkeljeve të ndodhura dhe që është më e rënda që ka ndodhur në këto zgjedhje, është fakti se një shtet u vu në shërbim, në dispozicion të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

një partie, shteti dhe Partia Socialiste u shkrinë në një. Të gjitha rregullat, i gjithë legjislacioni zgjedhor, ka për qëllim që të mbrojë barazinë e palëve në zgjedhje. Nuk ka parti politike as në Shqipëri dhe as kudo tjetër, që mund t'i vihet përballë një shteti dhe të garantohen zgjedhje të lira, të ndershme dhe të barabarta.

**Z. I. Kaso:** Në përmbledhje dhe në konkluzion, për sa parashtroam më sipër, lidhur me faktet, vlerësojmë që manipulimi i vullnetit të zgjedhësve nëpërmjet premtimit, ofrimit dhe dhënies së përfitimeve monetare, apo materiale, si dhe kërcënimi i votuesve, kanë qenë problematika të theksuara, të cilat kanë shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme, proceset zgjedhore në Shqipëri, veçanërisht në 10 vitet e fundit dhe kjo është evidentuar dhe nga raportet ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve, veçanërisht ato të ODIHR-it, por pavarësisht se këto problematika vijnë të përsëritura dhe ka rekomandime për të marrë masa të duhura ligjore dhe institucionale, për luftimin e këtyre fenomeneve. Në këtë proces zgjedhor i kemi parë të shpalosura dhe më të theksuara se në gjithë proceset zgjedhore të mëparshme. Sigurisht për luftimin me efikasitet të këtyre fenomeneve, legjislatori shqiptar, veçanërisht në reformën e fundit zgjedhore, i asistuar dhe nga ekspertiza ndërkombëtare e partnerëve, ka miratuar ndryshimet përkatëse në Kodin Zgjedhor, në Kodin Penal dhe në akte të shumta nënligjore, të cilat kanë synuar pikërisht adresimin e këtyre problematikave, veçanërisht duke përforcuar ato ndalime, të cilat u janë imponuar subjekteve zgjedhore, për të ofruar ose për të dhënë të holla, të mira materiale, premtime vendesh pune apo favorizime të tjera, me qëllim për të votuar në mënyrë të caktuar, apo për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme, në mbështetje të një kandidati të caktuar, ashtu sikurse janë bërë dhe rregullimet përkatëse në kodet, si në Kodin Penal ashtu dhe në Kodin e Procedurës Penale, duke përcaktuar në radhë të parë shit-blerjen e votave, korrupsionin aktiv dhe pasiv

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

në zgjedhje si një krim, i cili bie nën ombrellën e veprimtarisë së Prokurorisë së Posaçme, të SPAK-ut, por duke rritur nga ana tjetër dhe masat përkatëse të dënimeve penale për këto fenomene. Për fat të keq, vërejmë që këto ndryshime ligjore, të dakordësuara dhe të përshëndetura nga partnerët, nuk kanë dhënë atë masën e duhur të impaktit, për të parandaluar në mënyrë serioze, fenomene, të cilat në zgjedhje të kaluara, i kemi parë që të jenë sporadike dhe në këtë proces zgjedhor për fat të keq, janë kthyer për shkak të masivitetit të tyre, në një skemë të dukshme dhe të mirëstrukturuar, e cila ka ndikuar në mënyrë të ndjeshme, rezultatin zgjedhor, jo vetëm në Qarkun e Gjirokastrës, por edhe në qarqe të tjera, të cilat kanë qenë objekt i ankimit tonë zgjedhor. Konkretisht vërejmë, ndërtimin e një skeme kriminale, të shtrirë në mënyrë kapilare, në gjithë Qarkun e Gjirokastrës për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde të tmerrshme kriminale, çka përbën një shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke e cënuar rëndë këtë proces zgjedhor dhe për rrjedhojë, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndarjen e mandateve. Sigurisht që numri i votave të blera, është shumë i lartë, duke patur parasysh dhe numrin e lartë të personave dhe pozitave të tyre të fuqishme që gëzojnë, si dhe përmasat e vetë skemës kriminale të ngritur, por fakti që në raste të caktuara votohet, verifikohet dhe provohet katërcipërisht, jo vetëm nga faktet dhe provat që ne sjellim, por janë ato që vetë organi i akuzës ka në disponibilitetin e vet, shit-blerja e votës qoftë kjo e provuar në raste sporadike vërtetohet se cenimi i procesit zgjedhor ka ndodhur, cenimi ka qenë i rëndë dhe ka patur minimalisht pasoja në ndarjen e mandateve dhe në favor kjo të partisë në pushtet, që gëzon të gjitha pushtetet. Parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje është cënuar rëndë pasi shteti dhe partia në pushtet u shkrinë në një. Pra, u shkri ajo vija delimituese ndarëse, që veçanërisht raportet e ODIHR-it e kanë patur në vëmendje të theksuar në rekomandimet e proceve të fundit zgjedhore, si një vijë e qartë demarkacioni

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

midis resurseve dhe burimeve të shtetit, të cilat kurrsesi nuk duhet të viheshin në dispozicion të partisë në pushtet në një garë elektorale dhe për fat të keq, kjo është ajo që ka ndodhur në këtë proces zgjedhor. Zyrat elektorale të partisë në pushtet u kthyen në institucione shtetërore, ku qytetarët duhet të paraqiteshin, qoftë për t'u punësuar, qoftë për të marrë leje legalizimi, qoftë për të marrë dëmshpërblimin nga tërmeti, çelësat apo dokumentacionin për të ndërtuar një shtëpi, ose për ta legalizuar atë. Pra, shteti dhe partia në pushtet në koordinim dhe në bashkëpunim me njëra-tjetrën i vendosën të gjithë mekanizmat shtetërorë në funksion të manipulimit të vullnetit të zgjedhësve, projektet dhe investimet publike, shtëpi të ndërtuara apo të rindërtuara pas tërmetit, punonjësit e administratës, punësimet e reja në administratë, lejet e legalizimit, certifikatat e pronësisë. Shihet qartë që u vu në dispozicion të plotë të partisë shtet, të kryeministrit, të ministrave dhe deputetëve, me qëllim për të marrë me çdo kusht një rezultat zgjedhor, i cili nuk u takonte. Partia në pushtet nëpërmjet drejtuesve të saj, përfaqësuesve, strukturave, shtabeve qendrore, zyrave elektorale, kanë patur në dispozicion informacionin e marrë nga *server*-at shtetërorë të të dhënave personale të qytetarëve, me qëllim përdorimin e tyre për t'i bërë qytetarët më vulnerabël dhe eventualisht për të kontrolluar vullnetin e tyre gjatë fushatës zgjedhore dhe në ditën e votimit. Ky është një krim i shumëfishtë, me shumë përmasa. Një prej më të rëndësishmëve të tyre është përmasa ndërkombëtare dhe përbën një rast flagrant të asaj çka ndodh, kur shteti i vë në dispozicion partisë në pushtet infrastrukturën e vet, e cila është dizenuar dhe konceptuar për qëllime krejt të ndryshme, pra për qëllime për t'u ofruar qytetarëve shërbime dhe në këtë rast është keqpërdorur për t'u bërë pjesë e një infrastrukture zgjedhore e partisë në pushtet me qëllim për të ndryshuar dhe për të alteruar rezultatin e zgjedhjeve. Të dhënat, të cilat janë bërë publike për të dhënat personale që disponoheshin për mbi 910 mijë qytetarë dhe zgjedhës të

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

zonës zgjedhore të Tiranës, kanë qenë shumë më tepër se kaq, pra kanë qenë të shtrira në gjithë Shqipërinë dhe në dispozicion të shtabeve elektorale të partisë në pushtet kanë qenë, në rastin konkret, edhe të Qarkut Gjirokastrës, kanë qenë të dhënat për gjithë zgjedhësit e këtij qarku. Të dhëna, të cilat në masën e tyre kanë qenë shumë më të plota dhe më të gjera se ato që janë bërë publikë dhe në media, duke disponuar për fat të keq shtabet elektorale të partisë në pushtet dhe të dhëna sensitive, si ato që kanë të bëjnë me gjendjen në llogarinë bankare të zgjedhësve, si ato që kanë të bëjnë me aplikimin e tyre për kredi të mundshme ose aplikime për problematika të tjera në zyrat e shtetit, çka janë përdorur për të gjetur për secilin zgjedhës dhe shtetas ato pika vulnerabël, në të cilat presioni i pushtetit mund të ushtrohej lehtësisht, me qëllim për të ndryshuar rezultatin zgjedhor. Një aspekt tjetër që u prek dhe që është i rëndësishëm, që u prek dhe nga kolegët e Lëvizjes Socialiste për Integrim ka të bëjë me pengesën që iu bë shtetasve shqiptarë, me rezidencë jashtë Shqipërisë, që të votojnë në vendbanimin e tyre, në mënyrë të shpejtë, efektive dhe pa pengesa. Veçanërisht atyre shtetasve, të cilët jetojnë në vendet fqinje, si Greqia dhe Maqedonia e Veriut, pjesës më të madhe të të cilëve u është mohuar tërësisht kjo e drejtë, pasi siç u tha dhe u shtjellua gjerësisht, masat që u morën për të penguar ardhjen e tyre për të votuar, ishin drastike, ishin pa asnjë paralajmërim, ishin të pajustificuara, ndodhën në një moment shumë afër datës së zgjedhjeve, çka i ka penguar këta zgjedhës që të merrnin masa të ndryshme ose të organizoheshin në mënyrë të ndryshme, për të ushtruar të drejtën e tyre kushtetuese të votës dhe nga faktet dhe provat që u paraqitën dhe nga kolegu i Lëvizjes Socialiste për Integrim, ka qenë masa që ka patur një efekt dhe një impakt të dukshëm, veçanërisht në këtë zonë zgjedhore, pra në Qarkun e Gjirokastrës, në bashki të caktuara, të cilat racionalisht kanë patur një numër të lartë votuesish, të cilëve në këtë proces zgjedhor iu pamundësua ardhja dhe shprehja e vullnetit të


*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

tyre me votë. Aspekte të tjera që u prekën, që kanë patur impakt në këtë proces ka qenë dhe konfuzioni që iu shkaktua zgjedhësve nga miratimi me vendim të Kolegjit Zgjedhor i një flete votimi në kundërshtim me kriteret në këndvështrimin tonë, të përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe nga Kodi i Praktikës së Mirë në çështjet zgjedhore, i cili ka pasë sjellë në këndvështrimin tonë, ka qenë arsyeja kryesore që ka pasë sjellë një numër tejet të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme, të cilat në qoftë se do të ishin përkthyer në mandate, do të rezultonin në një numër të lartë mandatësh, nga 5 deri në 8 mandate në gjithë Shqipërinë, ç'ka nuk e lë pa impakt dhe procesin në zonën zgjedhore të Qarkut Gjirokastrë, i cili është dhe objekt i ankimit. Vlerësojmë se në tërësinë e tyre këto shkelje flagrante të ligjit, shit-blerja e votës, përdorimi i personave me precedentë kriminalë, përdorimi i paligjshëm i administratës, vjedhja dhe përdorimi kriminal i të dhënave personale të shtetasve nga partia në pushtet, përdorimi i paligjshëm, masiv dhe sistematik i parave të buxhetit të shtetit për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve, si dhe përdorimi i lejeve të legalizimit për vota, cenuan rëndë procesin zgjedhor duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve në zona...

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.05.2021*

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Zonës Zgjedhore të Qarkut të Gjirokastrës dhe vlerësojmë se këto shkelje dhe pasojat e tyre përmbushin kriteret e kërkuara nga neni 160 dhe 161, i Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe më pas rrjedhimisht urdhërimin për përsëritjen e tyre në zonën zgjedhore të Qarkut të Gjirokastrës. Për sa më sipër kërkojmë pranimin e ankimit të paraqitur përpara jush sipas objektit, faleminderit. Për sa u përket provave në qoftë se i kemi elenuar në mënyrë shteruese në kërkesën tonë, prova të cilat i kemi bashkëlidhur kërkesës ankimore por dhe prova të cilat për shkak se ndodhin jashtë disponibilitetit tonë, kërkojmë që të merren në mënyrë zyrtare nga ana e KAS-it, pasi vlerësojmë se janë prova vendimtare jo vetëm në mbështetje të pretendimeve tona të asaj çfarë kemi riprodhuar në këtë kërkesë ankimore dhe kemi sjellë në vëmendjen tuaj. Veçanërisht mendoj se janë prova të domosdoshme dhe themelore për tu administruar nga ana e KAS pa administrimin e të cilave zgjidhja e drejtë e kësaj mosmarrëveshje zgjedhore do të ishte e pamundur. Ky është një koment i përgjithshëm më pas nëse ka pyetje mund të ndalemi te secila kërkesë, faleminderit.

**Z. L.Braho:** Një pyetje në lidhje me provat zoti Kaso, meqenëse kam parë që pothuasje në të gjitha kërkesat ankimore të depozituara nga Partia Demokratike kërkohej prova, janë të njëjtat që janë në këtë kërkesë ankimore dhe në kërkesa ankimore të tjera, apo ka prova të ndryshme me kërkesa të ndryshme?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit për pyetjen, përgjithësisht janë të njëjta, pra kërkesat tona ankimore kanë një strukturë të ngjashme pasi kemi evidentuar një fenomologji të ngjashme shkeljesh, një tipologji të ngjashme shkeljesh të cilat janë materializuar dhe janë shpërndarë në të gjithë zonat



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

zgjedhore të cilat janë bërë objekt i ankimit tonë dhe që kanë ndryshuar në një masë të dukshme vullnetin e zgjedhësve shqiptarë dhe kanë pasur impaktin e tyre të konsiderueshëm në procesin e ndarjes së mandateve ku më shumë ku më pak. Sigurisht ne kemi sjellë dhe i kemi bashkangjitur kërkesave ankimore por duke qenë se jemi në Qarkun e Gjirokastrës flasim për këtë qark. Një pjesë të mirë të provave që ne disponojmë dhe kemi mbledhur për sa u përket shkeljeve të kësaj natyre që ne kemi përshkruar në kërkesën tonë ankimore në këtë qark. Por, një pjesë të mirë të asaj çfarë ne nuk e disponojmë në mënyrë zyrtare por e kemi nëpërmjet burimeve të hapura ose nëpërmjet denoncimeve ose nëpërmjet mënyrave të tjera të cilat kemi mundur ta sigurojmë në mënyrë operative, kërkojmë që në mënyrë zyrtare të merren nga ana e KAS. Në mënyrë të përmbledhur për t'u përgjigjur pyetjes suaj, përgjithësisht tipologjia e provave që kërkohen ka një bazë të njëjtë në të gjitha qarqet duke bërë dhe ndarjen e tyre pastaj sipas impaktit që ato kanë krijuar në secilën qark kërkohen prova të tjera shtesë ose jo, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Viojmë me Kërkesën Ankimore nr.52, e depozituar nga subjekti zgjedhor kandidat i pavarur zoti Kreshnik Merxhani. Fjala për ju.

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Faleminderit, kërkesa është për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore në Qarkun e Gjirokastrës. Gjithashtu kundërshton vendimin e KZAZ-së dhe KSHZ-së në lidhje me miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë për subjekte zgjedhore dhe kandidat për deputet në zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë në datën 25 Prill 2021. Ne këtë kundërshtim e bazojmë në nenin 123/1, 124, 124/1 dhe 126, gjithashtu nenin 160, pika 2 dhe 3, nenin 161/1 pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar. Para se të nis



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

me prezantimin e të gjithë ankesës, unë doja të bëja disa pyetje në lidhje me kohën tuaj pasi unë e kam dorëzuar gati një ditë para ankesën time bashkëngjitur edhe materialet. A ka pasur kohë komisioni t'i shikojë këto materiale? E para i kam dorëzuar pothuajse në orën 11 të natës në datën 10. E dyta ka të bëjë me një denoncim publik që personalisht e kam kryer në datën 26 Prill 2021 ku në KZAZ nr. 79, në Qarkun Gjirkastër shifet një numërues i akredituar nga KQZ në prani të numëruesve dhe komisionerëve tjerë gjithashtu të akredituar nga KQZ, i cili në një lirshmëri të plotë dhe i shpenguar dhe i papenguar nga askush duke përdorur një stilolaps fillon dhe falsifikon vullnetin e zgjedhësve. Doja të pyesja çfarë mase administrative është marrë në këtë rast? A është raportuar në prokurori dhe a ka vepruar prokuroria dhe SPAK-u eksoficio? Pra këto janë pyetjet e para pasi ne gjykojmë që ajo që ka ndodhur aty e ka shkatërruar totalisht këtë proces zgjedhor në të gjithë qarkun Gjirokastrë dhe kjo është një nga pikat pse ne kërkojmë shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore të Qarkut Gjirokastrë. A mund të kem një përgjigje për këtë?

**Z. L. Braho:** Zoti Merxhani faleminderit për pyetjet, por në fakt në Komision të Ankimimeve dhe Sanksioneve ju ngrini pretendime dhe jo pyetje ndaj komisionit për t'u qartësuar, për kortezi në lidhje me pyetjen që bëni, në qoftë se ne kemi përvetësuar materialin e depozituar nga ana juaj, për këtë mos kini as dyshimin më të vogël. Idea është që nga seanca e djeshme seancë e verifikimit paraprak në seancën e sotme, po t'i referoheni Kodit Zgjedhor neneve 126, 129 dhe 130 ajo procedurë që është zhvilluar ditën e djeshme dhe që është lënë seanca e shqyrtimit gjyqësor ditën e sotme është një procedurë që merret me aspektet formale dhe aspektet të verifikimit ligjor të kërkesës suaj, pra nuk kemi gjykuar përmbajtjen. Ne kemi gjykuar që kërkesa juaj plotëson formën, plotëson dhe kriteret e tjera



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

në lidhje me kompetencën dhe afatin dhe ka kaluar për shqyrtim ditën e sotme së bashku me kërkesa të tjera. Normalisht në kushte që mund të ishte kërkesa e juaj e vetme kërkesë për Qarkun e Gjirokastrës patjetër që nuk do të ishte në seancën e sotme, sepse ka qenë një nga kërkesat e fundit të depozituar. Por fakti që kërkesa e Lëvizjes Socialiste për Integrim për Qarkun e Gjirokastrës ka qenë e para dhe bashkimi që është i detyrueshëm këtë rast nga Kodi Zgjedhor nga neni 132 ka të bëjë që seanca të zhvillohet sot në orën 09:30. Në lidhje me materialin që ne duhet të shikonim, kjo seancë e sotmja është seancë që ju ngrini pretendimet, sillni provat mund të kërkonit prova të tjera siç kërkuan dy subjekte të tjera ankimore dhe pastaj KAS mblidhet dhe merret vendim. Pra kjo është për t'u qartësuar procedurat sesi funksionon jo vetëm këtu por dhe në gjykata. Pra kjo është procedura që ndiqet, pra çdo pretendim tuajin ju jeni të hapur ta shprehni siç e shprehën kolegët tuaj dhe më tej do të vendosim dhe në lidhje me provat që keni sjellë ju dhe në lidhje me provat që ju mund të kërkonit nga palë tjera. Ndërkohë për sa i përket pretendimit tjetër që ngritët në lidhje me një video, masat administrative në lidhje me komisionerët Kodi Zgjedhor përcakton që me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vendosen nga KAS. Deri tani nuk kemi pasur ndonjë kërkesë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ndërkohë që për çështje penale për këtë besoj se në zbatim të Kodit Procedurave Penale edhe ju mund të bëni kallëzim penal edhe Prokuroria e Gjirokastrës mund të nisë kryesisht një procedim penal kështu që këto janë çështje të ligjit që nuk na takojnë ne t'i shpjegojmë. Kjo ishte thjesht kortezi për t'ju sqaruar ju sesi funksionon. Kështu që nga ky moment mund të vazhdoni me pretendimet tuaja dhe me provat, faleminderit.

*Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Faleminderit, përshkrimi i shkeljes së pretenduar shkeljet që lidhen me pengimin e vëzhguesve dhe të*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani në rastin konkret. Kryetarët e 7 KZAZ-ve kanë penguar hyrjen brenda vendeve të numërimit të votave përkatëse gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV, duke moslejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranimit dorëzimit të kutive të votimit në kundërshtim të Kodit Zgjedhor, kjo ka ndodhur te të 7-at KZAZ-të. Policia e Shtetit ka zbatuar urdhëra të paligjshëm të dhëna nga kryetarët e KZAZ-ve duke penguar hyrjen në VNV të vëzhguesve të akredituar të kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani si dhe vetë kandidatit duke mos qenë të paanshëm në kryerje të detyrave për të garantuar trajtimin e barabartë të gjitha subjekteve politike. Mua personalisht më ka ndaluar të kem akses në momentin që kutitë e votimit po vendoseshin në VNV. Prania në masë brenda VNV-së të personave të pautorizuar, e cila mund të vërtetohet qartësisht edhe nga materiali filmik i vënë në dispozicion nga KQZ, të cilat ishin mbështetës të shtabit të kandidatëve të subjekteve të tjera zgjedhore duke shkakuar paqartësi dhe amulli brenda qendrave të numërimit. Shkelje që lidhen me vota të pavlefshme, të cilat në total në Qarkun Gjirokastrë kanë qenë 2317 fletë votimi, vëzhguesit e kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani kanë konstatuar raste kur janë shpallur shumë fletë votimi të pavlefshme pa asnjë arsytim dhe kontestimet për atyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së përkatëse. Vëzhguesit e kandidatit të pavarur të mi të akredituar, kanë konstatuar raste kur janë shpallur fletë votimi të pavlefshme ose të vlefshme të cilat më pas kanë kaluar në një grupim një dëm fletësh të votimit për subjektet të tjera politike. Nga fotografitë e bëra prej vëzhguesve të akredituar kandidati Kreshnik Merxhani dhe nga pamjet filmike janë paraqitur më shumë se 30 fotografi të fletëve të votimit që kanë nga një X të dytë shtesë ose të tretë në ato fletë votimi ku është vendosur një X për kandidatin e pavarur pra në numrin 13. Janë konstatuar raste të shumta të





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

përdorimit të stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit mbi tavolinat e numërimit dhe mbi fletët e votimit duke vendosur shenja në fletët e votimit, të cilat ndikojnë te rritja e numrit të votave të pavlefshme. Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor përkatësisht grisje e materialit zgjedhor. Shkelje që lidhen me procesin e numërimit, mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit i katrorit me numrin 13, i cili ndodhet përkatësisht në fundin e fletës dhe ishte lehtësisht i mbulueshëm që i përkiste kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani pra mua. Në ekranin e tavolinave të numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit dhe kjo konstatohet gjerë edhe në materialin e vënë në dispozicion prej KQZ-së. Refuzimi i dhënies së kopjes së procesverbaleve të nënshkruara me rezultatet e numërimit të qendrave të votimit të vëzhguesve kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani dhe mosvendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-të përkatëse e shkelje të dispozitës të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Mungesa e subjektit zgjedhor me nr.13, kandidati i pavarur Kreshnik Merxhani në tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-ve dhe e kemi dokumentuar këtë dhe e kemi përfshirë në anekset tona pjesë e kësaj dosje ankimuese. Në fillim të procesit të numërimit masivisht në KZAZ-të e qarkut nuk janë treguar në kamera ana e fletëve të votimit me vulë. Nuk janë thënë me zë si dhe nuk janë paraqitur në kamera të grupeve të numërimit të tavolinave të numërimit apo ndonjë formë tjetër e shqeshme numri i votuesve të qendrave të votimit, të fletëve të votimit në kuti apo dhe numri i fletëve të pa përdorura kodet e sigurisë së kutisë e të tjerë. Shumë qytetarë të Qarkut Gjirkastër u është mohuar e drejta për të votuar, për shkak se ishin të infektuar me Covid-19 dhe organet e shtetit dhe KQZ-ja nuk ndërrmorën masa për t'ia mundësuar votimin në spitale apo në vende ku ishin të karantinuara si një e drejtë kushtetuese. Qeveria vendosi masën për karantinë dy javore, u përmend edhe nga kolegët këtu dy javore për qytetarët që ktheheshin nga Greqia dhe



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Maqedonia e Veriut duke ndikuar negativisht drejtpërdrejt tek e drejta e votës e këtyre qytetarëve. Presioni ndaj qytetarëve përmes vjedhjes së të dhënave personale në një database që përmban afërsisht 900 mijë qytetarë shqiptarë duke cenuar parimet e përgjithshme të zgjedhjeve si dhe duke përbërë një vepër penale që ndikon në procesin zgjedhor. Qytetarëve të Shqipërisë që jetojnë jashtë shtetit iu mohua e drejta e votës edhe pse kjo është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore e përcaktuar dhe me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor. Keqpërdorimi i punësimeve në masë në administratën publike dhe i fondeve publike me synim ndikimin në rezultatet e zgjedhjeve. Këto janë pikat ku ne bazojmë të gjithë ankimin. Faktet argumentet dispozitat ligjore ku mbështet ankimimi: Pika 1, shkeljet që lidhen me pengimin e vëzhguesve të kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani dhe të vetë kandidatit. Kryetarët e 7 KZAZ-ve kanë penguar hyrjen brenda vendeve të numërimit të votave përkatëse gjatë kohës së pranimit të kutive në VNV duke mos lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranimit dorëzimit të kutive të votimit në kundërshtim të Kodit Zgjedhor. Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve të akredituar të kandidatit të pavarur të gjithë pak a shumë kanë dëshmi të përmbledhur që ju i keni të përfshira në dosjen që kemi dorëzuar, gjithashtu dhe dëshminë time personale. Këto dëshmi të vëzhguesve janë bashkëlidhur në cilësinë e provës në ankesin 1 të kësaj ankese. Në të njëjtën kohë kjo shkelje vërtetohet dhe nga kamerat 360 gradë, ato që janë vendosur në dispozicion pasi ka dhe kamera që ne nuk kemi aksesuar, sepse i kemi marrë me të paktën 3 ditë vonesë të gjithë materialin filmik brenda ambienteve të VNV-së ku thuajse në të gjitha rastet procesi i pranimit dorëzimit të kutive të votimit ka ndodhur pa praninë e vëzhguesve. Të njëjtin konstatim për këto kategori shkeljesh e kanë shprehur edhe organizatat Security të dëshmuara përmes raportit të saj të datës 25 Prill 2021, në orën 23:30, ju kemi vënë në dispozicion edhe linkun se ku aksesohet



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

ky raportim. Kjo shkelje ngre pikëpyetje serioze mbi të gjithë procesin e pranim dorëzimit të kutive si dhe bie ndesh me Kodin Zgjedhor neni 7. Shkelja rëndohet edhe më shumë pasi në asnjë moment grupet e numërimit nuk bënë publike kodet e sigurisë së kutive të votimit që hapeshin në vendet e numërimit të votave duke vendosur në pikëpyetje të gjithë procesin e administrimit të fletëve të votimit brenda kutive të votimit. Ekziston dyshimi i bazuar mbi argumentat dhe provat të kësaj ankese se shkelje të tilla janë bërë me synim për të vendosur për të vendosur shenja X të tjera në grupet e numërimit të votave të fletëve të votimit me synim për t'i kaluar këto vota partive të tjera ose për t'i shpallur ato të pavlefshme. Pika 1,2, Policia e Shtetit ka zbatuar urdhëra të paligjshëm të dhëna nga kryetarët e KZAZ-ve duke penguar hyrjen në VNV të vëzhguesve të akredituar të kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani dhe në disa raste edhe na e kanë mohuar akreditimin në mënyrë të pajustificuar si dhe të vetë kandidatit në fjalë pra mua personalisht duke mos qenë të paanshëm në kryerjen e detyrave për të garantuar trajtim të barabartë të të gjithë subjekteve politike. Kjo shkelje bie ndesh me Kodin Zgjedhor si në vijim pra nenin 121, paragrafi 1, si dhe neni 3 paragrafi 7. Ekziston dyshimi i bazuar mbi argumentet dhe provat e kësaj ankese se shkelje të tilla janë bërë me synim që vëzhguesit e kandidatit Kreshnik Merxhanit të pengohen për të kryer evidentimin e shkeljeve që lidhen me vendosjen e shenjave X të tjera nga grupet e numërimit të votave në fletët e votimit me synim për t'i kaluar partive të tjera ose për t'i shpallur ato të pavlefshme. Ky dyshim bazohet edhe mbi provat e paraqitura në pikën 2.5 të kësaj ankese që lidhet me ndërhyrjet në fletët e votimit gjatë procesit të numërimit si dhe me të gjitha shkeljet evidentuara në pikën 3 të kësaj ankese si dhe të gjitha pikat 1.1, 1.5 të këtij argumenti. Pika 1.3, prania në masë brenda VNV-ve të personave të pautorizuar e njëjta shkelje konstatohet dhe në raportin e organizatës KIR të datës 26 Prill 2021, ora 22:45, ku shkruhet se nga



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

informacionet e vëzhguesve që ne kemi ka dyndje të personave të pautorizuar. Në qendrën operative kanë ardhur foto dhe video që tregojnë prezencën e personave të cilët janë paakreditimin në vend të dukshëm dhe tregon për një dyndje tejnormale brenda këtyre qendrave të numërimit. E gjithë kjo situatë e shkaktuar brenda VNV-ve në Qarkun Gjirokastrë ka ndikuar drejtpërdrejt te transparenca standartet dhe ecuria e procesit të numërimit duke shkaktuar presion mbi grupet e numërimit dhe vëzhguesit në një nivel të tillë deformues për procesin e numërimit të votave në KZAZ-të ku është zhvilluar, ku ka dhe raste të konflikteve po themi të vogla. Shkeljet e evidentuara në një pjesë të ankesës janë edhe të karakterit penal. Pika 2, shkeljet që lidhen me vota të pavlefshme të cilat në total për Qarkun Gjirokastrë kanë qenë 2317 fletë votimi, vëzhguesit e kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani kanë konstatuar raste kur janë shpallur shumë fletë të pavlefshme pa asnjë arsytim dhe konstatimet e aty për atyshme nga vëzhguesit e kandidatit të pavarur, nuk janë marrë parasysh nga grupi i numërimit dhe kryetari i KZAZ-së përkatëse. Kjo shkelje konstatohet me anë të dëshmimeve të vëzhguesve tanë të cilat janë pjesë të kësaj ankese. Është në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Rregulloreve në shumicën e rasteve, ku ngriheshin shqetësime nga vëzhguesit e kandidatit në lidhje me shkeljet e evidentuara gjatë procesit të numërimit të votave komisionerët kryetarët ose nënkryetarët e KZAZ-ve jo vetëm që nuk i merrnim parasysh këto konstatime por dhe kërcënonin vëzhguesit tanë me largim nga VNV-ja. Pika 2.2, konstatime të bëra prej vëzhguesve të akredituar të kandidatit Kreshnik Merxhani dhe nga pamjet filmike janë paraqitur më shumë se 20 fotografi të fletëve të votimit që kanë nga një X të dytë shtesë ose të tretë në ato fletë votimi ku është vendosur një X për kandidatin e pavarur Kreshnik Merxhani. Këtu më lejoni të them që ne kemi bërë një verifikim gati të një 50-ës të orëve të filmimit të vëna në dispozicion nga ana e KQZ-së edhe për shkak të kohës, problematikë të cilën unë e



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

kam ngritur dhe më parë koha është shumë e shkurtër veçanërisht për kandidatët e pavarur, të cilët nuk kanë atë infrastrukturë që e kanë partitë e vjetra për t'i konstatuar të gjitha këto materiale filmike. Në një farë mënyre ka një dispropocion në trajtimin e barazisë po themi ose kohës që i duhet Kodi Zgjedhor të mendojë për një kod të përshtatshme për këto verifikime. Këtu unë përmend të gjitha dëshmitë që ne kemi prej akt konstatimeve nga vëzhguesit tanë, të cilat janë të përfshira në këtë ankesë. Për të mos u zgjatur po kaloj tek pika 2.3, ku janë konstatuar raste të shumta të përdorimit të stilolapsit nga ana e grupit të numërimit mbi tavolinën e numërimit dhe mbi fletët e votimit duke vendosur shenja në fletët e votimit, të cilat ndikojnë te rritja e numrit të votave të pavlefshme por edhe te falsifikimi i vullnetit të zgjedhësve. Më konkretisht në datën 26.04.2021, në orën 05:49 deri në orën 05:52 dhe mandej në orën 15:41 deri në 15:42 në VNV-në dhe KZAZ-në 79 është provuar me pamje filmike të vëna në dispozicion prej KQZ-së së anëtarëve të grupit të numërimit në bashkëpunim dhe me anëtarë të KZAZ-së kanë lejuar numëruesin e tavolinës 2 të ndërhyjë në fletët e votimit duke shënuar me stilolaps në hapësirën e përzgjedhjes së votës dhe duke tjetërsuar kështu vullnetin e votuesit dhe duke konsumuar vepër penale të parashikuara në nenin 326, të Kodit Penal, falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve. Kjo është shkelje vërtetohet dhe me anë të dëshmimeve të vëzhgueseve tanë në këto KZAZ, për më tepër këto shkelje konstatohen edhe nga unë personalisht. Mbajtja e stilolapsit në dorë nga anëtarët e grupeve të numërimit në VNV-të e Qarkut Gjirkastër është lehtësisht e dallueshme në pamjet filmike të shumicës të tavolinave të numërimit duke u dhënë mundësinë anëtarëve të grupeve të numërimit që ta keqpërdorin stilolapsin sipas rastit mbi fletën e votimit. Ne i kemi dokumentuar dy me video në 1 të 50-ën e materialit të vëzhguar, por duke u nisur dhe nga indiciet që kishim prej vëzhguesve tanë. Kjo shkelje vërteton se fletët e votimit janë manipuluar gjatë



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

procesit të numërimit të votave brenda VNV-ve që për këtë lloj manipulimi ka ekzistuar një miratim në heshtje mes anëtarëve të grupeve të numërimit dhe anëtarëve të KZAZ-ve, sepse askush prej tyre nuk ka ndërmarrë një kallëzim ndaj personave që kanë ndërhyrë, madje kanë heshtur dhe kanë miratuar ose kanë ndihmuar në mënyrë direkte në këtë proces. Konsumimi i veprave të tilla penale e minon të gjithë procesin zgjedhor në Qarkun Gjirokastrë, por jo vetëm duke rrënuar çdo parim dhe standart që lidhen me procesin zgjedhor për më tepër sot e kësaj dite edhe pse rastet të tilla janë bërë publike nuk ka asnjë informacion mbi masat e marra për ata persona që kanë kryer këto vepra. Mbase ata kanë marrëe dhe shpërblimin nga institucionet e shtetit për punën e kryer gjatë procesit të numërimit. Mosveprimi rrënon reputacionin e besueshmërinë edhe të organeve kompetente që duhet të merren me ndjekjen e rasteve të tilla. I përmendëm të gjitha shtrëngesat, i përmendëm të gjitha po themi joshjet ndaj votuesve por dhe ata votues të vendosur për të mos pranuar asnjë nga këto shtrëngesa apo joshje kanë zgjedhur atë që kanë dashur në fund fare numërues dhe komisionerë ua kanë falsifikuar vullnetin e tyre në mënyrë të padrejtë edhe pse e kanë kaluar një kalvar kaq të gjatë për ta çuar deri në fund vullnetin e tyre. Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor konkretisht në datën 26.04.2021, në orën 02:50, në VNV të KZAZ-së nr.80 është konstatuar nga vetë kandidati Kreshnik Merxhani dhe është provuar me pamje filmike të vëna në dispozicion prej KQZ-së përkatësisht kjo grisje e materialit zgjedhor. Kjo shkelje evidentohet në orën 02:50 e 56 sekonda, deri në 02:51e 49 sekonda nga ku evidentohet se një anëtar i grupit të numërimit të tavolinës nr.2 përgjatë procesit të numërimit ka grisur një sasi fletësh votimi duke konsumuar vepër penale të parashikuar nga neni 326/1, dëmtim me dashje i materialeve zgjedhore kryer kjo në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të grupit të numërimit si dhe me anëtarë të KZAZ-së, të cilët nuk ndërhyjnë apo penguan



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

konsumimin e kësaj vepre dhe as e denoncuan sigurisht. Pika 3, shkeljet që lidhen me procesin e numërimit, mbulimi me gisht gjatë procesit të numërimit i katrorit me numër 13 por dhe katrorëve të tjerë që numri 13 që i përkiste kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani. Për më tepër janë të shumta rastet e vërejtura gjatë pamjeve filmike të siguruara nga KQZ-ja ku gishti i anëtarit të grupit numëruar mbulon numrin 13, pasi e kalon te kamera dhe katrorin e subjektit zgjedhor të kandidatit të pavarur Kreshnik Merxhani. Ne kemi ilustruar me disa fotografi këtë shkelje, është pjesë e ankesit 2 të kësaj anese të marra nga pamjet filmike dhe të numërimit në KZAZ nr.79, por ka edhe pamje të tjera përkatësisht në orën 23:00 dhe në orën 23:01. Vlen për t'ë nënvizuar se këto raste janë thjesht ilustruese pasi kjo shkelje ka qenë e përhapur masivisht në një pjesë të konsiderueshme tavolinave të numërimit në VNV-të e Qarkut Gjirokastër duke ndikuar kështu jo vetëm tek ulja e transparencës dhe e besueshmërisë por marr parasysh dhe vjedhjen e deformimin e votës të konstatuar në këtë ankesë më sipër. Pika 3.2, në ekranin e tavolinave të numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit dhe ne jemi të pamundur të gjykojmë mbi vullnetin e votuesve. Kjo shkelje vërtetohet me anë të disa dëshmime të vëzhguesve tanë, por dhe të pamjeve filmike si dhe fotografive të bashkëngjitura në këtë ankesë. Pika 3.3 ka të bëjë me refuzimin e dhënies së kopjeve të procesverbaleve të nënshkruara të rezultateve të numërimit në qendrat e votimit të vëzhguesve të kandidatit pavarur Kreshnik Merxhani edhe pse janë kërkuar i është refuzuar vënia në dispozicion. Madje dhe janë kërcënuar me nxjerrje jashtë qendrës së numërimit, kjo konstatohet prej dëshmime që ne kemi të përfshira në këtë ankesë dosje si dhe nga unë personalisht. Pika 3.4, mungesa e subjektit zgjedhor nr.13 kandidati i pavarur Kreshnik Merxhani në tabelën përmbledhëse të rezultateve, tabela mbaronte me nr.12 duke mos më përfshirë fare në tabelën përmbledhëse në shumë raste kjo, një rast ua kemi ilustruar këtu. Pika



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

3.5, në fillim të procesit të numërimit masivisht në KZAZ-të e Qarkut Gjirokastrë, nuk janë treguar në kamera ana e fletëve të votimit me vulat përkatëse, të cilat përcaktojnë ligjshmërinë e këtyre fletëve. Pika 3.6, nuk janë thënë me zë si dhe nuk janë paraqitur në kamera të grupeve të numërimit të tavolinave të numërimit, apo në ndonjë formë tjetër të shqeshme numri i votave të qendrës së votimit të fletëve të votimit në kuti apo edhe numri i fletëve të papërdorura kodet e sigurisë e kështu me rradhë. Pika 4, unë e përmenda pak më parë që ka të bëjë me mohimin që i është bërë të drejtës për të votuar të infektuarëve me Covid-19 nga organet e shtetit dhe nga KQZ-ja, për të cilët nuk kanë marrë asnjë masë për t'i mundësuar këtë të drejtë kushtetuese. Që të mos zgjatëm argumentin besoj se para rëndësit e shteruan argumentin për masën e karantinës dyjavore për qytetarët që ktheheshin nga Greqia dhe nga Maqedonia e Veriut, si dhe argumentin mbi konfigurimin e fletës elektronike të votimit që u përdor ditën e zgjedhjeve po themi kjo i përket rasteve të Tiranës dhe është një çështje tjetër. Presioni ndaj qytetarëve me vjedhjen e të dhënave u ezaurua edhe nga parafolësit. Gjithashtu dua të theksoj pamundësinë për qytetarët jashtë Shqipërisë, të cilët jetojnë jashtë Shqipërisë ose që gjenden jashtë Shqipërisë, të cilëve u është mohuar e drejta e votës edhe pse kjo është një e drejtë kushtetuese dhe ligjore përcaktuar edhe në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor. Në fund fare është keqpërdorimi i punësimeve në administratën publike dhe i fondeve publike me synim ndikim në rezultatin e zgjedhjeve besoj se dhe kjo pikë është e ezauruar goxha ndjeshëm në ankesën tonë por u ezaurua edhe më parë. Nga këto prova dhe ky relatim kërkoj nga ju të shpallni të pavlefshme zgjedhjet në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë, si dhe e kundërshtoj vendimin e KZAZ-së nr.347, të datës 04.05.2021 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë për subjektet zgjedhore dhe



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

kandidatë për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”,  
faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Merxhani, fjala për përfaqësuesin e subjektit  
interesuar Partia Socialiste.

**Z. E. Saliانji, përfaqësues i PS-së:** Faleminderit, për sa i përket ankimit të Lëvizja  
Socialiste për Integrim, do të përjashtoja prapësimet në lidhje me kërkimin që ka  
bërë ky subjekt. Në asnjë dispozitë e Kodit Zgjedhor nuk është parashikuar  
pavlefshmëria e zgjedhjeve në zonën zgjedhore të qarkut sikurse ankuesi e kërkon  
në pikën 2 të ankimit. Pra, vetëm ana formale po të shikohet ankimi, ky  
ankim do të dorëzohet. Nga përmbajtja e kërtimeve nuk rezulton që ankuesi të  
ketë dhënë sqarime sipas të cilave ai kërkon pavlefshmërinë e rezultatit në një apo  
disa qendra votimi, secila me specifikat e saj dhe shpallja e pavlefshmërisë së  
rezultatit në këto qendra nënkupton rrjedhimisht dhe shpalljen e pavlefshme në të  
gjithë qarkun. Në interpretim të nenit 125, pika 4 e Kodit Zgjedhor, në çdo rast për  
pavlefshmi bëhet për çdo qendër votimi dhe për shkeljet që kanë ndodhur në atë  
qendër ditën e zgjedhjeve. Po të shikohet ankimi në asnjë element të ankimit nuk  
flitet për shkeljen që mund të ketë ndodhur në një qendër apo disa qendra votimi  
dhe kjo si pasojë të sjellë pavlefshmërinë në këto qendra dhe rrjedhimisht dhe  
pavlefshmërinë e qarkut. Ankuesi pretendon se janë penguar shumë emigrantë për  
të ardhur në Shqipëri dhe mungesa e tyre në qendrat e votimit ka sjellë  
pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë bashki dhe rrjedhimisht kërkon dhe  
pavlefshmërinë e të gjithë Qarkut Gjirokastrë. Fakti që ankuesi të paktën nuk ka  
arsyetuar në lidhje të shkaqeve me pasojën e pretenduar. Të paktën një qendër  
votimi të Bashkisë Dropull ku duhet të thoshte në shtetin grek janë kaq shtetas



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

filani fisteku, të cilët duan të vinin në këtë qendër votimi por për shkak të vendimmarrjes së ekspertëve për shkak të pandemisë e kanë të pamundur, nuk përmendi asnjë emër të personave të cilët pretendonin se duhet të vinin atë ditë për të votuar. Por nga ana tjetër është marrë me emra po me emra të cilët kanë ardhur që të kërkosh pavlefshmëri të personave pamundësi për të votuar duhet të kesh të paktën numrin e personave me të cilët kanë dashur të vijnë atë ditë dhe janë penguar për shkak të vendimmarrjes. Pavarësisht se vendimmarrja e Komitetit të Ekspertëve tashmë është e njohur publikisht është gjykuar nga Gjykata Administrative si dhe është një gjë e gjykuar nga institucioni i KQZ-së. Ka ardhur këtu në këtë institucion dhe ky institucion e ka shqyrtuar dhe ka bërë me dije që nuk është objekt i kërkimit pranë këtij institucioni, si nuk ka qenë objekt në atë kohë kur është shqyrtuar dhe tashmë nuk mundet që ky vendim të përdoret si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, pasi që të kesh pavlefshmëri duhet të shikosh masën në ndikim është e papërcaktuar masa në ndikim. Për sa i përket vendimmarrjes nuk mundet që në statistika t'i kërkojmë institucionit që meqënëse ne kemi pasur kaq zgjedhës atëherë pretendohet se po të vinin këta LSI-ja do të merrte mandatin. Për sa më sipër nuk do të zgjatem për kërkesën ankimore, kjo nuk i përmbush as kushtet formale dhe ligjore për t'u pranuar nga ana juaj. Në lidhje me kërkesën ankimore të paraqitur nga Partia Demokratike, do të thoja që kjo kërkesë efektin ligjor e ka zero, zero efekt ligjor në kërkesë, zero efekt ligjor në proces. Është një kërkesë e mbështetur në deklaratat politike, të cilat në disa raste janë shpifje dhe raste më të... janë opinione. Siç u parashtrua nga kërkuesi janë deklaratat nga viti 2016 e në vijim, pra kanë kaluar dy procese zgjedhore dhe prapë përmenden shkaqet e vitit 2016-2017-2019 e të tjerë që nuk kanë lidhje fare me procesin. Përgjigja ligjore ne skemi çfarë kundërshtim ligjor që mund t'i bëjmë këtyre deklaratave, unë thjesht do të citoj dhe do të kërkoj para jush që këto



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

deklarata ne i prapësojmë me deklaratat e lidërshiptit të Partisë Demokratike të cilët i kanë bërë ditën e zgjedhjeve. Në qoftë se do të ishte një deklaratë e cila do të kishte efekt për procesin, ishin deklarata të cilët janë bërë ditën e zgjedhjeve dhe ditën e votimit. Po citoj deklaratën e parë në orën 22:30 të darkës së Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike zotit Gazmend Bardhi ku thotë: Sapo bëra thirrje të nis procesi i numërimit sa më parë. Ftoj PS-në të caktojë numëruesit dhe të ketë besim te numëruesit e saj. Apeli im i vetëm të nisë procesi i numërimit dhe t'i ofrojmë Elbasanit një proces numërimi të qetë dhe korrekt. Menjëherë kjo e sotmja është fitore e madhe për Shqipërinë dhe Elbasanin. Pra, procesi zgjedhor është fitore e madhe e madhe për Shqipërinë dhe Elbasanin thotë Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike për ngjarjet e ndodhur në datën 25 prill. Në orën 23:00 të datës 25 Prill 2021, zoti Edi Paloka në deklaratën e tij për shtyp është momenti thotë që të shohim nga e ardhmja dhe të projektojmë të ardhmen tonë, të falenderojmë ata që me përkushtim gjatë gjithë kësaj kohe punuan dhe sakrifikuan për të arritur këtë fitore sot. Prandaj unë me falenderime më të mëdha të gjithë jam i bindur që dhe numërimi do të jetë i rregullt sipas të gjithave procedurave dhe në fund kjo fitore do të konfirmohet në të gjithë kutitë e votimit. Në 23:53, zoti Alibeaj nga Fieri, kjo është një fitore e madhe thotë procesi për të gjithë qytetarët e Fierit është fitorja më e madhe e Partisë Demokratike në Fier është koha të nisim një të ardhme të mirë për Shqipërinë faleminderit shumë që besuat në rrugën tonë, faleminderit për vendosmërinë përkushtimin tuaj. Shqipëria fitoi sonte ne festuam sonte pra fitoi Shqipëria fitoi procesi. Së fundi mbyllet me deklaratën e Kryetarit të Partisë Demokratike zotit Basha thotë: Faleminderit për procesin të gjithë qytetarët shqiptarë që morën pjesë në proces, zgjedhën ndryshimin, kjo është fitore e qartë për popullin shqiptar është një fitore për Aleancën për Ndryshim. Vullneti i popullit është në kutitë e votimit, pra kjo deklaratë dhe kjo shprehje në fund



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

“vullneti i popullit”, është kutitë e votimit dhe ne këtë duhet të gjykojmë. Atë çfarë vetë Kryetari i Partisë Demokratike e tha më së qarti në datën 25 prill pasi ku u mbyll procesi i votimit. Në qoftë se shkelja duhet parë në kutitë e votimit dhe jo jashtë kutive të votimit çfarë ne deklarojmë. Unë ua rikujtova këto deklarata meqënëse dhe ju të gjithë ankimin i Partisë Demokratike jo këtë ankim po të 9 ankimet që ka paraqitur i ka copy paste të deklaratave politike. Qëndrojeni koherent deklaratave të cilët ka lidhje me procesin. Deklarata të cilët janë bërë ditën e votimit, deklarata të cilët kanë qenë në kohë reale dhe për sa u përket veprimeve konkrete të atij procesi. Ju ftoj të reflektoni dhe t’i tërhiqni këto kërkesa ankimore të cilën nuk sjellin asgjë, por vetëm shtyrjen e procesit dhe zgjatjen e daljes së rezultatit, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Salianji, po zoti Kaziaj?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo për replikë zoti Braho, po për qartësi të procesit tani të dëgjosh nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste, parti e cila ngriti e çoi në nivel kushtetues pavlevfshmërinë e këtyre zgjedhjeve që t’i duhen statistika shtesë dhe nuk i mjaftojnë ato të cilat që ne i kemi vënë në dispozicion. I duhen emra shtesë ndërkohë që në bazë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale ne nuk mund të përmendim emra të qytetarëve shqiptarë të cilëve i është mohuar e drejta për të aksesuar në Shqipëri dhe për të votuar ditën e zgjedhjeve është një gjë që nuk ka...

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj ne jemi të qartë në lidhje me këtë...



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo do të doja jo të replikoja po të sillja në vëmendjen tuaj që në brendësinë e provave keni dhe një kërkesë të shoqatave të emigrantëve, të cilët kanë kërkuar të votojnë me domosdoshmëri për shkak se po i shkelin një e drejtë kushtetuese. Atje ka emra të posacëm në qoftë se do emra zoti Salianji dhe janë shumë qytetarë që u është mohur kjo e drejtë.

**Z. L.Braho:** Kërkesën mund ta depozitoni zoti Kaziaj, pra provën që ju citoni cilësinë e kërkesës dhe pastaj do e shqyrtojmë bashkë me provat e tjera.

**Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** E keni në dosjen tuaj zoti Braho.

**Z. L.Braho:** Bëjmë një pushim 5 minuta dhe kthehemi përsëri për të vijuar pyetjet për palët, faleminderit!



**Rifillon Mbledhja**

**Ora 11 :45**

**Z. L. Braho:** Atëherë riçelimi seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesave ankimore numër 33, 41 dhe 52 e vijojmë më pas përfundimit të pretendimeve të citimit, provave nga palët ankimuese. Vijojmë me pyetjet që kanë anëtarët e KAS-it ndaj palëve. Vazhdojmë me zotin Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit, unë kam ndoshta disa pyetje për përfaqësuesin e LSI. Juve përmendët në parashkrimin tuaj Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë mos gaboj për të cilin keni thënë urdhër i paligjshëm në mos gaboj? E keni kontestuar në rrugë ligjore këtë urdhër?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zoti Rusmali, është e vërtetë LSI sapo ka marrë dijeni mbi këtë urdhër, ka pasur vështirësi të mëdha për të pasur kopje të tij për shkak se njoftimi publik nga komiteti teknik i ekspertëve është dhënë diku në datën 19 Prill 2021 dhe efektet e tij në pikat e kalimit kufitar kanë filluar po në këtë datë pa marrë formë ligjore ky urdhër domethënë pa u materializuar në një urdhër të Ministrit.

**Z. I. Rusmali:** Unë e kisha pyetjen shumë të thjeshtë! Pse u devijua përgjigja?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Si doni ta jap përgjigjen?

**Z. I. Rusmali:** Përgjigje për pyetjen! E keni kontestuar në rrugë ligjore urdhërin?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar anëtar i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ju bëni një pyetje dhe unë jap një përgjigje. Më lejoni të jap përgjigjen ashtu si e mendoj unë.

**Z. I. Rusmali:** Përgjigja është ose po ose jo duhet të vazhdoj pyetjen tjetër në varësi nga kjo përgjigje.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nëse kërkoni që të jap përgjigjet sipas asaj që ju më referoni të jap atëherë po rezervohem të mos e jap këtë përgjigje.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, Ministri i Brendshëm keni thënë ju ka ndikuar në mënyre të paligjshme në nxjerrjen e këtij urdhëri. Mund të na e shpjegoni ndikimin në mënyrë të paligjshme në cilën formë është bërë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ndikimi në mënyrë të pa ligjshë ka qenë në formën indirekte duke qenë se Ministri i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë ka qenë në listat shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun e Gjirokastrës dhe ka dashur me çdo kusht ta merrte mandatin e tij si deputet në këtë qark. Ka ushtruar presion sipas pretendimit tonë lidhur me nxjerrjen e një akti të tillë.

**Z. I. Rusmali:** Presion ndaj kujt?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ka ushtruar presion pozitiv ndaj kolegëve të vetë, Ministres të Shëndetësisë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. I. Rusmali:** Nga cilët kolegë? Ministres së Shëndetësisë! Si keni ardhur në dijëni ju në lidhje të këtij presioni?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ky është një deduksion, i nderuar zoti Rusmali nuk është një provë që ne kemi, formalisht është një deduksion.

**Z. I. Rusmali:** Një opinion, se deduksion është gjë tjetër.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Patjetër, jo deduksion se kemi ardhur në këto kushte që një akt i tillë ka marrë formën ligjore dhe një akt i tillë ka ndikuar drejtpërsëdrejti në Bashkinë Dropull për të cilën ne ankimojmë dret këtij komisioni.

**Z. L. Braho:** zoti Kaziu një moment zoti Rusmali meqënëse jemi te kjo t'i biem pak shkurt kësaj pyetjeje tuaj. Pra përveç presionit që citoni në nxjerrjen e urdhërit nga Ministri i Brendshëm që ishte kandidat në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, po në ekzekutimin e urdhërit keni konstatuar presion që mund të jetë ushtruar meqënëse ju citoni dhe oficer të policisë në kufij apo në Qarkun e Gjirokastrës gjatë ditës së zgjedhjeve.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Zoti Braho, fakte dhe prova të vëna në dispozicion që lidhen me këtë kërkesë ankimore dhe lidhur me pyetjen tuaj janë të qarta për shkak se siç nisa të flisja fjalën kur më është bërë pyetja nga zoti Rusmali. Ky urdhër pavarësisht se nuk kishte dalë në fletoren zyrtare për tu bërë efektiv dhe për të vënë efektet e veta ligjore, është marrë nëpërmjet një formulari deklarimi në pikat kufitare shtetasit shqipëtar që hynin, aksesonin në Republikën e



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Shqipërisë nga pikat kufitare të Maqedonisë të Veriut ose të Greqisë ishin të detyruara të firmosnin këtë formular pavarsisht se urdhëri skishte formë ligjore dhe kjo përbën shkak të arsyeshëm dhe lidhur kjo me provat e depozituara dhe emrat e posaçëm që ju keni në disponimin tuaj të personave familjeve të gjitha të ardhura nga Greqia të sjellura mbështetës të Partisë Socialiste të cilët nuk janë vetë karantinuar, përkundrazi kanë qënë anëtar të komisioneve zgjedhore të ngarkuara me detyra zgjedhore të posaçme në numërim, në vendet e numërimit të votave në ZAZ dhe në KQV të Qarkut Gjirokastrë. Kjo është provë e mjaftueshme për të parë diferencimin midis shtetasve domethënë mbështetësit e LSI nuk paskan aksesueshmëri dhe duhet të vetë karantinohen nuk ju jepet e Drejta Kushtetuese për të zgjedhur dhe mbështetësit e PS i jepet kjo e drejtë dhe për më tepër vihen dhe nëpër komisionet zgjedhore.

**Z. L. Braho:** Dakord, zoti Kaziu faleminderit.

**Z. I. Rusmali:** Do të ndërpres një moment, pyetjet për ju do ti bëj një pyetje zotit Salianji! Zoti Salianji më ndiqni? Ju thatë në parashkrimin tuaj që urdhëri i ministrit të shëndetësisë është kontestuar në rrugë ligjore dhe për këtë ka një vendim gjyqësor të formës së prerë mos gaboj, kështu thatë! Mund të na e shtjelloni këtë gjë?

**Z. A. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Është thashë e njohur publikisht është bërë gjyqi në Gjykatën administrative si dhe në Gjykatën e Apelit Administrativ ku është rrezuar kërkesa e subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim për shfuqizimin e këtij urdhëri.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. L. Braho:** Zoti Salianji në lidhje me këtë vendimin e Gjykatës se publikisht dimë vetëm ka qenë zoti Vorani relator, kurse vendimarrjen nuk e dimë. Është vendimarrje për rrezimin e kërkesës apo vendimarrje që ka të bëjë me kompetencën për gjykimin e kësaj kërkesë të Lëvizjes Socialiste për Integrim?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Në dijeninë time është rrezim kërkesë, në dijeninë time ky vendim gjykate e kanë lënë në fuqi urdhërin e Ministrit.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, faleminderit ju përfaqësuesi i LSI keni dijeni për këtë gjë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po i nderuar kam dijeni për këtë gjë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord dijenia juaj, po dakord ju keni dijeni ju keni gjithmonë të drejtën që pyetjeve të mia të mos i përgjigjeni.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po kam dhe të drejtën t'i përgjigjem ashtu në interes të subjektit që përfaqësoj.

**Z. I. Rusmali:** Dakord do ti përgjigjesh pyetjes!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po ma mohoni, po ma impononi!

**Z. I. Rusmali:** Por nuk i përgjigjesh dot sepse unë akoma nuk kam bërë pyetjen akoma nuk përgjigjeni dot nëqoftëse unë nuk bëj pyetjen. Më konfirmuat që ju jeni në dijeni të kësaj gjëje. Sipas dijenisë që ju keni vendimi i Gjykatës i formës së

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

prerë ka rrëzuar kërkesën, ankimin apo është shprehur për mungesë kërkesë kompetence nga ana e gjykatës?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Mundet ta shtjelloj? Atëherë, pikë së pari nuk kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Përfaqësuesi i Partisë Socialiste abuzon duke pretenduar këtë gjë. Vendimi na është komunikuar vetëm ditën e sotme i nderuar zoti Rusmali! Vendimi nuk flet për thelbin e kërkesës duke qenë se kërkesa jonë ishte lidhur me marrjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e efekteve të këtij urdhëri i nderuar zoti Rusmali dhe vendimi flet për mospranim të kërkesës dhe jo për rrëzim të saj. Mospranimi i kërkesës dhe rrëzimi i saj janë dy çështje totalisht të ndara dhe orjentimi që i bën Gjykata Administrative e Apelit këtij vendimi ose kësaj kërkesës tonë, nuk e klasifikon si juridiksionin gjyqësor duke e çuar atë më tej në një juridiksion kushtetues dhe kjo është thelbi i kërkesës tonë që ka të bëjë me shkelje të drejtave kushtetuese dhe ky vendim e forcon atë që është mbështetja në argumentimin për pavlefshmëri të nivelit kushtetues të ligjit në atë zonë zgjedhore.

**Z. I. Rusmali:** Mirë që unë ta kuptoj të qartë shtjellimin tuaj. Gjykata ka rrëzuar kërkesën për masën e sigurimit të padisë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Gjykata nuk e ka rrëzuar kërkesën për masën e sigurimit të padisë! Gjykata ka disponuar me mospranim të kërkesës, duke orjentuar palët që ti drejtohen Gjykatës Kushtetues se kemi të bëjmë me një shkelje kushtetuese thotë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë, gjykata nuk e ka trajtuar themelin ju e keni vënë në lëvizje me një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe jo themelin.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ekzakt!

**Z. I. Rusmali:** Themeli në Gjykatë Administrative nuk është trajtuar kurrë!?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk është trajtuar për shkak të afatit të shkurtër që kemi pasur.

**Z. I. Rusmali:** Shumë faleminderit! Përgjigjia më ndihmoi e keqja është gjithmonë se paragjykohe përgjigjet, pyetjet.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk ishte ky qëllimi jonë i nderuar zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Dakord, dakord, tani me çfarë kuptoj unë ju ma konfirmoni ose ma përgënjeshtroi. Ju e keni quajtur të gjithë çështjen e karantinimit e keni quajtur akt të paligjshëm, paligjshmëri thatë juve në parashtrimin tuaj e thatë këtë gjë apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Akt antikushtetues!

**Z. I. Rusmali:** Dakord, antikushtetues dhe i paligjshëm. I paligjshëm sepse një gjykatë kompetente nuk e ka vlersuar akoma ligjshmërinë e tij. Tani të kaloj te një grup pyetjesh që kanë lidhje me zbatimin praktik të urdhërit me dijeninë e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

subjektit. Ju më duket se e thatë por unë kam nevojë ta konfirmoj. Sa është numëri i personave që kanë hyrë në Shqipëri në periudhën kur ishte vendosur kjo karantina sa ishte 14 ditore apo 3 javore?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Aksesueshmëria, në këto të dhëna zyrtare të Shtetit Shqiptar nga ana jonë është 0, për shkak se nuk na jepen këto statistika.

**Z. I. Rusmali:** Nuk e dini!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në rrugë informale më lini ju lutem, në rrugë informale kemi ardhur në dijeni që të paktën 500 mbështetës të Partisë Socialiste kanë hyrë në mënyra që mbeten për tu verifikuar. Për këtë që ngrita dhe pyetje ngrita dhe kërkesë përpara këtij komisioni, për marrjen e informacionit pranë organeve kompetente për zgjidhjen e kësaj çështje sa më drejt dhe sa më me objektivitet. Fakti është se në dosjen tuaj jo vetëm një gjë të fundit më lini ta mbaroj.

**Z. I. Rusmali:** Fakti është se del nga pyetjet!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo nuk dal nga pyetjet!

**Z. I. Rusmali:** Jo jo del nga pyetjet ajo që ke merak ti! Se unë kam listë me pyetje ma dhe përgjigjen.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju faleminderit që e dini se çfarë merak kam.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. I. Rusmali:** Jo nuk e di por thashë mbase del! Në rrugë informale keni marrë vesh që rreth 500 mbështetës 500 mbështetës të Partisë Socialiste kanë hyrë në shqipëri në këtë periudhë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në rrugë formale ju keni vënë në dispozicion emra të posaçëm që unë nuk munda t'i bëja dot këtu për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale të personave.

**Z. I. Rusmali:** Është e pamundur!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Është e mundur!

**Z. I. Rusmali:** Unë kam nevojë të kuptoj gjënë dhe dua të më ndihmosh që ta kuptoj. Rrugë informale mund të konkretizohet nga ana juaj çfarë do të thotë? Qoftë edhe me një shembull nuk ka rëndësi të më tregosh rrugën si i ke marrë ato, por të më tregosh shembullin e rrugës informale!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Atëherë, i nderuar zoti Rusmali po të shihni në çdo pikë kalimi kufitar ndodhet ky pyetsor për shtetasit që kthehen nga zonat e prekura me Covid 19, që është frut i asaj vendimarrje të Ministrisë së Shëndetësisë me urdherin 219. Pra në qoftë se në listat e atyre personave që unë kam sjell si provë të personave që kanë kaluar kufirin Greko-Shqiptar në ato data. A ekziston i plotësuar ky formular? A janë vetë karantinuar këto persona? Apo kanë pasur përfshirje efektive dhe totale dhe aktive në zonat e administrimit zgjedhor në Gjirokastrë nëpërmjet detyrave të psaçme të subjektit politik Partia Socialiste si numërues të kësaj partie, si anëtar të ZAZ të kësaj partie dhe si anëtarë të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

komisionit të qendrave të votimit të asaj partie! Për këtë në dosjen tuaj keni dhe një kallëzim penal të bërë me emra të posaçëm nga kandidati ynë që kanë informacion shtesë lidhur me këto emra që kanë aksesuar pikat e kalimit kufitar dhe nuk janë vetkarantinuar dhe ky është ai dyshimi i madh dhe i mbështetur nga ana jonë zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Tani, ndoshta duhet të shpjegojmë diçka rreth shkakut pse unë e bëj pyetjen që ju të më ndihmoni me përgjigjen tuaj se nuk e mora përsëri përgjigjen. Ju thoni që rreth 500 persona mbështetës të Partisë Socialiste kanë hyrë në këtë periudhë në Shqipëri në pikën e kalimit kufitare dakord. Komponenti sasior është shumë i rëndësishëm në shqyrtimin e kërkesave të kësaj natyre, ka shumë rëndësi dhe unë nuk kam asnjë lloj dyshimi që ju kur keni paraqitur kërkesën tuaj ankimore e keni pasur parasysh komponentin sasior. Për shkak se është i rëndësishëm dhe për shkak se ju e keni pasur parasysh, për mua ka rëndësi që të eksploroj sa e besueshme është kjo shifra prej 500 personash, që unë të krijoj një ide që është e besueshme shumë apo është e besueshme pak. Më duhet të di kush është rruga informale jo cila konkretisht? Po kush është tipo-tipi i rrugës keni pyetur një doganier? Keni pyetur një polic? I keni mbajtur shënim të gjithë që hynin? A keni bërë çek? Domethënë kush është rruga që e keni siguruar ju të dhënë. Cila është rruga nëpërmjet të cilës ju keni siguruar shifrën prej 500 personash që kanë hyrë në një nga pikat kufitare në zonën tuaj besoj?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Pyetja juaj është shumë e drejtë, këtu kemi të bëjmë me dy aspekte me numërin që ne pretendojmë të personave që kanë hyrë që është po ai numër që sapo thatë dhe me një numër personash që i është ndaluar e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

drejta për të hyrë ose nëqoftëse kanë hyrë, jo është shumë e rëndësishme nëqoftëse doni ta dini pjesën sasiore të vendim marrjes dhe të efekteve negative të ardhura.

**Z. I. Rusmali:** Më thoni në ç'loj rruge e keni marrë informacionin?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Informacioni është marrë nëpërmjet zyrtarëve të këtij shteti por jo me shkrim.

**Z. I. Rusmali:** Zyrtarëve? Të cilit institucion?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, të pikave kufitare!

**Z. I. Rusmali:** Zyrtarëve të pikave kufitare? Domethëne ose polic, ose doganier?!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, patjetër!

**Z. I. Rusmali:** Mirë, faleminderit është shumë e rëndësishme kjo! Tani për ju polici ose doganieri që ju thotë kanë hyrë 500 veta në pikën e kalimit kufitar besoj është i besueshëm apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Për neve besoj që po!

**Z. I. Rusmali:** Dakord, polici vetë dëshmitari i drejtpërdrejt besoj nuk është i të gjithëve, është dëshmitar për ata që janë të turnit të tij, por të tjerët i ka ose nga librat nëqoftëse ata kanë libra që mbajnë shënim ose nga thëniet e kolegëve!



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Informacioni ka edhe një komponent të dytë që 500 veta janë mbështetës të Partisë Socialiste. Ky sa është i besueshëm sipas burimit që keni pasur?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Sipas burimit që ne kemi ju sapo ju vura në dispozicion dhe një listë me emra të personave. Mjafton të verifikoni ato emra dhe pretendimit tone automatikisht deduktohet i besueshëm.

**Z. I. Rusmali:** Sa i besueshëm është polici apo doganieri që ju ka dhënë informacionin?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Më falni po si pretendoni ju që ta kishim marrë këtë informacion?!

**Z. I. Rusmali:** Jo, Jo unë pranova informacionin, po ngatërroresh me gjënë. Unë pranoj informacionin unë pranoj burimin e informacionit dhe nuk them për veten time për ju kur e keni marrë këtë informacion nga polici filan fisteku ky është burimi punonjës i Policisë së Shtetit ose Doganave. Mund të jenë 10 polic që jua kanë dhënë për ju jo për mua. Këta 10 polic që jua kanë dhënë secili pjesën e vet në totalin prej 500 emrave. Sa të besueshëm janë kur ju thonë janë votues të Partisë Socialiste? Për ju jo për mua! Ju sa i keni ndjerë ato të besueshëm?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Kandidati ynë i Bashkisë Gjirokastrë zoti Tavo është një person me një popullaritet shumë të madh në atë bashki. Njeh pothuajse emër për emër të gjithë votuesit dhe tanët dhe të Partisë Socialiste. Prej një kohe të gjatë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. I. Rusmali:** Dakord do të thotë që burimi i informacionit nuk janë policët që thonë kan ardhur 500 veta po janë policët që kanë dhënë në dispozicion listat me personat që kanë hyrë dhe kandidati juaj që pa dyshim është një njohës shumë i mirë i zonës nuk e ve njeri në diskutim, i ka çmuar këta si dëshmues të partisë në një farë mënyre është sjellur si një patronazhist apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo nuk është sjell si patronazhist ka bërë vetëm detyrën e tij, patronazhistët nuk ekzistojnë në këtë vend te Lëvizja Socialiste për Integrim!

**Z. I. Rusmali:** Vlerësimin e ka bërë kandidati për inflomacionin.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Vlerësimin ju e keni në dosje mjafton të shihni emrat e personave që janë depozituar në cilësinë e provës

**Z. I. Rusmali:** Nuk më thonë asgjë!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Juve sju thonë asgjë! Në qoftë se bëni një hetim të thelluar administrativ do ju thonë shumë gjëra.

**Z. I. Rusmali:** Unë kam nevojë të di për ju, për kandidatin tuaj kush ka qenë arsyetimi logjik që ka çuar që këta persona janë persona me bindje politike pra të Partisë Socialiste për këtë kam nevojë. Ju thoni i besoni kandidatit, kandidati e di me siguri.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Informacionet e ardhura janë të sigurta zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Duro ta mbaroj se e mbarova, përtej shifrës 500 persona me bindje të Partisë Socialiste që kanë hyrë në këtë perjudhë ju keni informacion shtesë për secilin nga këta persona sa prej tyre kanë marrë pjesë në votim?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Prej këtyre 500 personave? Lista mund të jetë më e madhe se 500 persona i nderuar zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Unë e dua për këta 500 persona!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Se ata normalisht kanë ardhur vetëm me qëllim votimin atë ditë domethënë racioni qëllimi i tyre ka qenë votimi ne nuk mund ta kemi këtë statistikë? Ju jeni anëtar i KQZ nëqoftëse keni qëllimin e mirë për një punë të thelluar të kësaj çështje atëherë ju mund ta merrni si informacion.

**Z. I. Rusmali:** Ju lutem unë nuk kam prapamendime të pyetja ime nuk kam të ske pse ke prapamendime të pyetja ime kur si kam vetë! Unë kam nevoj të di dhe mua më mjafton përgjigja është e mirë dhe e vlefshme përgjigja që ne nuk e disponojmë informacionin. Sa nga këta 500 persona kanë marrë pjesë në votim? Është korrekte!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ne disponojmë informacion të pjesshëm për këtë gjë jo se disponojmë fare.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. I. Rusmali:** Për sa nga këta persona?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Të paktën për 60 ose më shumë persona që depozitova ju keni emër mbiemër që kanë votuar dhe kanë qenë dhe anëtar të komisioneve zgjedhore.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kjo mbyll dhe pyetjen time tjetër do të thotë që lista që ju keni vënë në dispozicion është listë është ekstrakt nga kjo listë prej 500 personash të cilët sipas jush konfirmohet nga burimet e juaja që kanë marrë pjesë në votim rreth 60 veta?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ekzakt!

**Z. I. Rusmali:** Dakord, unë ju falenderoj për përgjigjet që më dhatë juve.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit ju!

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj në lidhje me këtë numërin prej 500 apo më shumë personash që kanë ardhur dhe kanë votuar sipas jush pa dashur të citoj si patronazhist zotin Tavo apo oficerët e policisë. Këta persona në dijeninë tuaj e kanë nënshkruar atë formularin e vetë deklarimit kur kanë kaluar në kufi? Pra është kjo një indicie që nuk kanë nënshkruar apo indicia është thjeshtë bindje politike?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ne kemi informacion që numëri i konsiderueshëm të personave të aksesuara në atë ditë për të ardhur dhe votuar subjektin politik Partia Socialiste nuk e ka nënshkruar pyetsorin ose dhe në rastet

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

se e kanë nënshkruar nuk janë vetkarantinuuar sipas detyrshmërisë së urdhërit të ministrit, përkundrazi kanë qënë dhe anëtar të komisioneve zonale. Për këtë kemi mjaftueshëm bindje për shkak se emrat që keni pranë jush një pjesë e tyre kanë qënë anëtar të këtyre komisioneve dhe është shumë e thjeshtë të verifikohet kjo gjë. Hetimi duhet bërë i plotë, i gjithanshëm dhe i pandikuar politikisht nga ana juaj!

**Z. I. Rusmali:** Se është shumë interesante në dijeninë tuaj këta nuk kanë nënshkruar atë formularin që ishte pjesë e procedurës që duhet kryer. Keni dieni nëse janë të regjistruara në sistemin TIMS si persona që kanë hyrë apo nuk janë regjistruar fare?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ky është një dyshim që ne e ngritëm në relatin e fjalës tonë hyrëse i nderuar zoti anëtar i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe dyshojmë nuk kemi prova për këtë gjë që këta persona mund edhe të mos jenë regjistruar pranë sistemin TIMS.

**Z. I. Rusmali:** Burimet tuaja që ju kanë ofruar listën nuk ua kanë konfirmuar?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Burimet tona ne na kanë ofruar numërin e shtetasve që kanë hyrë.

**Z. I. Rusmali:** Listën thatë ju, jo numërin?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Numërin e shtetasve që kanë hyrë.

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. I. Rusmali:** Nga numëri bindjen politike zoti Tavo nuk e gjen dot!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Shiko këtu po flasim për zgjedhjet politike, nuk e di çfarë ka marrë në dorë zoti Tavo. Këta janë emrat që ne kemi pasur dhe numëri i shtetasve na është konfirmuar në atë mënyrë

**Z. K. Beke:** Zoti Kaziaj kisha një pyetje lidhur me këtë listën që ju thatë është me 59 emra me shkrim dore ju përmëndët faktin që me respekt të mbrojtjes të të dhënave personale nuk do përmëndim emrat. Në fakt në këtë listë vetëm dy numrat e fundit 58 dhe 59 besoj e keni kopjen dhe ju janë të shënuar në kllapa komisioner dhe numërues dhe nga një verifikim diagonal që i bëj kësaj listës një lexim që shoh përshëmbull që duke filluar nga numëri 11 është një shtetas me të njejtin mbiemër janë 5 rresht dhe 2 më pas, pra janë 7 familjarë me të njejtin mbiemër. Ju thatë që kjo listë janë numërues dhe anëtar të qendrave të votimit. Në pamje të parë duken se janë familjarë burrë e grua vajza, më fal që ta përfundoj! Pra ju mendoni që këta të 7 me këtë mbiemër janë të 7 komisioner dhe numërues?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo, nuk e thashë këtë gjë thashë ajo listë është listë e mbështetësve të Partisë Socialiste, vetëm ata të shënuar të fundit janë anëtar të Komisioneve Zonale. Ashtu siç nga procesverbali i kallëzimit të veprës penale që ju keni në dosje keni emra të tjerë të posaçëm dhe nga një listë tjetër që është listë e KQZ keni emrat e anëtarëve të vijzuar që kanë qenë shtetas me banim në Greqi dhe janë futur në Republikën e Shqipërisë vetëm në momentin e ndalimit nëpërmjet urdhërit që duhet të ishin karantinuar dhe nuk e kanë bërë këtë gjë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. K. Bele:** Pra për ta konkluduar kemi një listë me 59 mbështetës të supozuar nga ana juaj mbështetës të Partisë Socialiste të cilët kanë hyrë në pikat e kalimit dhe ju është lejuar të votonë pavarësisht ndalimit të tyre.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ekzakt! Nuk është zbatuar urdhëri për vetkarantinimin dhe për disa persona kanë marrë dhe detyra të posaçme.

**Z. K. Bele:** Pra, ngrihet një pretendim për mos kryerjen e rregullt të detyrës punonjësit e policisë nëse ata kishin djeni për hyrjen ose jo të këtyre njerëzve.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Shumë e vërtetë!

**Z. K. Bele:** Dakord, faleminderit.

**Z. E. Çefa:** Atëherë, zoti Kaziaj në argumentimin të kërkesës tuaj për pavlefshmëri në zgjedhje në Bashkinë Dropull dhe më pas në të gjithë qarkun, referuat që sipas statistikave që ju administroni të votuesve ndër vite në Dropullku kanë marrë pjesë në votim rreth 6000 mijë persona apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Përveç këtyre zgjedhjeve po!

**Z. E. Çefa:** Pikërisht pra, në këto zgjedhje.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Janë diku, te 2956 pjesëmarrës në zgjedhje.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. E. Çefa:** Po pra, janë diku, te 2956 pjesëmarrës në zgjedhje pra me një diferencë të dukshme në krahasim me statistikat e viteve para ardhëse. Tani pyetja ime është kjo, ju pretendoni që kjo diferencë e madhe zgjedhësish janë të gjithë persona të cilëve ju është mohuar e drejta e votimit pikërisht për shkak të këtij urdhëri që ju e konsideroni të pa ligjshëm?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit, zoti Çefa nga statistikat që ju kemi vënë në dispozicion Lëvizja Socialiste për Integrim në Bashkinë Dropull ka qenë forcë e parë në të gjitha zgjedhjet duke marrë mbi 53% të totalit të votave. Domethënë nga 6000 votues klasik që votonin gjithmonë në Bashkinë Dropull LSI ishte gjithmonë forcë e parë. Ky urdhër ka bërë që këto statistika të çbëhen dhe qëllimshmëria ka qenë pikërisht lidhur me këtë bashki se të gjithë e dimë që forca e LSI ishte në këtë bashki dhe vetë të themi Partia Socialiste ka ndikuar duke goditur kundërshtarit figurativisht në këtë rast, atje ku kundërshtari kishte forcën më të madhe. Pra mos pjesëmarrja në votim e më shumë se 50% të zgjedhësve klasik që votonin në atë bashki dhe statistikat të cilat i kemi vënë në dispozicion. Janë të qarta dhe flasin për tregues të qartë mbi qëllimshmërinë e këtij urdhri dhe efektet negative që ka sjellë mbi LSI.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit, në vijim të kësaj tani dhe një pyetje e fundit. Cila është diferenca ose numëri i votave të nevojshëm subjektit Partia Lëvizja Socialiste për Integrim për të marrë mandatin në këtë qark?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Diferenca është pothuajse një e treta e pjesëmarrësve që mungojnë për të votuar për shkak të këtij urdhëri!



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. E. Çefa:** Pra ju thoni që Lëvizja Socialiste për Integrim i duhen 1000 vota në të gjithë qarkun për të marrë mandatin e deputetit?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** I duhen pak më shumë se 1000 vota i nderuar!

**Z. E. Çefa:** Qartë, faleminderit.

**Z. I. Rusmali:** Meqënëse jemi tek analiza e pjesëmarrjes, sipas jush ekziston mundësia që shifra e personave që nuk kanë ardhur në krahasim me ato që kanë ardhur në zgjedhjet e mëparshme të ketë lidhje me shkaqe të tjera përveç shkakut që ju përmendët që ka lidhje me urdhërin?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk ekziston kjo mundësi!

**Z. I. Rusmali:** Pse?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Për shkak se nga kontaktet që kemi pasur nga mbështetësit tanë që jetojnë në shtetin Grek ose Maqedonas ata kanë dashur të vijnë për të shprehur me vullnet të themi qëndrimin e tyre dhe ky urdhër ka ndaluar këtë iniciativë të tyre, në mënyrë që do të vetë karantinohehin dhe kishte kuptim më që ata të aksesonin në Republikën e Shqipërisë në momentin që nuk e ushtronin dot të drejtën e votës.

**Z. I. Rusmali:** Shifra e mbështetësve që ju keni kontaktuar dhe ju kanë konfirmuar që nuk vinin dot për shkak të këtij urdhëri? Është e barabartë me shifrën që ju rezulton nga ulja e pjesëmarrjes?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues LSI:** Janë mbi 3000 persona që duhet të vinin!

**Z. I. Rusmali:** Jo ata që keni kontaktuar janë 3000 persona?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Janë mbi 3000 persona që ka kontaktuar vetë kandidati për deputet.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, janë kontaktuar 3000 person dhe po të vinin 3000 persona shkohej në atë shifër.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Do rikualifikohej ndarja e mandateve.

**Z. I. Rusmali:** Jo, jo shkohej në shifrën e duhur po flas për pjesëmarrjen nuk më duhen mandatet.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në atë shifër për Bashkinë Dropull thoni ju gjithmonë i referoheni Bashkisë Dropull!

**Z. I. Rusmali:** Po, po Bashkisë Dropull! Në qoftë se vinin 3000 persona që janë kontaktuar nga kandidati, janë ftuar për të ardhur. Ata do ta barazonin shifrën me zgjedhjet pararendëse për Bashkinë Dropull, 3000 mungojnë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Sipas statistikave pak më shumë se 3 mijë mungojnë. Po.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Të 3 mijë personat janë votues të sigurt të LSI-së?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Sipas pretendimit tonë dhe sipas kontakteve tona janë votues të sigurt të LSI-së.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Ekziston mundësia që pengesë për njerëzit të ketë qenë, për shembull fakti që si Shqipëria të ketë pasur karantinë edhe Greqia? Do të thotë në momentin e kthimit nga Shqipëria individët do të duhej të futeshin pastaj në karantinë në Greqi?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ata kanë shprehur vullnetin dhe nuk e kanë ngritur si prezencë. Nuk e kanë ngritur këtë shqetësim fare, kanë shprehur vullnetin për të ardhur për të votuar kandidatin tonë.

**Z. I. Rusmali:** Shumë mirë, po riformuloj pyetjen. Në dijenin tuaj Greqia ka pasur masa karantinimi në fuqi në atë kohë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në dijeninë tonë prevalonte e drejta kushtetuese për të votuar se sa..

**Z. I. Rusmali:** Në Greqi nuk ta prevalon e drejta kushtetuese jonë. Në Greqi po them, Greqia në dijeninë tuaj ka pasur.. Greqia, shteti grek ka pasur masa karantinimi në atë periudhë? Po apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo, jo për zgjedhësit tanë. Shteti Grek masat e karantinimit i ka pasur në zona të ndryshme. Nga zona në zonë ndryshonin masat domethënë shtrënguese ose lehtësuese.

**Z. I. Rusmali:** Në zonën Limitrofe të Gjirokastrës cilat kanë qenë masat e karantinimit?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Në ato kontakte që kemi pasur me ata individë që unë iu thashë, me atë numër personash që unë iu thashë nuk kanë pasur më të voglin shqetësim për të ribërë dhe karantinimin.

**Z. I. Rusmali:** Është ose e dini ose sepse nuk e dini. Pyesim Ministrinë e Jashtme për këto të dhëna. Çështja është shteti grek në dijenin tuaj, ka pasur në zonën Limitrofe, me Gjirokastrën masa karantinimi në fuqi apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk ka rëndësi. Po ashtu pyesim Ministrinë e Jashtme. Sipas meje kjo është një gjë që nuk ka rëndësi për ne nuk kam dijeni për këtë.

**Z. I. Rusmali:** Ka rëndësi për mua po të bëj pyetje, jeni në dijeni apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk kam dijeni për këtë gjë, sepse siç iu thashë kam dijeni që shteti grek disponon me masa të ndryshme në vende të ndryshme.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, faleminderit, ju nuk keni dijeni. Për sa kohë nuk keni dijeni nuk mund ta themi me siguri që një pjesë prej tyre nuk kanë pasur hallin e shtetit grek apo jo?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Di.12.05.2021*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Më duket.. nuk e kanë pasur, sepse na e kanë konfirmuar në telefon këtë gjë. Prevalonte e drejta e tyre për të zgjedhur përfaqësuesit e vendit të tyre se sa karantinimi i mundshëm në atë rast në shtetin grek.

**Z. I. Rusmali:** Shumë mirë, e çartë. Ju nuk keni pasur asnjë motiv të besueshëm që të dyshoni tek sinqeriteti i përgjigjeve të 3 mijë personave që keni kontaktuar në raport me këtë çështje?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar zoti Rusmali, rezultatet janë kokëforta, nuk ka pse të kemi ndonjë dyshim tek mbështetësit tanë që shprehin as më të voglin dyshim.

**Z. I. Rusmali:** Dua të them është çështje besueshmërie jo çështje matematike.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Matematika është shkencë ekzakte dhe..

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Ata iu kanë thënë dhe ju e keni besuar plotësisht, sepse nuk keni pasur motiv që të dyshoni tek ata.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Patjetër, as më të voglin motiv.

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Z. L. Braho:** Kam një pyetje për Administratën e KQZ-së. Tek kjo lista që ka sjellë zoti Kaziaj ku dy nga emrat sipas zotit Kaziaj janë njëri komisioner, tjetri numërues. Tani nuk e di është komisioner i qendrës së votimit apo komisioner KZAZ-je? Ndërkohë që numëruesi patjetër është pjesë e KZAZ-së. Mundet që

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sauksioneve  
Dt.12.05.2021*

Administrata e KQZ-së të verifikojë për këto dy persona nëse kanë qenë pjesë e Administratës Zgjedhore, në datë 25 Prill dhe në vijim?

*Z. Y. Merkaj:* Po, mundet.

*Z. L. Braho:* Dakord. Për çështje të të dhënave personale emrat po i japim jashtë seance të këtyre dy personave.

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:* Edhe zoti Braho nëse mundem? Kemi dhe një listë tjetër bashkëlidhur ankimit që kemi bërë.

*Z. L. Braho:* E pashë atë por me thënë të drejtën nuk e kuptova, sepse ajo është foto dhe nuk e di kujt i kanë bërë foto.

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:* Jo, këtu keni numrin rendor të anëtarit të Qendrës së Votimit dhe i'ua japim dhe me emra po ashtu.

*Z. L. Braho:* Është person i ndryshëm nga këto dy të tjerët?

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:* Është person i ndryshëm, e keni dhe tek procesverbali kallëzimit të veprës penale se çfarë pozicioni ka mbajtur. Me detyra zgjedhore të posaçme zoti Braho. Janë dy persona, njëri prej të cilëve ka qenë..

*Z. L. Braho:* Tani kjo lista që i është bërë foto këtu çfarë liste është? Është listë e KQV-ve?

*Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:* Po.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Pra, 4282-shi?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po.

**Z. L. Braho:** Ky personi që është anëtar ju pretendoni se është person që ka hyrë në Shqipëri pas vendosjes së karantinës, duke qenë pjesë dhe e Komisionit Qendres së Votimit?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, patjetër.

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit.

**Z. E. Lako:** Kam dhe unë një pyetje për zotin Kaziaj.

**Z. L. Braho:** Patjetër.

**Z. E. Lako:** Këto listat që ju keni dorëzuar në dosjen e ankimit dhe sot në seancë janë disa lista pa firma, vula, fotokopje. Pra, disa lista emrash të cilët mund të jenë zgjedhës ose jo, duhet parë kjo punë. Kam një pyetje. Ju pretendoni që këta janë shtetas që kanë hyrë në kundërshtim dhe kanë votuar në kundërshtim me rregullat e vendosura nga shteti nëpërmjet vendimit të Komitetit. Si e provoni ju këtë? Domethënë, a keni depozituar ndonjë kërkesë ju gjatë kësaj periudhe organeve përkatëse? Për shembull, pranë organeve të Ministrisë së Brendshme që cila është lista e personave që kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe? Pra, këta janë thjesht anëtarë komisionesh? Si e provoni që këta janë persona që kanë hyrë dhe nuk kanë

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

zbatuar karantinën? Keni bërë ndonjë kërkesë? Nëse po mund të na e depozitoni dhe nëse nuk e keni bërë përse nuk e keni bërë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Unë prandaj investova këtë Komision, i nderuar zoti anëtar i Komisionit, për shkak se nga materialet e disponuara nga ana jonë me emra të posaçëm të personave. Pavarësisht se materiali është vënë në mënyrë, në një formë jo origjinale. Për shkak se nuk kemi pasur mundësi për ta gjetur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të gjitha mundësitë. I ka listat këtu dhe i verifikon. Po ashtu dhe nga kallëzimi penal janë tregues të qartë që këta persona.. sepse dikush nuk vete dhe kallëzon domethënë të themi një person pa pasur motiv, sepse për ndryshe shkon për kallëzim të rremë. Këta persona kanë hyrë në atë datë që ka qenë ndalimi dhe kanë vepruar me detyra të posaçme, të ngarkuar nga Partia Socialiste. Verifikimet e tyre mund të bëhen pranë TIMS. Mund të bëhen pranë listave të ndodhura pranë KQZ-së për Qarkun e Gjirokastrës të anëtarëve të Komisioneve të Qendrës së Votimit, të numëruesëve dhe të anëtarëve të KZAZ-ve, ne kaq mund të dispononim. Unë prandaj e investova këtë Komision që në bazë të nenit 136 të investohet nëpërmjet marrjes së provave të reja nga këto institucione. Në mënyrë që të kemi një thellim të hetimit administrativ dhe të nxjerrim përgjegjësitë personale të personave.

**Z. E. Lako:** Patjetër që ne do të bëjmë hetim të thelluar administrativ por, për të bërë një hetim duhen disa prova. Pyetja ime konsiston përse ju nuk i keni marrë këto prova? Ka qenë e pamundur? Ka ndonjë kërkesë nga ana juaj të organeve përkatëse për të marrë këto prova apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar zoti anëtar i Komisionit..

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*





**Z. E. Lako:** Sepse këto prova që ju kërkoni nuk i disponon KQZ-ja. KQZ-ja nuk disponon listën e personave që hyn nga sistemi TIMS, e disponon një organ tjetër. Për sa i përket listave, dokumentave që ka KQZ-ja patjetër që në këtu jemi do t'i marrim do t'i administrojmë. Po flasim për dokumenta që ndodhen jashtë KQZ-së.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk ka një ligj në Republikën e Shqipërisë që të na lejojë ne të legjitimohemi për të marrë emrat e disa shtetasve nëse nuk kemi një organ administrativ, për të marrë emrat e disa shtetasëve nga një organ tjetër administrativ. Nuk na lejohet dhe në një përgjigje të tillë. Po ashtu koha dhe afati i shkurtër nga vendimmarrja e Komisionerit deri në ankimimet që kemi bërë pranë jush është aq i shkurtër sa objektivisht nuk kemi mundur dhe në rast se do të ekzistonte një ligj ta shfrytëzonim këtë hapësirë.

**Z. L. Braho:** Pra, zoti Kaziaj që të qartësojmë, ju pretendoni që këto janë të dhëna konfidenciale dhe nëse do të kishit bërë kërkesë nuk do të kishit marrë një përgjigje pozitive?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po, patjetër që do të na refuzohej.

**Z. K. Bele:** Nëse mund të plotësoja këtu, pasi kemi të njëjtin pak a shumë diskutim. Duke qenë se ky proces është gati gjyqësor dhe mënyra e marrjes së provave, është e ngjashme me mënyrën se si çohet prova para një procesi gjyqësor civil apo administrativ besoj këtë po qartësonte dhe kolegu. Ka ndonjë lloj qoftë edhe kërkesë e lënë pa përgjigje? Apo pa i hyrë faktit nëse kjo përgjigje mund të vinte apo jo? A ka ndonjë kërkesë shkresore përgjatë kësaj periudhe "x" ditë nga përfundimi i zgjedhjeve ku ju të keni provuar tek organe të tjera përveç KQZ-së me këtë kërkesë ankimore? Marrjen e informacioneve të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

natyrave të ndryshme. Mund të ishte Komisioni i Ekspertëve të Ministrisë së Shëndetësisë, mund të ishte Zyra e Gjendjes Civile në qark apo diku tjetër pa.. sepse nuk e shtjelloj dot listën e institucionve të mundshme. Por, a keni ndonjë fillim, kërkim prove nëse mund ta përkufizojë?


**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar zoti Bele ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk na e toleron një kërkesë të tillë, nuk na jep autorizimin që ne të disponojmë një kërkesë të tillë dhe të kemi një vendimmarrje. Ose një përgjigje nga ana e organeve të themi administrative të këtij shteti, ose të organeve të posaçme të ngarkuara me ligj.

**Z. K. Bele:** Më fal, ajo do të ishte përgjigja e ardhur, pra, ju keni interes të ligjshëm, mendoj. Përderisa keni ardhur dhe e paraqisni këtë kërkim këtu.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ne po vlerësojmë që Komisioni ka të gjithë tagrat, pavarësisht se siç e thatë ju jeni një Komision me tagra pothuajse gjyqësore. Keni të gjithë tagrat për të krijuar bindjen tuaj të brendshme në bazë të materialeve që iu kemi vënë në dispozicion. Në bazë të hetimit të thelluar që kërkojmë të bëni nga ana juaj dhe në bazë të marrjes së provave të konsiderueshme sipas specifikimeve të kërkesës ankimore, keni të gjithë tagrat për t'u vlerësuar lidhur me bazueshmërinë e kërkesës apo jo.

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj që ta sqarojmë përfundimisht çështjen e provës që ju kërkon, pra ju kërkon që ne këtu në KAS të bëjmë një kryqëzim të të dhënave të sistemit TIMS të këtyre formularëve të vetëdeklarimit të personave që kanë hyrë në Shqipëri pas këtij urdhri po ashtu dhe me listat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me Administratën Zgjedhore të ditës së zgjedhjeve dhe në vijim. Për sa i përket Qarkut Gjirokastrë, pra nga ky kryqëzim të dhënash ju

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*


pretendoni që të gjeni shkelje? Në lidhje me përfaqësues që mund të kenë qenë të Partisë Socialiste në këto qendra votimi, apo mbështetës të Partisë Socialiste që nuk kanë plotësuar formularët e vetëdeklarimit janë një sërë provash këtu, nuk është thjesht një provë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Këtu le të mos jetë vetëm një provë, i nderuar zoti Braho, këtu flasim për tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve që është një shkak madhor që t'iu ngarkojë juve me përgjegjësi për një hetim të thelluar edhe kryesisht për marrjen e provave. Edhe në rast se subjekti nuk do të kishte mundësi për të marrë provat siç nuk e kemi pasur ne, ju keni përgjegjësinë administrative për këtë shtet për të dhënë qartësi lidhur me procesin zgjedhor në zonën ose në Qarkun e Gjirokastrës. Jeni një organ i ngritur dhe i konfirmuar nga Parlamenti Shqiptar dhe kërkojmë nga ju të dispononi nëpërmjet një hetimi të thelluar administrativ. Ne e kemi pasur shumë të vështirë për të gjetur dhe në mënyrë informale këto emra apo kemi ndihmuar këtë proces duke vënë në dispozicionin tuaj emra dhe mbiemra të personave dhe detyra për disa prej tyre, detyra që kanë pasur gjatë datës 25 Prill 2021.

**Z. I. Rusmali:** Unë tani nuk e kuptoj dot, ju keni bërë kërkesë për pavlefshmëri zgjedhjesh për Qarkun e Gjirokastrës, ligjërisht kërkesa duhet mbështetej mbi provat që mbështesin kërkesën. Ju po thoni tani që kërkonit të merren prova të cilat ju nuk e dini se çfarë rezultati do të nxjerrin? Por, ju shpresoni që t'iu mbështesin në kërkesën tuaj. Pra, ka ardhur sipas jush kërkesa para provave, ndërkohë që duhet të vinë provat para kërkesës. Kush është raporti midis provës dhe kërkesës që ju keni depozituar?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Zoti Rusmali, ju nuk është se ju mungojnë provat, ju mungon vetëm një nga provat për të bërë plotësimin. Është ndryshe

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

gjëja, pyetja që shtrohet nga ju nuk është ashtu për shkak se ju keni prova të mjaftueshme.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, mbaroje sepse dua ta vazhdoj.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju lutem, në bazë të nenit 223 të Kodit të Procedurës Civile ne kërkojmë nga ana juaj për pamundësi objektive për ta marrë provën. Kërkojmë nga ana juaj të bëni një hetim për marrjen e kësaj prove.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, do ta zgjidhim ne atë. Por, unë dua të kuptoj kush ka qenë orientimi i subjektit kur ka bërë kërkesën ankimore, unë nënkuptova deri tani që ju dispononit një listë prej 500 vetash edhe një listë derivate prej 59 vetash.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Është pjesë përbërëse ajo.

**Z. I. Rusmali:** Derivate. Dakord e asaj, por e ndarë për shkak të një veçorie prej 59 vetash, këto dy lista kuptova unë janë të mjaftueshme si provë për ju për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në bashki dhe pastaj në të gjithë qarkun. Unë e lexova kërkesën ankimore në këtë formë, tani ju thoni këto nuk na mjaftojnë por ne duam edhe disa të tjera që të gjejmë sa mund të jenë realisht?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo, nuk është kështu.

**Z. I. Rusmali:** Janë të mjaftueshme këto 500 veta dhe këto 59 veta për mbështetjen e kërkesës suaj?

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALIELARI*



**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Kërkesa jonë ankimore duhet parë në tërësinë e saj, ju po e veçoni duke i dhënë një konformitet tjetër.

**Z. I. Rusmali:** Tërësinë e të gjitha provave e mora si një grup.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Pikërisht, në tërësinë e të gjitha provave, ne ankimojmë..

**Z. I. Rusmali:** Në të gjitha prova që dispononi ju kërkesa qëndron apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** I nderuar zoti Rusmali po, ne ankimojmë një vendimmarrje e cila..

**Z. I. Rusmali:** Dakord, po është.. me provat që ju dispononi kërkesa qëndron?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po dhe statistikave që ne disponojmë.. që ju dispononi.. jo vetëm që ne disponojmë.

**Z. I. Rusmali:** Saktësisht ato dokumenta, ato prova, ato të dhëna që ju keni shfrytëzuar deri tani janë të mjaftueshme për të mbështetur kërkesën për pavlefshmëri po apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Këto të dhëna kanë qenë të dhëna që ne kemi mundur të aksesojmë. Ne e kemi patur të pamundur për të aksesuar në të gjitha organet shtetërore për shkak të një blloku që na bëhet..

**Z. I. Rusmali:** Dakord por ato mjaftonin për kërkesën për pavlefshmëri apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Kjo është një pyetje sugjestionuese zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Ka dy opsione..

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo, ju lutem! Ju kërkoni që unë të përgjigjem gjithmonë në mënyrën që ju doni t'iu përgjigjem. Ju lutem shumë, mos ushtroni as presion dhe as sugjestionim.

**Z. I. Rusmali:** Më vjen keq. Kam respekt të jashtëzakonshëm..,

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju lutem shumë, më leni kohën dhe unë respektin personal e kam të jashtëzakonshëm. Por, këtu po flasim për interesa të ligjshme të një përfaqësimi që unë..,

**Z. I. Rusmali:** Ka një gjë të rëndësishme në procedurën tonë administrative. Ne si organ administrativ mund.., sepse unë nuk mund të flas në emër të organit. Por, mund ta marrim një provë në shqyrtim edhe nëse ajo nuk i ka ekstremitetet. Nuk është zyrtare. Me procedurën tonë e konfirmoj zyrtarisht provën. Është normale që në listën prej 500 peronash ta përplasim me TIMS. Listën prej 59 personash ta përplasim me listën e votuesve. Nuk ka asnjë gjë të keqe këtu. Por, kjo është një gjë që rri në përputhje me kërkesën tuaj ankimore. Por, të thuash që tani të dhënat e TIMS merreni ju dhe bëni.., kriheni ku të jetë dhe ku mos të jetë. Që të shofim apo kapim ndonjë gjë që na intereson për linjën tonë kjo është të dalësh nga objekti i kërkesës.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nuk e thashë këtë. Unë thashë pikërisht atë që thatë ju.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë ju kërkoni këtë që ne të krehim 500 emrat dhe 59 emrat, dakord.

**Z. L. Braho:** Ka ndonjë pyetje tjetër për palët e tjera ankimuese?

**Z. E. Çefa:** Unë kam një pyetje për përfaqësuesit e Aleancës, PD - AN. Tani meqenëse jemi..., një sqarim është më shumë. Meqenëse jemi tek ballafaqimi i listave. Duke qenë se ju pretenduat që jeni në dijeni të rasteve të votimit të dyfishtë në Qarkun Gjirokastrë. Ky është fenomen i përsëritur rëndom i cili mund të verifikohet nëpërmjet krahasimit nga KQZ-ja të të dhënave në pajisjen PEI apo jo? Nëse e kam kuptuar drejt ju po kërkoni që ne të administrojmë zyrtarisht pra, të bëjmë këtë ballafaqim? Për të përsëritur kolegun të bëjmë një krehje të pajisjes? Të të dhënave të pajisjes PEI për të nxjerrë këtë produkt?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar për pyetjen e cila na jep mundësinë të shpjegojmë edhe qëndrimin tonë lidhur me funksionimin e pajisjes. Por, edhe me atë çfarë kërkohet. Ka patur historikisht në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në kuadër të kërkesave jo vetëm për pavlefshmëri por edhe për rezultat pretendime të natyrave siç është dhe një nga pretendimet e kërkesës sonë ankimore. Pra, votimi i shumëfishtë ose votimit për llogari të personave të tjerë. Për këtë arsye në kuadër të Reformës Zgjedhore u adresua kjo problematik në saj të kërkesës që subjekti jonë kishte bërë. Duke kërkuar implementimin e teknologjisë që do të ishte garantuese për mos parandalimin në masën 100% të këtij fenomeni. Të paktën të shërbente si deterrent. Pra, si motiv vetë frenimi për ata që kishin ndërmend që ta bënin këtë gjë për shkak se si pasoj e implementimit të teknologjisë kjo gjë do të ishte lehtësisht e verifikueshme. Siç besojmë që është ende dhe abuzuesit me të drejtën e tyre të

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimore dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

votës për shkak të difekteve të ndryshme të sistemit joelektronik. Por, siç themi të listave ose të procedurës së votimit ose edhe thjesht për shkak të pavëmendjes së komisionerëve zgjedhor të përballëshin me të gjithë forcën e ligjit. Kodi Zgjedhor e parashikon që një procedurë e tillë mbas procedurës së implementimit të teknologjisë. Pra, të pajisjeve PEI me një masë të madhe të qendrave të votimit edhe me një farë suksesi do të thoja, të kryhet nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nga Komisioneri besoj. Për shkak se pajisjet dhe memoriet e tyre në të cilën përmbahen të dhënat disponohen dhe janë këtu në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Është vetë ligji që parashikon kryqëzimin e këtyre të dhënave. Në një moment që procesi zgjedhor ka përfunduar. Pra, zhvillimi jo prefektiligjet deri në daljen e rezultatit përfundimtar. Por, për sa i përket administrimit operativ të tij. Nuk e dimë nëse ky proces është ende në vijim apo ka përfunduar. Pra, ligji nuk është se parashikon një moment kohor të qartë për këtë gjë. Por, meqenëse teknologjia e lejon le të themi kryqëzimin e këtyre të dhënave dhe i evidenton identitetet për identitet të përdorur. Pra, dy kritere që parashikon teknologjia për ta lejuar zgjedhësin të votoj është numri i tij i identitetit. I cili duhet të jetë ndër zgjedhësit e lejuar që votojnë në atë qendër votimi. Lënia e gjurmës së gishtit si shenjë identifikuese, pra për të zëvendësuar firmën. Jeni në dijeni të rasteve të cilat na janë referuar që në këtë zonë zgjedhore sikundër edhe në zona të tjera zgjedhore ka pasur zgjedhës të cilët kanë abuzuar me të drejtën e tyre për të votuar vetëm në një qendër votimit të caktuar për motive nga më të ndryshmet. Çka përbën shkelje për sa i përket ligjit zgjedhor. Për të evidentuar masën e kësaj shkelje kërkojmë nga ana juaj që kjo provë e cila gjendet në administrimin tuaj të merret të administrohet sipas ligjit dhe të shihet masa e kësaj shkelje. Të cilën e dimë që ka ndodhur për secilën zonë zgjedhore. Pasi një kërkesë e tillë analoge pavarësisht se këtu jemi në shqyrtimin e rastit të Gjirokastrës është e paraqitur në kërkesat e mëvonshme ankimore, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*





**Z. E. Çefa:** Shumë e qartë. Pyetje për Administratën. A kemi ndonjë produkt të kryqëzimit të të dhënave të pajisjes PEI për Qarkun Gjirokastrë? Konkretisht dhe në përgjithësisht për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë?

**Z. Y. Merkaç:** Për momentin nuk mund të jap një përgjigje. Por, jemi duke punuar për këtë.

**Z. E. Çefa:** A ekzistojnë mundësitë objektive që për efekt të shqyrtimit të ankesave ky proces të përqëndrohet fillimisht tek Qarku Gjirokastrë. Në mënyrë që ne të kemi një produkt sa më të shpejt? Sa kohë do të na duhet eventualisht për ta patur këtë?

**Z. Y. Merkaç:** Nuk e di. Ne jemi duke punuar. Jemi duke bërë kryqëzimet. Por, procesi është edhe një proces kryqëzimi kështu që nuk mund të jap dot një përgjigje. Për momentin ndoshta pak më vonë.

**Z. L. Braho:** Zoti Sekretar i Përgjithshëm kush mund të na japë një përgjigje më të sakt në lidhje me këtë? Sepse besoj dikush po merret me këtë proces.

**Z. Y. Merkaç:** Atëherë, dje Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka dalë në një deklaratë dhe ka deklaruar se jemi në proces të kryqëzimit të të dhënave dhe ende nuk ka përfunduar procesi. Kjo është.

**Z. L. Braho:** Këtë e kuptuam që jemi në proces, idea është ku ka filluar. Çfarë qarku? Sa kohë merr një qark si Gjirokastra? Pra, nëse ndërpriten të tjerët të merremi me Gjirokastrën. Meqenëse ka interes për shqyrtimin e kësaj çështje ankimore. Pra, këto janë përgjigjet. Ndoshta me të vërtetë ju nuk i jepni dot

përgjigje. Por, besoj dikush që po merret me këtë çështje mund ta japë një shpjegim që ta dimë edhe ne për elementin kohë.

**Z. Y. Merkaç:** Po patjetër. Besoj shumë shpejt mund të japim përgjigje. Një orë, dy orë ose mund të thërrasim personin që merret me këtë.

**Z. L. Braho:** Dakord, mund ta thërrisni personin dhe ndërkohë e pyesim dhe personin. Unë kisha një pyetje për zotin Merxhani. Në ankimim.. *(diskutime me mikrofon të fikur)*

**Z. K. Bele:** Unë e ndoqa me vëmendje këtë material, i cili është voluminoz. Do të pyes për disa gjetje të cilat u prezantuan në fakt. Ishin më shumë në shkallë kombëtare. Por, mendoj që fokusi ka qenë ose supozohet që në këtë qark janë këto problematika. Për shembull, është tek pika b3. Flitet për intimidimin e Administratës Shtetërore duke mbështetur PS. Janë dy pika, pika 6 dhe 7 për t'u orientuar mos e keni materialin para ju. Sipas ankimit tonë janë faqet 7 dhe 8. Që pak a shumë u lexuan nga ana juaj. Citohet që problematika e drejtorive arsimore. Por, pa dhënë ndonjë gjë konkrete. Për shembull, i është kërkuar thuhet në një pikë këtu në nivele Gjirokastër, Këlcyrë, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë, Dropull është kërkuar të paraqesin nënpunës. Flitet për nënpunës të Administratës, nënpunës civil e saktësoni objektin, pra, nënpunësit civil në Gjirokastër, Këlcyrë, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë dhe Dropull kanë denoncuar presionin e vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të paraqitur një listë me 30 deri në 50 votues. Pra, nënpunësit civil thoni ju në Këlcyrë apo në Libohovë duhet të paraqesin një listë nga 30 deri në 50 votues. Pyetja ime është që a keni ndonjë referim nga vjen kjo e dhënë? Pra, përtej thënies kështu xhenerike kemi një fillim të kësaj? Fillim prove apo një provë?

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit për pyetjen i nderuar. Ne kemi pasur. Sigurisht që Partia Demokratike ka qenë e vetëdijshme për përdorimin masiv që do t'i bëhej Administratës Shtetërore për qëllimet zgjedhore. Për këtë arsye ka qenë i ngritur dhe një grup pune pranë Partisë Demokratike për të evidentuar të gjitha raset. I cili ka marrë në mënyrë të përsëritur denoncime që vinin nga vetë nënpunës civil. Të cilët sigurisht për shkak po themi të frikës që kanë për vendet e tyre të punës. Sepse duhet kuptuar edhe situata ku ata veprojnë. Kanë denoncuar faktin që i'u kërkohej të paraqesnin lista me emra dhe me votues. Nëse doni ne nuk kemi listat po themi që ata kanë paraqitur sepse nuk mund të na vinin në dispozicion listat e familjarëve të tyre. Por, na kanë paraqitur disa tipologji listash të cilat janë pjesë e dosjeve ankimore që ne kemi paraqitur.

**Z. K. Bele:** Jo, ndoshta unë nuk isha ose nuk u kuptuam. Sepse ju keni listuar këtu 7 Bashki apo njësi administrative. Pra, ju për secilën nga këto të 7-ta njësi administrative të cilat i listoni i'u rezulton që i është kërkuar punonjësve nga 30 deri në 50 persona?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për secilin prej tyre i nderuar ne kemi pasur denoncime nga nënpunës civil ku janë kërkuar. Sepse tipologjia edhe njëherë siç e tha edhe kolegu Kaso pak më herët. Tipologjia e shkeljeve ka qenë pothuajse e ngjashme ose e njëjtë në të gjithë territorin. Të gjitha këto bashki ashtu siç edhe në rastet e tjera janë nënpunës civil. Kanë sjellë denoncime qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte. U janë kërkuar lista me votues nga 30 deri në 50 familjarë. Në rastin e Qarkut Gjirokastrë kemi pasur vetëm kallëzime. Në qarqet e tjera ka patur edhe prova që janë shumë më konkrete..

**Z. K. Bele:** E kam specifikisht për këto 6 bashki.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Specifikisht edhe unë po përgjigjem. Për këto 6 bashki ka pasur denoncime nga nënpunës civil. Të cilët sigurisht janë emëruar politikisht që i'u janë kërkuar lista me 30 deri në 50 votes për Partinë Socialiste. Emrat dhe numrat e identitetit të tyre. Siç në fakt u provua dhe nga listat e patronazhistëve. Të të dhënave që mblidhte PS-ja.

**Z. K. Bele:** Dakord. Më fal, është bërë kallëzim penal për këto 7 bashki?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Për këto 7 bashki i nderuar ne kemi bërë denoncime publike për kallëzime penale duhet ta verifikojmë. Por, unë di që për çdo shkelje për të cilat ne kemi konstatuar kemi bërë kallëzime penale. Numri i kallëzimeve penale që ne kemi bërë në Prokurori të rretheve apo në SPAK është 180 kallëzime. Që lidhen sigurisht edhe me rastin e intimidimit dhe kërcënimit ndaj punonjësëve të shtetit.

**Z. K. Bele:** Edhe për zotin Kaso kisha një pyetje ose për ju. U përmend fakti që ose në material relatohet diku 500 mijë emigrant ose 600 mijë emigrant. Mund të jem unë i pasaktë. Diku e lexova 600 ju e thatë 500. Po marrim secilën nga këto dy shifra që mund të jetë për efekt krahsimi. Ju ngrini, arsyetoni dhe pretendoni që janë penguar të ushtrojnë të drejtën e votimit 500 apo 600 mijë emigrant. Në kujtesën time. Mund ta nxjerrim shifrën e saktë. Përqindja e pjesëmarrjes në votim ose numri i përgjithshëm i shtetasëve që kanë votuar në këto zgjedhje në nivel vendi është pak a shumë i ngjashëm. Ndoshta dhe më i lartë se sa zgjedhjet e kaluara. Si e arsyetoni ose si derivoni që këto.. pamundësia për të votuar e këtyre 500 mijë emigrantëve ka ndikuar? Pra, themi që 6 nga këto 500 na vinë në një masë kritike. Nuk e di mund të na e shpjegoni?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit për pyetjen i nderuar. Më jep mundësinë që të risjell në vëmendje të atyre që kanë ndjekur proceset zgjedhore. Një dilemë të tillë analoge. Në të cilën na vë pyetja juaj. Me një rast të ndodhur vitin 2007, në zgjedhjet e vitit 2007 në Bashkinë e Elbasanit. Kur për shkak të tipologjisë dhe të asaj çka ndodhi dhe të masës së paligjshmërisë që ndodhi në atë zonë zgjedhore u detyrua që të ndryshohej dhe Kodi Zgjedhor. Pikërisht në një rast analog. Rasti ka qenë..

**Z. K. Bele:** Kur ishte qarku apo bashkia, komuna?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Jo, ka qenë Bashkia e Elbasanit. Kur diferenca midis dy kandidatëve ka qenë në mos gaboj rreth 600 vota. Një qendër votimi e cila nuk u hap fare. U sabotua procesi votimit në atë qendër votimi. Kishte më shumë se 700 zgjedhës dhe kodi për sa i përketë pavlefshmërisë ishte i qartë. Kur thoshte që duhej që masa e paligjshmërisë të ishte më e madhe se diferenca midis dhe kandidatëve. Ç'ka ishte e qartë në atë rast. Megjithatë, Kolegji Zgjedhor asokohë më një akrobaci jo për t'u përshëndetur. Sipas raportit përfundimtar të ODIHR për ato zgjedhje u fut në një arsyetim analog. Ky është një eufemizëm po ta them..

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Nuk e vlerësoi ODIHR ashtu sikundër nuk e vlerësoi edhe kandidati që iu vodh fitorja në tavolinë por është histori zgjedhore tashmë. U fut në një arsyetim të tillë analog siç bëtë ju i nderuar, Kolegji Zgjedhor tha që po të ishte hapur kjo qendër pavarësisht se janë potencialisht 700 zgjedhës do të kishin votuar aty tek 300 siç kanë votuar në qendrat e tjera dhe 300 ose 400 është më e vogël se 600 një sekond se po sjell në vëmendje atë. Kjo është nga pikëpamja zgjedhore ishte shkatërruese ishte kriminale dhe çfarë bëri legjislatori zgjedhor pastaj e kodifikoi dhe thotë që në qoftë se masa e pavlefshmërisë merr një rast të tillë analog përshëmbull në qendra që nuk hapen thotë nuk votojnë ose pengohen zgjedhësit për të votuar ky Kod Zgjedhor aktualisht, duhet të jenë në Kod Zgjedhor dispozita thotë: merret numri i plotë i zgjedhësve të asaj qendre votimi. Pra, edhe për analogji për të njëjtën dispozitë sa ta përfundoj... për analogji siç e ka dispozitën kodi sot mbrojtëse pra thotë që ku ndodh paligjshmëria sabotohet një qendër votimi që ka 1 mijë zgjedhës nuk mund t'a paragjykojmë dot ne sot do të vij një, do të vijnë 1 mijë , do të vijnë 900, do të vijnë 500. Atëherë legjislatori zgjedhor, Kodi Zgjedhor thotë që merret numri i plotë i zgjedhësve të asaj qendre. Pra në të njëjtën mënyrë duke ndjekur të njëjtën logjikë legjislative, të legjislatorit zgjedhor që kemi ende sot ende në fuqi. Neve duke marrë një shifër zyrtare nga INSTAT, se INSTAT është burimi i kësaj shifre zyrtare nuk mund të paragjykojmë që në qoftë se kjo masë jo proporcionale nuk do të ishte ndërmarrë në një kohë krejt të papërshtatshme në raport me procesin zgjedhor se sa do të vinin. Mund të vinte një ... mund të vinin 20 mijë mund të vinin 500 mijë. Unë barazoj logjikën e legjislatorit .

**Z. K. Bele:** Dakord, 1 mijë zgjedhësit, këndvështrimi ishte shumë i vlefshëm dhe ne na ndihmoi dhe është fat që kemi njerëz me eksperiencë në proces. Po në deduksion logjik ne flasim për një rast kur një QV me 1 mijë zgjedhës nuk u hap. Pra është

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*


kuantifikim i pastër, që të kuptojmë rastin e Gjirokastrës nëse nuk do të ishin hapur 3 QV me nga 700 që është limiti sot, dhe do kishim 2100 zgjedhës të cilët objektivisht nuk mund të votonin në ato 3 QV, atëherë do të kishim një rast pavlefshmërie të ngjashëm me të vitit 2007, ku ndoshta kolegji nuk do të bënte akrobaci, por do kishim rast të pastër. Pra, nëse mandati diferenca e mandatit është 2 mijë vota, nëse kemi 3 QV me nga 700 vota, pra 2100 vota ose 2100 zgjedhës potencialisht jemi përpara pavlefshmërisë. Po këtu po flasim për zgjedhësit në një listë të caktuar në një QV që u hap apo nuk u hap. Ndërsa pyetja ime ishte, kishte të bënte me 500 mij emigrantët, të cilët, të paktën hipotetikisht nuk do vinin ose jo po kjo është një ngjarje probable dhe ka diferencë midis dy ngjarjeve dhe pse shëmbulli juaj vërtet i vlen këtij procesi se na solli në mendje që në fund të fundit i gjithë debati për pavlefshmërinë është një debat që mbështet mbi kuantifikim. Pra, analizohet ligji bashkë me aritmetikën, u penguan një numër X zgjedhësish për të arritur QV por duhet të ketë një gjë që lidhet me një QV jo me 600 mijë zgjedhësit në potencial të paktën kështu e kuptoj unë.

**Z. I. Rusmali:** Për përfaqësuesit e PD-së, në vijim të pyetjes së zotit Çefa, keni statistikë ju për zgjedhësit që kanë votuar më shumë se njëherë?

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Faleminderit! Nuk kemi një statistikë numerike, pasi fenomeni ndoshta nuk ka qenë i kapshëm në masën e tij vizive në të njëjtën mënyrë siç ka qenë në proceset zgjedhore të mëparshme për shkak edhe të rrisë teknologjike por kemi denoncime të shumta, të shpërndara nëpër të gjithë zonat zgjedhore dhe kjo zonë nuk përbën përjashtim.

**Z. I. Rusmali:** Përmbajnë emra të përvetshëm denoncimet, domethënë jo denoncuesi, denoncimet?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Denoncimet përmbajnë emra të përvetshëm por që ne nuk i verifikojme dot, pasi në këtë rast.

**Z. I. Rusmali:** Sa janë emrat e përveçëm që ju thuhet që filani ka votuar dy herë? Sa janë këto persona? Që sipas denoncimeve kanë votuar më shumë se njëherë.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Janë të shumta po nuk mund t'a kontifikojë dot në një shifër për sa i përket këtij qarku.

**Z. I. Rusmali:** Në rregull. E keni mundësinë që në vijim të shqyrtimit të na jepni emrat e përvetshëm të këtyre personave që tek ju kanë ardhur si denoncime si votues më shumë se njëherë.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Në teori mund të raportojmë dhe të risjellim përpara jush denoncimet por për sa kohë që nuk kemi provë shkencore për bazueshmërinë e tyre. Bazueshmërinë le të themi lidhur me identitetin e personave sepse nuk i verifikojmë dot...

**Z. I. Rusmali:** Po emrat e personave se nuk ka gjë....

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** E shohim le të themi këtë provë ose këtë indicie të pa arsyeshme për t'a paraqitur, për sa kohë prova shkencore disponohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pra, gjurma e gishtave që përbën provën biologjike dhe provën shkencore në kuptim edhe të legjislacionit penal i cili do të vij si pasojë në qoftë se do të verifikohen raste të tilla, është plotësisht në dispozicion të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është ndoshta kryqëzuar dhe ndoshta le të themi ndoshta është arritur edhe në përfundimin e plotë. Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Një pyetje tjetër, përsëri në lidhje me temën. Mbase unë i kam kuptuar gjërat gabim dhe shpresoj të më ndihmoni. Një nga argumentet që ju përdorni në të gjitha kërkesat tuaja për pavlefshmëri ka lidhje, unë po e perifrashoj : “Me pa besueshmërinë e sistemit të identifikimit elektronik të zgjedhësve” PEI që i thoni ju.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Është lapsus ai, ju kërkoni ndjesë përpara se t’u shtjellojmë atë argument ai paragraf është lapsus edhe qendrimi jonë mbi teknologjinë është ky që shpreha unë përpara.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë ju i besoni (PEI-t) dhe investigimi nëpërmjet (PEI-t) është i pranueshëm për ju.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Po, po i pranueshëm dhe i besueshëm.

**Z. I. Rusmali:** Domethënë (PEI-t) vetë nuk është i atakueshëm.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Jo, jo absolutisht.

**Z. I. Rusmali:** Në rregull.

**Z. E. Lako:** Kam edhe unë të njëjtën pyetje, që bëra pak më parë edhe për subjektin tjetër edhe për ju zoti Kaso. Që përgjithësisht provat e paraqitura nga subjekti që ju

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Di.12.05.2021*

përfaqësoni janë fotokopje të disa dokumenteve të printuara që pa ekstremitet përkatëse, fotokopje të disa gazetave përgjithësisht këto janë provat ku ju mbështesni pretendimet. Pyetja është që ju edhe kërkonti në ankim që KAS të disponoj provat që mbi të cilat ju mendoni që do provoni çka pretendoni. Është e njëjta pyetje që bëra edhe për subjektin tjetër. Që a nuk keni mundur dot t'i merrni e keni provuar? Nëse e keni provuar, ndonjë dokument që e keni apeluar, keni bërë kërkesë përpara këtyre institucioneve dhe nuk i'ua në vënë në dispozicion këto prova? Pastaj kur të kalojmë edhe tek pjesa e provave një shpjegim për secilën nga provat që pse kërkohet dhe çfarë kërkohet të arrihet me atë provë? Faleminderit!

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Patjetër, faleminderit për pyetjen. Për sa i përket provave që ne kemi kërkuar të disponohen kemi qendrim të ngjashëm me qendrimin e kolegut tonë të Lëvizjes Socialiste për Integrim, gjatë procesit zgjedhor. Ne kemi vërejtur dhe kemi denoncuar një aktivizim krejtësisht të paligjshëm të gjithë institucioneve shtetërore, të cilat ne i kemi përmendur dhe kemi kërkuar në pjesën më të madhe që të merren prova prej tyre, në përkundër asaj çfarë ka qënë ose çka mbetet ende misioni i tyre ligjor dhe thellësisht në mbështetje të një operacioni politik për marrjen e një rezultati elektoral. Në mbështetje të një ministri të caktuar, të një drejtori poste të caktuar në këtë qark, por duke vijuar më tej në qarqet e tjera. Rrugën e bashkëveprimit institucional ose të kërkesës zyrtare institucionale e kemi tentuar gjatë përpara procesit zgjedhor dhe nuk na ka çuar askund. Pra, të gjitha kërkesat tona kanë ngelur pa përgjigje aq më tepër tani, kur kërkesat tona për marrjen e këtyre informacioneve do të ekspozonin në mënyrë domethënëse dhe përfundimtare vlerësojmë ne veprimtarinë e tyre të paligjshëm në raport me misionin e tyre ligjor dhe në ndërhyrje të hapur të procesit zgjedhor. Kështu që duke qënë se ky informacion mund të merret dhe mund të administrohet në rrugë zyrtare nga një

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

institucion i cili vepron si "quazi gjykatë" në bazë të kompetencave që i jep ligji. Ky informacion që ne ërkojmë të merret, vlerësohet si thelbësorë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, pra për verifikimin e pretendimeve tona të shtrira jo vetëm në një qark, siç është qarku i cili është objekt ankimi, por pothuajse në të gjitha zonat zgjedhore pra në nëntë qarqe të Republikës së Shqipërisë, vlerësojmë se institucioni juaj në kuadër të këtij shqyrtimi ankimor por dhe të shqyrtimit të kërkesave të tjera, është i vetmi që mund t'i administrojë këto prova, kur fjala vjen një provë përshembull të parën që kërkojmë në marrjen e një informacioni zyrtar nga "Prokuroria kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar" për numrat procedimet penale lidhur me krimet zgjedhore në fazën e tyre. Neve paravarësisht se jemi, si subjekt furnizuesi më i madh me punë në thonjëza i tyre për gjatë periudhës para zgjedhore ndoshta dhe pas zgjedhore ende nuk kemi mundur t'a sigurojmë. Pra, pavarësisht se vetë kemi depozituar 50 kallzime penale jemi ende në padituri të faktit që sa nga këto kallzime penale janë rregjistruar si procedime, për sa është vendosur mos fillimi. Njihemi për shëmbull po marr rastin e parë për ilustrim vetëm me një deklaratë publike të bërë ditën e drejtësisë përpara dy ditësh nga drejtuesi i prokurorisë kur thotë që kemi nën hetim 40 raste për krim zgjedhor. Ende jemi të paqartë që këto 40 raste, janë nga 50 që kemi ne paraqitur apo janë raste që i kanë filluar kryesisht apo çfarë është bërë me kallzimet e tjera penale. Për shëmbull po marr vetëm këtë rast. Ky është në përgjithësi panorama e bashkëveprimit tonë institucional. Llogaritë kur kjo situatë është me një institucion të pavarur i cili ka si mision të tij krahës luftës korrupsionit edhe tashmë me dispozitat ligjore të ndryshuara garantimin e një procesi zgjedhor pa ndikime dhe infiltrime kriminale. Si mund të jetë nga ato institucione që administrohen drejtëpërsëdrejtë nga persona që janë në konflikt interesi pasi kanë qenë kandidatë qoftë edhe në këtë zonë zgjedhore. Pra, si mund të jetë informacioni që mund të na përcillet, nga Ministria e

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Brendshme kur vetë ministri është i akuzuari numër një nga ana jonë për falsifikimin e rezultatit zgjedhor në Qarkun e Gjirokastrës. Apo si mund të jetë ky informacion nga Posta Shqiptare, ku vetë drejtori i postës në kundërshtim me ligjin që nuk ka dhënë dorëheqjen por tjetër histori kjo, është i akuzuar drejtëpërdrejtë për.....  
(ndërrhyrje pa mikrofon) Në letër po të funksionin do të ishte mirë.

**Z. E. Lako:** Domethënë ju e keni paragjykuar procesin. Keni kërkesa për marrje provash apo ju mendoni që nuk do t'iu jepeshin përgjigje dhe keni lënë KAS-in për t'a bërë punën tuaj?

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Atëhere, ne e dimë që nuk do na jepen përgjigjet nuk është se e mendojmë. Ne kemi provuar përpara procesit zgjedhor që të marrim përgjigje dhe informacion nga këto burime që duhet të jenë zyrtare dhe të hapura dhe nuk kemi marrë. Janë subjekte të treta të pavarura nga ne. Kur ankohen subjekte le të themi ekspozuese dhe denoncuese të veprimtarisë së institucioneve të cilat edhe financohen nga partnerët, që nuk kanë asnjë lidhje me subjektet politike nuk dua të përmend emra këtu të subjekteve. Po janë publike denoncimet e tyre në media që as ata nuk arrijnë dot të marrin informacion, llogarit neve që jemi etiketuar si armiku dhe si ata që nuk duhet të marrin asnjë lloj informacioni.

**Z. K. Bele :** Më fal jashtë retorikës se këto 20 vjet a më shumë që mbaj mend unë Ministrat e Brendshëm, pavarësisht nga krahu politik kanë qenë gjithmonë të dyshuar numri 1, 2 apo 3. Po këtu jemi tek faktet që po i quaj proceduriale. Pra, ju keni qenë subjekt kallzues dhe legjitimoheni në kujtesën time më të mirë të Kodit të Procedurës Penale që të kërkonte informacion mbi kallëzimet dhe në një fazë të caktuar të kallëzimit ju informoheni lidhur me pushimin, mos fillimin, dërgimin në

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

gjqyq apo thireni për të dhënë deklarime sipas rastit. Nga ana tjetër sot jemi përpara një procesi administrativ, të cilin ligjvënësi në një nen të kodit i ka vendosur një afat 10 ditor mbasi lidhet me marrjen e një rezultati ose me përfundimin e një procesi që ka të bëjë me shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve. Pra, nëse ne do të pa e paragjykuar vendimmarrjen e KAS-it. Nëse KAS-i do të kërkonte përgjigjen e disa pyetjeve ku përgjigja shtruese për shëmbull për fatin e një kallëzimi penal shkon, javë, muaj, vite mbasi mund të ketë ecuri të ndryshme. Si mendoni ju që një përgjigje eventuale, pra nëse pyetet prokuroria SPAK-u apo një Prokurori e Gjirokastrës në këtë rast dhe thotë, jam duke e hetuar, ose kam filluar procedimin apo e kam dërguar në gjykatë për pushim sipas procedurës. Si do t'i shërbente kjo pikë procesit? Sepse po flasim për kuantifikim si ai rasti shumë i bukur i Elbasanit që ju sollët me 700 me 1 mijë votuesit. Si do t'i shërbente kjo procesit tonë? Përtej debatit politik për cilësinë e zgjedhjeve në Shqipëri në çdo palë zgjedhje, që mundet raportit të ODIHR apo palëve të tjera i intereson. Si do t'i shërbente procesit tonë këtu? Që në fund të ditës do kuantifikojë ka pasur 2 mij votues që nuk mundën të votonin dhe u penguan të votonin sipas nenit 160 që ne të arrijmë ose jo tek pavlefshmëria. Pra, këtë deshëm të kuptojmë.

**Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së:** Faleminderit! Atëhere, pyetja juaj është pyetje e gjerë dhe do të përpiqem që do t'i përgjigjem sa më shkurt dhe në një mënyrë koncize që të mundem. Si do t'i ndihmonte shqyrtimit tuaj. Unë besoj që shqyrtimi i plotë, i gjithanshëm, i çdo pretendimi të ngritur nga subjektet zgjedhore, do të shërbente për hedhjen dritë të çdo aspekti ende të errët të procesit zgjedhor dhe ky i fundit në mënyrë të veçantë është mbushur plotë të panjohura dhe aspekte që kanë ngelur me qëllim jashtë vemëndjes së publikut. Besoj për zgjidhjen e drejtë të kësaj mosmarrëveshje qoftë të karakterit administrativ siç është shqyrtimi juaj. Janë të

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.12.05.2021*

domosdoshme dhe të nevojshme administrimi i të gjithë këtyre të dhënave. Të gjithë këtyre të dhënave të cilën ju përmendët kohën e shkurtër që iu obligon juve që të ndiqni një procedurë të caktuar administrative. Llogaritni pak nga ana tjetër kohën akoma më të shkurtër që kemi ne për të jo vetëm për të evidentuar gjithë faktet dhe provat por dhe për të paraqitur përpara jush një dosje të plotë le të themi. Kjo na detyron që ne si subjekt zgjedhor , me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kemi, sigurisht që nuk janë të pashtershme, sigurisht nuk janë ato resurse që shteti ka. Sepse në të kundërt nuk do të flisinim për një betejë të pabarabartë nga njëra anë e një partie politike dhe një subjekti koalicioni të rregjistruar, për kundër gjithë fuqisë së shtetit dhe gjithë institucioneve shtetërore të vëna në dispozicion të partisë në pushtet nga ana tjetër. Pra, janë të limituara resurset tona, kemi informacione, kemi indicie, kemi prova, ato që ne konsiderojmë të tilla , kemi edhe prova që nuk i disponojmë që iu kërkojmë juve që me autoritetin që juve ju njeh ligji, ndoshta ju dëgjojnë institucionet dhe ti merrni dhe të zbardhni. Vlerësojmë që të gjitha kërkesat për prova janë në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjeve dhe cilado përgjigje çfarë do lloj përgjigje që të vij nga institucionet lidhur me këto kërkesa e bën më të qartë çështjen për ju, e bën më të lehtë për ju zgjidhjen e mosmarrëveshjes që keni mbi tavolinë. Ju faleminderit!

**Z. L. Braho:** Në fakt e vlerësoj pyetjen e zotit Bele dhe përgjigjen e zotit Kaso. Mendoj që për pjesën e drejtësisë zgjedhore që ne do të japim këtu, nuk besoj se vjen e keqja nga marrja e provave por mungesa e ndonjë prove mund të sillte probleme. Megjithatë ne do i shqyrtojmë provat një nga një , duke përfshirë edhe provën që provat që u kërkuan nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim por meqenëse shoh që ka ardhur.. zoti Sekretar i Përgjithshëm mund të na sqaroni në lidhje me pjesën e kryqëzimit ...

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. Y. Merkaç:** Po, Ervini është personi që mund t'i jap përgjigje pyetjes suaj. Për kryqëzimin e të dhënave.

**Z. L. Braho:** Atëhere, pyetja që kemi. Sot kemi për shqyrtim Qarkun Gjirokastrë, është fakti njohur botërisht tashmë që po kryhet kryqëzimi i të dhënave nga pajisjet PEI. Por edhe Sekretari i Përgjithshëm nuk kishte informacion se në çfarë faze ishte ky kryqëzim ose më konkretisht në çfarë faze është Qarku Gjirokastrë, që ne na intereson tashmë për momentin. Duke qenë se është dhe një nga provat që kërkohet nga subjektet ankimuese, ne kemi interesin të dimë se ku është, në çfarë faze është ky proces dhe më konkretisht për Qarkun e Gjirokastrës.

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Procesi është në vazhdim, procesi i qendërimit se të dhënave dhe krahasimi, për Qarkun Gjirokastrë mund të kemi një raport brenda tre-katër ditëve.

**Z. L. Braho:** Çfarë mund të dali, jo produktin konkret, çfarë prodhon raporti, pra çfarë të dhënash mund të marrim ne nga raporti për 3-4 ditë?

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Nga raporti mund të marrim të dhëna nëse një gisht është vendosur në pajisjen elektronike të identifikimit një herë ose disa herë, ose sa herë është vendosur.

**Z. L. Braho:** Për qendra të ndryshme brenda qarkut të Gjirokastrës.

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Po!

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. E. Çefa:** Kjo shprehja “vendosja e një gishti disa herë”, e kam degjuar edhe Komisionerin në deklaratat e tij publike, dhe unë të paktën kam krijuar një fare konfuzioni. Pyetja ime është vendosja e gishtit nënkupton për ju dhe për pajisjen që është votuar dy herë apo që ka pasur dy tentativa për të votuar nga i njëjti person? Që jo domosdoshmërisht përbëjnë shkelje të ligjit. Unë kam parë të paktën publikisht në ndjekjen në televizion gjatë procesit të votimit edhe të personave publik që jo dy herë por kanë tentuar të vendosin gishtin 7 apo 8 herë dhe pajisja nuk e merrte gjurmën. Pra, domethënë këtë dëshirojë të më sqaroni. Kur ju përdorni shprehjen “tentativa për vendosjen e gishtit disa herë” nënkupton votimin disa herë apo thjesht tentativat edhe të pasukseshme për të votuar? Faleminderit!

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Arsyeja e vendosjes së gishtit ka qenë për të zëvendësuar nënshkrimin. Pra vendosja e gishtit ka nënkuptuar nënshkrimin që ai votues ose ai zgjedhës le të themi është identifikuar dhe më pas ka vendosur gishtin për të nënshkruar. Në raste të caktuara ka pasur operator të cilët për të mbaruar procesin më shpejt, procesin e identifikimit kanë vendosur gishtin e vet për të mbyllur procesin sa më shpejt. Por mund të ketë pasur, supozojmë se mund të ketë pasur dhe raste të cilat është vendosur gishti në rastet e votimit familjar. Këto janë supozime, akoma.

**Z. L. Braho:** Për ta kuptuar, ka raste që është vënë gishti i operatorit dhe jo gishti i votuesit pas identifikimit të votuesit.

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Sipas të dhënave paraqitura po. Është vendosur gishti i operatorit.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Po nga raporti që do të prodhohet për Qarkun e Gjirokastrës meqënëse ai na intereson për momentin, do të jenë të identifikueshme të gjithë rastet se ku janë operatorët, sa herë ka vendosur gishti operatori dhe jo votuesi, në ç'farë intervalesh kohe e tjera, e tjera?

**Z. K. Bele:** Më fal, veç gishtit a vendoset dhe karta.

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Patjetër!

**Z. K. Bele:** Se duket sikur përdoret vetëm gishti.

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Procesi është i tillë, vendoset karta, dhe pas kartës, pasi shfaqet identiteti në pajisjen elektronike të identifikimit vendoset gishti.

**Z. K. Bele:** Pra, ajo që po thoni ju, nëse shtetasi Koli Bele ka vajtur ka vendosur kartën dhe pastaj ka vendosur gishtin, pajisja e ka vonuar dhe nuk e ka njojtur, operatori mund të ketë vendosur gishtin e vet për ta procesuar. E kuptova drejt?

**Z. E. Dushallari, specialist IT, në KQZ:** Pajisja nuk ka bërë verifikim direkt të shenjës së gishtit. Pajisja thjesht ka depozituar, ka marrë, ka ruajtur shenjën e gishtit. Në fund do të dali, domethënë raporti për Gjirokastrën do jetë i tillë, do të kemi shenjat e gishtave, sa shenja gishtash janë unike dhe sa janë përdorur disa herë. Por identiteti në rastin hipotetik kur kemi një shenjë gishti që është përdorur pesë herë, ne nuk e dimë se i kujt është ajo shenjë gishti.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Po ajo identifikohet nga kamerat në qendrat e votimit pastaj?

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Një sekondë, se nga konfuzionet dhe nga hipotezat na dalin pyetje që as i kishim menduar. Na vjen këtu thua s'kam raport, hodhe disa hipoteza për sistemin që edhe vetë nuk je i qartë.

**Z. I. Rusmali:** Nuk ka nevojë.

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Të lutem zoti anëtar. Elementi kontroll është thelbi i sistemit është identifikimi i kartës së identifikimit ky është sistemi. Pra, ajo verifikon që nuk mund të kalosh dot tek gishti nëqoftëse nuk të njihet karta ID-së, dhe ju këtë duhet të verifikoni në fillim. Në një qendër votimi me 500 zgjedhës që kanë votuar 300-të. Janë futur në sistem 300 karta identifikimi? Sa nga këto karta janë njohur nga aparatura? Pastaj gishti është element plotësues, nuk është gishti që të lejon të votosh, është karta.

**Z. L. Braho:** Zoti Saliaini se duket se edhe ju e paskeni të paqartë, mund të ndodhë që nga 300 karta, 50 karta i ka pasur një person dhe 50 herë është vënë gishti i operatorit.

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Jo, jo një sekondë.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Sepse shenjat e gishtave nuk janë të vendosura paraprakisht në paisje. Pra, mundet që dhe votuesi Ledio Braho, të shkojë me 20 karta identiteti, t'i kalojë të gjitha kartat e identitetit dhe të bëhet me gishtin e operatorit dhe timit...

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Jo, jo se kjo e para nuk ndodh se aty janë shtatë anëtarë të komisionit...

**Z. L. Braho:** Atëherë, unë po të them...

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Aty janë shtatë anëtarë komisioni...

**Z. L. Braho:** Nuk ka rëndësi, mua më duhet rezultati...

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Është një kamerë...

**Z. L. Braho:** Nuk ka rëndësi se sa anëtarë komisioni ka, mua më duhet...

**Z. E. Salianji, përfaqësues PS-së:** Nuk mundet që të hedhim një tymnajë këtu tek gishti.

**Z. I. Rusmali:** A do t'ia mbyllësh pak mikrofonin atij..

**Z. L. Braho:** Zoti Salianji, të lutem!

**Z. I. Rusmali:** Tani, ky është një proces shumë serioz dhe ka interes të madh. Ky proces nuk duhet lejuar të devijojë nga objekti i vet. Po shqyrtojmë kërkesat

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

ankimore të tre subjekteve. Me argumentat që ata kanë të cilat do t'i gjykojmë të gjitha seriozisht. Ky proces nuk improvizohet dhe nuk futet në pyll, siç po futet tani. Pyetje, kuptojmë që përgjigjet tuaja janë të improvizuara se nuk keni material dhe janë një pjesë dhe hipotetike, nuk ka problem. Tani unë kam një pyetje për administratën e KQZ-së. Nga ajo dijeni që kam unë për ligjin, ligji i ri ka parashikuar disa instrumenta kontrolli shumë të rëndësishëm, të cilët vihen në funksionim për herë të parë për të kontrolluar transparencën, për të kontrolluar rregullshmërinë e procesit të votimit. Këto instrumenta kontrolli përfshijnë verifikimin e gjurmëve të gishtave nga paisjet PEI. Këto instrumenta kontrolli përfshijnë rinumërimin, hapjen e kutive të votimit në një përqindje të caktuar, me një sistem të caktuar, me një metodologji të caktuar dhe rinumërimin e votave pavarësisht kryesisht nga KQZ-ja. Pastaj përfshijnë dhe mundësinë që të gjitha subjektet e interesuara, të mund, kundrejt procedurave të miratuara, e imagjinoj, të mund të hapin 100% të kutive të votimit, apo jo? A është kështu ligji? Tani kam një pyetje për administratën. Këto procedura kontrolli sipas ligjit në cilën fazë të procesit bëhen? E dini kur bëhen?

**Z. Y. Merkaj:** Këto procedura bëhen pas zgjedhjeve, pasi shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve.

**Z. I. Rusmali:** Pra, pasi shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, kështu thotë ligji?

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. I. Rusmali:** Pyetja e dytë, e dini pse ligji kërkon që këto procedura kontrolli të kryhen pasi të shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve? E di ndonjë nga

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

administrata e KQZ-së këtë gjë? Se ka një motiv për këtë punë. E dini apo jo?! Një motiv po ua them unë. Minimumi për të mos krijuar këtë konfuzion që ne po krijojmë këtu me ndihmën tuaj të çmuar. Qëllimi i leximit të paisjes PEI, qëllimi i verifikimit të votave në kutinë e votimit në 10%, apo në 100% të tyre, qëllimi i verifikimit të numërimit të votave në paisjet elektronike në 10% të tyre, apo në 100% të tyre, bëhet për nevojat e procesit, jo për nevojat e procesit ankimor. Procesi ankimor administrohet me provat që disponojnë subjektet kur paraqesin kërkesat e tyre. Prandaj nuk duhet të shpërndahe mi shumë në dëshirat tona për të pranuar, apo refuzuar gjëra që si përkasin këtij procesi. Ne jemi shumë të interesuar që të shohim të gjitha rastet e votimit të dyfishtë, por rastet e votimit të shumëfishtë nuk na vijnë nga subjektet zgjedhore dhe ne do t'i verifikojmë me aq prova sa kanë ata. Ne do t'i verifikojmë provat, jo rastet! Kjo është procedura e hetimit administrativ. Ne verifikojmë provat, jo rastet! Ne nuk jemi këtu për të marrë kazmën e lopatën e për të punuar qelizëm gjithë territorin e Shqipërisë. Ne jemi këtu për të bërë hetim administrativ mbi bazën e kërkesave të palëve dhe mbi bazën e provave që paraqesin palët. Kështu që ju lutem shumë ne si KAS ta alokojmë gjithë debatin rreth teknologjisë ke vendi që i ka caktuar ligji dhe të përqëndrohemi te hetimi serioz i kërkesës, e cila ka nevojë për hetim serioz. Minimumi në respekt të subjektit që e bën dhe të atyre qindra mijëra votuesve të vet. Hetim serioz të kërkesës. Nuk ka nevojë të improvizojmë ndërhyrje bombastike në proces dhe pastaj devijime nga objekti.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali, faleminderit për të gjithë sqarimin, tani ligjin e njohim të gjithë, por ideja është që unë e citova dhe kur bëra pyetjen ndaj ekspertit që erdhi si pjesë e administratës. Tashmë është fakt i njohur botërisht, ka komunikime për publikun si nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ashtu dhe nga Nënkomisioneria

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Shtetërore që po bëhet kryqëzimi I të dhënave. Paisjet PEI janë materiale zgjedhore. Duke qenë se janë materiale zgjedhore, duke qenë se po bëhet dhe kryqëzimi i të dhënave është e drejtë e secilit anëtar të KAS-it që të kërkojë këqyrjen e këtyre materialeve. Pra, të kërkojë materialin e kryqëzimit, apo dhe paisjen PEI në ndonjë rast specifik për të parë se si ka operuar dhe çfarë produkti ka ardhur. Kjo s'ka lidhje fare me improvizime, apo me pretendime bombastike. Subjekti ankimor ngriti një pretendim, nuk besoj se ka ndonjë mënyrë tjetër për ta provuar votimin e dyfishtë, apo të shumëfishtë, përveç se kësaj, në fund të fundit ky ishte dhe qëllimi i paisjes PEI së bashku me kamerat në çdo qendër votimi.

**Z. I. Rusmali:** Siç e kuptova unë gjithë këtë që ndodhi në këtë moment janë këndvështrimi ligjor. Ne ndërpreme shqyrtimin administrativ për t'u marrë me një provë të vetme, për të marrë dëshminë e një punonjësi të KQZ-së. besoj e kam kuptuar drejt! Ishim në seancën e pyetjeve për palët. Ne nuk kemi përfaqësues të institucionit drejtorin teknik të IT-së, apo punonjësin e IT-së. Punonjësi i IT-së vjen me cilësinë e një dëshmitari. Tani...

**Z. L. Braho:** Ne nuk e thirrëm për dëshmi atë! E thirrëm sepse Sekretari i Përgjithshëm nuk kishte asnjë lloj informacioni se çfarë bëhet në atë proces.

**Z. I. Rusmali:** Më fal, ne jemi në momentin kur po shqyrtojmë provat, apo jemi në momentin kur po pyesim palët rreth pretendimeve të tyre? Na e saktësoni këtë se unë kam prova të tjera që mund t'i shqyrtojmë.

**Z. L. Braho:** Patjetër, të gjitha provat, zoti Rusmali, ua lejon ligji që t'i shqyrtoni.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Atëherë, kthehemi tek momenti i pyetjeve për palët dhe e falenderojmë për zemërsisht atë djalë të shkojë e të vazhdojë tek puna e tij, por ne duhet të jemi rigorozë në punën tonë.

**Z. L. Braho:** Shumë rigorozë po tregohemi, më rigorozë se kaq, nuk besoj se ka.

**Z. I. Rusmali:** Unë vërejtjet e mia nuk i kisha për KAS-in, i kisha për administratën e KQZ-së që na improvizoi shfaqjen këtu. E mbylla komentimin tim besoj në mënyrë shumë korrekte në raport me ligjin. Administrimin e provave, kërkesat për marrje provash të reja, vendimet për marrje provash të reja, i përkasin një momenti të mëvonshëm, që ne do ta trajtojmë bashkërisht, por nuk i përkasin këtij komenti.

**Z. L. Braho:** Patjetër, unë nuk kërkova provë në këtë moment, as nga administrata. Nuk administrova provë. Unë kërkova informacion siç kërkoi dhe zoti Çefa në lidhje me procesin e kryqëzimit, që ta dijmë që në momentin që do të vendosim për të marrë prova apo jo, a është një provë e mundur për t'u marrë apo jo? Nga dëshmia rezultoi që për Qarkun Gjirokastrë këtë provë mund ta marrim brenda tre-katër ditëve. Patjetër zoti Rusmali, por po jap edhe unë sqarime, sepse u hodhën akuza dhe po ju sqaroj. Nuk kisha në mend të merrja asnjë provë, thjesht doja të sqaroja amundet të mërret si provë, apo jo? kaq! Vazhdojmë tani! Ka pyetje të tjera për subjektin ankues Partia Demokratike? Në qoftë se s'ka, unë kam një pyetje për kandidatin e pavarur, subjektin zgjedhor zotin Kreshnik Merxhani. Në ankimin tuaj, në pikën 6 të tij, gjendet një fjali e tipit "konfigurimi i fletës elektronike të votimit që u përdor në ditën e zgjedhjeve në 32 qendra të votimit të Gjirokastrës.."

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Është lapsus, ndjesë.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Pra, ky paragrafi është lapsus nuk ka lidhje me Qarkun Gjirokastër?

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Po, po!

**Z. L. Braho:** Dakord! Pyetje tjetër?

**Z. K. Bele:** Kisha dhe unë një pyetje për zotin Merxhani. Do më paraqiten disa fletë të printuara, janë.. nuk i numërova dot të gjitha, por do t'i shoh.sipas jush që i keni sjellë, të gjitha këto printime, është një fletë votimi e ndryshme, apo është e njejta e printuar disa herë?

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Ka orën atje..., ka tavolinën dhe orën.

**Z. K. Bele:** Në fakt ora nuk është se duket, duket data.

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Po kemi vënë minutazhin atje se kur i kemi marrë..., ndoshta..

**Z. K. Bele:** Po ju pyes sepse nga një vështrim i këtyre të printuarave, më duket se 5, apo 6 herë është e njejta gjë..., mund ta kem gabim ndoshta..

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Nuk e besoj, se janë verifikuar të gjitha. Janë të veçanta nga qendra votimi të ndryshme.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jon DERVISHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. K. Bele:** Dakord, faleminderit!

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Pyetje tjetër, ju lutem? Në qoftë se jo, mund të bëj unë një koment. Ne kemi vendosur në provë tre video të cilat janë shumë të qarta me atë që po ndodh në Qarkun Gjirokastrë...

*Pa mikrofon!*

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Mos u shqetësoni zoti Rusmali! Në qoftë se keni ndonjë koment ju?!

**Z. I. Rusmali:** Ndërpriteni pak atë! Ka procedurë, këtu kemi gjithë të drejtën të thuash të gjitha gjërat që do ti. Do t'i thuash në momentin që i takon. Mbaj shënim, do të të jepet fjala kur të vijë puna tek pretendimet përfundimtare dhe bëje çarçaf i dashur, por jo koment në këtë fazë.

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** U kuptua, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Atëherë, ju keni ndonjë kërkesë për prova të tjera? Përveç atyre që ke sjellë vetë dhe këtu mund të sqaroni dhe provën.. atë cd, dvd-në që gjendet bashkëlidhur provave. Aty janë video të marra nga KQZ-ja? Apo janë dhe video të tjera që ju i keni siguruar nga burime të tjera?

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Jo, ne kemi respektuar burimin zyrtar atë të KQZ-së për të vërtetuar atë që ne kemi konstatuar prej vëzhguesve tanë.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit!

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Faleminderit ju!

**Z. L. Braho:** Pyetje të tjera, ka?

**Z. E. Çefa:** Në ankimin tuaj ju keni referuar që sipas informacionit që ju keni në Qarkun Gjirokastrë në ditën e votimit kanë qenë rreth 17000 persona të infektuar me Covid. Doja ...

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Ndjesë i dashur, është një koment i përgjithshëm për gjithë Shqipërinë kjo dhe është detyësore siç e përmenda dhe në fjalën time. Në fjalën time e përmenda shumë qartë që parësore për ne janë provat filmike që kemi dorëzuar këtu dhe nuk i ndryshojmë atij.. detyësoret janë detyësore për mua.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit, faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, unë do të doja nga një koment ligjor nga të tre subjektet, se ndoshta na ndihmon ne. Pavarësisht se të tre mund të mos kenë lidhje që të gjithë bashkë me çështjen. Ne kemi në shqyrtim si prova bashkëlidhur një pjesë të kërkesave, kemi dhe kallëzime penale. Tani, sigurisht që ne do të bëjmë analizën tonë ligjore të raporteve midir rolit që ka KAS dhe rolit që ka prokuroria në raport me trajtimin e kallëzimeve penale. Ju vetë shihni pengesë për KAS-in që të merret dhe të analizojë kallëzimet tuaja penale, apo nuk e konsideroni që ka pengesë, ne mund të merremi me to? Secila palë mundësisht!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** I nderuar, ne kallëzimet penale i kemi depozituar, sepse një nga pretendimet tona kryesore si pala ankuese, ka të bëjë me manipulimin e vullnetit të zgjedhjes nëpërmjet blerjes së votës. Sigurisht kallëzimet penale përmbajnë të dhëna dhe informacione që bazohen pikërisht në këto pretendime. Disa kallëzime penale kanë qenë të shpëruara edhe me fakte konkrete, për të ditur se cili ka qenë vijueshmëria e këtyre kallëzimeve penale. Në qoftë se këto kallëzime penale kanë pas produkte të caktuara. Pra, kanë arritur të provojnë si rezultat i hetimeve të prokurorisë: vjedhje, blerje votash, manipulime të caktuara, në qarqe të caktuara. Meqenëse jemi në rastin e Gjirokastrës, kjo është arsyeja që ne kemi kërkuar zyrtarisht institucioni juaj t'i drejtohet prokurorisë së posaçme kundër krimit dhe korrupsionit dhe prokurorive të rretheve për të marrë informacion që këto kallëzime penale janë të regjistruara dhe cila është faza e tyre.

**Z. I. Rusmali:** Pyetja që kam është shumë e thjeshtë!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Edhe përgjigjja që kam është shumë e thjeshtë, por ju duhet ta dëgjoni.

**Z. I. Rusmali:** Nuk po kërkoj çështjen tuaj për marrje prove! Nuk po kërkoj administrimin e provës, të asaj që kërkon. Po kërkoj vetëm arsyetimin tuaj juridik, ka pengesë për KAS-in, që KAS atë që ju keni paraqitur si provë, 5, apo 15 kallëzime, nuk e di sa keni për qarkun, ta marrë ta shqyrtojë, apo po ndërhyjmë në punën e prokurorisë. Më thoni ka pengesë? Ta regjistroj vlerësimin tuaj! Më thoni nuk ka pengesë dhe unë mbaj shënim vlerësimin tuaj. Kaq e thjeshtë është pyetja, nuk ka fare nevojë për provat.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** I nderuar, kompetencat ndërmjet KAS-it dhe kompetencat ndërmjet prokurorive janë të qartazi të ndara. Ne nuk i kërkojmë KAS-it që të fillojë ndjekje penale, të kërkojë burgimin e njerëzve dhe kështu me rradhë. KAS-i e bazon veprimtarinë e tij mbi Kodin Zgjedhor, prokuroria e bazon veprimtarinë e saj mbi Kodin e Procedurës dhe mbi Kodin Penal. Blerja e votës i nderuar është shkelje e nenit 78, pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe në këtë këndvështrim duhet parë, analizuar, lexuar kallëzimet tona penale, ndërkohë që blerja e votës është po ashtu vepër penale mbi të cilët heton SPAK-u. Pra, ne nuk i kërkojmë SPAK-ut të arrijë në konkluzione që i takojnë organit të prokurorisë. KAS-i duhet të shqyrtojë të gjitha shkeljet që i janë bërë Kodit Zgjedhor dhe në rastin e blerjes së votës ka një parashikim të qartë siç është neni 78 i Kodit Zgjedhor.

**Z. I. Rusmali:** Shumë e qartë, shumë faleminderit! Që ta plotësoj me të gjitha gjërat, praktikisht deduksioni im nga përgjigjja juaj dhe duhet të ma konfirmoni, ose të ma përgënjeshtroi është që: ju keni vendosur si prova kallëzimet penale për të referuar tek faktet që përmbajnë ato dhe tek asgjë tjetër. Pra, në vëmendjen tonë duhet të rrijnë faktet që përmbajnë kallëzimet penale.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Absolutisht!

**Z. I. Rusmali:** Në gjykimin e subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ashtu siç relatoi dhe përfaqësuesi i Partisë Demokratike është në rëndësi të procesit.. ka një rëndësi madhore zoti Rusmali, meqenëse pyetjet na i bëtë ju, që ky organ kolegjal në të cilin ju jeni një prej

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DËRVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve  
Di.12.05.2021*

anëtarëve të veprojë pa vonesë dhe të gjitha kërkesat e parashtruara nga ana e subjekteve zgjedhore ankuese në këtë rast, me qëllim dhënien e një drejtësie në vendimmarrjen e saj, nëpërmjet krijimit qoftë edhe të bindjes së brendshme nëpërmjet materialeve që do të administrojë. Daljes në një konkluzion sa më objektiv të kësaj vendimmarrjeje. Në mënyrë që qytetarët shqiptarë të kenë të drejtën që vota e tyre të adresohet atje ku ka qenë vullneti i tyre. Në mënyrë që vota e tyre të mos vidhet, të mos manipulohet, të mos tjetërsohet nëpërmjet veprimeve të ndaluara me ligj të cilat kanë pas dhe përgjegjësi penale. Jam dakord me kërkesën e bërë nga Partia Demokratike që të administrohen gjithë kallëzimet penale. Qoftë dhe kallëzimi i bërë nga zoti Tavo në datën 25.04.2021, ora 11:50, për persona të posaçëm të cilët kanë ushtruar detyra zgjedhore dhe kanë qenë në kushtet e një vetëkarantinimi të detyrueshëm sipas urdhërit të ministrit, faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! Pra edhe ju thoni që nuk ka pengesë për KAS-in që t'i marrë dhe administrojë si prova kallëzimet penale. Zoti Merxhani, ju?!

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Pyetja ishte juridike, unë nuk jam jurist, kështu që do të më duhet të konsultohem, faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit ju!

**Z. L. Braho:** Që ta kuptojmë saktë çështjen e kallëzimeve penale. Është e vërtetë dhe nuk na pengon askush që KAS të procedojë penalisht, të dënojë apo të burgosë komisionerë, apo këdo qoftë që është përfshirë në të tilla afera. Patjetër që atje ku shohim që nëpërmjet veprës penale kemi detyrim ligjor për të bërë kallëzim, por meqenëse ankesat janë ngritur për pavlefshmëri të zgjedhjeve në qendra votimi, apo

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

në zona zgjedhore, ajo që desha unë një sqarim nga palët se më mbeti e paqartë nga përgjigjet e që i dhanë anëtarit Ilirjan Rusmali, ka të bëjë me, shkeljet ligjore janë vetëm shkeljet e Kodit Zgjedhor, apo shkelje të legjislacionit në tërësi? Sepse neni 160 flet për ligj, nuk flet për Kod Zgjedhor. Kështu që është e udhës ta sqaroni, sepse pretendimet qenë nga më të shumtat. Nga urdhëri për karantinën i ministrit të shëndetësisë dhe deri tek gjithë pretendimet e tjera që u ngritën nga Partia Demokratike, apo dhe nga kandidati i pavarur. Kështu që është me vend të sqarohet kjo edhe a janë këto shkelje ligjore elementë që mund t'i marrim ne nga kallëzimet penale që ju keni sjellë në cilësinë e provës këtu në KAS?

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Neni 160 i Nderuar që sigurisht duhet t'i referoheni për çështjet e pavlefshmërisë, e thatë me të drejtë, nuk flet vetëm për shkeljet e ligjit zgjedhor, por për shkeljet e ligjit në përgjithësi. Pra, ka dy kritere në vlerësimin tonë në një analizë ligjore. Së pari duhet të ketë shkelje ligji e dyta, sigurisht duhet të lidhet me procesin zgjedhor. Pra, shkeljet e caktuara, pavarësisht se mund të jenë shkelje të ligjit, ndoshta në momente të caktuara nuk lidhen me procesin zgjedhor. Ato që ne kemi sjellë dhe paraqitur janë të gjitha shkelje të ligjit që lidhen drejtë për drejtë me procesin zgjedhor. I tillë është rasti i shitblerjes së votës. Të tilla janë rastet e përdorimit të paligjshëm që i janë bërë administratës publike. I tillë është përdorimi i paliogjshëm i të dhënave personale, sepse të dhëna personale të qytetarëve nuku përdorën për qëllime të tjera përveçse zgjedhore në shtabet elektorale të PS-së. I tillë është po themi ndalimi i emigrantëve, sepse prodhoi një pasojë të drejtë për drejtë, meqenëse këtu jemi në kërkim të pasojës, që ndaloi potencialisht 500000 zgjedhës sipas INSTAT-it që të vinin e të ushtronin të drejtën e tyre. I tillë është të themi edhe raste të tjera që janë denoncuar nga ana jonë. Pra, shkelje të ligjit kudo që ka pasur, me kusht që ato të kenë ndikuar procesin

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

zgjedhor. Kjo ka qenë logjika që kemi ndjekur në kërkimet tona. Kjo ka qenë edhe logjika që ne kemi ndjekur në paraqitjen e kallzimeve penale duke treguar fakte të cilat sigurisht përbëjnë shkelje të legjislacionit penal, por përbëjnë shkelje edhe të Kodit Zgjedhor, për të cilat veçanërisht KAS-i është organi ekskluzivisht kompetent për t'i shqyrtuar. Nuk ka në dijeninë time më të mirë, organ tjetër kompetent, përgjegjës në shkallë të parë të themi, instancë të parë, përveç KAS-it për të shqyrtuar shkeljet e Kodit Zgjedhor.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Këtu, jo vetëm që kemi qenë në prezencë të shkeljeve të përsëritura të karakterit të rëndë të ligjit, por kjo paligjshmëri është ngritur në nivel kushtetues, ashtu siç e relatova dhe më parë, në bazë të vendimit të mosvijimit të shqyrtimit të kërkesës tonë për marrjen e sigurimit të padisë dhe vetë Gjykata Administrative e Apelit e ka ngritur në një nivel kushtetues këtë çështje. Kemi pas shkelje të nivelit kushtetues të cilat kanë kulmuar me mohimin e të drejtës për të votuar të qytetarëve shqiptarë. Kjo është shumë e rëndësishme për t'u mbajtur parasysh, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Dakord, faleminderit! Ka ndonjë gjë tjetër për t'u sqaruar nga anëtarët e KAS përpara se të kalojmë tek provat, ose në qoftë se propozoni të bëjmë një pushim dhe pastaj të vijojmë me provat, meqenëse ora është 13:30 dhe kemi filluar që në orën 09:30? Të bëjmë një pushim 60 minuta? Pastaj duhet të shqyrtojmë provat që janë sjellë, provat që kërkohen, pra do të marrë kohë dhe ai si proces. Ne vendosëm që të bëjmë një pushim 15 minuta, të kthehemi përsëri të diskutojmë në lidhje me provat, në mënyrë që të shohim se si do të vijojmë me procesin. Atëherë, shihemi në orën 13:45, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



**Rifillon Mbledhja**  
**Ora 14:08**

**Z. L. Braho:** Atëhere çelim seancën e shqyrtimit administrativ për Kërkesat Ankimore me numër 33, 41 dhe 52 respektivisht subjekteve zgjedhore Lëvizja Socialiste për Integrim, Koalicioni PD - AN dhe kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish, zoti Kreshnik Merxhani dhe me subjekt të interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë. Të gjithë palët janë përveç zoti Kreshnik Merxhani. Është e pranishme dhe administrata e KQZ-së. Siç e lamë kur mbyllëm seancën më parë, do të diskutojmë në lidhje me provat. Një e nga një, provat që palët kanë sjellë dhe provat që ato palët që kërkojnë kanë argumentat e tyre në lidhje me kërkimin e këtyre provave në mënyrë që të arrijmë në një vendimmarrje. Fillojnë me rradhë nga zoti Kaziaj që është përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zoti relator! Atëhere siç shihni në faqen e fundit të ankimimit tonë, ne kemi regjistruar provat që kemi depozituar në KAS, të cilat i citoj:

Vendimi nr.347, dt.04.05.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Rekomandimin e avokatit të popullit me nr. 222 dt.21.04.2021.

Rezultatin e Zgjedhjeve për Kuvendin 2021 Bashkia Dropull.

Rezultatin e Zgjedhjeve për Kuvendin 2017 Bashkia Dropull.

Kallëzimi penal i Kandidatit për deputet zoti Vangjel Tavo lidhur me përfshirjen e disa komisionerëve të subjektit politik Partia Socialiste të personave të ardhur nga Greqia.

Dokumentacion provues i QV-së nr. 42, 52 numër rendor 42, Qarku Gjirokastrë ku pasqyrohet se anëtarët e kësaj KQV-je janë shtetasit e kallëzuar. Ju keni emra por



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

për efekt të ligjit unë nuk po i përmend, të cilët kanë ardhur në kundërshtim dhe janë vënë në dispozicion të kësaj partie, në kundërshtim me urdhrin për t'u vetkarantinuuar të Ministrit të Shëndetësisë.

Pyetësi i Ministrisë së Brendshme për personat që kthehen nga zonat e prekura nga COVID-19.

Peticioni i shoqatave shqiptare, i emigrantëve në Greqi. Letër e institucionit të Presidentit të Republikës nr. 14, 13\2 protokolli dt. 22.04.2021.

Listën që unë gjatë shqyrtimit paraprak jua vura në dispozicion me emrat përkatës të shtetasve që mendojmë dhe kemi indicie të mjaftueshme që janë futur në Republikën e Shqipërisë dhe nuk janë vetkarantinuuar në bazë të urdhrin. Po ashtu dhe donim që KAS për pamundësinë objektive që kemi pasur si subjekt politik, ti drejtohet me qëllim marrjen e provës Drejtorisë së Policisë për Kufirin dhe Emigracionin dhe përkatësisht për pikat kufitare Qafë Botë, Kakavijë, Qafë Thanë, Kapshticë lidhur me marrjen e informacionit të mjaftueshëm për kalimin e shtetasve nga data që urdhri është bërë efektiv ose më mirë nga data që Komiteti Teknik i Ekspertëve ka dalë publikisht me thënie zyrtare në televizion, në informacion publik dhe ka filluar ndalimi i shtetasve për të aksesuar në Shqipëri.

**Z. L. Braho:** Më thuaj periudhën që ti ke për qëllim të kërkosh.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Zoti Braho urdhri i ministrit është publikuar në fletoren zyrtare ditën e merkurë, dt. 2 prill 2021, ndërkohë që mban nr. 219 dt. 19.04. Pra, ne mendojmë se nga data 19.04, kur në deklaratë publike Komiteti Teknik i Ekspertëve për Shëndetësinë ka sugjeruar marrjen e këtyre masave dhe Ministri e ka konkretizuar këtë nëpërmjet nje akti administrativ zyrtar ose një akt normativ. Në këtë rast, ne mendojmë nga 19.04 deri në datën e zgjedhjeve se dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

vet dita e zgjedhjeve ka qënë në fokus tërheqës nga ana e Partisë Socialiste, të mbështetësve të vet, në mënyrat që ajo ka mundur të bëjë, qofshin këto të ligjshme apo të paligjshme. Administrimin e pyetësorit pranë këtyre pikave kufitare që shpreha në pikën 1 të kërkesës për marje prove të të gjithë shtetasve që kanë kaluar nga këto pika kufitare, kanë nëshkruar dhe kopje e tij është lënë pranë organeve policore, në mënyrë që të bëhej kqyrja e këtyre shtetasve sipas ndalimit të këtij urdhri. Po ashtu kërkojmë nga ana juaj të merni informacion lidhur me kallzimin e bërë nga përfaqësues i LSI-së zoti Vangjel Tavo pranë organit procedues të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër që mban datën 24.05.2021 ora 15:50 me emra të posaçëm, për efekt të ligjit unë nuk po i përmend, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Dakord me të gjitha këto që relatuat dhe qëllimin që i kërkon këto është për të provuar...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Qëllimi që kërkohet është shterues në kërkesën tonë ankimore z. Braho, kërkon në ekstrem arritjen e qëllimit final të ndikimit që ka ardhur për efekt të shkeljeve ligjore të rënda të parashikuara në nenin 160 të Kodit Zgjedhor të cilat sipas nesh ka arsye të mjaftueshme për të krijuar bindjen në bazë të provave të këtij komisioni për të marrë në shqyrtim kërkesën dhe për të vendosur për pranimin e saj lidhur me ndryshimin e vendimit 347 të Komisionerit dhe shpalljen e pavlefshmërisë në këtë qark që ne kemi ankimuar, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Për të plotësuar dhe diçka në lidhje me këto formularët që kërkon, listën nga sistemi TIMS, nga pyetjet dhe përgjigjet që bëtë me z. Rusmali më parë, thatë që kërkon nga këto emra që keni sjellë, ndërkohë nga mënyra se si e kërkuat

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

tani rezulton se doni në tërësi gjithë qytetarët shqiptarë që kanë hyrë nga data 19 deri në 25 dhe të gjithë formularët e vetdeklarimit që janë plotësuar. Pra, provat i doni vetëm për këtë listë apo doni të gjithë çfarë kanë hyrë?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Për qartësi të procesit në këtë rast kërkojmë vetëm qytetarët shqiptarë në tejkalim dhe të asaj liste të cilët janë futur në këto datat që unë specifikova, por që kanë të bëjnë me qytetarët që jetojnë dhe votojnë në qarkun e Gjirokastrës, që ta limitojmë pak punën e shtetit në vënien në dispozicion të materialeve, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Të dimë se kjo shkon kundër qartësimi, tani kërkon dhe vendbanimin, ose më sakt në çfarë qëndrash votimi janë gjithë bashkëqytetarët që kanë hyrë në TIMS dhe të bëjmë ne filtrimin se kush është i Qarkut të Gjirokastrës e kush nuk është. Pastaj kush është i Qarkut Gjirokastër a ka bërë formular të deklarimi, a ka votuar, a ka qënë komisioner? Pra ta qartësojmë pak këtë që edhe në rastin hipotetik që do të kërkohen këto prova, duhet të dimë se çfarë ndodh më tej me këto prova? Duhet të bëjmë seancë tjetër për të analizuar provat apo mjafton që të marim provat?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Unë mendoj që e lehtësova punën tuaj, deri diku dhe punën e organeve që ju do u drejtoheni për të na vënë në dispozicion vetëm një pjesë të tyre, pra duke limituar këtë kërkesë tonën vetëm për momentin për Qarkun e Gjirokastrës. Do ta ketë më të lehtë edhe shteti Shqiptar nëpërmjet Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit që të vërë në dispozicion vetëm këto prova që ne kërkojmë të marim dhe jo për të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Mbase në një moment të dytë do të na lindë e drejta për të kërkuar dhe në kërkesat e tjera ankimore për qytetarët e tjerë, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*



**Z. L. Braho:** Faleminderit, ka ndonjë pyetje nga ndonjë nga anëtarët?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Dëgjova kërkuesin. Në asnjë prej kërkimit të provave nuk vura re që ai të kërkonte provë dokumentacion zgjedhor, atë çka vërtet kërkon neni 136 e vijues i Kodit Zgjedhor, 160-ta për pavlefshmëri, pra kërkon pavlefshmërinë e qendrës së votimit. Do të thotë të vërtetojë faktet dhe shkaqet përse ka ndodhur shkelja e ligjit. Pothuajse të gjithë provat janë hipotetike, në kuptimin e fjalës provë nuk janë prova. Kallëzimi penal nuk është provë, është thjesht një kallëzim i dikujt për të kërkuar hetim. Pra këtu s'mund të thuash mere kallëzimin penal, mere fute provë se vet kallëzimi nuk përbën provë. Deklaratat e shtetasve, të cilët kanë kaluar në kufij, edhe ato në vetvete nuk përbëjnë provë. Për sa i përket personave të cilët kanë kaluar kufirin dhe kjo nuk është provë që lidhet me procesin zgjedhor. Pra institucioni i KAS-it duhet ta futi procesin , pavarësisht se gjatë gjithë shqyrtimit administrativ këtu nuk u fol vetëm për pavlefshmëri të qendrës së votimit në gjithë ankimin, në asnjë parashtrim, as Lëvizja Socialiste për Integrim si ashtu dhe të Partisë Demokratike, nuk u tha në asnje rresht se në këtë qendër votimi, kjo duhet të shpallet e pavlefshme për shkak se ka ndodhur kjo shkelje. Kjo qendra e votimit duhet të shpallet e pavlefshme se mungojnë kaq zgjedhës që duhet të vinin nga Greqia. Nuk u fol për këtë çfarë kërkon Kodi Zgjedhor dhe hapësira ku po gjykohet ky proces nuk është në dispozitat që përmban kodi. Dhe ju lutem dhe për praktikën që do të ndiqni në vijim ju duhet të merni prova vetëm provat të cilat janë prova të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prova të cilat kanë lidhje me procesin zgjedhor, që janë material zgjedhore, kuti votimi, listë zgjedhësish siç ka ndodhur. Ky është një proces që kemi me vite këtu që gjykojmë dhe është hera e parë që nuk kërkohet vendimi, minimum vendimi i KZAZ-së i cili ka shpallur votimet, as libër



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Di.12.05.2021*

protokolli. Pra, në të gjitha KZAZ-të duhet së paku të kërkonte librat e protokolleve të KZAZ-vë që kanë marrë procesin administrativ. Nuk kërkohen këto dokumentacione zgjedhore. Pra, ketu kërkohet pavlefshmëri dhe nuk kërkohet provë, dokumentacioni zgjedhor por kërkohen kallëzime, deklarata politike etj... Prandaj ju ftoj që nëqoftëse do ketë kërkesë për provë dokumentacion zgjedhor patjetër që ja pranoni dhe t'ia shqyrtoni. Nëqoftëse ka kërkesa për prova të cilat nuk janë pjesë e shqyrtimit administrativ zgjedhor ju duhet ta refuzoni marrjen e tyre, për arsye se nuk e ndihmojnë procesin por e zvarrisin dhe e dëmtojnë atë, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Zoti Salianji faleminderit për sugjerimin. Ne besoj se e njohim ligjin, e dimë se çfarë mund të kërkohet, por kërkesa që bën pala për prova është ekskluzivitet i palës, ndërkohe që pranohet apo nuk pranohet ajo është vendimmarrje e KAS-it. Nuk është e vërtetë ajo që thoni ju që ne mund të kërkojmë vetëm prova nga materialet zgjedhore sepse neni 137 njih mundësinë dhe të organeve të tjera për të vënë në dispozicion prova kur ato kërkohen nga KQZ-ja. Dhe besoj se dhe provat që i referohen palët janë prova që kërkohen nga organe të tjera por që sipas palës në këtë rast të Lëvizjes Socialiste për integrim kanë interes për çështjen e ligjit që përmendët në nenin 136. Dakord, kalojmë tek Partia Demokratike në lidhje me provat që ka sjelle dhe provat që kërkon të marrë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Atëhere i nderuar unë do të relatoj prova që ne i kemi bashkëlidhur kërkesës tonë ankimore, ndërkohë që provat që kërkojmë të marrim do të relatohen nga kolegu Kaso.

Së pari në përputhje dhe me detyrimin e Kodit Zgjedhor, kemi sjellë vërtetimin për tabelën përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonat zgjedhore në Qarkun Gjirokastrë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët, për deputet në Zgjedhjet për

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Kuvendin të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Është një ekstrakt tregëtar historik i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjegjësi të kufizuar LA-OR Shpk me NIPT K71420003R në pronësi të zoti Laert Duro, Drejtor i Përgjithshëm i Postës Shqiptare dhe kandidat për deputet i Partisë Socialiste me numër rendor 2 në listën shumëmemërorë. Kemi sjellë një listë të nxjerrë nga të dhënat e prokurimeve publike ku dalin të gjitha tenderat dhe prokurimet publike, kontratat publike që kjo kompani në pronësi të zoti Laert Duro ka përfituar nga shteti me vlerë 31000000 (tridhjetë e një milion) euro, për të cilat ne kemi pretendime që janë përdorur më pas për blerje votash në Qarkun Gjirokastrë. Kemi sjellë formularët e njoftimeve të fituesit për dy kontrata të cilat zoti Laert Duro i ka fituar pasi ka filluar periudha 4 mujore, pra periudha parazgjedhore dhe edhe pasi ai ishte shpallur kandidat për deputet në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste. Gjithashtu provë i nderuar, vendimi nr.44, dt.18.12.2020 për krijimin dhe përdorimin e një fondi të veçantë të Këshillit të Ministrave firmosur nga Kryeministri Edi Rama. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1076, dt. 24.12.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 555, dt. 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e strukturës dhe të niveleve të bazave të punonjësve me arsim të lartë dhe punonjësve të infermieristikës, të [Ministrit të Shëndetësisë dhe Njësive Mjekësore Ushtarake, nëpërmjet të cilit ne kemi kërkuar të provojmë që këto ndryshime që kanë ndodhur në strukturën dhe nivelin e pagave të sistemit shëndetësor kanë patur për qëllim të rriten pagat në prag të fushatës zgjedhore, çfarë është në mënyrë të qartë e ndaluar nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore. Gjithashtu vendimi 1102 dt 24.12.2020 të cilat siç mund të konstatohet edhe nga ana e këtij komisioni pavarësisht se mbajnë datën 24.12.2020, në fakt të gjitha janë botuar në fletoren zyrtare në shkurt të vitit 2021 në një kohë kur ne kishim hyrë në kohën e ndaluar zgjedhore për të prodhuar akte që sillnin përfitime për kategori të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

caktuara të individëve. Ky vendim i Këshillit të Ministrave u ka akorduar personave apo biznese të caktuara që angazhohen në fushën e buqësisë rreth 100.000.000 (njëqind milion) lekë grante.

Vendim tjetër nr 1151 dt 24.12.2020 për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021 në njësitë e qeverisjes qendrore ku janë krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave 2472 pozicione të reja në administratën shtetërore për të cilën vetëm pak ditë më parë Ministria e Financave deklaroi se do të largohen pasi ishin me kontratë të përkohëshme. Gjithashtu kemi sjellë një material kronologjik të të gjitha punësimeve që kanë ndodhur në administratë publike nga viti 2017 deri në 2021 për të demonstruar që rritja që ka ndodhur në prag të fushatës zgjedhore ka qënë një rritje disa herë më e lartë sesa numri i punonjësve një janë punësuar më parë. Pra, kemi të bëjmë me punonjës me kontrata të përkohshme që angazhohen pranë institucioneve shtetërore. Sigurisht besojmë që kjo është një provë që dhe vet Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mund ta ketë. Raporti paraprak i OSBE-së ku janë konstatuar disa prej pretendimeve që ne kemi ngritur përpara këtij komisioni.

Provë sa i përket audio përgjimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës Artan Lame, i cili deklaroi që 100.000 (njëqind mijë) aplikime për legalizime të cilat mund të prishen duhet të mbahen pezull pasi ata mund të jenë vota për opozitën . Ndërkohë që u kërkon vartësve të tij që 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) aplikime të tjera të përshpejtohen në mënyrë që të përkthehen në vota dhe mbështetje për Partinë Socialise.

Provë tjetër, artikull mediatik i cili shpjegon skemën që përdorin të gjithë drejtuesit politik të Partisë Socialiste në të gjitha qarqet e Shqipërisë për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin në mënyrë të paligjshme të të dhënave personale me qëllim që më pas ato të përdoren për qëllime zgjedhore gjatë fushatës elektorale.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Artinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Provë tjetër që rezulton nga një hetim që kanë kryer një media investigative ku rezulton se nenpunës, policë dhe ushtarakë në listë me mbi 9.000 (nëntë mijë) patronazhistë socialist, pra lista e patronazhistëve të Partisë Socialiste ishte e kompozuar tërësisht nga punonjës të administratës publike sipas një artikulli të publikuar nga një media investigative. Urdhër nr. 211(dyqind e njëmbëdhjetë) dt.19.04.2021 i Ministrisë së Shëndetësisë për karantinimin e personave që vinë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe nga Greqia. Duke qenë se ashtu si kolegët edhe ne kemi kemi ngritur pretendimin se vendimi për karantinim vetëm 6 ditë para zgjedhjeve ishte një vendim në shkelje të nenit 45 të Kushtetutës së Shqipërisë, në shkelje të nenit 3 protokollit 1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në shkelje sigurisht të Kodit Zgjedhor që synon të garantojë të drejtën e çdo qytetari për të shprehur vullnetin e tij. Nga ana tjetër provë tjetër është njoftimi zyrtar që ka bërë Ministria e Shëndetësisë për heqjen e karantinës me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut vetëm një javë pasi kishte përfunduar procesi zgjedhor, kishin përfunduar zgjedhjet.

Nga ana tjetër kemi depozituar në cilësinë e provës dokumenta që edhe vetë Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mund ti ketë, megjithatë për efekt prove që kanë të bëjnë me praktikën e ndjekur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me fletët e votimit, të cilat çuan më pas në 83.000 (tetëdhjet e tre mijë) fletë votimi të pavlefshme të cilat në vlerësimin tone vijnë në kundërshtim të hapur me kriteret e parashikuara nga neni 98 i Kodi Zgjedhor dhe nenet 27 dhe 49 të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venecias, si dhe letrën e bërë publike vetëm në ditën në të cilën po shqyrtohej vendimi për fletët e votimit të kompanisë CETIS, e cila duhet të prodhonte fletët e votimit.

Gjithashtu në cilësinë e provës edhe deklarata e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zotit Ilirjan Celibashi sipas së cilit nëse fleta e votimit do të ishte me

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

emra nuk do të kishim kaq shumë vota të pavlefshme. Lidhur me provat që kërkojmë të merren do t'i relatojë zoti Kaso.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Atëhere faleminderit! Në përmbajtje të kërkesës tonë ka një listë shteruese të provave që kërkojmë që të merren nga ana juaj, pjesa më e madhe e të cilave nuk janë në disponibilitetin tuaj, pra të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pra nuk disponohen, por që besojmë se janë thelbësore për zgjidhjen e drejtë jo vetëm të kësaj mosmarrëveshje zgjedhore, por edhe të mosmarrëveshjeve të tjera zgjedhore të cilat përmbajnë në vetvete të paktën ato që kemi referuar ne përpara jush. Një natyrë të ngjashme shkeljesh, ndonëse ne një masë edhe më të madhe për shkak edhe të dimensioneve të zonave zgjedhore ku janë materializuar, por secila me gravitetin e vet që ka ndikuar ndjeshëm mund të themi shpërndarjen e mandateve dhe rezultatin zgjedhor ne qarqet përkatëse. Kemi kërkuar së pari marrjen dhe administrimin nga ana juaj të një informacioni zyrtar nga prokuroria kundër krimit...kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, lidhur me numrin e procedimeve penale për krimet zgjedhore dhe fazën e trajtimit të tyre. Gjithashtu kemi kërkuar marrjen dhe administrimin nga ana juaj të një informacioni zyrtar nga Prokuroria e Përgjithshme, për numrin e procedimeve penale lidhur me krimet zgjedhore në prokuroritë e rretheve dhe bazën e trajtimit të tyre. Gjithashtu kërkojmë marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për numrin e shtetasve të ndaluar, të arrestuar dhe numrin e rasteve të referuara për krime zgjedhore. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit mbi gjendjen e rezervave të shtetit, në depozitat qendrore dhe lokale për çdo muaj duke filluar nga periudha e dhjetorit të vitit të kaluar deri ne maj të këtij viti. Kjo lidhur edhe me informacionet të cilat janë bërë tashme publike, por që janë materializuar edhe në qarqe të tjera që do të jenë objekt i shqyrtimit të mëvonshëm nga ana juaj, lidhur

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*

121



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

me kapjen e automjeteve të cilat shpërndanin materiale zyrtare te rezervave të shtetit, mbi baza dhe mbi lista plotësisht politike zgjedhësish të evidentuar si mbështetës të garantuar le të themi të mazhorancës në fuqi. Kërkojmë marrjen e informacionit zyrtar nga Inspektoriati Qendror, lidhur me të gjitha inspektorjatet që veprojnë në Shqipëri dhe numrin e inpektimeve të kryera në periudhën nga 24 dhjetori i vitit të shkuar deri në 1 maj të këtij viti, për numrin e gjobave dhe sanksjoneve të vendosura, numrin e sanksioneve dhe gjobave të revokuara me vendim administrative ose vendim gjyqësor. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjenci e Prokurimeve Publike për numrin e tenderave, koncesioneve, partneritetit publik, privat, të shpallura rishtazi apo të cilat janë shpallur fitues në periudhën duke filluar nga data 24 dhjetor deri në 1 maj të këtij viti. Marrjen e informacionit zyrtar nga Këshilli Kombëtar i Territorit për numrin e lejeve të ndërtimit të dhëna në periudhën nga 24 dhjetori deri ne 1 maj të po këtij viti. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për numrin e lejeve të legalizimit të dhëna, të ndara kjo sipas qarqeve, për periudhën nga 24 dhjetor deri në 1 maj të këtij viti. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile mbi numrin e shtetasve shqiptar që kanë ndryshuar adresat e banimit në periudhën 1 janar 2020 deri në 1 maj 2021. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Departamenti i Administratës Publike për numrin e punonjësve të institucioneve publike, vendore apo qendrore si dhe si ka ndryshuar ky numër sipas qarqeve për periudhën nga 1 janar i vitit 2020 deri në 1 maj të vitit 2021. Marrjen e një informacioni zyrtar nga të 61 bashkitë e vendit, agjencitë e vartësisë dhe shoqëritë në pronësi të shtetit apo bashkive, për numrin e punonjësve të institucioneve publike, vendore apo qendrore dhe si ka ndryshuar ky numër për periudhë nga 1 janar 2020 deri në 1 maj 2021. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale dhe 61 bashkitë e vendit lidhur

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arlinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

me numrin e familjeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike si dhe ndryshimin e masës së kësaj ndihme ekonomike për periudhën nga 1 janar 2020 deri në 1 maj 2021. Marrjen e nje informacioni zyrtar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar lidhur me fazën e hetimeve dhe me bërjen publike të të dhënave të 910.000 (nëntëqind e dhjetë mijë) qytetarëve të Tiranës. Marrjen e një informacioni zyrtar nga INSTAT mbi numrin e shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë, numrin e shqiptarëve që jetojnë në Greqi dhe në Maqedoninë e Veriut dhe numrin e këtyre shtetasve me moshën mbi moshën 18 vjeç, pra ata që kanë të drejtë për të votuar. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë mbi numrin e personave të infektuar me COVID-19 në datën 25.04.2021 sipas qarqeve, informacion të cilin kjo ministri e ka pas bërë publik, por nuk e ka bërë kohët e fundit. Marrjen e një informacioni zyrtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mbi numrin e shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në Shqipëri në periudhën 19.04.2021 deri në 25.04.2021 nga Republika e Greqisë dhe Maqedonia e Veriut, duke disponuar njëkohësisht dhe listën e plotë të këtyre personave. Marrjen e një informacioni zyrtar nga OSHE-ja mbi të gjitha shpërblimet që u janë dhënë punonjësve të kësaj kompanie shtetërore sipas qarqeve për periudhën nga 1 janar 2020 deri në 1 maj 2021. Marrjen e një informacioni zyrtar nga KESH dhe nga OSHE mbi numrin e personave të punësuar në këto institucione ose nga këto shoqëri të kontrolluara nga shteti për saktësi, në periudhën nga 1 janar 2020 deri në periudhën 1 maj 2021. Gjithashtu edhe ajo çfarë u bë objekt i diskutimit të mëparshëm është marrja e të dhënave të kryqëzuara nëpërmjet pajisjes së identifikimit elektronik PEI, veçanërisht në formën e një raporti për zonën zgjedhore Qarku i Gjirokastrës që është dhe objekt i këtij shqyrtimi, provë kjo e fundit e cila është në disponibilitetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Arinda Bahollari*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Zoti Kaso kam një pyetje. Gjithë këto provat që ju kërkoni, shërbejnë në lidhje me pretendimin tuaj për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrat e votimit të Qarkut Gjirokastrë dhe si nëse po?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar! Besojmë që marrja dhe administrimi i këtyre provave do të hedhin drite dhe do të provojnë të gjitha ato aspekte të kërkesës tonë ankimore jo vetëm për këtë qark, por edhe për qarqet e tjera për të cilat pjesa më e madhe e provave që kërkohet të administrohen. Pra, jo e atyre të depozituara nga ana jonë është e njëjtë pasi, siç e thashë tipologjitë e shkeljeve dhe të shitblerjes së votës, qoftë kjo dhe në masën më të madhe të tyre nëpërmjet përdorimit të burimeve të administratës publike dhe të resurseve shtetërore në favor të fushatës elektorale të partisë në pushtet mund të provohen vetëm në këtë mënyrë. Fjala vjen, e kemi theksuar në kërkesën tonë ankimore që shitblerja e votës nuk është materializuar në çdo rast, thjesht dhe vetëm me dhënien e premtimit të shkëmbimit të suportit elektorale, pra të votës me një sasi të konsiderueshme të hollash, qofshin këto të shkëmbyera në moment ose qofshin këto të premtuara për tu dhënë mbas përfundimit të procesit zgjedhor, por edhe nëpërmjet një shkëmbimi favoresh i cili ka ngërthyer në vetvete tipologji të ndryshme siç janë lejet e legalizimit, siç janë punësimet e përkohshme në administratën publike, në përgjithësi në shoqëritë e kontrolluara nga shteti siç janë KESH-i dhe OSHE-ja që ne kërkuam që të hetohet le të themi pjesa e punësimit të tyre në periudhën parazgjedhore, siç janë punësimet e përkohshme nëpër bashki, ku ka patur raste flagrante dhe do të arrijmë dhe aty në kërkesat ankimore të mëvonshme, por edhe në këtë qark të cilin ne e kemi objekt shqyrtimi ku bashki që kanë një organik të miratuar punonjësish të përhershëm prej 300 (treqind) deri në 400 (katërqind) punonjësish, kanë shtuar me masa të përkohshme në kundërshtim



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

me ndalimet që vet Kodi Zgjedhor i disponon dhe vendimi përkatës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me mospërdorimin e burimeve shtetërore, kanë rritur organikën e tyre. Le të themi, p.sh. Bashkia Kamëz me 1003 (një mijë e tre) njësi ku punonjësit e miratuar i ka jo më shumë se 400 (katërqind). Osc raste flagrante, po marr rastin e Bashkisë së Përmetit që është edhe brenda zonës zgjedhore, kur një bashki e cila asnjëherë nuk e ka kaluar numrin e punonjësve të miratuar me kontrata të përhershme pune në periudhë jozgjedhore nga 300 (treqind) njësi ka arritur në periudhë parazgjedhore, ka shtuar me punësime të përkohshme vetëm për të marrë një efekt elektoral në një masë të caktuar, në mbi 800 (tetëqind) të punësuar, çka është jo vetëm e palejueshme nga dispozita urdhëruese të Kodit Zgjedhor, por edhe e dënueshme penalisht si shpërdorim i hapur i detyrës dhe i burimeve të administratës publike. Të kësaj natyre janë gjithë provat që kërkohen dhe besoj se vënia në dispozicion e gjithë këtij materiali, që ndoshta në pamje të parë mund të duket voluminoz, por që është i nevojshëm dhe i domosdoshëm që këto mosmarrëveshje zgjedhore, pra jo vetëm për këtë qark, të trajtohen nga ana juaj sa më plotë dhe sa më drejt. Besoj që janë të domosdoshme, pra administrimi i tyre, pra se vetëm administrimi i tyre do të mund ti japë një dimension real dhe të plotë të asaj çfarë ka ndodhur me shpërdorimin dhe me keqpërdorimin e burimeve dhe të resurseve të Shtetit Shqiptar, jo vetëm të administratës, por të gjithë institucioneve në funksjon të arritjes dhe të mbajtjes me çdo kusht të një rezultati të caktuar zgjedhor nga mazhoranca në pushtet, faleminderit.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Artinda Bahollari*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Faleminderit.

**Z. K. Bele:** Në fakt, këtu po mundohem të kuptoj dhe duke i parë konkretisht këto prova, në fakt janë shumë dhe po shikoja një për t'u thelluar. Ju kërkoni dhe te nr.5 marrjen e informacionit zyrtar dhe nga inspektoriat qendror dhe nga inspektoriatet e tjera. Nga një vëzhgim i shpejtë që bëra janë 9 inspektoriate. Pra marrje e informacionit zyrtar nga inspektoriat qendror dhe të gjithë inspektoriatet që veprojnë në Shqipëri për numrin e inspektimeve të kryera në periudhën dhjetor 2020 - 1 maj 2021 për numrin e gjobave, sanksioneve të vendosura numrin e sanksioneve, gjobave të evokuara, vendim administrativ, vendim gjyqësor. Pra ju kërkoni që kjo trupë t'i drejtohet 9 inspektoriateve minimumi 9 se mund të jenë më shumë të vendit dhe t'u marrë një pasqyrë të të gjitha gjobave të vena, të revokuara, të ankimuara gjyqësisht dhe ne këtë ta marrim dhe ta analizojmë këtë të dhënë nëse merret një e dhënë e tillë. Kjo është kërkesa apo jo?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Kërkesa është t'i drejtoheni së pari inspektoriatit qendror, i cili për efekt të ligjit duhet t'i disponojë të gjitha këto të dhëna dhe të kordinojë dhe veprimtarinë e inspektoriateve që të gjitha këto të dhëna, të cilat janë të rëndësishme sepse instrumenti i inspektimeve selektive dhe më pas i gjobevënies së bizneseve të caktuara ose i revokimit të gjobave për analogji për ato biznese të cilat vendosën që të konformoheshin me linjës zyrtare të partisë në pushtet qoftë edhe për të premtuar votën e tyre ose të punësuarve të tyre në një mënyrë të caktuar ka qenë një nga instrumentat thelbësorë që është përdorur masivisht për të deformuar vullnetin e qytetarëve nëpërmjet një resursi dhe një burimi shtetëror të rëndësishëm siç është sistemi i inspektoriateve.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. K. Bele:** Dakord.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Dhe një koment të fundit për të gjitha këto. Nuk duam ne si subjekt...

**Z. K. Bele:** Dua të kuptojë metodologjinë. Supozojmë i marrim këto të dhëna, duhet të jenë disa mijëra vendime, ankesa të qytetarëve, vendime gjyqate që i pezullojnë diku, vendim gjyqate që i revokon, një apel që bëhet në gjykatë të apelit dhe kështu me rradhë.

**Z. L. Braho:** Mesa kuptojë nuk po kërkon provat por po kërkon tabela. Të jenë thjeshtë mënyra se çfarë ka ndodhur. Jo se do marrin ne të gjithë procedurat e inspektimit këtu.

**Z. K. Bele:** Ne do marrim preferencat nga subjektet politik, të kuptojmë ku është ndihmuar një subjekt X dhe ku është penguar një subjekt Y dhe si kjo i vlen pavlefshmërisë.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Tani një rast i inspektimit të një subjekti X apo Y i parë në mënyrë të vecuar.

**Z. K. Bele:** Më fal, si i vlen pavlefshmërisë? Se po ju pyes dhe si jurist duke marrë parasysh dhe parimin e profesionalitetit. Të përdorimit të një mjeti me arritjen e qëllimit brenda tagrave që na jep ky Kod. Pra ne nuk mund të marrim një listë simpatizantësh të subjektit X apo Y dhe të themi që gjykojmë se inspektoriat


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

industrial apo inspektoriat i ushqimor ka vajtur tek ky subjekti që është i majtë apo i djathtë apo i qendrës dhe ka bërë këtë veprim, ne nuk e kemi këtë tagër.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Qartë aty do arrijë. Besoj se e kuptuat pyetjen, e aty do arrijë, e të përpiqem të jap një sqarim. Ne sigurisht kërkesën për prova nuk e kemi të limituar tek një provë e caktuar e vetme dhe analizimi i saj në mënyrë të veçuar dhe jo harmonike në raport me provat e tjera. Për këtë që thatë ju psh. Nuk kemi kërkuar marrjen e çdo praktike dhe qymtimin nga ana juaj e çdo praktike inspektimi në këtë periudhë por kemi kërkuar më shumë një tabelë përmbledhëse. Pra të dhëna referuese statistikore më shumë që ju lejojnë ju ose do t'ju lejojnë ju në teori nqs do të vendosni t'i merrni që të bëni një gjykim ose një vlerësim performance të caktuar. Pra nqs instrumenti shtetëror i ngritur për vullnet të legjislatorit, për të arritur një qëllim tjetër është përdorur dhe për efekte elektorale ose jo. Ne besojmë se është përdorur dhe ne besojmë nqs këto të dhëna vijnë në mënyrën sesi ne i kemi kërkuar do të shohim çudira nga përgjigjet që do na vinë nga institucionet. Pra, masën e madhe të ndikimit që ato kanë pasur në procesin zgjedhor, por sigurisht ajo që thatë ju ta marrësh, ta analizosh këtë gjë apo një praktikë të vetme inspektimi në mënyrë të veçuar nga të tjerat, ndoshta nuk e ndihmon procesin tuaj. Prandaj, ajo ç'ka ne kemi kërkuar është marrja e një serie evidencash dhe provash nga një numër i madh institucionesh, të cilat nqs gjykohen dhe vlerësohen në harmoni me njëra - tjetrën ju japin një mundësi që të vlerësoni nqs veprimtaria institucionale shpesh herë e drejtuar dhe urdhëruar drejtë për drejtë nga persona në konflikt të drejtë për drejtë interesi si ministra, drejtorë të ndryshëm, të cilët kanë qenë vetë kandidatë ka qenë në përputhje me ato, jo vetem përshkrim pune që kanë institucionet ose ligjin organik që u rregullon atë funksionimin e tyre të përditshëm por dhe në raport me ndalimet që vetë ky Kod

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Zgjedhor, ose le të theni aktet të ndërrmarra dhe të miratuara nga kolegët tuaj po të KQZ-së kanë parashikuar që nuk duhet të funksionojë apo të funksionojnë në një mënyrë të caktuar. I referohem në veçanti vendimit që ka dalë në detajim të nenit 91, në mos gaboj.

**Z. K. Bele:** Janë referuar raste të tilla?


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Janë referuar pa fund raste të tilla. Janë referuar nga ana jonë dhe në prokurori raste të tilla dhe besoj që përgjigjja që do vijë nga prokuroria nqs ju gjithmonë do të vendosni ti merrni do të hedhi dritë dhe mbi këtë aspekt, faleminderit.

**Z. K. Bele:** Pra,në konkluzioni ju mendoni se ky proces administrativ me një kohë të caktuar do harmonizojë gjithçka çfarë ndodh në gjitha institucionet lokale, qendrore të shtetit, në prokurori, në gjykatë dhe do i mbledhi të gjitha këto në guackën apo kuadrin e këtij ankimi dhe do konkludojë për pavlefshmërinë e Gjirokastës.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ajo ç'ka besoj unë është që jemi në një moment dhe një fazë delikate të procesit zgjedhor, atë të shqyrtimit të ankimeve dhe kemi mundësinë të gjithë së bashku, ne me aq sa kemi mundësi, ju me aq sa keni kopetenca, që të hedhim dritë dhe për sa është e mundur t'a investigojmë dhe qartësojmë situatën dhe çfarë pasoja janë të mundshme të evientohen dhe t'i kuantifikojmë në rezultat zgjedhor. T'i japim dhe sanksionin përkatës, se ajo çka nuk duam ne të ndodhi si forcë politike, është ajo çka ndodh tani. Psh në raport me zgjedhjet e vitin 2016 në Bashkinë Dibër, ku kemi persona të marrë të pandehur

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

zyrtarisht nga prokuroria për shit-blerje votash kemi vendime gjykate dhe flasin se votat janë shitur dhe janë blerë. Po s'kemi çfarë t'i bëjmë se ankimet zgjedhore janë mbyllur dhe rezultati zgjedhor është certifikuar nga gjykata. Jemi ende në kohë që për aq sa t'a kemi të mundur, ndoshta s'kemi të mundur që të bëjmë dritë 100% por për aq sa t'a kemi të mundur të tentojmë, e të bëjmë aq sa t'a kemi të mundur, faleminderit.

**Z. I. Rusmali:** Me një fjali sqaruese paraprakisht lidhur me këtë. Detyra e këtij komisioni nuk është të hedhë dritë mbi zgjedhjet, detyra është të vërtetojë nëse pretendimet tuaja të tre palëve, janë të mbështetura në ligj dhe në prova nëse jo. Shumë e ngushtë detyra jonë, nuk jëmi ne titanë. Ne kemi një detyrë që është shumë e thjeshtë. Ju keni një pretendim, ne do gjykojmë rreth pretendimit tuaj me dy kritere. Me kriterin e ligjit dhe me kriterin e provës. Për t'a futur në kontekstin e gjësë, në kontekstin e objektit. Tani pyetja e parë, në lidhje me kërkimet tuaja për provën se kuptoja që një pjesë e tyre duhet të ishin të dhëna statistika tabela, në dijeninë tuaj këto të dhëna disponohen nga Administrata Publike Shqiptare apo duhet të prodhohen?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit, në dijeninë tonë pjesa më e madhe disponohen nga administrata publike dhe prodhohen në mënyrë periodike qoftë dhe për efekt të raportimit të tyre në organet eprore.

**Z. I. Rusmali:** Cila disponohen? Në apo prova, cila disponohen sot t'i bëjmë konkrete.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Nga ne apo administrata?

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Jo, nga administrata cila provë që kërkonti ju disponohet sot, cila tabelë?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Psh që nga e para, informacionin, tabelën e SPAK-ut, psh që sa nga rastet e referuara janë regjistruar si procedime penale dhe llojin e tyre besoj ata i disponojnë.

**Z. I. Rusmali:** Ju e dini e disponojnë apo jo?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Jam i sigurt sepse kodi i tyre i procedurës implikon që të kenë një regjistër të posaçëm që regjistrojnë të gjitha rastet e referuara.

**Z. I. Rusmali:** Jo, një regjistër të vecantë për kërkesat ankimore të PD-së.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Jo, një regjistër për kërkesat ankimore të PD-së. Ata kanë në bazë të ligjit një regjistër zyrtar në bazë të cilit regjistrohet çdo rast i referuar pranë tyre siç kanë dhe një regjistër të procedimeve penale që ata regjistrojnë.

**Z. I. Rusmali:** Por ju nuk po kërkonti çdo rast, ju nuk po kërkonti një kopje të regjistrit që përdorin ata. Ju po kërkonti një ekstrakt vetëm për krimet zgjedhore. E para duhet prodhuar. Shkojmë tek e dyta, e para nuk ekziston duhet prodhuar shkojmë tek e dyta kush është?

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** E njejta gjë, nga Prokuroria e Përgjithshme.

**Z. I. Rusmali:** E njejta gjë, e treta?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Unë besoj se i kanë të gatshme.

**Z. I. Rusmali:** Jo, jo nuk ka sens në logjikën e një njeriu me intelekt normal. Tabela, informacione që janë, dmth t'i shkon e merr dhe e sjell këtu, apo ata duhet të ngarkojnë një njeri që duhet t'i nxjerrë?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Unë besoj se i kanë të gatshme, gjithësesi është kjo si e konceptoj unë apo e mbaj mend unë se si kanë funksionuar.

**Z. I. Rusmali:** E kanë të gatshme nqs i nevojiten punës së tyre, është puna e tyre e përditëshme, nqs në punën e tyre ata e kanë, krimet apo kundravajtjet zgjedhore rrinë në një regjistër të vecantë dhe ai udatohet me dorë apo me ndonjë mënyrë të veçantë, ai është regjistri. Marrim kopjen dhe e sjellin por nqs në praktikën e tyre nuk është kështu nuk është regjistri.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Ne jemi familjarë, vetëm nga jashtë nga një këndvështim i jashtëm lidhur me procedurat e tyre të brendshme, jo vetëm të SPAK-ut, që e morën se ishte i pari në listë, por dhe të institucioneve të tjera ne kemi një dijeni të përgjithshme lidhur me të dhënat që ata i disponojnë dhe një pjesë e tyre, psh janë institucione varësie ose instritucione me kapital tërësisht

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Di.12.05.2021*

shtetëror dhe kanë obligim referimi në organet e tyre eprore dhe besoj që janë të dhëna që në mënyrë periodike besoj ata i prodhojnë dhe i raportojnë.

**Z. I. Rusmali:** Ju keni një djieni të përgjithshme lidhur me të dhënat që ata i disponojnë, një dijeni?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Jo, më fal se po ju ndërpres, ne e dimë që ata i kanë këto të dhëna po mënyrën sesi i mbajnë, pra dalin automatikisht apo...

**Z. I. Rusmali:** Nuk bëjmë lojë fjalësh.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Dhe e dimë që të gjitha këto që i kemi kërkuar i kanë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, nuk po bëjmë lojë fjalësh dua pyetjen vijuese, përmbajtjen e të dhënave që ata disponojnë e dini ju?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Në një pjesë të mirë të tyre sepse jo në të gjitha rastet përmbajtjen e dimë por e kemi nga burime jo zyrtare dhe jo të konfirmuara.

**Z. I. Rusmali:** Mund të na i referoni?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Jua dhashë, psh një rast që nuk i përket këtij qarku por e kisha shifrën e saktë se për shifrat e tjera duhet të konsultohem, psh ju thashë rastin e Bashkisë Kamëz që është thjeshtë për t'ju sjellë shembullin që ka marrë me kontratë të përkohëshme në periudhën e ndalimit që Kodi Zgjedhor dhe

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i ka ndaluar që të marrë punonjës me kontrata të përkohëshme. Ka marrë 1003 punonjës në dhunim të plotë të dispozitës ligjore, thjeshtë dhe vetëm që ata 1003 punonjës të detyroheshin ose të gënjuheshin të votonin partinë në pushtet që për fat të mirë i futi në punë ndoshta dhe ca familjarë të tyre.

**Z. I. Rusmali:** Po të dhëna respektive për Qarkun e Gjirokartrës bashë me burimin që keni marrë mund të na vijet ne në dispozicion? Sa është shifra të punësuarve në Qarkun e Gjirokastrës dhe burimi nga ju ka ardhur?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Po patjetër, një që e mbaja mend unë është kjo e Bashkisë së Përmetit që ka pasur deri në një periudhë, le të themi 20 ditë përpara datës së zgjedhjeve që na është referuar ne, në zyrat ku vjen informacioni nga vetë punonjës të bashkisë. Nuk na e sjellin dot atë listën e pagesës, që do ta vërtetonte më së miri sesa janë paguar muajin e fundit, por që ka qenë mbi 800 punonjës në një kohë përpara periudhës zgjedhore dhe përpara periudhës së ndalimi, numri ka qenë 400 në mos gabojë bashkë me institucionet e varësisë ujësjellës dhe me institucione të tjera.

**Z. I. Rusmali:** Kjo është një, dmth qytetari dixhital ka thënë janë 800, ju nuk keni emrat e tyre, adresat e punësimit të tyre, nuk keni emrat i institucioneve, keni vetëm shifrën 800.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Ne kemi të dhënë që besojmë është në kundërshtim më një dispozitë urdhëruese të ligjit zgjedhor por në këtë rast kjo lloj e

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

dhënë administrohet lehtësisht nga ana e tyre dhe mund t'ju vihet juve lehtësisht në dispozicion se mund t'ju sjellin listpagesën e muajit.

**Z. I. Rusmali:** Ju çfarë keni në dispozicion?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Ne kemi shqetësimin.

**Z. I. Rusmali:** Po diskutojmë provat jo shqetësimet, i mbyllëm seancën e parë. Çfarë mund të na vini ju në dispozicion ato që mund të na vini dhe që mund të marri vlerën e provës? Ne kemi thënë që për kushtet e hetimit administrativ i pranojmë gjërat edhe të mos jenë zyrtare por të jenë me vlerën e provës. Informacioni që janë punësuar kaq apo janë punësuar aq i thënë nga një shok apo nga një komshi nuk është me vlerë, nuk e administrojmë dot. Një gjë që është përtej kësaj, një listë me burime konfidenciale nga institucioni, një e dhënë më konkrete se kaq, na vihet dot në dispozicion nga ana juaj?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Atëherë...

**Z. I. Rusmali:** Apo vetëm në këtë model, në modelin e kërkesave për prova?

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali, çfarë nënkuptoni me listë konfidenciale?

**Z. I. Rusmali:** Burimi konfidencial?

**Z. L. Braho:** T'a qartësojmë, se pala ka ardhur këtu për prova dhe ne t'i themi ku i ke provat? Prandaj ka ardhur, t'i kërkojë provat se si ka.

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Kujtova se kishit vëmendjen kur bëmë dialogun me kolegun e LSI-së.

**Z. L. Braho:** Unë kam qenë i vëmendshëm gjatë gjithë kohës.

**Z. I. Rusmali:** Rëndësi ka që e dhëna të jetë e detajuar. Nëse burimi është konfidental dhe subjekti thotë nuk e tregojë dot se është njeriu im në frontin e perëndimit, ne nuk ja kërkojmë s'kemi pse t'ia kërkojmë e verifikojmë zyrtarisht por e dhëna duhet të jetë aty.

**Z. L. Braho:** Ne presim që përfaqësuesi i PD-së të na sjellë një listë me 400 emra që janë punësuar rishtazi?

**Z. I. Rusmali:** Pse përfaqësuesi i LSI-së e solli një listë me 500 emra mos është më i mirë ai nga përfaqësuesi i PD-së.

**Z. L. Braho:** Ishin 59 emra.

**Z. I. Rusmali:** Ishin 500, nga të cilët 59 ishin.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Ne kemi përgjigje, por përgjigjet po rezervohen sepse nuk janë të njëjta për të gjitha raste apo për të gjitha llojet e provave. Ka raste që të jem më specifik, si ky që të dhënë e ka në bazë të informacionit, psh përmenda Bashkinë Përmet meqë është zona zgjedhore e cila po diskutohet dhe qarku por për të njëjtën të dhënë apo në një bashki tjetër të një zone zgjedhore që

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

të gjithë e kemi ankimuar të zonës zgjedhore Tiranë psh dhe po përmend Bashkia Rrogozhinë.

**Z. I. Rusmali:** Mos na ço në Tiranë.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Ju çoj aty se kam konflikt interesi aty.

**Z. I. Rusmali:** Mos mu fut në domainin e Gridës.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Për të sjellë atë që na intereson për të njëjtin pretendim kemi psh një provë të kësaj natyre që sapo ilustruam psh Bashkia Rrogozhinë, kemi një listëpagesë dhe pse në formë jo zyrtare me firmë dhe me vulë prandaj themë u rezervova për të njejtat pretendime i kemi të ndryshme provat.

**Z. I. Rusmali:** Mos të bëjmë debat për një gjë që e kemi të qartë të dy. Dokumenta që kanë vlerën e provës dhe që sillen nga subjekti janë më të mira sesa kërkesat abstrakte për informacion nga institucionet nqs i kení dhe nga aq sa pashë unë nga provat që keni paraqitur nuk janë aty, na i sillni shtohini se besoj se aq procedurë kemi për t'i shtuar. Pyetja tjetër që kam dhe besoj se e mbyll me ju. Dua një arsyetim nga ju, vlera e kerkimit për prova të gjitha provat që kërkoní çfarë vlere kanë për padinë tuaj, janë të rëndësishme, shumë të rëndësishme, kryesore, anësore, janë plotësuese, çfarë vlere ju jepni, ju atyre?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Ne i japim një vlerë të një rëndësie të veçantë, pra janë shumë të rëndësishmë për padinë tonë të paktën për këtë qark që po

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

diskutojmë, pra si të vlerësuara në harmoni dhe me atë që ne kemi sjellë, provojnë më së miri të gjitha shkeljet e kategorizuara në tipologjitë e ndryshme që ne kemi evidentuar dhe kemi strukturuar dhe në kërkesën tonë ankimore.

**Z. I. Rusmali:** Por gjithsesi, kërkesa juaj ankimore rri dhe vetëm në ato që keni sjellë pa këto?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Atëherë kërkesa jonë ankimore është paraqitur me ato prova që ne kemi pasur disponibilitet ose që kemi mundur të sigurojmë por sigurisht, vlerësimi i saj i plotë mbi bazueshmërinë ose jo të pretendimeve që kemi ngritur bëhet duke administruar edhe këto prova që ne kërkojmë.

**Z. I. Rusmali:** Nuk jeni në gjendje ta gjykoni që rri apo bie pa këtë kompleks kërkesash?

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Nuk e ndajmë dot qëndron apo jo, vetëm po vlerësojmë që ato që kemi paraqitur së bashku me këto japin një pasqyrë të qartë dhe vërtetojnë 100% katërcipërisht pretendimet tona.

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit zoti Kaso.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali, nuk besoj se provat shërbejnë për të bindur PD-në për zgjedhje të pavlefshme, provat janë për ne, për ne a janë të mjaftueshme është çështje që do i kalojnë vendimmarrjes tonë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Meqë po e bëjmë dialogun kaq shkencor. Provat janë për të mbështetur kërkesat ankimore. Nqs kërkesa ankimore nuk ka prova të mjaftueshme bie kërkesa ankimore dhe Ivi sapo tha mund të rri, mund të bjerë pa këto. Nqs nuk ka prova të mjaftueshme bie sepse kërkesa ankimore duhet të jetë e mbështetur në njërën këmbë në ligj në këmbën tjetër në prova. Dhe kjo është ABC –ja e hetimit administrativ përndryshe nuk vihet në lëvizje nqs mungojnë provat sepse përndryshe është investim i mjetit ligjor në mënyrë abuzive. Kjo është doktrinë.

**Z. L. Braho:** Patjetër që është doktrinë por ne nuk vendosim dot gjoha në rastin kur abuzojnë subjektet zgjedhore se kemi pasur dhe raste abuzive. PD-ja, LSI-ja dhe kandidati Kreshnik Merxhani kanë sjellë ankime dhe pretendojnë se zgjedhjet janë të pavlefshme. Një pjesë e tyre e kanë mbështetur me prova dhe një pjesë tjetër që ata e kanë informacion kërkojnë prova shtesë që të administrohen nga ana e KAS. Kjo është çështje që i takon vendimmarrjes tonë prandaj them që nuk mund të pyesim përfaqësuesit apo vetë partitë politike a mendoni ju se mund të qëndrojnë kjo pa prova apo me këto prova? Për ata qëndron edhe me kërkesën pa prova sepse nqs kanë ardhur këtu...

**Z. I. Rusmali:** Pse jo, detyrimi për t'i mbështetur pretendimet në prova dhe në ligj është për ne apo për ata?

**Z. L. Braho:** I kanë mbështetur në prova dhe në ligj.

**Z. I. Rusmali:** Dhe çfarë të keqe ka këtu që unë të pyes subjektin që kërkon prova shtesë pretendimet që ka argumentuar ai provat shtesë nuk i pa në filxhan përmbajtjen e tyre, ai nuk e di, sepse nuk e di, nuk është në dijeni të tyre.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

Pretendimet që ai ka ngritur përpara këtij institucioni. Ky subjekt i ka të mbështetura në provat që disponon apo se kjo është praktikë e njohur dhe në Shqipëri dhe është praktikë e gjykuar dhe në Shqipëri por kjo është siç thoni ju pjesë e diskutimit tonë. Ka shumë mundësi që subjekti të na qartësojë për këtë punë nëse i rrinë pretendimet me provat që ka apo duhet doemos ne të hulumtojmë provat e reja që të mund të shohim a mbështeten pretendimet apo jo.

**Z. L. Braho:** Kalojmë tek subjekti tjetër kandidati Merxhani në lidhje me provat që keni sjelle bashkëlidhur Kërkesës Ankimore dhe nqs kërkonit dhe ju prova të tjera?

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Faleminderit i nderuar! Kërkesa e parë është shqyrtimi i provave që ne kemi vënë në dispozicion kërkesa e dytë është në përputhje me nenin 136, pika 3, kërkojë marrjen në shqyrtim dhe në hetim të materialit filmik nga KQZ dhe evidentimin e mëtejshëm të parregullsive apo shkeljeve ligjre. Ne për arsye kohe dhe kapacitetesh, ato që kemi arritur të evidentojmë i kemi vënë, i kemi bërë pjesë të ankesës por kemi dyshimin e bazuar që aty ka akoma material për të hulumtuar dhe për t'i shkuar deri në fund këtyre shkeljeve dhe parregullsive ligjore. Kërkesa tjetër ka të bëjë më një raport nqs ka nga ana e KQZ-së mbi miratimin e komisionerëve dhe numëruesve dhe verifikimin nëse ka konflikte interesi në këto miratime të anëtarëve.

**Z. L. Braho:** Ka pyetje?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Për sa i përket kërkesës për prova si nga PD dhe nga kandidati i pavarur do të thoja që asnjëra nuk është në kufijtë e ligjit në

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

atë çfarë kërkon ligji pavlefshmëri përsa i përket gjithë kërkesave që u bënë nga PD është informacion. Informacioni nuk është provë. Informacion, informacion, informacion, ti kërkosh KAS-it të marrësh një dokument për informacion kjo nuk është nga ato llojet e provave që përcakton Kodi i Procedurës Civile. Për arsye të parashikuar qartë në nenin që duhen marrë ato prova, llojet e të cilave përcaktohen nga Kodi i Procedurës Civile. Kush është informacioni? Nuk përcaktohet informacioni si një ndër llojet e provave pavarësisht thelbit se çfarë mund të kenë ato dhe në formë nuk qëndrojnë. Për sa i përket pamjeve filmike të cilat janë thënë e stërthënë nga kandidati i pavarur, unë besoj se këto kanë të bëjnë me procesin e numërimit, pavlefshëria kërkon shkelje ditën e zgjedhjeve, aty ndalon konstatimi i shkeljes, aty ndalon pra shkelje që kanë ndodhur ditën e zgjedhjeve, ato shkelje mundet të shqyrtohen nga Komisioni dhe të sjellin ndikim në pavlefshmërinë, ajo ç'ka ka ndodhur në numërim ka të bëjë me rezultatin. Ka të bëjë më rinumërimin është kërkesë tjetër nuk është më në objektin e këtij kërkimi. Nqs ju duhet për statistikë, ju mund t'a merrni atë lloj video, por për procesin e pavlefshmërisë nuk është në formën e kërkuar nga ligji, nuk është në objekt. Objekti për videon në procesin e numërimit është kur ne të shqyrtojmë një objekt tjetër të kërkimit, ndryshimin e rezultatit. Këtu nuk kërkon pala ndryshimin e rezultatit, kërkon pavlefshmëri. Do të thotë edhe sikur të merren të mirëqena ato shkelje në fletë votimi 1, 2, 3 ose dhe po vajtën 10 fletë votimi ndikon në rezultat jo në pavlefshëri, prandaj nuk janë në objektin e kërkimit.

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:**Ne nuk po kërkojmë rinumërimin zotëri. Në momentin që ka fallsifikim, rinumërimi nuk ka sens. Ne kërkojmë sigurisht përsëritje të atij rezultati dhe mos njohje të zgjedhjeve. Nuk ka

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

sens në momentin që është futur dora tek vullneti i zgjedhësve, është mbyllur çështja për ne.

**Z. E. Çefa:** Kam edhe unë një pyetje, jo për debat por thjesht për përfaqësuesin e palës së interesuar. Sipas jush kush do ishin provat e përshtatshme për t'u administruar nga KAS për sa i përket pavlefshmërisë? Mqs provat e kërkuara në adresë të subjekteve ankimues sipas jush nuk shërbejnë për pavlefshërine kush do ishin? Nëse mundeni të na i thoni sigurisht?

**Z. L. Braho:** Për t'i shtuar diçka pyetjes që thatë, pavlefshmëria vlen vetëm ditën e votimit, mund të na e referoni këtë ku është parashikuar ajo që vetëm dita e votimit është sepse në fund fare ajo qendër votimi mbetet dhe kur numërohet?

**Z. E. Saliانji, përfaqësues i PS-së:** KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjekteve i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose shumë qendra. Ne asnjë kërkim të subjekteve nuk u gjykua dhe në shqyrtimin administrativ një shkelje në një ose disa qendra votimi. Ky është thelbi shkelja në një ose shumë qendra votimi. Tani kur ngjallet qendra e votimit? Se po bëjmë teori, ditën e votimit. Nuk thotë shpallja e pavlefshme gjatë fushatës zgjedhore ose gjatë periudhës së qeverisjes 4 vjeçare.

**Z. L. Braho:** Ngjallja dakord, po vdekja e qendrës së votimit kur është ora 9, 12 datën 25 prill?

**Z. E. Saliانji, përfaqësues i PS-së:** Shkelja dakord, prandaj kodi është shumë i qartë që në ditën e votimit palët hyjnë në proces zgjedhor, kandidojnë deri ditën e

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

zgjedhjeve dhe procesi administrohet nga të dy palët deri atë ditë. Dita, e cila është një ditë, do referuar shkeljes zgjedhore është qendra e votimit dhe kodi dhe praktika 20 vjeçare, gjithmonë e gjykuar për pavlefshmëri dhe shkelje të ndodhura në qendrën e votimit për arsye se duhet të vërtetojmë ndikimin që ka ndodhur shkelja në lidhje me ndarjen e mandateve në lidhje me rezultatin.

**Z. L. Braho:** Pra, ju thoni që nqs dikush gjatë numërimit abuzon dhe mbush 30, 50 fletë, kjo nuk e prek ditën e zgjedhjeve?

**Z. E. Sallianji, përfaqësues i PS-së:** Jo fare, fare, këto 30, 50 fletë shpallen të pavlefshme dhe ndyshon rezultati. Ka ndodhur që janë prishur dhe po të kemi rast që rezultati është tjetërsuar në numërim. Këto fletë shpallen të pavlefshme dhe aty kemi të bëjmë me rezultatin e votimit dhe jo me shkeljen e ligjit.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Mundem zoti Braho, përfaqësuesi i PS-së citon vetëm nenin 160, por ky nen nuk mund të lexohet pa pasur parasysh dhe përsëritjen e zgjedhjeve që është parashikuar në nenin 161, pika 1, që thuhet: "Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ kryesisht ose me kërkesë të subjektit shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria është shpallur në një ose disa qendra sipas nenit, ndikon në ndarjen".

**Z. L. Braho:** Jemi të qartë me këtë zoti Kaziaj?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ne kemi bërë kërkesë për të gjithë zonën zgjedhore.

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

**Z. L. Braho:** Faleminderit, atëherë në lidhje me kërkesat për provat ne do të tërhiqemi si trupë për t'u këshilluar dhe për të vendosur në lidhje me provat që kërkojnë, nqs do arrijmë një vendimmarrje për 30 minuta do e shpallim vendimin sot për provat. Në të kundërt, do e lëmë për datën 14 Maj ora 9:30. Meqenëse nesër është festë zyrtare, Festa e Bajramit, nuk do të lëmë seancë. Pra, shihemi për 30 minuta në orën 15:40, faleminderit.

**Rifillon Mbledhja  
Ora: 15:56**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Çelim sërish seancën për shqyrtimin të Kërkesave Ankimore nr.33, nr.41 dhe nr.52 të subjekteve zgjedhore LSI, Koalicioni PD - AN dhe Kandidati i Propozuar nga Zgjedhësit zoti Kreshnik Merxhani. KAS u tërhoq në dhomë këshillimi, në lidhje me provat që palët kanë depozituar së bashku me kërkesat ankimore, po ashtu dhe në lidhje me kërkesat për prova që të merreshin nëpërmjet KAS-it dhe për të qartësuar në lidhje me provat që palët kanë sjellë secila nga palët. Të gjitha provat do të pranohen për shqyrtim. Ndërkohë që për kërkesat që palët bënë, përkatësisht se u vendos rrëzimi me shumicë votash i kërkesës së subjektit zgjedhor LSI, në lidhje me provat që kërkon të merren por për sa i përket emrave që pretendon që kanë qenë komisionerë, dy anëtarë të KAS-it unë dhe zoti Çefa, i kërkojmë Administratës së KQZ-së, në bazë të nenit 136, pika 3, që të na vënë në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur. Nëqoftëse këto persona që gjenden në këto lista janë pjesë e Administratës Zgjedhore duke filluar nga dita e zgjedhjeve dhe deri në përfundimin e procesit, deri në shpalljen e rezultatit nga KQZ-ja. Pra që të kenë qenë pjesë dhe e Administratës së KZAZ-së. Në lidhje me kërkesën e subjektit zgjedhor PD - AN, po ashtu KAS vendosi me

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.12.05.2021*

shumicë votash rrëzimin e kërkesave për marrjen e provave që kërkohen nga ky subjekt. Ndërkohë në lidhje me kërkesën e fundit që ka të bëjë me kqyrjen dhe me kryqëzimin e të dhënave nga pajisja PEI për Qarkun e Gjirokastrës, sërish dy anëtarë të KAS-it në zbatim të nenit 136, pika 3, më konkretisht unë dhe zoti Çefa. Kërkojmë që brenda afatit, sa më shpejt dhe nga deklaratimet u bë e ditur që mund të bëhet për 3-4 ditë. Të na vihet në dispozicion informacioni në lidhje me kryqëzimin e të dhënave nga pajisjet PEI Qarku Gjirokastrë. Po ashtu në lidhje me kërkesën për prova të subjektit zgjedhor, kandidatit Kreshnik Merxhani u vendos me shumicë votash rrëzimi i kërkesës. Në lidhje me vijimin e seancës së shqyrtimit administrativ për këto tre kërkesa ankimore që i përkasin Qarkut Gjirokastrë, duke qenë se do presim dy provat që kërkohen nga Administrata e KQZ-së dhe që janë pjesë e materialeve zgjedhore, do të pezullohet ky proces i shqyrtimit administrativ deri në marrjen e provave. Do të njoftohen sërish se kur do të rinis procesi ndërkohë që në datë 14.05.2021 ora 10:00 do të nis shqyrtimi administrativ për kërkesat ankimore që i përkasin Qarkut Berat. Më konkretisht, Kërkesa Ankimore nr.34 e subjektit zgjedhor LSI dhe Kërkesa Ankimore nr.35 e po subjektit zgjedhor LSI si dhe Kërkesa Ankimore nr.42 që i përket subjektit zgjedhor Koalicioni PD - AN. Faleminderit, seanca për sot është e mbyllur.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



18.05.2021  
Ora 10:06

**RENDI I DITËS**

Projektvendim "Shqyrtimi administrativ i kërkesës ankimore me nr.33, datë 07.05.2021, kërkesës ankimore me nr.41, datë 09.05.2021 dhe kërkesës ankimore me nr.52 datë 10.05.2021, me objekt "Ndryshimin e vendimit nr.347, datë 04.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër".

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD, PS, LSI
- **Kandidati i pavarur:** Suela Hasani, përfaqësuesia ligjore e zotit Kreshnik Merxhani.

**Z. L. Braho:** Sot në datë 18.05.2021, riçelim seancën publike të shqyrtimit administrativ të kërkesave ankimore nr.33, datë 07.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Kërkesa Ankimore nr.41, datë 09.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor PD-AN. Kërkesa Ankimore nr.52, datë 10.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Kandidati i paraqitur nga një grup zgjedhësish zoti Kreshnik Merxhani. Ky shqyrtim administrativ zhvillohet në lidhje me ankimin që këto subjekte zgjedhore kanë bërë ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës së rezultateve për

1

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

Qarkun e Gjirokastrës për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021 për Kuvendin. Deri tani kemi zhvilluar seancat, palët kanë bërë pretendimet e tyre. Janë depozituar provat përkatëse, palët kanë kërkuar dhe prova nga KAS. Një pjesë e tyre është rrëzuar me shumicë votash, një pjesë tjetër janë kërkuar nga anëtarë të KAS-it. Konkretisht janë dy prova që janë kërkuar: Një provë që është kërkuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim dhe një provë nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike. Këto prova janë vënë në dispozicion nga Administrata e KQZ-së duke qenë se ishin prova që ishin në administrim të KQZ-së. Së pari një listë të paraqitur nga Lëvizja Socialiste për Integrim ku pretendohet se disa emra ishin komisionerë të Partisë Socialiste ditën e zgjedhjeve. Prova tjetër kishte të bënte me kërkesën e Partisë Demokratike për kryqëzimin e të dhënave të pajisjeve PEI për Qarkun e Gjirokastrës. Ju lutem administratës të bëjë një sqarim lidhur me faktin në qoftë se këto prova ua ka dhënë subjekteve dhe më tej subjektet në qoftë se janë njohur me këto prova.

**Z. Y. Merkaj:** Po sipas kërkesës dhe urdhërimeve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve i kemi nxjerrë këto prova. Dje i kemi shpërndarë nëpër subjektet zgjedhore, gjithashtu një kopje i kemi dhënë dhe KAS-it.

**Z. L. Braho:** Faleminderit para se të vijojmë me palët, sot janë prezent përfaqësuesit e Partisë Demokratike, përfaqësuesit e Lëvizjes Socialiste për Integrim, përfaqësuesi i subjektit të interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë. Ndërkohë që nuk shoh kandidatin subjektin që është kandidati, ka një person që ka qenë dhe herën e kaluar ju lutem në qoftë se mund të prezantohuni.

**Znj. S. Hasani, përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Jam Suela Hasani kam një autorizim duke qenë se vetë kandidati i pavarur nuk kishte mundësi sot të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

ishte këtu edhe për arsye të kohës së shkurtër të njoftimit. Kështu që mund t'ua paraqes autorizimin.

**Z. L. Braho:** Mund t'ia depozitoni administratës, unë personalisht ju mbaj mend nga hera e kaluar. Atëherë në bazë të nenit 141, sot në këtë seancë të bëhet mbyllja e hetimit administrativ, nuk e di në qoftë se palët kanë ndonjë kërkesë tjetër në lidhje me prova.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ashtu siç tha dhe sekretari i përgjithshëm, ditën e djeshme na është vënë në dispozicion pjesë e materialit të kërkuar qoftë nga subjektet ankuese nga Lëvizja Socialiste për Integrim dhe nga Partia Demokratike e Shqipërisë. Për sa u përket dhe kryqëzimit të të dhënave të PEI për Qarkun Gjirokastrë dhe dokumentacionit shkresor të ZAZ-ve dhe QV-ve përkatës për ata dy persona të cilët ne kemi kontestuar si persona të përfshirë në proces zgjedhor për Qarkun Gjirokastrë nëpërmjet listave të subjektit politik Partia Socialiste, ndërkohë duhet të ishin të vetë karantinuar në bazë të udhërit të Ministrisë të Shëndetësisë.

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj kjo ka të bëjë me pretendimet, keni kërkesa për prova të reja?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Të lutem zoti Braho pikërisht të kërkesa për prova të reja do të vijë. Duke qenë se mendojmë se shqyrtimi pavarësisht se nga provat dalin që ata persona kanë qenë qartazi anëtarë të komisioneve zgjedhore për Partinë Socialiste do të duhet që KAS të investojë akoma më shumë për qartësimin e pozicionit të tyre. Dakord që KAS rrëzoi kërkesën tonë për marrjen e të gjithë



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

materialit të Drejtorisë për Kufirin e Emigracionit që ka të bëjë me kalimet e këtyre shtetasve në atë periudhë kur ka qenë ndalimi. Por, fakti është që ata ishin persona që ju mund t'i merrni dhe t'i thërrisnit këtu, t'i pyesnit, t'i merrnit dhe pashaportat e tyre për të parë kalimet apo jo në këto pika kufitare dhe detyrimin apo jo për t'u karantinuar të këtyre personave, gjithsesi ne këtë kërkesë kishim.

**Z. L. Braho:** E kuptuam do shprehemi pasi të dëgjojmë dhe palë të tjera në lidhje me këto, Partia Demokratike ka ndonjë gjë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Jemi dakord me kërkesën për provat të kolegëve të LSI-së, nuk kemi kërkesa për prova të tjera shtesë.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, përfaqësuesja e subjektit Kreshnik Merxhani?

**Znj. S. Hasani, përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Ne nuk kemi kërkesë të tjera shtesë kështu që jemi dakord.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Salianji si përfaqësues i subjektit të interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë?

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Faleminderit, dje na është vënë në dispozicion raporti i PEI, në të cilët sipas deyrave që i'u dha nga KAS-i, këta kanë bërë kryqëzimin e të dhënave nga ai shqyrtim i raportit. Arsyetimi në të cilën dhe konkluzionin që ka dalë ky raport për ne është i paqartë dhe ka mangësi të theksuara, për shkak se kërkohet një sqarim i mëtejshëm se çfarë të dhënash janë këto që na janë paraqitur ne. Unë kërkoj që të thirren në seancë të shqyrtimit



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

administrativ Kryekomisioneri ose Nënkomisioneri personat përgjegjës, të cilët kanë administruar raportin e PEI si dhe përfaqësuesi i firmës i cili ka në administrim këtë proces. Pra, aparaturat e PEI dhe operatorët teknikë të cilët kanë administruar këtë proces që janë operatorët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe firmës, kjo e fundit në varësi të shpjegimeve të cilët do të japin Kryekomisioneri ose Nënkomisioneria. Unë nuk do e ngrija në fakt këtë kërkesë, por meqenëse kjo provë ka bërë lajm dhe opinionin publik nuk është thënë ajo që në të vërtetë ka ndodhur. Ne informacionin se çfarë ka ndodhur në Gjirkastër nëpërmjet anëtarëve tonë të komisionit e kemi shumë të qartë. Në shkresë thuhet 73 raste të dyshimta që nënkupton kur e lexon si shifër nënkupton që 73 raste mund të kenë votuar. Për ne nga verifikimet që kemi bërë dje në këto qendra votimi është 0 persona, të cilët kanë votuar në qendra e votimit, personat të cilët nuk u takonte të votonte. I vetmi rast thuhet në operator është vetëm një rast i cili një person ka vajtur në dy qendra votimi për të votuar si dhe bie në sy që janë në një qendër votimi 17 klikime shenjë gishti dhe një qendër votimi 20 klikime. Ne e hetuam këtë rast se po të ishte e vërtetë normalisht do përbënte shqetësim, por kjo ka të bëjë me veprimtarinë e dy operatorëve të cilët nga mostrajnimi në rastet në të cilat personat e moshuar gishti nuk jepte OK për të vazhduar, atëherë operatori i ka dhënë OK me gishtin e vet. Por kjo që tashmë të sqarohet një herë e mirë se nuk do t'i shërbejë vetëm këtij procesi i Gjirokastrës por i gjithë procesi në tërësi, unë mendoj se do të bëjmë një hetim të thelluar, kjo do t'i shërbejë dhe procesit të Gjirokastrës dhe transparencës zgjedhjeve. Unë besoj që siç dhe ne e kemi marrë informacionin, por informacioni jonë për ju është një anshëm, prandaj ju si KAS duhet të thërrisni dy drejtuesit kryesor të institucionit dhe ata duhet të sqarojnë se çfarë në të vërtetë ka ndodhur, pra problemet teknike nuk mundet që të bëjnë pis procesin. Unë e kërkoj me këmngulje këtë provë që të merret, për arsye se tani siç

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

e dimë jemi në një situatë ankimore dhe çdo gjë që del nga kjo sallë këtu është qime por kur del jashtë bëhet tra. Tani meqënëse kjo vërtet e ka marrë vëmendjen e opinionit publik, ne kemi detyrimin si për procesin si për transparencën ta sqarojmë deri në fund se çfarë ka ndodhur me aparatet e PEI. Unë ua them me bindje të plotë, 0 persona të cilët kanë votuar dy herë për arsye që të gjithë persona që kanë votuar kanë hedhur nënshkrime ka dhe kartat e identitetit në qendrat e votimit. Difektet teknike të vijnë t'i sqarojnë këtu operatorët dhe personat përgjegjës, të cilët pas sqarimit besoj dhe ju do të bindeni që nuk ka asnjë efekt për procesin e votimit në Gjirokastër, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Salianji, palët prapësimë në lidhje me këtë provë të kërkuar nga përfaqësuesi i subjektit të interesuar?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Për ne është shumë e qartë tabela e sjellë bashkëlidhur dokumentit që na është vënë në dispozicion ditën e djeshme. Nuk e di se ku nuk e gjen qartësinë zoti Salianji, e tha që ne kemi informacion por ndërkohë që paska bërë hetime dhe nuk e vë në dispozicion hetimin të këtij komisioni në mënyrë që të gjithë ne të njihemi me të. Ashtu siç tha zoti Salianji është marrë të themi hapësirë e mjaftueshme mediatike për të thënë një të vërtetë ashtu siç e mori zoti Salianji për të pretenduar të kundërtën e të vërtetës. Ndërkohë që ne gjejmë shumë të qartë këtë tabelë, është e sqaruar në hollësi që kanë qenë raste 73, 12 shenja gishtash kanë përdorur tentativa ose votim për 70 persona në këtë rast dhe është rast të dyfishtë të parashikuar në kolonën e tretë të pasqyruar në këtë dokument. Po ashtu bashkëlidhur këtij dokumenti i nderuar zoti Braho është dhe një listë emërore të paktën për fshehtësi të themi dhe imponim të ligjit rezulton të jetë vetëm shkronja e parë e emrit dhe mbiemrit, domethënë inicialet e personit

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

gjinia, datëlindja e tij numrit i qendrës së votimit dhe qarkut përkatës. Më shumë se kaq nuk di se çfarë duhet të bënte operatori teknik ose personi i ngarkuar me këtë punë këtu që në këtë rast është Nënkomisioneria Shtetërore e Zgjedhjeve. Është shumë e qartë kjo gjë më shumë e shoh si një dokument të karakterit hetimor që ka të bëjë me organin procedues për të thelluar më tej hetimet mbi përgjegjësitë të konsiderueshme penale që mund të kenë personat të caktuar, të cilët në tentativa ose në realizimin e qëllimit për votim të shtyrë nga persona të tretë kanë ndërmarrë këtë nismë. Për sa i përket pjesës së zotit Salianji nuk e shoh të arsyeshme që të kemi një hetim të thelluar, nuk do i bënte mirë procesit për shkak se transparenca është aq e qartë sa....

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Kaziaj, zoti Kaso.

**Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit i nderuar, në vijim të asaj çfarë tha zoti Kaziaj, por dhe të asaj se çfarë tha përfaqësuesi i Partisë Socialiste, besoj që të dhënat që na u paraqitën nga administrata sipas provës që ne kemi kërkuar të kryqëzimit të të dhënave janë eksplisite dhe flasin qartë. Flasin për paaligjshmëri të ndodhur në një masë të caktuar po them në gjithë zonën zgjedhore të shpërndarë sipas qendrave të votimit dhe lista që i bashkëngjitet kërkesës sonë dhe relacionit shpjegues të dhënë nga administrata është po ashtu aq e qartë pasi vetëm nga sa konstatojmë në dy raste flet për administratë zgjedhore dhe pjesën tjetër e paraqet në llojin e verifikimit si lista e qendrës së votimit. Pra ka ndodhur nga persona dhe besoj që për aq sa i duhet këtij hetimi, pra kësaj shqyrtimit të kërkesës për paligjshmëri qoftë tonës qoftë kërkesës së Lëvizjes Socialiste për Integrim, besoj se të dhënat janë të qarta, ajo çfarë i mbetet këtij komisioni për të vendosur është në qoftë se kjo paligjshmëri është e tillë që të shkaktojë pavlefshmëri. Është e tillë





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

që ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore është një lloj paligjshmërie le të themi aq e rëndë sa të ketë cënuar procesin në një mënyrë të tillë që ky proces duhet të ripërsëritet në të gjithë zonën zgjedhore apo jo. Nga ana tjetër ne kemi qenë të parët që kemi bërë kërkesë në KAS për hetim të plotë dhe të gjithanshëm për çfarë do lloj shkelje zgjedhore, për çfarë do lloj parregullsie që mund të ketë ndodhur në këtë proces. Parimisht jemi pro hetimit të çfarë do lloj rasti qoftë edhe të këtij lloji pavlefshmërie që mund të ketë ndodhur kur persona kanë tentuar ose potencialisht kanë votuar që të gjithë më shumë se një herë, sepse vetë relacioni parashtron si raste të dyshimta për ne janë të gjithë raste potencial që kanë ndodhur. Kështu që tërësisht të hapur për hetimin e plotë, të çfarë do lloj karakteri administrativ i juaji dhe më pas penal i organeve tjera që do të shqyrtohen këto lloj shkelje pasi Kodi e parashikon si të tillë. Kohën dhe momentin në të cilën do të ndodhë ky hetim zgjidheni ju, pra në qoftë se ju e konsideroni që kaq prova sa kanë ardhur që për fat të mirë falë implementimit teknologjisë ne e kemi sot të plotë relacionin, janë të mjaftueshëm dhe të dobishëm për shqyrtimin tuaj administrativ, vazhdoni dhe konkludoni me këtë provë. Në qoftë se ju e konsideroni që kjo provë në këtë gjendje siç është nuk është e mjaftueshme për ta rritur në konkluzion, ne jemi të rësisht të hapur për hetim të çfarë do lloj shkelje në çfarë do lloj mase kudo që të ketë ndodhur nga kushdo që të ketë ndodhur që të mbajë secili përgjegjësitë e veta për çfarë ka ndodhur në këtë proces, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Kaso, përfaqësuesja e zotit Merxhani nuk e di ju është vënë në dispozicion kjo provë?

**Znj. S. Hasani, përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Jo këtë doja dhe unë të kërkoja faleminderit për këtë pyetje. Ne nuk na është vënë në asnjë nga këto në



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

dispozicion kështu që nuk mund të shprehemi lidhur me diçka.. Madje dhe lidhur me këtë mbledhje na është njoftuar tepër vonë çdo gjë shumë vonë, kështu që do ju falenderoja nëse na jepni këtë mundësi.

**Z. L. Braho:** Kërkoj unë falje në emër të Administratës së KQZ-së për njoftimin dhe për mungesën e provës, por merrni kohën e mjaftueshme tani që të njiheni dhe të bëni prapësime në lidhje me atë çfarë pretendoi subjekti i interesuar Partia Socialiste.

**Znj. S. Hasani, përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Faleminderit.

**Z. K. Bele:** Kam dhe një diskutim për çfarë u tha ndoshta dhe pyetje, por pyetje nuk kam kujt t'ia bëj. Në fakt bie dakord me atë çfarë tha në fund zoti Kaso që sistemi ka qenë i duhur dhe kemi besim në integritetin e sistemit është thënë dhe më parë kjo që ne kemi besim në integritetin e sistemit por nga ana e tjetër nuk e kuptoj një lloj stepje spo e quaj refuzim për të sqaruar këtë material. Për hir të vërtetës ky ndoshta është dhe një raport teknik dhe raportet teknike mund të jenë kaq të shkurtra por ky raport ka një tabelë në dy tre rreshta përdoret termi "raste të dyshimta", nuk ka një shpjegim për metodologjinë pra çfarë përfaqëson dhe nuk ka as edhe një konkluzion. Me të drejtë shumëkush përfshirë personalisht unë kur e lexoj do të doja të kuptoja më shumë qoftë edhe për faktin se ky sistem është implementuar për herë të parë në këto zgjedhje. Pastaj ajo që tha zoti Kaziaj se nuk është qëllimi im të komentoj çfarë thoni ju po meqënëse është pjesë e këtij diskutimi tani t'i marrim këto raste të dyshimta dhe të konkludojmë në një kohë që raporti në asnjë fjalë nuk e thotë që ka votuar më shumë se një herë, flet vetëm për një tentativë të një personi për të votuar në dy qendra mund të jetë lajthitje mund të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

jetë e qëllimshme, patjetër duhet të vlerësohet penalisht siç e thanë dhe parafolësit. Unë mendoj që i vlen këtij hetimi administrativ të paktën këtë herë ose nëse vlerësohet dhe në raste të tjera që përfaqësues të ngarkuar të KQZ-së dhe ligjvënësi ka bërë një rregullim ligjor në nenin 14 të posaçëm ku thotë Nënkomisioneri është përgjegjës për caktimin e zbatueshmërisë dhe drejton punën në zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve. Pra do të ishte e udhës që të paktën Nënkomisioneri po ndoshta dhe Komisioneri ta gjykojë KAS-i, të vijë dhe të na ndihmojë të kuptojmë më shumë nga ky raport dhe ndoshta do të na japë dhe një përgjigje më shumë që i vlen këtij hetimi që kjo është thelbësore po pse jo në fund të ditës ka një qëllim pse kjo seancë bëhet publike dhe nuk bëhet si një seancë e zakonshme administrative apo një çështje gjyqësore. Pra një qëllim pse kjo seancë bëhet publike sepse zgjedhjet janë çështje në interes të madh publik dhe po të themi që PEI provoi këtë, provoi atë krijojnë konfuzione të panevojshme. Në këtë sallë ka pasur dakortësi për vlerën e sistemit, shumë mirë që na ka prodhuar një raport dhe krijon edhe perceptimin që kushdo të votojë dy herë sistemi të dallohet, po për nevoja të procesit administrativ për më tepër kur kërkohet pavlefshmëri për shkelje të rënda të ligjit do të ishte e udhës. Unë mendoj që këta persona përgjegjës që kanë njohur i të thelluara për këtë proces, të cilat nuk mendoj se i ka ky komision të na ndihmonin të kuptonim çfarë janë këto raste të dyshimta, sa këto raste kanë ndikuar nëse mund t'i marrim këto pyetje në rezultat. A ka ndonjë votë e cila është në kuti për shkak të mosfunkcionimit apo keqfunktionimit të sistemit, apo pyetje të tjera? Se nuk jam unë në gjendje të shteroj pyetjet. Për ta mbyllur mendoj se kërkesa për të pasur përfaqësuesit e nivelit të lartë të KQZ-së, të cilët aq më tepër dhe të ngarkuar me procesin pra përkatësisht Nënkomisionerja dhe Komisioneri nëse do të çmohet do i vlen procesi dhe nuk shoh që kjo do të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

krijonte ndonjë pengesë në zvarritje përkundrazi do i rriste transparencën këtij procesi, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Zoti Bele meqënëse ju u shprehët “unë jam i paqartë”, kjo ishte në diskutimin e debatit që u bënë palët apo në kuptim të nenit 136, 3 që ju po kërkonti këtë provë më dëshmitarët duke qenë se dëshmitarët janë pjesë e KQZ-së. Në qoftë se do të presim dhe prapësimet e palës që përfaqëson subjekti Kreshnik Merxhani, apo të vijojmë direkt me marrjen e kësaj prove me kërkesën tuaj që ta qartësojmë proceduralisht.

**Z. K. Bele:** Meqënëse këtu u paraqit edhe një kërkesë për të fituar kohë për t’u njohur me provën nga një proces ndërkaq njëra palë, pala tjetër në një farë mënyre kërkoi marrjen e një prove të re ose thellimin e kësaj. Pra qasja procedurale për mua ka pak rëndësi mbase një konsultim me administratën do të sygjeroja. Nëse ka dakortësi në atë të komisionit mund të caktohet një seancë më vonë sot për këtë qëllim ndoshta sot paradite apo pasdite të merret një kontakt dhe ecim me të dyja dhe me prapësimet e palës së tretë në këtë proces, përfaqësueses së kandidatit të pavarur dhe mund të kryejmë dhe pyetjen e këtyre personave në drejtim të thellimit të hetimit administrativ lidhur me marrjen e kësaj prove. Nëse duhet ta kërkojmë si provë të re si anëtar KAS-i dhe proceduralisht ju mendoni që i vlen shqyrtimit të cilësohet i tillë mund ta cilësojmë dhe ashtu.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Bele, po zoti Çefa.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit zoti drejtues, sigurisht jo për të humbur shumë kohë po thjesht mbase e shoh me vend të bëj dy sqarime që mbase do të na vijnë të gjithëve



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

në ndihmë lidhur me raportin e kryqëzimit të të dhënave të pajisjes bimiotrike. Në opinionin tim unë raportin e shoh krejtësisht të qartë dhe nuk besoj që prania e një personi më teknik se ne këtu duhet të na sqarojë përtej sa është shkruar në raport. Janë vërejtur dy fenomene nga kryqëzimi i të dhënave, dy raste kur i njëjti person ka votuar në dy qendra votimi të ndryshme dhe 12 shenja gishtërinjsh të përdorura si nënshkrim bimiotrik për identifikimin e 70 zgjedhësve të tjerë. Mendoj që saktësimi i faktit se cilët zgjedhës kanë përdorur një shenjë dhe sa është numri i tyre dhe qëllimin pse është përdorur kjo, ne nuk do ta arrijmë kurrë sado që t'i kemi qoftë dhe dëshmitarë personat këtu. Unë mendoj që kjo është një çështje që i përket një hetimi të një karakteri tjetër mbasi një hetimi penal në mënyrë që të evidentohet. Pra që organi procedues apo organi i akuzës të evidentojë qëllimin e këtyre veprimeve dhe mënyrën sesi këto veprime janë kryer konkretisht. Unë nuk besoj që prezenca e Zevëndëskomisionerit sot do të na japë përgjigjen e kësaj pyetje. Kështu që për ekonomi administrative unë do të kisha thënë që dhe mund ta anashkalojmë këtë moment procedural, sepse jam i bindur në fund dhe ata nuk do të jenë në gjendje të na e sqarojnë këtë, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Çefa përfaqësuesja e zoti Kreshnik Merxhani në lidhje me këtë provë dhe me prapësime në qoftë se keni ndaj kërkesës së përfaqësuesit të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë.

**Znj. S. Hasani, përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Në lidhje me këtë kërkesë, doja të thoja në fakt që thellimi i kësaj kërkesë edhe hetimi i mëtejshëm ka më shumë të bëjë me një qark penal. Në fakt në çështjen administrative në të cilën ne jemi mesa unë pata mundësi të shoh është e qartë dhe kjo vlen më shumë për t'i qartësuar shkeljet dhe pavlefshmëritë e Qarkut Gjirokastrë. Ky është



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

qëndrimi që ne kemi nuk ka pse të thellohet është më shumë humbje kohe dhe ka vende të tjera në të cilat mund të thellohet kjo dhe sigurisht do të thellohet.

**Z. L. Braho:** Faleminderit në fakt për të sqaruar dhe unë tabela më duket e qartë, informacioni më duket i qartë. Më duket një informacion i tillë që sado të thërrasim Zevëndëskomioinerin apo Komisionerin Shtetëror i Zgjedhjeve nuk besoj se do arrijmë të gjejmë rastet ose më saktë t'i identifikojmë rastet se kush janë këto persona që kanë vendosur gishtin më shumë se një herë, sepse ne thjesht mund të identifikojmë kartat e identitetit për të cilat është votuar, por jo se kush është personi që ka vënë gishtin. Kjo për mendimin tim i përket një hetimi penal që duhet të kryhet së bashku me kamerat çdo qendër votimi në mënyrë që të gjendet se kush është personi që ka vendosur gishtin për këto karta identiteti. Unë jam shumë dakord me pjesën e transparencës në zgjedhje, është shumë e rëndësishme. Siç e tha dhe kolegu Bele duke qenë se jemi në kushtet e një teknologjie të re që përdoret për herë të parë patjetër që vlen për transparencën e zgjedhjeve, por duhet të themi që këto zgjedhje për herë të parë u caktuan dhe disa rregulla në lidhje me përdorimin e administratës publike të aseteve publike nga partia që është në pushtet sipas rastit dhe transparenca në lidhje me këto kërkesa nuk u pranua kështu që besoj se jemi në të njëjtat kushte dhe në këtë rast. Ndaj përveç faktit që nuk do të arrijmë dot të zbulojmë ndonjë gjë, unë i kërkoj Administratës së KQZ-së që të zbatojë detyrën të paktën për rastet e Komisionerëve apo administratës zgjedhore që është konstatuar në kushtet e votimit të dyfishtë. Në dijeninë time jemi në kushtet e një veprë penale të konsumuar nga këta komisionerë kështu që në zbatim të ligjit Administrata e KQZ-së duhet të procedojë në qoftë se nuk ka proceduar ende. Për pjesën tjetër në qoftë se nga anëtarët e komisionit kanë ndonjë gjë për të sqaruar?

13

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Më duket se ne e çuam gjënë prapsh domethënë i takonte palëve të bënin vlerësimin e provës në pretendimet e tyre dhe pastaj ne të gjykonim për vlerën që ka prova. Po evidentojmë më shumë këtë provë dhe po merremi vetëm me këtë sikur të jetë ky objekti i çështjes tonë në fakt nuk është kështu. Unë jam dakord për ta thënë përpara gjënë që duhet thënë në fund, jam dakord që nuk ka nevojë të thellohem më shumë dhe të thërrasim të pyesim Nënkomisioneren ose pjesë nga stafi për një motiv që është shumë i thjeshtë. Ne duhet të pranojmë të gjithë faktin që kjo provë që është prodhuar pas kërkesës së dy anëtarëve se nuk ekzistonte është prodhuar me nxitim dhe është prodhuar pa kryer një hetim përfundimtar mbi fenomenin. Ky fakt kondicionon pastaj gjithë përmbajtjen e provës, prova ka statistikën për leximin e gjurmës së gishtit nga pajisja dhe statistika deri në këtë pikë është ajo që është ka dyshim për dy persona në Qarkun e Gjirokastrës që mund të kenë votuar dy herë dhe ka një dyshim që për një grup personash me identitet të përcaktuar, sepse është lexuar karta e tyre dikush tjetër ka vënë gjurmën e gishtit vetëm kaq asnjë gjë më shumë se kaq. Nuk ka dyshim për gjëra të tjera nuk ka dyshim për votim masiv për më shumë sesa një një herë ka vetëm këtë dyshim i cili është në vlerësimin tim 100% i verifikueshëm, sepse bashkë me regjistrimin e makinës është dhe regjistrimi video i kameras, i cili përputhet menjëherë dhe me cilësi me regjistrimin e makinës dhe identifikon personat dhe rrethanat në të cilat kanë ndodhur gjëja. Por në qoftë se ne thërrasim Nënkomisioneren, ajo nuk do të na thotë dot asnjë gjë nga këto nuk do të na thotë dot asnjë gjë nga këto, nuk do të na sqarojë dot asnjë gjë, sepse hetimi administrativ i KQZ-së nuk është mbyllur. Është prodhuar me nxitim një raport i cili duhet të kënaqte kërkesat e një pjese të komisionerëve të anëtarëve të komisionit, pavarësisht nga kjo, prova që u kërkua është në tryezën tonë. Secili

14

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

nga ne është në gjendje t'a vlerësojë atë, secili nga palët pjesëmarrëse në këtë proces ka aftësinë e plotë të bëjë dhe propagandë me të mundësisht jashtë mureve të kësaj zyre sepse në këtë zyrë bëhet profesionalizëm jo propagandë. Secila palë, të thotë të vërtetën e vet, janë të lirë ta thonë si të duan, ne të vërtetën tonë do ta themi me vendimin tonë dhe kemi mjafrueshëm të dhëna për të pasur qartësi tek vlera e provës në raport me kërkesën. Kërkesa është pavlefshmëria e zgjedhjeve në qark, vlerën e provës do ta çmojmë me vendimin përfundimtar. Kështu që nga kjo pikëpamje nuk ka nevojë që ne të shkojmë dhe ta tjerim më gjatë çështjen, por le ti lëmë rradhën palëve të shprehin pretendimet e tyre përfundimtare dhe vlerësimin e të gjitha provave bashkë me pretendimet e tjera përfundimtare. Ne pastaj të tërhiqemi, të pjekim mendimin tonë, debatin, diskutimin dhe dalim me një vendim të shëndodhë nga kjo mbledhje.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Rusmali! Po zoti Bele.

**Z. K. Bele:** Meqenëse këtu patëm dhe një diskutim procedural, unë bie dakord pjesërisht, që këtu sigurisht kemi çfarë kuptojmë, por unë insistoј tek e drejta për të kuptuar më shumë. Është neni 136 që na ka dhënë këtë mundësi procedurale që një anëtar i KAS-it në fakt dhe dy anëtarë të KQZ-së, mund të kërkojnë, nuk e di nëse jemi një apo dy apo më shumë anëtarë. Por unë do të insistoja që, ose do të kërkoja se ndryshe ishte insistim, do të kërkoja që kjo provë të merret në këtë proces qoftë edhe për sqarimin pjesor të KAS-it për kuptueshmërinë time do të më ndihmonte, shpresoj dhe opinionin. Bëjmë pak minuta pushim, do sugjeroja që edhe ne t'a diskutojmë. Marrim dhe kohën...

**Z. L. Braho:** Dakord zoti Bele, po zoti Lako.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

**Z. E. Lako:** Pavarësisht pjesës që kjo provë që u kërkua i takonte procesit pas përfundimit të këtij hetimi dhe nuk ka të bëjë në opinionin tim me këtë hetim. Bie dakord me atë që tha zoti Rusmali, përderisa kjo është një provë që është kërkuar dhe është një dokument që na është vënë në dispozicion dhe palët janë shprehur. Do të ishte mirë të ketë një sqarim nga administrata për ta bërë më të dobishme nëse e quajmë provë, për ta bërë më të sqaruar që të mos fillojmë të bëjmë interpretime pavarësisht se interpretimet mbi rastet të dyshimta nuk na takojnë ne t'i bëjmë. Megjithatë unë e çmoj të nevojshme prezencën e Nënkomisioneres ose kush do të jetë nga administrata për këtë.

**Z. K. Bele:** Më fal dhe një plotësim të asaj që thashë, sigurisht në asnjë rast nuk nënkuptoj që ky sqarim do të pengonte një hetim penal nëse do të jetë e nevojshme dhe bie dakord me atë që tha zoti Rusmali që kjo kërkon një thellim. Një hetim të thelluar të karakterit penal nëse ka prova si dhe faktin që këto prova nuk u deshën marrë në këtë fazë të procesit qoftë dhe për këtë konfuzion që krijojnë po pavarësisht nga kjo ne jemi para faktit, Kështu që e diskutojmë mbase dhe me njëri tjetrin dhe gjejmë një modus.

**Z. L. Braho:** Dakord unë thjesht doja të kuptoja kë kërkoni të thërrisni qartësisht dhe në çfarë cilësie? Meqënëse po flasim për prova cilësinë e ekspertit, dëshmitarit..

**Z. K. Bele:** Prova është kjo që është.

**Z. E. Sallianji, përfaqësues i PS-së:** Më fal vetëm për një gjë teknike që do t'jua zgjidhte dhe ju problemin, nuk është provë e re kjo që kërkojmë ne. Kjo shkresë



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

është firmosur nga Alba Pelingu, pra është kjo prova që na kanë sjellë, ajo duhet të vijë që ka sjellë provën se ne nuk po kërkojmë jashtë këtij procesi. Të vijë të sqarojë Alba Pelingu sesi e ka kryer këtë proces administrativ kaq nuk po kërkojmë provë të re.

**Z. L. Braho:** Ju e konsideroni akt ekspertimi dhe doni sqarime në lidhje me aktin e ekspertimit mesa kuptoj.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Unë sqaroj një akt i cili është i paqartë kërkon personi që ka hartuar aktin jo provë e re nuk keni çfarë votoni keni votuar ju për ta marrë këtë akt. Të vijë ta lexojë sesi 3 operatorët që ne kemi dijeni në 45 raste kanë shtypur vetë.. të vijë ta thotë ajo se ne e dimë çfarë ka ndodhur.

**Z. L. Braho:** Zoti Salianji unë nuk e di nga e keni identifikuar ti këtë punën e operatorit se nuk identifikohet.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Të vijë personi i cili ka bërë shkresën e njëjta provë është siç tha zoti Rusmali...

**Z. L. Braho:** Pra në qoftë se u referohemi specifikimeve teknike të pajisjes nuk besoj se mund ta identifikojë dot as zonja Pelinku, as ju këtë çështje.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Të vijë ta thotë prandaj kërkova dhe 3 operatorët.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

**Z. L. Braho:** Zoti Merkaj ju lutem kontaktoni me Nënkomisioneren dhe thojini kur e ka të mundur sa më shpejt që të vijë e pranishme në këtë seancë shqyrtimi administrativ, për të bërë sqarime në lidhje me këtë provë të sjellë dhe të nënshkruar nga ajo dhe sa e gatshme është që të bëjë sqarime në një kohë sa më të shpejtë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Nënkomisionerja është nënshkruesja e këtij akti të sjellë në cilësinë e provës, por Nënkomisionerja në dijeninë time nuk është personi teknik përgjegjës.

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj, Nënkomisionerja vendos vetë në qoftë se do të vijë së bashku me ekspert apo jo. Këtë do ta lemë ta sqarojmë në një moment tjetër, të marrim vesh kur e ka mundësinë të vijë në mënyrë që të vijojmë dhe të mos zvarrisim procesin. Atëherë bëjmë 15 minuta pushim dhe rikthehemi në orën 11:00, faleminderit.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora: 11:06**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Riçelim seancën e shqyrtimit administrativ të Kërkesave Ankimore nr.33, 41 dhe 52 që kanë të bëjnë me tabelën e rezultateve të Qarkut Gjirokastrë. Seanca u shty me qëllim që Administrata e KQZ-së të kontaktonte Nënkomisioneren Shtetërore të Zgjedhjeve lidhur me kërkesën e bërë prej 2 anëtarëve të KAS-it për pyetjen e saj në lidhje me një raport që ka dorëzuar pranë KAS-it. Atëherë zoti Merkaj?



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

**Z. Y. Merkaç:** Sipas porosisë së KAS-it, unë kontaktova me zonjën Alba Nënkomisioneren por nuk ishte në zyrë. Zonja Pelingu kërkoi mirëkuptimin e KAS-it dhe të gjithë të pranishmëve dhe tha: Pyetjet të bëhen me shkrim dhe unë jam e gatshme t'u kthej përgjigje me shkrim.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Merkaç, një mendim të anëtarëve në lidhje me këtë? Nuk e bëme me kërkesën e palëve të propozur, e bëme me kërkesën e anëtarëve.

**Z. K. Bele:** Megjithatë, është e udhës që Nënkomisionerja Shtetërore e Zgjedhjeve të jetë në këtë seancë dhe të shpjegojë. Sjell dhe një herë vëmendjen që kjo është një provë e kërkuar nga ankuesi PD si dhe Nënkomisioneri, personi përgjegjës për teknologjinë është emëruar me propozim të opozitës për mbikqyrjen e këtij procesi. Pra, kjo provë që ne diskutojmë është kërkuar dhe përgjigjja është dhënë. Sigurisht mund t'i bëjmë dhe me shkrim, ne tërhiqemi dhe vendosim këtë se nuk i vlen këtij debati por mendoj është e pakuptim mos ardhja e Nënkomisionerit në këtë seancë kur duhet të ishte e kundërta, duhet të kishim një vullnet të qartë për të shpjeguar çfarë ka ky raport. Megjithatë tërhiqemi dhe diskutojmë.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, zoti Bele. Në fakt, të gjithë jemi në dijeni se kush është propozuar nga kush, kush e kërkoi provën, ne në fakt provën e kërkuam në seancë me shkrim na erdhi dhe nuk besoj se ka ndonjë problem që dhe përgjigjet e zonjës Pelingu të vinë po me shkrim ndaj pyetjeve tuaja që keni sqaruese mbi këtë akt që ka depozituar. Gjithsesi e vlerësojmë dhe e vendosim, nëqoftëse ju i keni pyetjet të gatshme tani, mund t'i bëjmë pyetjet dhe në lidhje me përgjigjen e vendosim nëqoftëse do bëhen përgjigje verbale apo përgjigje me shkrim.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.18.05.2021*

Pelingu të vinë po me shkrim ndaj pyetjeve tuaja që keni sqaruese mbi këtë akt që ka depozituar. Gjithsesi e vlerësojmë dhe e vendosim. Nëqoftëse ju i keni pyetjet të gatshme tani, mund t'i bëjmë pyetjet dhe në lidhje me përgjigjen e vendosim nëqoftëse do bëhen përgjigje verbale apo përgjigje me shkrim.

**Z. K. Bele:** Ne ishim përgatitur për të patur një diskutim sqarues në lidhje me zonjën Pelingu dhe mbase dhe palët mund të bënin pyetje pasi kjo u kërkua dhe nga palët, të paktën pala që ishte e pa sqaruar se nga 4 palë 3 ishin shumë të qarta për provën. Gjithsesi, marrim kohën e nevojshme dhe procedojmë me përgatitjen e pyetjeve ose eventualisht me riapelimin e zonjës, se ne nuk jemi organ procedues penal që të kërkojmë shoqërim të detyrueshëm nëqoftëse nuk është e mundur që të paraqitet dhe të sqarojë, atëherë do të shikojmë opsionet e tjera që na lejon shqyrtimi administrativ në këtë proces. Kështu që unë do të propozoja shtyrjen e kësaj seance dhe vazhdojmë me seancën tjetër kush është në rradhë, pasi kemi mjaftueshëm procese.

**Z. L. Braho:** Faleminderit, KAS i konsultuar në vend vendosi ta pezullojë dhe ta shtyjë seancën për kërkesat ankimore që janë në këtë gjykim administrativ, për nesër në orën 9:00. Në lidhje me seancën që është caktuar për kërkesat ankimore të Qarkut Berat për pavlefshmërinë, duke qenë se palët që janë pjesë e këtij shqyrtimi administrativ janë pjesë dhe të Qarkut Berat po ashtu i ndihmon dhe palët në lidhje me kohën e nevojshme për provat që u nxorrën dje nga kutitë e materialeve. Kështu që seancën për Gjirokastrën e shtyjmë për nesër, datë 19 maj, 2021, ora 09:00. Ndërkohë që për seancën e Beratit të jeni të gatshëm që menjëherë në përfundimin e seancës se Gjirokatrës të vijomë me Qarkun e Beratit, faleminderit.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

19.05.2021  
Ora 09:24

**RENDI I DITËS**

Projektvendimi "Për shqyrtimin e Kërkesës Ankimore nr. 33, datë 7.05.2021;  
Kërkesës Ankimore nr. 41, datë 9.05.2021 dhe Kërkesës Ankimore me nr. 52 datë  
10.05.2021, me objekt "Ndryshimin e vendimit nr. 347, datë 04.05.2021, të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse të  
rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastër".

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli BELE, Z. Ledio BRAHO
- **Nënkomisioneria Shtetërore e Zgjedhjeve:** Znj.Lealba Pelinku
- **Stafi KQZ:** Z. Y.Merkaj, Z. O.Peto
- **Parti Politike:** PD, PS, LSI
- **Kandidat i propozuar nga zgjedhësit, zoti Kreshnik Merxhani**

*Z. L. Braho:* Mirmëngjes, sot në datën 19 Maj 2021 riçelet seanca publike e shqyrtimit administrativ të kërkesave ankimore nr. 33, 41 dhe 52 të depozituara respektivisht nga subjektet zgjedhore Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Koalicioni PD-AN dhe kandidati i paraqitur nga një grup zgjedhësish, zoti Kreshnik Merxhani. Seanca e sotme u shty me qëllimin që të bëhej një përmbledhje dhe t'i jepej përgjigje disa pyetjeve nga Nënkomisioneria Shtetërore e Zgjedhjeve. Pyetje këto që u bënë nga dy anëtarë të KAS-it. Është e pranishme Nënkomisioneria Shtetërore e Zgjedhjeve zonja Lealba Pelinku, administrata e KQZ-së. Palët

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

ankimuese përfaqësuesi i LSI-së, përfaqësuesi i PD-së, vetë kandidati, subjekt zgjedhor zoti Kreshnik Merxhani, përfaqësuesi i subjektit të interesuar PS dhe KAS-i. Përpara se të vijojmë me pyetje-përgjigje me zonjën Pelinku, ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët? Nuk ka kërkesa paraprake. Atëherë, vijojmë me pyetjet që keni zoti Bele, zoti Lako!

**Z. K. Bele:** Falemenderit, në vijim të asaj çfarë u parashtua dje, për ta bërë më të kuptueshme, ne kemi bërë disa pyetje me shkrim, të strukturuar si dy pyetje. Kemi marrë dhe një përgjigje me shkrim nga Nënkomisioneria, të cilën e falenderoj që shpjegon përtej pyetjeve. Megjithatë për ta ndihmuar dhe për palët e tjera të kuptohen, unë po i drejtoj këto pyetje shkurtimisht. Sjell në vëmendje që në informacionin e dhënë paraprakisht nga zonja Nënkomisionere, flitet për 14 raste shenjash gishtërinjsh të përdorura në Gjirokastër, të identifikuar nga PEI si të dyshuara dhe ne i kemi ndarë. Një nga këto raste, ose më saktë në dy raste, i njeji person është identifikuar dy herë, përkatësisht në 2 QV. Pyetja jonë ka pas të bëjë me "A identifikohen këta persona konkretisht"? në fakt nga materiali bashkëlidhur i cili është në formën e një table excel, ne kuptojmë që personat identifikohen nëpërmjet ID. Pra, nuk po zgjatemi tek kjo pyetje. A është e mundur që të ketë qenë personi në dy qendra votimi në listën e zgjedhësve? Se kjo në fakt nuk e ka përgjigjen tek materiali me shkrim, do të na ndihmojë dhe ne të kuptojmë. Pra, a mund të ndodhë që një person, një shtetas ta ketë emrin në dy qendra të ndryshme votimi?

**Znj. L. Pelinku:** Përshëndetje anëtarë të nderuar të KAS-it, lidhur me pyetjet e paraqitura me shkrim nga dy anëtarët e këtij komisioni, referuar pyetjes tuaj të parë. Lidhur me dy rastet që i njeji person është identifikuar dy herë në dy qendra votimi të ndryshme. Në këto dy raste bëhet fjalë, për dy persona të paktën nga numëri i

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

identifikimit personal, për ta shpjeguar në terma praktikë. Bëhet fjalë për të njëjtin person i cili supozohet që me të njëjtin dokument identifikimi është paraqitur në një qendër votimi dhe paisja ka lexuar atë dokument identifikimi dhe ka depozituar shenjën e gishtit në funksion të nënshkrimit biometrik. Dysohet që po ky person është paraqitur në një qendër tjetër votimi ku po me të njëjtin dokument identifikimi dhe po me të njëjtin nënshkrim, pra me të njëjtin shenjë gishti, po themi ka realizuar procesin e identifikimit të tij në qendrën tjetër të votimit. E njëjta gjë edhe për rastin tjetër. Bëhet fjalë për dy persona.

**Z. K. Bele:** Zonja Pelinku, në dijeninë tonë sistemi nuk është i lidhur on-line me data base, pra funksionon off-line, por në çdo qendër votimi sistemi është i lidhur me listën e zgjedhësve në atë qendër votimi. Pra, një shtetas..., unë shtetasi Koli Bele jam paraqitur në qendrën time të votimit, në qoftë se do të shkoja në një qendër tjetër, besoj se në momentin që do të vihej karta, sistemi do ta refuzonte personin. Ajo që dua unë të kuptoj në të këto dy raste, pavarësisht se ju jeni në fazën e supozimeve, si mendoni se mund të ketë ndodhur që një shtetas është paraqitur në dy qendra votimi dhe sistemi e ka pranuar?

**Znj. L. Pelinku:** Në dy rastet konkrete, nga të dhënat që na rezultojnë nga procesi i kryqëzimit të të dhënave, bëhet fjalë për persona të cilët i përkasin administratës zgjedhore, që do të thotë, ose komisionerë të qendrës së votimit, ose operatori, pasi në mënyrë të tillë u konfigurua dhe paisja për të munësuar votimin e anëtarëve të komisionit dhe të operatorëve të cilët nuk ishin e listës së zgjedhësve të asaj qendre votimi ku ata ishin emëruar si komisionerë. Çdo qendër votimi, ose çdo paisje e vendosur në një qendër votimi ka pas listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi. Paisja ka pas opsionin, apo mundësinë që këta persona të administratës zgjedhore të mund

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

të ushtronin të drejtën e tyre, pra kishte të konfiguruar mundësinë që të ushtronin të drejtën e tyre të votës në atë qendër votimi. Supozojmë që mbasi e kanë ushtruar këtë të drejtë..., ose të paktën... ne flasim për procesin e identifikimit. Pra pasi janë identifikuar në atë qendër ku ata kanë qenë komisionerë, janë paraqitur në qendrën e votimit ku ata kanë qenë të regjistruar në listën e zgjedhësve. Nga këto të dhëna që kemi këtë arrijmë të supozojmë.

**Z. K. Bele:** Faleminderit, kjo e shpjegon në fakt dhe pyetjen e radhës që përse sistemi nuk e ka penguar zgjedhësin të votojë dy herë. Në kuptueshmërinë time kemi të bëjmë me rastin e abuzimit të një personi përjashtimin që ofron sistemi për komisionerin. Pra ka votuar dhe në qendrën ku është zgjedhës dhe në qendrën ku është komisioner. Kjo, për të konkluduar pyetjen time të parë, është vlerë e sistemit, pra tregon që sistemi ka funksionuar, i ka kapur këta dy persona të cilët, ata qofshin, pa i paragjykuar se të kujt krahu janë, besoj ligji do të bëjë punën e tij. Faleminderit, po kaloj tek pyetja tjetër. "Janë opurtunë 12 shenja gishtërinjsh..", po citoj "secila shenjë unike të përdorura si nënshkrim biometrik për identifikimin e shtatëdhjetë zgjedhësve", sipas një tablele sjellë nga ana juaj. Këto raportime lidhen me 13 qendra të caktuara. Në tabelën excel që na është depozituar, janë evidentuar tre raste që bien në sy ku respektivisht kanë shenjë gishti unike për 14 raste të dyshuarish dhe 17 dhe 20. Pra konkretisht është QV nr. 4240 ku rezultojnë se në 20 raste është përdorur e njejta shenjë gishti. Një nga këto raste sipas tabelës që ju na kenidepozituar fillimisht është cilësuar si administratë zgjedhore. Kemi kërkuar sqarimin tuaj dhe paraprakisht nga materiali që na keni dorëzuar me shkrim kemi identifikimin për këtë rast. Shohim dhe për dy raste të tjera, ose të paktën për këtë rast që në një informacion të zgjeruar që keni dhënë citoni që "është operatori i cili e ka përdorur

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

19, apo 20 herë shenjën e gishtit”, të dyshuar sipas informacionit. Mund të na e shpjegoni në çfarë rrethanash mendoni se ka ndodhur?

**Znj. L. Pelinku:** Për ta bërë të qartë dhe për publikun. Rradha e veprimeve të një zgjedhësi: paraqitet para qendrës së votimit dhe para komisionit paraqet dokumentin e identifikimit. Dokument i cili duhet të lexohet nga paisja e identifikimit. Pasi është lexuar nga paisja e identifikimit dhe janë shfaqur të dhënat dhe komisioni ka pas mundësi të verifikojë përputhshmërinë e të dhënave që paraqiten në ekranin e pajisjes PEI të personit që ka përballë e të dokumentit të identifikimit, hapi i radhës do të ishte ai i nënshkrimit biometrik me anë të gishtit. Çfarë do të thotë që kemi shenjë unike gishti për dy, apo më shumë raste. Do të thotë që kemi leximin e dokumentit të identifikimit nga paisja dhe më pas për nënshkrim është përdorur shenja e gishtit nga ... një shenjë unike gishti të cilën ne, nuk mund në këtë fazë, ta identifikojmë se e cilit individ është për dy ose më shumë raste. Në tabelën e paraqitur., apo le të themi nga të dhënat që ne na kanë rezultuar nga kryqëzimi, një nga numrat e identifikimit që lidhet me shenjën unike të gishtit është edhe ai i operatorit pasi ne e kemi të dhënë se cili ka qenë personi që ka dhënë shërbimin si operator teknik i pajisjes PEI në atë qendër votimi. Në këto kushte na lind e drejta të dyshojmë se një nga shenjat unike, një nga skenarët mund të jetë ai ku shenja unike e përdorur për nënshkrimin e zgjedhësve nga dy apo më shumë zgjedhës ka qenë e operatorit. Por gjithësesi KQZ-ja në këtë fazë nuk mundet e nuk ka se si të verifikojë se cilit person i takon ajo shenjë gishti. Kjo duhet të jetë objekt i një hetimi në vazhdim për të verifikuar falë si materialeve të mbledhura nga videoregjistrimet, ashtu dhe më pas organet e prokurorisë të cilit do t'i përcillen këto materiale të mbledhura nga KQZ-ja. Në mënyrë që të verifikohen sa më saktë se cilit i takon ajo shenjë gishti.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. K. Bele:** Më falni, një pyetje thjesht për procedurë, sepse kjo është e shpjeguar në një manual por pak kush mund ta ketë lexuar. Në rastin kur sistemi nuk lexon gishtin e një shtetasi, pra vendoset gishti dhe nuk lexohet. Çfarë procedure do të duhet të bëjë operatori në vazhdim?

**Znj. L. Pelinku:** Programimi i pajisjes ka qenë i tillë ku operatorit i duhej që të merrte masat që secilit zgjedhës ti merrej shenja e gishtit që është e parashikuar, marrja e shenjave të katër gishtërinjëve duke tentuar shtatë herë për secilin gisht. Pasi të dështone me gishtin e parë shtatë herë do të kalonte tek gishtat vijues sipas një protokolli të mirëpërcaktuar. Nga informacionet, në fakt paraprake, që kemi marrë në kohë reale ditën e zgjedhjeve, nga vetë operatorët na është bërë me dije fakti që kanë pas vështirësi në marrjen e shenjave të gishtërinjëve, kryesisht tek personat në moshë të madhe. Ata vetë me justifikimin të paktën e dhënë verbalisht në rrugë telefonike për të përshpejtuar procesin, në shkelje të protokollit, kanë vijuar ata vetë me vendosjen e shenjës së gishtit. Por këtë e them që është një informacion i ardhur në rrugë telefonike gjatë ditës së zgjedhjeve. Edhe kjo duhet të jetë më pas objekt i verifikimit të thelluar.

**Z. K. Bele:** Unë mendoj se i muarëm përgjigjet e pyetjeve që ne kishim bërë..., për ne të dy. Në konceptin, në kuptueshmërinë tonë, kemi vetëm dy raste ku dy persona kanë..., potencialisht kanë hedhur 4 vota, ose janë paraqitur për të votuar dy herë, pra mund të supozojmë që dy shtetas kanë votuar katër herë. Rastet e tjera kam dyshimin e arësyeshem të përdorimit të gishtit nga operatori apo dikush tjetër por dyshimi i parë shkon tek operatori. Këto raste... nuk është një, edhe për rastin tjetër "administratë zgjedhore" thotë. Megjithatë këto janë ato çfarë na u shpjeguan, ju

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

faleminderit! Në qoftë se na del ndonjë diçka tjetër, ne rezervojmë të drejtën të pyesim përsëri, faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! Në materialin shpjegues që na keni sjellë sot, ju keni analizuar termin dyshim. Çfarë do të thotë “dyshim”? keni thënë që “në rastet kur gjurma e gishtit nga makina, dy gjurmë gishti përputhen me njëra-tjetrën, makina e nxjerr si përputhje, jo si dyshim”. Dyshimet janë, të themi ngjashmëri të mëdha të cilat kërkojnë verifikim të mëtejshëm? E kemi kuptuar saktë? Raste përputhjeje në Qarkun Gjirokastrë keni pas? Jo dyshimesh, përputhjes!

**Znj. L. Pelinku:** Të dhënat që rezultojnë nga sistemi, pra i tillë është programuar, duke vendosur pika përputhjeje ndërmjet gishtave, e dhënë teknike. Nga këto të dhëna rezulton që kanë një ngjashmëri të shenjave të gishtit me ato parametra që janë përcaktuar në sistem dhe dua ta them këtë që kanë qenë parametra të një filtri goxha të lartë për të evidentuar edhe ato raste të cilat dukshëm me syrin e njeriut, siç ka rezultuar dhe më pas nuk kanë qenë raste përputhjeje. Shprehemi për dyshim, sepse këtë duhet më pas ta verifikojë prokuroria. Duke pas parasysh se shenjat e gishtërinjëve të shtetasve shqiptarë i ka Kompania ALEAT do t'i duhet më pas prokurorisë të verifikojë në mënyrë objektive përputhshmërinë e shenjës së gishtërinjëve. KQZ-ja në këtë moment mund të shprehet vetëm për raste të dyshuara.

**Z. I. Rusmali:** Unë nuk kërkoja se si duhet të shprehet KQZ-ja. Unë kërkoja si shprehet makina. Në shpjegimin tuaj me shkrim, jo në shpjegimin tani, thoni që “makina kur ka përputhje nxjerr përputhjen”. Në shpjegimin që bëtë tani thoni që “ju e keni taruar makinën në mënyrë të tillë që të shprehë ngjashmëri jo përputhje”. Cili nga dy shpjegimet është i vërteti?

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

*Znj. L. Pelinku:* Ndjesë! Të shpreh përputhjen...

*Z. I. Rusmali:* Pyetja ime ishte për Qarkun Gjirokastrë, ka nxjerrë përputhje në ndonjë rast makina, apo ka nxjerrë vetëm dyshimin, ngjashmërinë me një fjalë?

*Znj. L. Pelinku:* Sipas sistemit, ajo çfarë rezulton që keni ju përpara në tabelën e nxjerrë nga sistemi, sipas sistemit janë përputhje.

*Z. I. Rusmali:* Në materialin shpjegues thuhet dyshime, janë përputhje, apo janë dyshime, vetëm kaq më thoni?

*Znj. L. Pelinku:* Nga pikëpamja ligjore ne nuk mund të themi..

*Z. I. Rusmali:* Jo, jo, nga pikëpamja e makinës! Materiali shpjegues thotë "makina ka dy opsione. Opsionin kur e saktëson gjënë jashtë çdo lloj dyshimi e nxjerr përputhje dhe kur vëren ngjashmëri e nxjerr dyshim". Tani...

*Znj. L. Pelinku:* Sipas sistemit janë përputhje!

*Z. I. Rusmali:* Të gjitha këto raste janë përputhje, materiali shpjegues nuk ka vlerë, nuk duhet marrë në konsideratë, apo jo?! në materialin shpjegues thuhet të gjitha janë dyshime, jo përputhje.

*Znj. L. Pelinku:* Materiali shpjegues..., nga pikëpamja ligjore, ne nuk mund të shprehemi...

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Nga pikëpamja e makinës?

**Znj. L. Pelinku:** Nga pikëpamja e makinës jua dhashë përgjigjen.

**Z. I. Rusmali:** Në materialin shpjegues thuhet “nga pikëpamja e makinës janë të gjitha dyshime”. Nuk ka nevojë të marrim në konsideratë materialin shpjegues, marrim në konsideratë dëshminë tuaj. Një lloj është për ne, por duhet ta dijmë me saktësi këtë punë.

**Znj. L. Pelinku:** Nga pikëpamja e makinës janë përputhje.

**Z. I. Rusmali:** Ju thatë, më duket në mënyrë të përsëritur që hetimi i deritanishëm që keni kryer ju nuk është përfundimtar. Do të ketë nevojë për veprime të mëtejshme nga ana e KQZ-së për të saktësuar përfundimisht gjithë dinamikën e këtyre ngjarjeve dhe çdo rast në mënyrë individuale dhe eventualisht do të ketë nevojë për hetim të mëtejshëm nga prokuroria. Nuk është përfundimtar, apo jo?

**Znj. L. Pelinku:** Edhe njëherë siç e shpjegova. Sistemi nuk lejon që ne të identifikojmë në mënyrë shterruese secilit..

**Z. I. Rusmali:** Më thuaj po, ose jo se kam pyetje vijuese

**Znj. L. Pelinku:**..secilit i takon ajo shenjë gishti. Për të bërë këtë gjë është e nevojshme hetimi i thelluar që do të thotë që do të duhet të shqyrtohen, të verifikohen materialet filmike të regjistruara. Nga ana tjetër prokuroria të cilës KQZ-ja ka

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

detryrimin t'i paraqesë këto materiale, pra ato që për ne përbëjnë raste të dyshuara, prokuroria do të duhet të bëjë më pas verifikimet e saj për të konkluduar.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, kjo do të thotë që nuk është përfundimtar ky material, apo është përfundimtar? Kjo është pyetja.

**Znj. L. Pelinku:** Për sa i takon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është përfundimtar.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Znj. L. Pelinku:** Për sa i takon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është përfundimtar.

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë që ju nuk keni për të bërë veprime të tjera më tutje.

**Znj. L. Pelinku:** Të cilës natyrë?

**Z. I. Rusmali:** Të cilës natyrë?! Të identifikoni personat psh, të shihni videokameran dhe të identifikoni qartësisht rastin cili është. Është rasti i supozuar ose i referuar me telefon, që operatori ka vënë gjurmën e gishtit apo është rasti që operatori ka votuar 15 herë? Do t'a bëni këtë hetim?

**Znj. L. Pelinku:** Ne me anë të videomonitorimit po prapë nuk mundemi të lidhim identitetin me personin që paraqitet në....

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë se nuk keni për të bërë veprime të mëtejshme.

**Znj. L. Pelinku:** Jo.

**Z. I. Rusmali:** Nuk keni për të bërë, përfundimtar. Mirë, nga ajo që shoh unë këtu, janë dy raste që ju i keni shënuar në të gjithë tabelën. Këtu bëhet fjalë për dy persona që kanë votuar me të njëjtin identitet të njohur, emër, mbiemër numri i kartës, numri personal. Kanë votuar në dy qendra të ndryshme votimi. Që të dy rastet bëjnë fjalë për individ që janë në njërin qendër votimi ku kanë votuar administratorët zgjedhor. Në tjetrën imagjinojmë zgjedhëz me emrin në listën e zgjedhësve. Dhe ju i njihni se keni numrin personal, keni identitetin e këtyre personave. E dini çfarë funksionesh kanë ushtruar këto në administratën zgjedhore ditën e zgjedhjeve?

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Znj. L. Pelinku:** Në kuptimin... informacioni që ne kemi është administratë zgjedhore, pra ajo çfarë ne...

**Z. I. Rusmali:** Pra, ka qënë Operator, ka qënë sekretar, ka qënë anëtar, ka qënë nënkryetar, ka qënë kryetar. Cila është detyra, funksioni që kanë...me çfarë detyre janë ngarkuar këta persona ditën e zgjedhjeve?

**Znj. L. Pelinku:** Atëhere ne na rezulton administratë zgjedhore sepse në momentin që personi me këtë numër identiteti është identifikuar në pajisjen PEI, është zgjedhur opsioni i identifikimit si administratë zgjedhore. Që do të thotë, mund të ketë qënë komisioner i qendrës së votimit, mund të ketë qënë edhe operator, por nuk kemi verifikimin nëse është komisioner.

**Z. I. Rusmali:** Domethënë nuk e keni çekuar identitetin me dokumentacioni e KZAZ-së për anëtarët e KQV-ve që kanë emëruar?

**Znj. L. Pelinku:** Ende jo.


**Z. I. Rusmali:** Dhe nuk keni ndërmend ta bëni këtë gjë?

**Znj. L. Pelinku:** Kjo mund të kryhet.

**Z. I. Rusmali:** Por a ishte përfundimtar hetimi? Apo do t'a riçelni përsëri dhe do t'a bëni për këta persona.

**Znj. L. Pelinku:** Kjo ishte çfarë ka rezultuar nga kryqëzimi i sistemit të të dhënave.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLIARI*



*Procesverballi i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali ku është qëllimi i këtyre pyetjeve? Kemi kryqëzimin e të dhënave.

**Z. I. Rusmali:** Shumë e thjeshtë, unë dua të kuptoj vlerën e provës, nuk kanë rëndësi ato të tjerat.

**Z. L. Braho:** Vlera e provës është e qartë.

**Z. I. Rusmali:** Nëqoftëse hetimi....

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Zoti relator ta marrim dhe ne fjalën për procedurë meqënëse jemi ne subjektet e interesuara...

**Z. I. Rusmali:** Të mbaroj njëherë pyetjet unë, pastaj...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Të karakterit domethënë...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, unë mora leje për të bërë pyetjen.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po dhe unë po marr leje për procedurë.

**Z. I. Rusmali:** Ti nuk po merr leje, ti po flet.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju nuk jeni relator i çështjes. Ju drejtova relatorit.

**Z. I. Rusmali:** Por nuk morët leje.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo, i thashë për procedurë.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali, tani ku është qëllimi i këtyre pyetjeve? Prova është kjo që kemi, u sqarua nga...

**Z. I. Rusmali:** Atëhere ne kërkuam thirrjen e dëshmitares.

**Z. L. Braho:** Në fakt ju nuk e kërkuat thirrjen e dëshmitares, e kërkuan dy anëtarët e tjerë të KAS-it. Ju ishit kundër.

**Z. I. Rusmali:** Atëhere, dy anëtarë të KAS-it kërkuan thirrjen e dëshmitares me qëllim që të çmonin provën. Ne jemi duke çmuar provën që na ka ardhur dhe nëqoftëse ne nuk arrijmë ta vlerësojmë, ta çmojmë provën, ne nuk jemi në gjendje të japim vendime. Dhe unë kam nevojë të di që prova që na është servitur është një dokument përfundimtar i KQZ-së apo është një material pune i KQZ-së i cili nuk nxjerr konkluzione përfundimtare. Sepse nëqoftëse ne bazojmë vendimin tonë mbi një material, i cili nesër do të grisët nga KQZ-ja dhe do të zëvendësohet nga një material tjetër, ne do të bëjmë një akt padrejtësie. Prandaj është thelbësore që ne t'a sqarojmë deri në fund këtë element. Elementin nëse materiali është përfundimtar apo jo, nëse KQZ-ja do të bëjë hetime të mëtejshme për të saktësuar të dhënat që janë këtu. Nëse të dhënat që janë këtu janë përfundimtare apo jo, sepse kemi dy dokumenta dhe habitem si nuk ju hën përshtypje. Njëri thotë që nuk është përfundimtar dhe dëshmia thotë që është përfundimtare. Si do ta çmojmë ne këtë? Kaq e parëndësishme është për ju?

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali janë të njëjtat dokumenta, thjesht njëri dokument, ai që u paraqit ditën e sotme është më i detajuar dhe i ndan me qendra votimi.

**Z. I. Rusmali:** Sqarimin e ditës së sotme që do të thotë, nuk është përfundimtar sepse janë dyshime që kërkojnë verifikim të mëtejshëm dhe...

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Këto janë dyshime ligjore që do i ketë prokuroria.

**Z. I. Rusmali:** Ke dëshminë e Nënkyetares së KQZ-së që thotë, materiali është përfundimtar. Si do ta çmojmë?

**Z. L. Braho:** Është përfundimtar për KQZ-në.

**Z. I. Rusmali:** Por dokumenti thotë nuk është përfundimtar.

**Znj. L. Pelinku:** Dokumenti, pra tabela...

**Z. I. Rusmali:** I nënshkruar nga Nënkyetarja.

**Znj. L. Pelinku:** Nuk mund të interpretoni juve... Atëhere të dhënat që juve ju janë paraqitur, janë të dhënat që përfundimisht rezultojnë...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem të mbaroj unë debatin me kolegët.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali ju po bëni pyetje për identifikimin e komisionerit. Komisioneri është identifikuar. Unë dje i bëra thirrje dhe KQZ-së që të vijojë me kallëzim penal për këta persona që janë të identifikuar me të njëjtën kartë identiteti, kanë votuar në dy qendra votimi dhe nuk ke vetëm komisionerët, ke dhe një tjetër që kanë votuar dhe në Gjirokastër dhe në Berat.

**Z. I. Rusmali:** Ju lutem shumë, do të çmojmë provat dhe do të flasim sipas bindjes.

**Z. L. Braho:** Prova është e çmuar, nuk ke çfarë i çmon më kësaj.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverballi i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. A. Kaziaj:** Zoti relator mund t'a marrim fjalën të lutem?

**Z. I. Rusmali:** A ka mundësi të mbaroj unë të lutem? Mos merrni zjarr kot se po krijohet përshtypja sikur çfarë po ndodh.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Jo, nuk po ndodh asgjë, e krijoni ju atë përshtypje. Interesi është i joni në zgjidhjen e çështjes.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, muk po ndodh asgjë. Po kërkojmë të saktësojmë vlerën e provës, sepse pretendimet tuaja kanë nevojë të mbështeten në një provë, e cila ka vlerë të saktësuar. Interesi madhor i juaji është dhe i joni që do i japim drejtim, por në rradhë të parë i juaji dhe ju e keni përballë sot dhe nuk mund të kalojë jashtë vëmendjes. Keni dokument dhe thënie dëshmitarësh kontradiktorë me njëri tjetrin. Cilën anë do të mbani?

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali mos e shfrytëzoni për fjalime, nuk ka asgjë kontradiktore. Provat janë të njëjtat, thjesht kjo e sotmja është më e detajuar. Sot mund të zbulosh që ka edhe votues të tjerë, jo vetëm komisionere që kanë votuar në dy qendra votimi të ndryshme.

**Z. I. Rusmali:** Jo nuk është e vërtetë...

**Z. L. Braho:** Në të njëjtën qendër votimi ke katër shenja që kanë votuar për një numër më të madh njerëzish dhe që asnjëri nuk është as komisioner as operator. Vini re këtë, pse po vini re që janë kontradiktor dokumentat? Nuk ka, nëqoftë se ju gjeni një statistikë të ndryshme nga i pari tek i dyti, hajde na e thoni.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Znj. L. Pelinku:** Ju lutem të sqaroj diçka? Ajo çfarë është përfundimtare, ka të bëjë me të dhënat që kanë rezultuar nga kryqëzimi i të dhënave në sistem. Nëse zotëria është paraqitur dhe është identifikuar në dy qendra votimi dhe e ka ushtruar apo jo të drejtën e tij dhe jo më kot fola për proces identifikimi që i paraprin ushtrimin e të drejtës së votimit që janë dy momente kronologjikisht të ndara. Pra, duhet të identifikohesh dhe më pas të ushtrosh të drejtën e votës. Unë përgjigjem për fazën e parë të procesit, atë të identifikimit. Nëse e ka ushtruar apo jo më pas, nëse është paraqitur apo jo i njëjti person në të dyja qendrat e votimit duke u identifikuar e më pas duke votuar, kjo do të jetë, e thashë edhe më parë objekt i një hetimi të mëpasshëm. Unë nga të dhënat që më jep tani sistemi, nuk mundem të them e ka ushtruar apo jo të drejtën e votës në të dyja qendrat e votimit. Ajo çfarë thashë është përfundimtare, janë të dhënat që ka gjeneruar procesi i kryqëzimit të të dhënave nga sistemi.

**Z. I. Rusmali:** Në dokumentin tuaj që u shpërnda sot, është thënë që bëhet fjalë vetëm për dyshime. Në dëshminë tuaj sot, është thënë që bëhet fjalë për të dhëna përfundimtare, për përputhje të plotë të gjurmës së gishtit. Janë dy informacione kontradiktore me njëri tjetrin.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali, por e sqaruam këtë tani. Rasti i dyshimtë është në aspektin ligjor, rasti që përputhet është në aspektin e sistemit. Por tani mos të përsërisim të njëjtat gjëra.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-ë:** Mund t'a marrim pak fjalën? Tani po citoj zotën Salianji, tani po bëjmë teatër.

**Z. I. Rusmali:** A ka mundësi të flas, se jam duke punuar për ju, nuk jam duke punuar për veten time.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-ë:** Shumë faleminderit, punën tonë e bëjmë vetë.

**Z. I. Rusmali:** Pëpiquni të bëheni seriozë.

**Z. L. Braho:** Tani këtë e sqaruam. Që të biem dakord këtu në tavolinë për pjesën e dyshimit, pra këto janë shenja gishtërinjsh që përputhen zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Zoti Braho, qenia relator dhe kryesues i kësaj seance të jep të drejtën të menaxhosh debatin duke i dhënë fjalën sipas rradhës gjithsecilit, por nuk të jep të drejtën që të kushtëzosh bindjen time. Bindja ime duhet të krijohet nga analiza e provave dhe që unë të krijoj bindjen nga analiza e provave duhet të kem siguri për provat që po merren. Kemi një dokument shkresor nga KQZ-ja dhe kemi një dëshmi të një funksionari të KQZ-së. Me shumë qëllim të mirë unë po arrij të përpiqem të kuptoj që zonja është duke folur në cilësinë e vet si kupola e sistemit të informatizimit. Ndërkohë që ne e kemi thirrur që të na flasë në emër të institucionit. Na flet si institucion sepse provën e ofron institucioni.

**Z. L. Braho:** Po dhe prova është shumë e qartë.

**Z. I. Rusmali:** Dokumenti është i institucionit dhe dëshmia bëhet në emër të institucionit. Kështu që ne kemi nevojë të dimë me siguri, do të ketë verifikime të mëtejshme mbi këtë dokument apo jo?

**Z. L. Braho:** U dha përgjigjja më parë.

**Z. I. Rusmali:** U thanë të dyja more zotëri. U dhanë dy përgjigje, dhe është përfundimtar dhe nuk është përfundimtar.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbalë i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** U tha që sipas sistemit janë të përputhura. Sipas ligjit e verifikon prokuroria. Kaq e thjeshtë është. Këto janë element penal tani për të gjithë këta persona.

**Znj. L. Pelinku:** Komisioni Qendror, e ka detyrim...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, KQZ-ja do të bëjë veprime të mëtejshme, po apo jo?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-ë:** O zoti Braho të lutem, mund ta marrim fjalën? Po ktheheni në organ inkuizitor, po bëhet hetimi tani i Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nënkomisioneria me shumë qëllim të mirë ka ardhur këtu përpara jush, e thirrur nga dy anëtarët e nderuar të KAS-it. Me shumë qëllim të mirë nuk ka asnjë varësi administrative kundrejt këtij komisioni, mos e trajtoni si vartësen tuaj. Nuk jeni organ hetimor juve. I nderuar nuk jeni organ hetimor që bëni pyetje. Ju jeni ai që keni bërë ligjin dhe e dini shumë mirë. Ju keni bërë ndryshimet e Kodit Zgjedhor dhe e dini shumë mirë pozicionin e Nënkomisioneres, kështu që mos ta kthejmë në një organ hetimor.


**Z. L. Braho:** Ka pyetje tjetër?

**Z. I. Rusmali:** Kam unë një pyetje.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali ju paskeni pasur më shumë pyetje se dy anëtarët që kërkuan zonjën Pelinku.

**Z. I. Rusmali:** Nëqoftëse më vihet në tavolinë prova që unë nuk e kërkova dhe nuk e desha, unë jam i detyruar t'a marr seriozisht sepse unë marr seriozisht procesin, kaq është e gjithë historia.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Të gjithë seriozisht e marrim procesin.

**Z. I. Rusmali:** Jo nuk jam i sigurtë.

**Z. L. Braho:** Këtu kemi pranuar dhe prova të tjera pa firma, pa nënshkrime. Kjo është një provë që është nënshkruar nga Nënkomisioneria dhe nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**Z. I. Rusmali:** Fakti që rezistohet për të analizuar një provë më bën të dyshoj. Fakti që prova kërkohet të analizohet vetëm në një drejtim...

**Z. L. Braho:** Zonja Pelinku ishte shumë më transparente se anëtarët e KAS-it në lidhje me procesin.

**Z. K. Bele:** Për procedurë më falni, në përgjithësi ne debatin e kemi mbajtur jashtë pyetjeve dhe do të lutesha në fakt...

**Z. L. Braho:** Zoti Bele jam shumë dakort me këtë që thoni ju, por po e kthejmë si prokurori me pyetjet që bëhen ndaj palëve. Është rast i përsëritur që pala në këtë rast është Nënkomisionerja Shtetërore e Zgjedhjeve që pyetet si në hetuesinë e dikurshme. I mungon vetëm një dritë që ta fiki dhe ta ndezi dhe të arrijmë të marrim përgjigjet që duam.

**Z. K. Bele:** Nuk është ky qëllimi.

**Z. I. Rusmali:** Po çfarë i keni këto fantazira, ç'janë këto gjëra?!

**Z. I. Rusmali:** Mirë dakord, i njëanshëm është ai që e do provën t'i shërbejë vetëm qëllimeve të veta. Unë dua që prova t'i shërbejë zbardhjes së vërtetës dhe

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

t'i shërbejë drejtësisë dhe është shumë interesante, psh dhe do e them, sepse do e bëj dhe si pyetje, por do jua them. Psh si ka mundësi që asnjërit në sallë nuk i intereson të dijë që këta dy persona që me gjasë kanë abuzuar me funksionin e tyre shtetëror , kujt force i përkasin? Pse nuk e beni asnjëri këtë pyetje? As PS-ja, as PD-ja, as LSI-ja.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-ë:** Nuk duhet ta dimë se cilës force i përkasin, ata e kanë vendin në burg nëqoftëse e kanë bërë këtë gjë.

**Z. I. Rusmali:** Dhe ju nuk doni t'a dini nëse administratorët tuaj janë për burg?! Pse nuk doni t'a dini?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-ë:** Nuk na intereson. Do i çojë Prokuroria në burg, nuk do i çojë KQZ-ja.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali kemi kërkuar që ditën e djeshme që të bëhet kallëzim penal për këto persona, pavarësisht bindjes politike që kanë.

**Z. I. Rusmali:** Pse nuk doni t'a dini?

**Z. L. Braho:** Nuk është e rëndësishme fare. Ju nuk doni të dini qindra prova që janë këtu, të bëni transparencë, doni të dini të kujt janë këta.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, t'ia bëj pyetjen?

**Z. E. Çefa:** Më falni, për procedurë unë po të kisha kohë do t'a kisha bërë pyetjen, po nuk po më vjen rradha për t'a bërë kështu që ju lutem mos na paragjykoni, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Keni mundësinë brenda harkut kohor të kësaj seance të nxirrni dokumentat e emërimit të këtyre personave dhe të na identifikoni çfarë funksioni kryejnë këta dy persona që janë njëri tek pika 5 e tabelës dhe tjetri tek pika 11 e tabelës?

**Znj. L. Pelinku:** Po, do të marrim të gjitha masat që të realizohet ky verifikim.

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Po ku e çon hetimin administrativ kjo gjë? E çon në një hetim penal. Ç'na duhet ne për hetimin administrativ me emrin dhe mbiemrin e një personi që sipas gjasave nga sa është relatuar këtu e ka vendin në burg. Ç'na duhet neve? Do e shohim në News 24 apo televizionet e tjera?

**Z. I. Rusmali:** Mund të jap një përgjigje për këtë? Atëhere ka një mundësi ndër shumë mundësi që mund të provojë faktin që këta dy komisionerë kanë provokuar me dashje sistemin për t'i shërbyer padive të mundshme nga subjektet ....

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali kjo është fantazi, jo ajo që thashë unë. Kjo është fantazia më e madhe që është thënë në këtë tavolinë këto dy javë.

**Z. I. Rusmali:** Me hipoteza kemi ecur.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Mos e fut këtë mundësi në Kod i nderuar. Pse se parashikuat si ekspert ligjor juve?

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali kjo është e tepërt. Të hedhësh hipoteza të tilla janë të tepërta meqenëse ju nuk po i shërbeni procesit.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Kjo mundësi ka rëndësi vendimtare për vlerësimin e provës në këto dy aspekte. Vendimtare, por ju duhet të keni interes për provën, duhet t'a doni provën, duhet t'a respektoni provën që të mund të shkoni tek ideja se pyetjet duhen bërë për të zbardhur, jo për të mbuluar të vërtetë.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali pavarësisht se të kujt force politike janë ata komisionerë, kjo nuk ka asnjë lidhje me hipotezën që hodhët ju. Unë ditën e djeshme i jam drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm që të procedojë ligjërisht me rastin e këtyre dy komisionerëve, që është vërtetuar që kanë votuar dy herë me të njëjtat karta identiteti në qendra të ndryshme. Ka dhe një rast të tretë që është një qytetar që ka votuar në dy qarqe të ndryshme, me shenjë gishti të njëjtë por me karta të ndryshme, siç ke dhe raste të tjera në tabelë. Kështu që është krejtësisht e panevojshme kjo që kërkon ju dhe nuk mund të sjellë asnjë pasojë për pretendimet që kanë palët. Nëqoftëse ju doni të rrëzoni kërkesën ankimore me fantazi të tilla jeni i hapur t'a shpallni vendimin që tani...

**Z. I. Rusmali:** T'ju bej një pyetje? A ka mundësi? Zoti Braho a mund t'ju bëj një pyetje pas kësaj që thatë. Vendimin për mua do t'a merrni ju apo do t'a marr vetë?

**Z. L. Braho:** Vendimin për ju do e merrni ju, patjetër që do e merrni ju.

**Z. I. Rusmali:** Sipas bindjes tuaj apo sipas bindjes sime?

**Z. L. Braho:** Do e merrni sipas ligjit shpresoj unë. Unë shpresoj që ta merrni sipas ligjit.

**Z. I. Rusmali:** Atëhere mos bëni komente të tilla se janë...

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Ju keni gjithë të drejtat që të kërkonti prova, por hedhja e hipotezave për të kërkuar provat, tregon që ka qëllime të tjera kërkimi i kësaj prove dhe nuk është aspak qëllimi vënia e drejtësisë. Në qoftë se keni qëllim për të bërë drejtësi, bëni vetëm thirrje që ata persona të procedohen penalisht. Fakti se a ka prapavijë politike apo prapaskena që këta persona kanë shkelur ligjin, kjo është e patolerueshme

**Z. I. Rusmali:** Shiko, nëqoftëse ju doni debatin, ne do të bëjmë debatin. Është i panevojshëm dhe është i padenjë për këtë institucion, por ka dy qëndrime që janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Nëqoftëse jemi përpara një shkelje individuale, vlera e saj në raport me kërkesën për pavlefshmëri është ajo e një shkeljeje individuale. Nëqoftëse jemi përpara një rasti ku provokimi bëhet me motive dhe shtyrje politike, vlera e shkeljes është shumë më e ndryshme nga ajo e një rasti individual dhe ne duhet të çmojmë vlerën e shkeljes në raport me kërkesën për pavlefshmëri.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali ne nuk jemi as prokurori as gjykatë që të vlerësojmë anën subjektive të këtyre komisionerëve. Nuk e vlerësojmë dot ne atë. Nuk e dimë ne se nga çfarë premisash është nisur ai komisioner për të votuar në dy qëndra votimi..

**Z. I. Rusmali:** Ne nuk mund të jemi në gjëndje t'a provojmë...

**Z. L. Braho:** këtë nuk e gjen dot asnjëherë. Këtë nuk e paraqet dot asnjëherë në këtë komision.

**Z. I. Rusmali:** Ne nuk mund t'a provojmë dhe ne duhet t'a themi që nuk jemi në gjëndje t'a provojme. Por ne nuk mund t'a fshehim nën rrogos.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverballi i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Që t'ju lejojë ju që të bëni rakordimet tuaja, ky është qëllimi?

**Z. I. Rusmali:** Të zbulojë të vërtetën në të gjitha aspektet e veta. Për mua nuk ka rëndësi...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Tani na lejoni të bëjmë pyetje përpara se të jepni konkluzionet. Nëqoftëse doni t'a jepni vendimin që tani, ne e kuptojmë zoti Rusmali sepse jeni sjellë gjatë gjithë këtij procesi si i njëanshëm. Na lini të bëjmë pyetjet ne.

**Z. I. Rusmali:** Ti nuk kupton asgjë nga ato që them unë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Dakord nuk kuptoj ne kemi pyetje për Komisionerin është shumë e qartë se çfarë keni ju për të thënë!

**Z. I. Rusmali:** Une mezi pres që ju të bëni pyetje është shumë të rëndësishme.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali ju lutem mbani etikën dhe mos u shprehni në këtë mënyrë pa etikë!

**Z. I. Rusmali:** Edhe unë nuk kam plan të bëj zhurmuesin, ju nuk më intimidoni dot, këtu të ushtroj detyrën time nuk më pengoni dot, as ju as zotëria atje.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali nuk ka askush qëllimin të intimidojë njeri në këtë proces. Ju kërkoni të hidhni hipoteza, jo mo unë nuk kam ndërmend të vazhdoj po të doni bëjmë dhë 5 minuta pushim që të qetësoheni ju dhe të qetësohet gjithkush tjetër. Zonja Nënkomisionere nuk u thërrit as për ti bërë gjyqin Nënkomisioneres as për të dënuar një nga ata komisionerët që e kanë ndarë mendjen për të shkel ligjin. Për këto është Prokuroria. Nqs ju doni të hidhni aludime filloni dhe ju bëni kështu merrni në telefon merrni dëshmi nga këta komisionerët mund t'i nxirni dhe në media dhe të tregojnë prapavijat politike që mund të kenë pasur qëllim ata. Por që këtë proces ta përdorim për të thërritur dëshmitar komisionerët, mua më duket e tepërt sepse nuk do të arrijmë dot në asnjë rast të zbulojmë anën subjektive se ata. Atëherë kërkojmë bindjet politike që ju të aludoni?

**Z. I. Rusmali:** Kush i ka propozuar Komisionerit?

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Ç'rëndësi ka kjo?

**Z. I. Rusmali:** Ka rëndësi kjo!? Unë nëpërmjet kësaj do të vlersoj provën!

**Z. L. Braho:** Nëpërmjet kësaj do të vlerësosh provën? Po pse?

**Z. I. Rusmali:** Ka rëndësi kjo!

**Z. L. Braho:** Po pse çfarë varësie ka Komisioneri? Komisioneri nga momenti i propozimit është përgjegjësi personale nuk është përgjegjësi e partisë politike.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Në fakt kjo ishte një provë e kërkuar nga ne jo prova se prova ka ardhur por sqarimi nga komisionerët prandaj desha fjalën se nga debati u sqaruan disa rrethana thjesht kisha dy pyetje konkrete për komisioneren. Shohim që 13 shenja gishta për 13 qendra, për qendrën që janë 14 gishtash ju keni sqaruar që është operatori tani po shikoj 9 raste që janë 2 shenja gishti. Sistemi në kontrollin që ju keni bërë, testimin që i bëhet paisjes nga operatori ose komisionerët mund të ndodhi që kjo shenja 2 herë e të njëjtit gisht mund të jetë pjesë edhe e testimit të aparaturës? Se këtë kam vënë re te Gjirokastra e vura re te Berati që janë një shenjë gishti 2 herë dhe nga pyetja që kemi bërë ne. Komisionerët e Qendrave të Votimit kanë thënë që është testuar në mëngjes sistemi nga operatori dhe mund të jenë që ka ndodhur për shkak të testimit edhe testimi është pjesë e kryqëzimit të dhënave? Testimi në mëngjes i aparaturës.

**Znj. E. Pelinku:** Protokolli parashikonte ndezjen e pajisjes dhe vijimin e identifikimit nuk ka parashikuar testim të pajisjes në ditën e zgjedhjeve.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Për sa i përket pra gjithë debati nga 1 që u hodh 70 persona dyshohet se kanë votuar gjithë debati tani kanë votuar 2 persona ose jo pra këtu është konkluzioni. Konkluzioni juaj ka të bëjë me këta dy persona kanë vendosur gishtin apo kanë votuar, pra e keni të provuar ju që këta dy personakanë votuar? Kanë hedhur fletën e votimit në kutinë e votimit.

**Znj. L. Pelinku:** Besoj në atë që thashë më sipër e saktësova.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Pra këta dy persona të cilët pra shkelja më e madhe që ka ndodhur në gjirokastër thatë se janë dy persona që kanë votuar dy herë, këta dy persona kanë hedhur fletën e votimit në qendrën në bazë të identifikimit keni ju dijeni?

**Znj. L. Pelinku:** Unë e saktësova dhe më parë ndoshta nuk arritët që ta kapni këtë moment por çfarë të dhënash i janë vënë në dispozicion KAS dhe juve janë të dhëna që flasin vetëm për procesin e identifikimit. Nëse më pas personi i cili marrim hipotezën është paraqitur me kartën e identitetit të dikujt tjetër në mënyrë tëlaigjshme, ka vendosur shenjën e gishtit të tij në mënyrë të paligjshme pra ka nënshkruar për dikë tjetër e ka ushtruar apo jo ai më pas pra e ka materializuar ai apo jo më pas të drejtën e votës kjo ngelet për tu verifikuar më pas. Çfarë keni ju përpara lidhet me identifikimin si hallkë e procesit si një nga hallkat e procesit të votimit që paraprin të drejtën e votës pra.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Po, kryqëzimi i të dhënave ka të bëjë dhe me rastin kur një zgjedhës paraqitet në qendrën e votimit vendos gishtin nuk e ka emrin në atë listë dhe paraqitet tek qendra tjetër e votimit në të cilën ka listën. Pra

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

sistemi paraqitesh dhe shkon në qendrën e votimit, ngatërron qendrën e votimit, vendos gishtin sistemi nuk të lejon të votosh apo jo? Pastaj paraqitesh në qendrën tjetër prap vendos gishtin dhe aty voton. Ky kryqëzim këtë rast e parashikon?

**Znj. L. Pelinku:** Atëherë sistemim nuk lejon leximin dy herë të të njëjtës kartë identiteti pra ta saktësoj ndërsa të gishtit ajo çfarë ka bërë paisja ka qënë magazinimi pra mbledhja e të dhënave të gishtërinjve për tu kryer më pas ajo çfarë është kryer për qarqe konkrete kryqëzimi i të dhënave opostore shenjave të gishtërinjve për të verifikuar pra pikërisht nëse një shenjë gisht është vendosur në dy apo më shumë pajisje në të njëjtën qendër votimi apo në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

**Z. E. Saliانji, përfaqësues i PS-së:** Dakord, pyetja e fundit sistemi e lejon votimin e dyfishtë? Në një qendër dhe në të gjitha qendrat s'ka problem sistemi PEI i cili u realizua në Gjirokastrë sipas informacionit që ju keni ju ka lejuar votimin e dyfishtë?

**Znj. L. Pelinku:** Edhe një herë e saktësova sistemi të ndalon që me të njëjtën kartë identiteti të paraqitesh dhe të identifikohesh pasi si në sinjale akustike.

**Z. E. Saliانji, përfaqësues i PS-së:** Ju lutem një përgjigje, po/jo prandaj pyetjet i kam patur shumë konkrete dhe shumë të qarta e lejon sistemi PEI i realizuar në Gjirokastrë votimin e dyfishtë po ose jo se na duhet për procesin kaq.

**Znj. L. Pelinku:** Lejon vendosjen e shenjës se gishtërinjve dy apo më shumë herë sepse e thashë nuk e ka të depozituar shenjat e gishtërinjve.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Të lutem pyetja është shumë e shkurtër dhe përgjigjja.

**Z. L. Braho:** E dha përgjigjen zoti Salianji.

**Znj. L. Pelinku:** Një sekondë sistemi lidhet me identifikimin dhe çfarë karakteristikash ka.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Edhe një herë sistemi PEI që është drejtuar organizuar nga ju po ua bëj më të qartë pyetjen e lejon votimin e dyfishtë po ose jo?

**Znj. L. Pelinku:** Po nëse komisionerët do i anashkalojnë ato çfarë ju rezultojnë nga ato pajisja, teknologjia nuk mund sado e perfeksionuar të jetë nuk mundet të kapërcejë gjenialitetin e njerëzve.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së:** Edhe një herë ju lutem se çfarë ndodh në qendrat e votimit e dimë ne e dinë partitë politike. Sistemi që ju keni organizuar dhe keni drejtuar e lejon votimin e dyfishtë në qendrën e votimit.

**Znj. L. Pelinku:** Përgjigja ime është sistemi lidhet me identifikimin

**Z. L. Braho:** Po zoti Logu!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Braho, faleminderit edhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për materialet e përgatitura dhe për prezencën e saj. Ne në fakt kemi tre pyetje të cilat mendojmë se i shërbejnë këtij procesi pa paragjykuar asnjërin prej pyetjeve apo përgjigjes të Nënkomisioneres. Së pari nga materiali që na është vënë sot në dispozicion pra nga kjo tabelë që është bashkëlidhur vërejmë se shenja e gishtit me nr rendor 62598281 rezulton se e njëjta shenjë gishti është përdorur për të identifikuar 2 zgjedhës që ndodhen përkatësisht njëri në qarkun Gjirokastrë në Bashkinë Gjirokastrës dhe tjetri në qarkun e Beratit Bashkia Kuçovë. Pra dy zgjedhës të ndryshëm me dy mjete identifikimi të ndryshme kanë përdorur të njëjtën shenjë gishti në qarqe të ndryshme dhe bashki të ndryshme. Pyetja këtu zonja Pelinku është nga kryqëzmi i dona PEI që është realizuar nga ana e komisionit qendror të zgjedhjeve është bërë për të gjitha qendrat e votimit brenda të njëjtit qark, është bërë për të gjitha qendrat e votimit në qarqe të ndryshme apo deri tani jemi vetëm në fazën kur është arritur të krahasohen qendrat e votimit Berat, Gjirokastrë ndoshta edhe Vlorë. Kjo për të ditur se mbase ka edhe raste të tjera kur e njëjta shenjë gishti është përdorur për të identifikuar zgjedhësit në qarqe të ndryshme.

**Znj. L. Pelinku:** Nese e kam kuptuar drejt pyetjen zoti Logu ka të bëjë me verifikimin nëse është kryer për këtë qark apo për?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po domethënë e njëjta shenjë gishti mund të jetë përdorur në qarkun Gjirokastrë dhe në qarkun Shkodër por nëse të themi akoma nuk është realizuar kryqëzimi i të dhënave PEI të Qarkut Shkodër po themi do na duhet pastaj që të presim dhe këtë të dhënë për të parë krahasimet e shenjave të gishtit në gjithë Shqipërinë.

*Zbardhi materialin audio  
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Znj. L. Pelinku:** Atëhere, procesi parashikon që cdo shenjë gishti do ti nënshtrohet verifikimit duke u përplasur po themi me të gjithë shenjat e gishtërinjve që janë depozituar nga pajisjet PEI.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Aktualisht që flasim kjo është bërë pra të gjitha shenjat e gishtërinjve janë krahasuar kudo në të gjitha Qarqet e Shqipërisë?

**Znj. L. Pelinku:** Po, kjo është verifikimi i bërë është bërë mbi të gjitha shenjat që janë depozituar pra nga dorëzimi i të dhënave që është bërë për cdo pajisje PEI është kryer përplasia sepse e tillë është nëse do të ishte shterruese nëse nuk do të thoshim është verifikuar vetëm brenda përbrenda qarkut kur ndërkohë sic rezulton dhe në rastin konkret që ngelet më pas për tu.

**Z. L. Braho:** Zonja Pelingu në fakt sic e kuptoj unë pyetjen është në nivel kombëtar pra kjo përputhshmëri këtu është në nivel kombëtar pra ka përfunduar procesi në të gjithë vendin pra nuk mund të dali në një moment që ky shtetas ka votuar dhe ne Korçë supozohet pra kjo është versioni përfundimtar.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Prosesi është kryer për në rang kombëtar po!

**Z. L. Barho:** Faleminderit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit, pra sic po themi e kuptoj ka një qytetar që ka shenja gishti unike i cili ka votuar edhe në Qarkun Gjirokastrë në Bashkinë Gjirokastrë edhe në Qarkun Berat, Bashkia Kuçovë. Rasti besoj pyetja kjo konkludon në pyetjen e parë. Pyetja e dytë zonja Nënkomisionere ju thatë që në

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

qoftë se pasi lexohet mjeti identifikimit të një zgjedhësi dhe shenja e gishtit nuk merret me të parën votuesi zgjedhësi se duhet ta provojë shtate herë shenjën e gishtit të madh të darës së djathtë kështu? Edhe pastaj në qoftë se dhe kjo nuk funksionon do të duhet që të provojë të gjithë gishtërinjtë. E marrim hipotetikisht që nuk funksionojnë të gjithë gishtërinjtë ka të drejtë në ndonjë moment operatori që ta kryejë këtë procedurë në vend të zgjedhësit apo në cdo rast është shkelje ligji edhe kur e kryen operatori?

**Znj. L. Pelinku:** Nëse do të dështonin të 28 tentativat të themi 4 herë 7 do të kalohej në identifikimin e zgjedhësit pa marjen e shenjës së gishtërinjve gjë e cila do të dokumentohej pra kjo e dhënë do ruhej në pajisje dhe gjithashtu do të rezultonte dhe në kuponin që do të printohej për atë zgjedhës pra do të evidentohej që kemi të bëjmë me rastin e identifikimit pa nënshkrim biometrik.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Qartë, pra për hir të procesit zgjedhor edhe fakti që këtë mund ta kenë bërë operatori i cili sigurisht duhet vërtetuar dhe duhet verifikuar sic me të drejtë e thatë për shkak të kërkesës tonë për pavlefshmëri kjo përbën shkelje të ligjit dhe përbën cënim të procesit zgjedhor. Pyetja nr 3 dhe e fundit e nderuar zonja nënkomisionere ka të bëjë me këtë fakt :një nga raste që është identifikuar nga ana juaj është një shenjë gishti me nr të lutem zoti Rusmali mund të mbajmë pak qetësi, faleminderit. Pra pyetja e tretë pra zoti Rusmali unë e di çfarë flas pyetje do ta vlerësoja zoti Laku që ta mbanit këtë qëndrim edhe në rastin e kolegut tuaj por c' rëndësi ka pyetja nr 3 e nderuar ju thoni në materialin që shpjeguat na është vënë në dispozicion se në rastin e shenjës së gishti me nr 2591383 dyshohet se e njëjta shenjë gishti është depozituar në qendrën e votimit 4240 gjatë leximit të 19 dokumenteve të identifikimit pyetja ime është kjo! A

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

ekziston mundësia e cila sigurisht duhet vërtetuar deri në fund po si mund të në këtë fazë që jemi që një person të paraqitet me 19 karta identiteti në çantën e tij dhe këto 19 karta identiteti ti lexojë në pajisjet PEI dhe për të 19-ta të ketë vendosur shenjën e tij të gishtit? Nuk po themi fazën e votimit ju e thatë me të drejtë jemi vetëm në fazën e identifikimit pra që i njëjti person të ketë përdorur shenjën e tij të identifikimit për 19 karta identiteti të ndryshme. Ekziston kjo mundësi?

*Znj. L. Pelinku:* Po.

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Faleminderit zonja Nënkomisionere faleminderit zoti kryesues.

*Z. L. Braho:* Faleminderit zoti Logu, zonja Pelinku kishit ndonjë pyetje për këto raste që ka dështuar nënshkrimi me gisht 28 herë keni një statistikë se sa herë ka ndodhur pra sa shënime ka në sistem të tilla?

*Z. E. Dushallari:* Po e kemi

*Z. L. Braho:* Mund të na e thoni?

*Z. E. Dushallari:* Duhet ta analizojmë dmth e kemi si statistika patjetër por që duhet ta analizojmë.

*Z. L. Braho:* Dakord, faleminderit

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Po shkakun e dini apo keni vetëm hipotezat? Shkakun e dini për këto raste sado që të jenë?

**Z. E. Dushollari:** Për rastet kur nuk lexon shenja e gishtit?

**Z. I. Rusmali:** Po pra keni identifikuar sa raste nuk janë lexuar shenjat e gishtit dhe keni dhe procedurën që në shumë raste operatori në shumë raste dikush tjetër ka firmosur ka vendosur gjurmën e gishtit sikur se kemi dhe hipotezën që një njeri mund të ketë votuar për 15-20 vetë në një qendër votimi, kemi këto hipoteza tani ju verifikoni gjurmët dhe keni statistikë do taconi më tej deri në fund që të identifikoni dhe rastin konkret dhe shkeljen konkrete dhe shkakun pse ka ndodhur?

**Znj. L. Pelinku:** Do të duhet për të parë rast pas rasti nëse është respektuar!

**Z. I. Rusmali:** Do ta shihni rast pas rasti kjo është pyetja?

**Znj. L. Pelinku:** Po po tani në këtë fazë.

**Z. I. Rusmali:** Do ta vazhdoni me këtë punë?

**Znj. L. Pelinku:** Po, po patjetër në kuadër të sic e thashë materialeve që do t'i përcillen prokurorisë për të qenë shterrues neve si Komision për të dhënat që kemi nga sistemi patjetër që do ta analizojmë.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Do të thotë në fund të këtij procesi ne nuk kemi nevojë më të ngremë hipoteza por ne do të dimë me siguri çfarë ka ndodhur me gjurmët e gishtave në Shqipëri në të gjithë procesin zgjedhor në çdo rast të identifikuar.

**Znj. L. Pelinku:** Falë të dhënave.

**Z. I. Rusmali:** Në fund të kësaj pune? Tani se dimë akoma.

**Znj. L. Pelinku:** Jo nuk e dimë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Z. L. Braho:** Kush është fundi çfarë supozoni të dali në fund, ca supozoni ju të dali më tepër nga Nënkomisionerja!

**Z. I. Rusmali:** Ato që tha Nënkomisionerja të lutem shumë respekto komisioneren se foli qartë foli korrekt ju përgjigj pyetjeve si duhen dhe nuk mund të indimidojmë nuk është prokurori kjo dhe nuk ke pse frikëson dëshmitarët. Nuk është vartësja jote është po të dti eprorja jote se ka një rrang më të lartë se ty kështu që të lutem mos i bëj presion një komisionere se nuk e meriton.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali po silleni si prokurori, zoti Rusmali unë nuk e di se ku doni të dilni por doni të vërtetoni hipotezat tuaja.

**Z. I. Rusmali:** Se ku dua të dal ta them në dhomë të këshillimit se atje kemi.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Po mund ta thoni dhe këtu publikisht!

**Z. I. Rusmali:** Jo jo ta them në dhomë të këshillimit ti thuaje në televizor. Unë këtu jam në seancë pyetjesh dhe unë pyes dëshmitaren sepse e keni sjellë këtu. Mu duk se nuk po intimidoj unë ndërhyra kaq kërkova.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali ju deri tani me votën tuaj keni qënë kundër zbulimit të çënimit të vullnetit. Ndërkohë doni të zbuloni vullnetin e komisionerëve. Psenë e gjen prokuroria nuk e gjejmë ne psenë. Pse një njeri ka votuar me 30 me 10 karta idedntiteti.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Ju lutem tani pezullojmë procesin, mblidhni veten të gjithë të nënkomisionit këtu po na çenojnë të drejtat, ne kemi ardhur për tju pyetur juve që të shprehni me vendim mbi çënimin e të drejtave të shprehni me vendim, ju po bëni ide teatri!

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj keni pyetje të tjera? A ka njeri pyetje të tjera?

**Z. I. Rusmali:** Ka mundësi të bëj një prapësim unë! Në këtë seancë nuk i kam ndërhyrë asnjë njeriu vetëm kam mbrojtur të drejtën time për të bërë pyetje dhe nuk mund të pranoj si të mirqenë kritikën që më drejtoheni mua. kritikën adresojeni atje ku duhet adresuar vetëm evidentoni faktin që në këtë seancë kam mbrojtur vetëm të drejtën time për të bërë pyetje vetëm dhe nuk i kam ndërhyrë asnjë njeriu sikurse keni bërë ju të gjithë ju vazhdimisht.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
të datës 19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Kjo është një akuzë shumë e rëndë që bëni zoti Rusmali, askush nuk i ka ndërhyrë askujt gjithsesi kjo është seancë publike dhe e vleron publiku se kush ka ndërhyrë ku dhe kush ka cënuar një të drejtë! Kështu që gjithësi faleminderit për kritikën që na bërë të gjithëve. Ka pyetje të tjera apo të bëjmë 5 minuta pushim?

**Z. K. Merxhani kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Po, një pyetje të fundit nëqoftëse ka mundësi!

**Z. L. Braho:** Po, patjetër.

**Z. K. Merxhani kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Nëse është e vërtetë kjo që sapo u tha, a ka qëllim kjo provë? Pra qëllimi i kësaj prove a është për të vërtetuar që procesi është i cënueshëm faleminderit.

**Z. L. Braho:** Zoti Merxhani se pyetja ishte e pa qartë cila provë dhe..

**Z. K. Merxhani kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Fakti që ne pyesim ndjesë është sepse këtu u thirr zonja për të dhënë sqarime.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. K. Bele:** Të paktën për mua atë që desha e dha. Ideja është kjo që ne pyesim për faktet pastaj për qëllimet futemi në sferën subjektive. Pa iu ndaluar ju që të bëni pyetjen që doni më mirëkuptoni.

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Ky ishte edhe qëllimi i pyetjes, sepse ky debat është i gjatë dhe i gjërë. Ideja është e tillë, kjo provë është marrë për të parë cënueshmërinë e procesit po apo jo? Nëse procesi që zonja tha është i cënueshëm, kjo vazhdimësia e qëllimeve, kërkimi është vetëm një pengesë e mëtejshme e këtij procesi. Këtë donim të thonim dhe prandaj pyetëm drejtëpërdrejtë zonjën në lidhje me a është e vërtetueshme që ky proces është i cënueshëm apo jo? Nëpërmjet kartave dhe gishtave kjo mospërputhja është e cënueshme apo jo, po ose jo? Kjo është pyetja.

**Z. L. Braho:** Patjetër që zonja Pelinku mund t'a jap përgjigjen, por e dha njëherë përgjigjen. Përgjigja e pyetjes që a mund të shkojë një person me 30 apo 40 karta të ndryshme identiteti dhe të votojë në emër të këtyre 30-40 emrave. E dha përgjigjen që është e mundur. Pra, objektivisht e mundur.

**Z. K. Bele:** Më fal për ndërhyrjen, po mu duk se nuk dha këtë përgjigje.

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Ndaj, nuk paska qenë shumë e qartë, prandaj dhe ne e ribëmë si pyetje.

**Z. K. Bele:** Se nuk duam që të bëhemi që secili të japi versionin e tij për atë çfarë tha zonja Pelinku, zonja Pelinku mua mu duk se foli qartë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Po pikërisht prandaj edhe ne kërkojmë që të na e japi këtë përgjigje të qartë nga zonja Pelinku.

**Znj. L. Pelinku:** Lidhur me procesin në tërësi apo me procesin e identifikimit. Pra, teknologjia.

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Teknologjia. Teknologjia domethënë është e lidhur me kartën.

**Znj. L. Pelinku:** Besoj se iu përgjigja kësaj pyetje.

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Siç edhe ju e dëgjuat nuk ishit shumë e qartë edhe midis anëtarëve. Prandaj do të doja të ishit më e qartë. Është e mundur që të votohet në mënyrë...

**Znj. L. Pelinku:** Unë thashë se cilat janë karakteristikat e sistemit dhe çfarë nuk lejon sistemi, teknologjia. Se çfarë pastaj vullneti njërezor që e tejkalon kapacitet e teknologjisë mund të ndodh për këtë nuk mund të përgjigjem unë.

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Jo, ideja është që me kartë të ndryshme një qytetar që nuk i përket ajo kartë mund të votojë apo jo? Nuk po them që dështojë apo jo procesi nuk është kjo?

**Znj. L. Pelinku:** Po! Kësaj pyetje iu përgjigja, po!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Kjo është që po themi që të jetë i qartë që është po, që është i cënueshëm.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zonja Pelinku! Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera për zonjën Pelinku? Nuk ka . Mund të largoheni.

**Z. I. Rusmaili:** Unë përsëris kërkesën që i bëra pak më parë, ju lutem merrni masa që të më vij informacioni sa më shpejtë.

**Z. L. Braho:** Është kërkesë që duhet të mbështet nga dy anëtarë në fakt se është në administrim të KQZ-së. Kështu që nuk e di, në qoftë se e mbështet ndonjë anëtar tjetër, kërkesën e zotit Rusmali. Kërkon dokumentacionin në lidhje me...

**Z. I. Rusmaili:** Le t'a bëjmë këtë eksperiment. Kush e mbështet kërkesën time që të identifikojmë çfarë funksioni kanë kryer dy personat që dyshohen se kanë votuar dy herë, në Qarkun e Gjirokastrës, çfarë funksioni kanë pasur brenda administratës zgjedhore të këtij qarku.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali nuk jemi këtu për të bërë eksperiment jemi për të dhënë drejtësi.

**Z. I. Rusmaili:** Ka njeri që e mbështet këtë kërkesë?

**Z. K. Merxhani kandidat i pavarur:** A ka mundësi një pyetje. Është shumë interesante sepse këtë e kam kërkuar unë zoti Rusmali, dhe e keni refuzuar në mënyrë unanime.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. I. Rusmaili:** Ke kërkuar gjë tjetër ti.

**Z. K. Merxhani kandidat i pavarur:** Kam kërkuar edhe këtë edhe hetim në qoftë se ka konflikt interesi për emërimet. Unanime, unanime.

**Z. L. Braho:** Këtu nuk është rrëzuar asnjë gjë në mënyrë unanime. Kështu që...

**Z. K. Merxhani kandidat i pavarur:** Atëherë, unanimitet brenda një personi.

**Z. L. Braho:** Në qoftë se ju e gjeni tek një njeri unanimitetin kjo është çështje tjetër. Po zoti Bele!

**Z. K. Bele:** Një saktësim, neni 21 pika 2 thotë: secili anëtarë i KAS ka të drejtë që gjatë hetimit administrativ të marrë kryesisht pa debat dhe as votim provat që janë në administrim të KQZ-së. Le t'a vlerësoj KQZ nëse prova është e mundur të disponohet, e dhënëshme të disponohet, ka të drejtë ligjore t'a japi apo mos t'a japi pa e paragjykuar, nuk mendoj se ka nevojë për dy apo më shumë anëtarë.

**Z. K. Merxhani kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** U mbështet edhe nga anëtari i dytë.

**Z. I. Rusmaili:** Me leje, unë dua t'a bëj ushtrimin edhe pak më të vështirë. Në qoftë se nuk e mbështet njeri kërkesën time, unë nuk e bëj kërkesën. Dua që t'a mbështesin nëse kanë interes tek çështja, në qoftë se asnjë nga palët atje dhe asnjë nga anëtarët

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

këtu, nuk do ta dijë, çfarë funksioni kanë pasur ata dy persona, unë tërhiqem nga kërkesa ime.

**Z. L. Braho:** Pozicioni është i qartë administratë zgjedhore. Kaq.

**Z. I. Rusmali:** Jo, funksioni, funksioni..

**Z. L. Braho:** Po pra ky është funksioni. Po zoti Çefa!

**Z. E. Çefa:** Ju faleminderit! Nëse do të më lejoni shkurtimisht se e kuptojë që të gjithë jemi të lodhur, por hipotetikisht në qoftë se na rezulton nga kërkesa e zotit Rusmali, se është pikërisht personi që ka administruar pajisjen, që ka vënë gjurmën e tij të gishtit sikundër mund të jetë një nga probabilitetet. Unë nuk e di që të ketë që këto persona të jenë propozuar nga partitë politike. Unë e di që këto persona janë rekrutuar nga administrata e KQZ-së si teknikien dhe kanë pasur një detyrë specifike jashtë procesit politik apo jo?

**Z. I. Rusmali:** Po, çfarë të keqe ka t'a marrim vesh këtë gjë? Pse? Le të jetë operatori nuk ka asnjë problem. Kush është personi që ka dhunuar zgjedhjet në dy Qendra Votimi duke votuar dy herë.....

**Z. E. Çefa:** Unë besoj se nuk është aspak relevante.....

**Z. I. Rusmali:** Administrator zgjedhor.... jo është relevante. Është relevante sepse ka gjithmonë skenarët alternativ. Në qoftë se është operatori do t'a çmojmë provën në varësi të faktit që këtë punë e ka bërë operatori. Në qoftë se është sekretari do t'a



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

çmojmë në varësi të faktit që këtë punë e ka bërë sekretari. Në qoftëse është anëtari, nënkryetari apo kryetari do t'a çmojmë në varësi të këtij fakti.

**Z. L. Braho:** Çlidhje ka kryerja e një vepre penale me funksionet ka qenë sekretar, ka qenë anëtarë.

**Z. I. Rusmali:** Ka lidhje me çmimin e provës.

**Z. L. Braho:** Po pse? Ku është...

**Z. I. Rusmali:** Çështja është shumë e thjeshtë...

**Z. L. Braho:** Çfarë e bën të ndryshme shkeljen e ligjit?

**Z. I. Rusmali:** Çështja është shumë e thjeshtë, unë iu sfidova ju. Unë iu thashë në qoftë se bashkoheni me mua tek kërkesa... unë e bëj kërkesën.

**Z. L. Braho:** Na sqaroni ne çfarë e bën të ndryshme shkeljen e ligjit?

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se e refuzoni nuk doni t'a dini, unë tërhiqem nga kërkesa.

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali... nëse dikush e ka shkelur ligjin çfarë rëndësie ka është i bardhë apo i zi.

**Z. I. Rusmali:** Në qoftë se ju doni t'a dini këtë punë bashkohuni me mua. Në qoftë se ju refuzoni t'a mësoni bashkohem unë me ju, është shumë e thjeshtë.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali, unë jam i gatshëm t'iu mbështes në qoftë se me jepni një arsye ....

**Z. I. Rusmali:** U bëmë dy veta, unë dhe zoti Ledio, na sillni provën...

**Z. L. Braho:** ....T'a mbarojë fjalinë. Jam i gatshëm t'iu mbështes në qoftë se ju më shpjegoni qëllimin se përse iu intereson se çfarë roli ka pasur ky person në administratë zgjedhore. Po të jetë qëllim i shëndosh jo për të hedhur hipoteza.

**Z. I. Rusmali:** Edhe komponentin e "portokallisë" tek kjo seancë sapo e mbyllëm. Na ka ngelur "rubrika e sportit", në qoftë se ka ndonjë top hajde luajmë një 5 minutësh dhe....

**Z. L. Braho:** Zoti Rusmali, në këtë seancë kemi parë mendime pakice që dalin më përpara në gazetë se sa këtu. Kështu që nuk është nevoja të hidhni hipoteza me "portokalli" apo me gjëra të kësaj natyre. Kështu që përmbahuni, tregohuni profesional deri në fund dhe lërin këto etiketime. Unë po iu them më tregoni një arsye të shëndosh sepse një nga anëtarët e tjerë të KAS-it duhet t'iu mbështësi për këtë kërkesë? Në qoftë se ju doni ti bëni një gjyq publik një personi, nuk është vendi këtu për të bërë gjyqe publike. Por unë arsye të shëndosh që të shoh një anëtar ka qenë i bardhë apo i zi nuk më duket fare, mjafton që ka shkelur ligjin. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të vazhdojë procedurat për të bërë kallëzim penal për këto persona. Mund t'a merrni vesh në prokurori pastaj se kush ka qenë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. K. Merxhani kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Nëse mund të shtojë, ndaj të njëjtin mendim, interesi është a ka shkelur apo jo ligjin. Se çfarë është, se kush është, se kush e ka emëruar nuk ka asnjë rëndësi për ne. Veçanërisht për ne dhe po e them këtë në kushtet e një kandidati të pavarur. Ku jemi krejtësisht të diskriminuar brenda këtij sistemi që është ndërtuar zgjedhor. Kështu që ne e kemi parë që ditën e parë në sy, kush shkel ligjin, për mua çënon të ardhmen e fëmijëve të mij.

**Z. I. Rusmali:** Po mirë nuk doni të dini pse mund t'a ketë shkelur ligjin?

**Z. L. Braho:** Po nuk e zbulojmë dot pse-në pra.

**Z. K. Merxhani kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Atëherë, le të bëhen analiza psikoanalitike, të vazhdojnë studimet, të bëhen raporte, por në qoftë se kanë shkelur ligjin është prokuroria që vendos dhe është detyra juaj t'a çoni aty. Se nuk është bërë ky debat për pamjet filmike që kemi vendosur në dispozicion tuaj, nuk është bërë ky debat. Nuk është zgjatur kaq shumë për një elefant në mes të sallës aty. I cili në një dakordësi të plotë fillon e ndërhyjnë dhe dëgjojmë këtu kërkesa për gjoja rinumërim, kur aty ndërhyhet. Atë nuk e ka regjistruar pajisja zotëri se sa herë ai voton për ne. Nuk e ka regjistruar pajisja, nuk di gjë fare pajisja elektronike se sa herë ai zotëri merr dëngun edhe fillon edhe punon, për të ardhmen tonë. Kështu që për ne një shkelës i ligjit është shkelës i ligjit pikë muhabeti. Nuk ka këtu interpretime, a dua t'a di unë sa fëmijë ka ai, a ka doktoraturë apo jo, çfarë interesi ka. Në finale ka çënuar procesin zgjedhor. E ka bërë një hallkë të dobët, të këputshme. Për ne është këputur, është mbyllur çështja. Pastaj të tjerat janë teorizime. Faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Merxhani! Po zoti Salianji!

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Këtu po trashëtohet një gjë që u morë një përgjigje nga zonja Nënkomisionere që nuk është vërtetuar që këta dy persona kanë votuar. Pra, po bëjmë gjyq publik kot, po kërkojmë një gjë të cilën e vetmja e dhënë që kemi është paraqitur i njëjti person në dy Qendra Votimi, ka hedhur fletën e votimit po ose jo? U dha një përgjigje që kjo nuk ka ndodhur. Pra, shkelja e ligjit ....

**Znj. S. Hasani përfaqësuese ligjore e Kreshnik Merxhanit:** Jo, që nuk ka ndodhur, që nuk mund të dëshmojë në lidhje me këtë...

**Z. L. Braho:** Po vazhdoni zoti Salianji!

**Z. E. Salianji përfaqësues i PS-së:** Se po flasim prokurori, shkelje ligji, unë në të gjithë debatin edhe sqarimet që u bënë nga Nënkomisioneria, mësova vetëm një fakt. Që sistemi ka funksionuar, ka identifikuar persona të cilët janë paraqitur në një QV dy herë dhe nga ky hetim administrativ nuk del që persona të cilët janë identifikuar nga pajisja kanë votuar ose jo. Dhe këta dy persona që po hidhet gjithë kjo tymnaj është e pa vërtetuar që e kanë hedhur fletën e votimit po ose ose jo. Nuk mundet shkelja e ligjit të diskutohet është pajisur, ka vënë shenjën e gishtit në dy QV dhe thuhet ka ndodhur shkelje e ligjit. Çfarë problemi ka? Ka vajtur në QV ka ngatërruar QV, ka vajtur tek qendra tjetër mund të ketë votuar. Përderisa është e pa provuar që ka hedhur dy fletë votimi, këtu ngelet dyshim dhe vendimmarrja nuk bazohet asnjëherë në dyshime, ju keni prova dhe fakte. Doli nga seanca fare qartë që çdo gjë ngeli në kuadrin e dyshimeve dhe përderisa nuk vërtetohet që ky person ka votuar një herë ose dy herë. Atëherë, unë nuk shikoj që t'a bëjmë kaq të madhe, t'a marrim

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

emrin e atij, t'a shikojmë kush është, në qoftë se kanë votuar, atëherë është kryer vepra penale.

**Z. L. Braho:** Po zoti Logu!

**Z. M. Logu përfaqësues i PD-së:** Në emër të subjektit politik që përfaqësoj edhe të koalicionit. Ne do ishim dakord me kërkesën e zotit Rusmali, në qoftë se ai nuk do të kishte refuzuar 57 herë, kërkesat e Partisë Demokratike për të bërë transparencë. Një person që refuzon 57 herë kërkesat e një subjekti politik për transparencë, besoj se e ka të qartë përgjigjen tonë, e para. E dyta, meqenëse po themi që këtu po bëhen konkluzione, besoj se nga ana e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve u shpjegua që nuk është se do mund të gabosh qendrën e votimit domethënë këtë konkluzionin që gabon QV dhe shkon në qendër tjetër votimi. Se në qoftë se gabon Qendrën e Votimit, mjetei jot i identifikimit nuk lexohet nga pajisja. Pra, nuk ekziston mundësia që të gabohet Qendra e Votimit se nuk të lexohet po themi mjetei i identifikimit. Ekziston mundësia që një Qendër Votimi të të lexohet pajisja e identifikimit dhe në një qendër tjetër të shkosh ose duke qenë se je anëtarë i administratës zgjedhore si komisioner apo si operator. Ose vetëm në ato raste kur ke një vendim gjyqësor i cili të autorizon të votosh në një QV. Për ne si Parti Demokratike që kemi kërkuar marrjen e provave, kryqëzimin e të dhënave të pasisjeve PEI . Ajo që ka rëndësi dhe që u tha dhe u pranua në këtë proces, është që një person mund të marrë me vete, 20, 30, 40 karta identiteti, të ketë shkuar në një QV, ti ketë identifikuar apo të jenë lexuar nga pajisja e identifikimit dhe më pas të ketë vendosur të njëjtën shënje gishti. Ky është konkluzioni që na doli ne nga prova, kjo është prova që vërteton çënimin e procesit zgjedhor që kërkojmë ne si subjekt ankuese. Se kush janë ata, se çfarë bëjnë ata në jetën e tyre të përditshme ky mund

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

të jetë interesi i ndonjë media shumë të kujdesshme ndaj këtij procesi, po sigurisht që nuk pse të jetë kujdesi po them i jonë . Çka për ne vlen konkluzioni që në ato raste kur ka pasur votim të shumfishhtë, votim familjar, apo votim për të tretë, përbën një shkelje të rëndë të Kodit Zgjedhor dhe kjo të nderuar anëtar të komisionit duhet t'iu çoj ju drejt vendimmarrjes së pavlefshmërisë së zgjedhjeve në këtë qark.


**Z. L. Braho:** Zoti Logu faleminderit! Këto mund t'i parashtroni në konkluzionet përfundimtare. Po zoti Kaziaj! Zoti Rusmali, ironitë bëj kur të jesh ti relator, sot që jam unë relator mos bëj ironi. Po mirë do e lë.

**Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:** Zoti Rusmali mora fjalën ju lutem!

**Z. I. Rusmali:** Ju kërkoj ndjesë, bëra shkelje, nuk e bën procesin të pavlefshëm por bëra shkelje.

**Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:** Po paragjykoni procesin, se do kërkojmë përjashtimin tuaj se po shpreheni mbi çështjen. Kini kujdes se do e vëmë në ngërç institucionin. Do kërkojmë përjashtimin tuaj se po shpreheni mbi çështjen, po paragjykoni çështjen, ju lutem! Lidhur me prezencën e sotme të Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve. E cila na ka qartësuar pak lidhur me materialin që na ka vënë në dispozicion, e falenderojmë publikisht, dhe i terheqim vëmëndjen këtu opinionit publik që qendrimi i mbajtu nga kolegu im Salianji nuk mund të devijojë për nevojat të subjektit politik që ai përfaqëson atë çfarë është shkruar..

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj, tani edhe ju po bëni konkluzionet, pa iu dhënë fjala për konkluzionet. T'a lëmë zonjën Pelinku të largohet, në qoftë se nuk ke pyetje tjetër dhe pastaj vazhdojmë me konkluzionet dhe mund të shprehesh.

**Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:** Edhe një minutë të vetme. Zonja Pelinku mund të largohet gjithësesi, nuk është e thirur këtu nga unë.

**Z. L. Braho:** Pra, ia jepni lejen ju.

**Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:** Nuk është e thirur nga unë. Lejen ia jepni ju zoti Braho ose anëtarët e tjerë që e kanë thirur. Po shohim qartësisht se dy raste është i njëjti person. Në rastin e 12 shënjave unike daktiloskopike të gishtave janë identifikuar 70 zgjedhës dhe nuk është ajo që tha zoti Salianji. Janë 12 raste që kanë votuar për 70 raste. Kjo është e zeza mbi të bardhë.

**Z. L. Braho:** Edhe kjo i përket konkluzioneve zoti Kaziaj, kështu që mund ta vijoni më tej. Zonja Pelinku faleminderit! Jeni e lirë të largoheni. Jeni gati për pretendimet përfundimtare ditën e sotme?

**Z. A. Kaziaj përfaqësues i LSI-së:** Bëjmë pak pushim, edhe ditën e sotme jemi gati, pavarësisht se materiali na u vu në dispozicion pak më parë.

**Z. L. Braho:** Rikthemni në orën 11:00 për të vijuar me konkluzionet përfundimtare. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

**Rifillon Mbledhja**

**Ora 11:16**

**Z. L. Braho:** Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr.33, 41 dhe 52. Të pranishëm janë sërish trupa e KAS, Administrata e KQZ-së, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim, përfaqësuesi i Partisë Demokratike, vetë kandidati Kreshnik Merxhani. Ndërkohë që nuk është i pranishëm subjekti i interesuar përfaqësuesi i Partisë Socialiste. Zoti Merkaj ju lutem njoftoheni megjithëse zoti Salianji ishte në dijeni të orës që do të fillonim po për korrektesë për parimin e kontradiktoritetit të jetë i pranishëm. Atëherë pyetje për palët jeni dakord që ta mbyllim hetimin administrativ dhe të vijojmë me pretendimet përfundimtare të secilëve nga palët? Zoti Logu?

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Dakord i nderuar.

**Z. L. Braho:** Zoti Merxhani jeni dakord ta mbyllim hetimin administrativ dhe të vijojmë me pretendimet përfundimtare?

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Për procedurë doja të bëja një sqarim në lidhje me dy kërkesat tona, sepse njëra ka të bëjë edhe me hetim. Kërkesa e parë ka qenë që në përputhje me nenin 136, pika 3, kam kërkuar marrjen në shqyrtim dhe hetim të materialit filmik nga ana e KQZ-së dhe evidentimin e mëtejshëm të parregullsive apo shkeljeve ligjore. Një pjesë të të cilave ne ua kemi vënë ju në dispozicion pamjet filmike qoftë nga kamerat që filmojnë direkt kalimin e votës, por qoftë dhe kamerat 360 gradë të cilat jo gjithmonë kanë rezultuar pamje

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

shumë të mira. Megjithatë aty ka vend për hetim dhe për të evidentuar parregullsi. Pyetja e dytë ka qenë në lidhje me raportin, vendimin për mënyrën sesi janë miratuar po themi numëruesit dhe komisionerët nëpër KZAZ, si dhe një raport në qoftë se ka konflikt interesi në këto emërime janë të dyja materiale që janë në dispozicion të KQZ-së nuk është një institucion i tretë kishte pamundësi. Kështu për procedurë kërkojmë të viheni në dijeni për mospranimin e kërkesave tona dhe si ka qenë votimi zyrtar, sepse nga media jam i informuar jo në mënyrë zyrtare që refuzimi ka qenë unanim e nuk dua të krijoj këtu asnjë lloj keqkuptimi qoftë edhe me ju anëtarë të nderuar, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Në fakt zoti Merxhani ajo çfarë unë thashë është për prova të reja, provat që ju keni sjellë janë administruar me vendim të KAS-it, ka qenë vendim në unanimitet për administrimin e provave jo vetëm tuajin por dhe të palëve tjera ankimuese. Pyetja ime është a kishit prova të tjera apo ta mbyllim hetimin administrativ?

**Z. K. Merxhani, kandidat i propozuar nga zgjedhësit:** Jo prova të reja ne nuk kemi, ne kërkuam përmbushjen në provat që ekzistojnë tashmë ose në materialin filmik aty dalin prova të reja sigurisht. Në gjykimin tonë ne kemi arritur të vëzhgojmë një të 30-tën e atij materiali dhe kemi evidentuar të paktën 3 shkelje penale. Megjithatë prova të reja ne nuk kemi, sepse nuk kemi më afat kohor për t'iu sjellë juve këtu, kështu që e konsideroj të mbyllur nga ana jonë, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Mund të vazhdoni atëherë me pretendimet përfundimtare sipas rradhës duke filluar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, më tej Partia Demokratike,

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

tek kandidati Kreshnik Merxhani dhe te subjekti i interesuar Partia Socialiste në qoftë se do të jetë i pranishëm zoti Salianji të vijë, falemidnerit.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së:** Faleminderit zoti relator i çështjes. Edhe sot në seancë dëgjimore të themi të asaj çfarë ishte fjala e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve dolën elemente të mjaftueshëm të cilët ndihmojnë procesin administrativ të inicuar për pavlefshmëri nga ana jonë dhe nga ana e subjektit politik Partia Demokratike për pavlefshmëri të zgjedhjeve në këtë qark, i mëshojmë faktit që do të ketë një vendimmarrje objektive nga ana e këtij komisioni të nderuar. Po ashtu dolën elemente të mjaftueshme të provave që ne kemi kërkuar dhe që u morën nga ana juaj për sa i përket pjesës së përfshirjes së personave nominal nga ana e subjektit politik Partia Socialiste në ZAZ-në 82, që korrespondon me Bashkinë Dropull Qarkut Gjirokastrë, të cilët rezultojnë të ishin në moment ndalimi të vetkarantinimit të tyre nëpërmjet një urdhëri të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i dalë pak ditë përpara procesit zgjedhor të datës 25 prill 2021. Po ashtu dhe nga tabela e vënë në dispozicion për përplasjen e të dhënave daktiloskopike të pjesës së Qarkut Gjirokastrë të procesuara nëpërmjet pajisjes PEI, dalin elemente të mjaftueshëm dyshues. Mbase janë të karakterit penal në këtë rast por normalisht do të administrohen dhe nga ana juaj dhe do të jenë pjesë besoj të vendimmarrjes suaj finale mbi këtë qark. Për sa më sipër i nderuar zoti relator, të nderuar anëtarë pas nenit 141, pika 2 të Kodit Zgjedhor relatojmë ato që janë pretendimet përfundimtare të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, lidhur me qarkun e parë që po shqyrtohet për pavlefshmëri për zgjedhjet e 25 prillit. Ju pak a shumë jeni njohur me materialin tonë me kërkesën ankimore momentet e para dhe mirëmbajtjen e saj lidhur me dokumentacionin e vënë në dispozicion në cilësinë e provës materiale dhe të

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

kontestimeve që ne i bëjmë vendimmarrjes shtetërore të qëllimshme, e cila ka sjellë një pengesë të caktuar e cila ka ndikuar negativisht për subjektin që përfaqësoj. Ka të bëjë dhe jo vetëm me Bashkinë Dropull ku subjekti që përfaqësohej ka qenë forcë e parë politike gjatë gjithë zgjedhjeve qofshin këto vendore apo për Kuvendin. Ky urdhër i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që mban numrin 219, datë 19.04.2021, ka mohuar qartësisht një të drejtë kushtetuese të zgjedhësve të kësaj zone dhe për pasojë ka ardhur të themi rezultatin negativ kundër subjektit tonë duke mos i garantuar subjektit tonë marrjen të paktën një mandati në këtë zonë zgjedhore. Ky urdhër është qartësisht kualifikuar të themi i karakterit kushtetues dhe nga vetë vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, e cila në mospranimin e kërkesës së bërë nga ana jonë për marrjen e masës së sigurimit të padisë lidhur me pezullimin efekteve të këtij urdhëri në pjesën arsyetuese të tij argumenton që ka karakter kushtetues dhe ne shumë shpejt do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese për këtë urdhër. Për më tej siç ju thashë janë fakte këto të mjaftueshme të cilat të ndihmuara nga pjesa e vënies në dispozicion të materialit nga ana e KQZ-së, që lidhet me pretendimet e LSI-së po ashtu nga vënia në dispozicion e materialit nga ana e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve që lidhet me dyshimet e arsyeshme të ndodhura në pajisjen PEID të qëllimshme të paktën nga ana jonë deri sa të konkludohet një hetim i plotë gjithëpërfshirës i karakterit administrativ dhe penal të qytetarëve apo personave të ngarkuar me detyra zgjedhore në datën e zgjedhjeve, të cilët kanë tentuar dhe ia kanë arritur qëllimit në rast se për të kryer manovra jo ligjore të dhunueshme penalisht me ngarkesa krejtësisht personale, se asnjë subjekt besoj dhe unë e kolegët e mi nuk mund të mbrojnë një paligjshmëri qoftë kjo e bërë nga ana e personave të vet të emëruar nga subjektet për menaxhimin e çdo hallke të procesit zgjedhor në zgjedhjet e fundit të ndodhura në Shqipëri. Këta persona duhet

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

absolutisht të identifikohej ashtu si kërkoi dhe anëtari i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve por jo nga ky proces. Duhet të identifikohej të themi nga organi procedues shqiptar qofshin këto organet proceduese të rretheve gjyqësore apo vet nga SPAK-u ku kemi të bëjmë me pjesën e kompetencave të kësaj prokurorie të posaçme. Statistikat janë kokëforta dhe flasin shumë qartë për pretendimin e ngritur nga ana jonë, fillimisht për pavlefshmërinë e Bashkisë Dropull në bazë të statistikave që ju thashë dhe më parë kemi qenë forcë e parë gjithmonë. Në këtë rast një urdhër i nxjerrë nxitimthi nëpërmjet një deklarate publike të bërë nga një komitet partiak që quhen me gjasa "ekspert", i cili ka marrë efekte pa dalë ky urdhër në Fletoren Zyrtare dhe pa marrë efektet e ligjit. Pa marrë të themi atë që është një procedurë ligjore që duhet të ndalojë nëpërmjet një urdhri, një institucion publik. Kjo ka sjellë pa dyshim në këndëvështrimin e subjektit që përfaqësoj dhe duhet të sjellë dhe në vendimmarrjen tuaj një pavlefshmëri të një pjesë të qarkut dhe për pasojë të gjithë qarkut ashtu siç parashikohet në nenin 160 të Kodit Zgjedhor. Po ashtu përsëritem se ka shumë rëndësi ky fakt, ditën e djeshme na është vënë në dispozicion dhe na është vënë në dijeni nëpërmjet materialit të ndodhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe të kërkuar dhe nga ana juaj nga dy anëtarët të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për persona të posaçëm të cilët rezultojnë qartazi. Ju i keni të gjitha dokumentet përpara jush me emër, mbiemër rezultojnë të jenë në administratë zgjedhore të Qarkut Gjirokastrë Bashkia Dropull dhe subjekti politik është ai që ju e dini fare mirë Partia Socialiste e Shqipërisë. Ky fakt i jep një provë të mjaftueshme qëndrimit tonë që nxjerrja e urdhërit të Ministrit për Shëndetësinë, ka ndikuar dhe ka bërë të mundur përfitimet të paligjshme dhe të pa tolerueshme që subjekti tjetër politik, i cili ka gjithë Shtetin në dorë dhe nxjerr urdhëra të tillë në mënyrë që të denigrojë qytetarët shqiptarë të cilët mos ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Të denigrojë qytetarët shqiptarë duke

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

mos i dhënë atyre përfitimet që i njih Kushtetuta nëpërmjet shprehjes me votë për cilin subjekt ata kërkonin të votonin. Në këto kushte të nderuar anëtarë të komisionit, besoj se keni prova të mjaftueshme. Jeni thirrur për t'u shprehur me vendim duke treguar integritet, duke sjellë një ligjshmëri një proces që në këndvështrimin tonë është zhvilluar në diktatin e metodave jo ligjore. Duke dhënë transparencë nëpërmjet vendimmarrjes suaj e cila duhet të vendosë standarte europiane është viti i parë që në këto zgjedhje në komision i posaçëm që jeni ju 5 perona të nderuar, do të shprehet mbi disa kërkesa të subjekteve politike që është interesi madhor të tyre. Po ashtu është në interesin madhor të Shqipërisë të programeve që ka shteti ynë për të ndërruar hapat e mëtejshëm për aderimin nëpër institucione dhe nëpër të themi komunitete të caktuara siç është BE-ja. Shpresojmë që nga vendimmarrja juaj do të përmbushen pritshmëritë e shqiptarëve të cilëve e në këtë rast qartësisht është cënuar e drejta kushtetuese e votës, faleminderit. Po ashtu për të konkluduar mbështetëm nenin 30, pika 1, germa "c", të vendimit nr.3 2020, të Komisionit Rregullator. Përfundimisht ju kërkujmë ju aëntarëve të komisionit që të shpreheni me vendim duke disponuar "me ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.347, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit në zonën zgjedhore Qarkut Gjirokastër". Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Bashkinë Dropull dhe për pasojë duke qenë se kjo ndikon në marrjen e një mandati nga leximi që i bëjmë nenit 161, pika 2, kjo pavlefshmëri ndikon në marrjen e një mandati për subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim shpalljen e pavlefshme të gjithë Qarkut Gjirokastër dhe ju falenderon për vënien në dispozicion të gjithë materialit të kërkuar.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Kaziaj, po zoti Logu.

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Faleminderit i nderuar, duke qenë plotësisht dakord me të gjitha parashtrimet dhe përfundimet e përfaqësuesit ligjor të Lëvizjes Socialiste për Integrim, më lejoni që të paraqesim qëndrimin përfundimtar të PD-AN, lidhur me zgjedhjet e datës 25 prill në Qarkun e Gjirokastrës. Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, Partia Demokratike e Shqipërisë në emër të Aleancës për ndryshim paraqiti para jush një material ankues prej 52 faqesh të mbështetura në 26 prova duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet që kanë ndodhur në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë në periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore. Konkretisht ne ju parashtruar të nderuar se shtetasi Bledar Çuçi me detyrë Ministër i Punëve të Brendshme dhe drejtues politik i Partisë Socialiste në Qarkun Gjirokastrë, në bashkëpunim me shtetasit Arantit Arapi dhe Ermir Gerxhani ish drejtues të lartë të Policisë së Shtetit në Gjirokastrë dhe Përmet të larguar për shkak të përfshirjes në kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, kishin ngritur një strukturë kriminale të blerjes së votave nëpërmjet parave, ndihmave ushqimore, dhënies së përfitimeve por edhe nëpërmjet kërcënimeve presionet të drejtpërdrejta votuesve në Qarkun e Gjirokastrës. Këta shtetas drejtonin një strukturë kriminale që kishte në përbërje shtetas me rekorde të tmerrshme kriminale e përkatësisht shtetasit Andrea Çausi, Dino Selimi, Sokol Feruni, Andi Shkurta, Fatmir Hoxha, Kujtim Onjea, Julian Çibini, Bilbil Makri, Oltion Bistri, Perlat Sullaj, Klodian Haruni, Edmond Targaj, Maks Hadëri dhe Ervin Hoxha. Të nderuar anëtarë të KAS-it, krahas 26 provave të tona ne ju treguar provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Rezervave Materialeve të Shtetit dhe Inspektoratit Qendror apo

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

inspektorateve të tjera por ju refuzuat. Ju keni refuzuar të bëni transparencë për blerjen e votës në Qarkun e Gjirokastrës, ne ju parashtruam se shteti vendosi në dispozicion të partisë, tendera koncesione pipipi dhe çdo lloj investimi publik në Qarkun e Gjirokastrës. Kjo shkelje flagrante e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe neni 3 të vendimit nr.9 të vitit 2020, të Komisionit Rregullator u përsërit në 781 raste në gjithë Shqipërinë. Ne ju treguam me fakte dhe prova sesi shtetasit Edi Rama, Mirela Kumbaro, Bledar Çuçi, Artemis Malo, Kosat Garo dhe Kjara Dharmo, drejtues dhe zyrtar të lartë të Partisë Socialiste u shfaqën duke promovuar investime publike për qëllime të pastra elektorale. Ne ju treguam sesi shtetasi Lear Duraj me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Postës Shqiptare dhe kandidat për deputet i Partisë Socialiste në Gjirokastrë në konflikt të pastër interesi kishte përfituar nëpërmjet kompanisë së tij 31 milionë euro kontrata publike nga cilat mbi 10 milionë euro në 4 muajt e fundit të fushatës zgjedhore. Krahas 26 provave tona, ne ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë Agjencisë së Prokurorimeve Publike për numrin e tenderave, koncesioneve pipipive të shpallura rishtazi apo për të cilat janë shpallur fituesit në periudhën Dhjetor 2020-Maj 2021, por edhe këtë provë ju refuzuat ta merrnit. Ju keni refuzuar të bëni transparencë sesi paratë e taksapaguesve shqiptarë si paratë e të gjithëve ne këtu u vendosën në funksion të Partisë Socialiste në Qarkun e Gjirokastrës. Ne ju parashtruam se punonjësit e Administratës Shtetërore në Gjirokastrë, Përmet, Kërçyrë, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë dhe Dropull u kërcënuan, u intimiduan dhe u vendosën nën presion të vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të marrë pjesë detyrimisht në takime elektorale. Për të dorëzuar lista me emrat e 30 deri në 50 votuesve, për të dhënë kartat e tyre të identitetit apo familjarëve. Për të pëlqyer apo shpërndarë postimin në rrjete sociale, për t'u përfshirë në fushatë derë më derë apo për të dhënë përfitime të tjera për

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

mbështetësit e Partisë Socialiste. Ne ju parashtruam se administrata shtetërore u rrit me 13 mijë punonjës në rreth 4 muaj dhe nga buxheti i shtetit nga taksat e qytetarëve shqiptarë u paguan 63 milionë euro më shumë për paga krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ne ju parashtruam se qeveria pagoi 2.6 milionë euro më shumë ndihma ekonomike për periudhën Janar-Prill 2021, se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm, ndërkohë që u shpërndanë paga lufte me vlerë rreth 1.9 milionë euro. Krahas 26 provave tona ne ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar pretendimet tona pranë Departamentit Administratës Publike 61 bashkive të vendit, 244 shoqërive aksionare në pronësi të Shtetit, Agjencitë e Varësisë së ministrive dhe bashkive për numrin e të punësuarve me kontratë të përkohshme apo të përhershme dhe si ndryshoi ky numër përgjatë periudhës Dhjetor 2020-Maj 2021. Ne ju treguam provat që ju duhet të merrnit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo 61 bashkive lidhur me numrin e familjeve që përfituan rishtazi ndihmë ekonomike apo se si ndryshoi ndihma e tyre ekonomike gjatë periudhës Janar-Prill 2021. Por edhe këto prova ju i refuzuat, ju keni refuzuar të bënit transparencë sesi administrata shtetërore vendet e punës, ndihma ekonomike dhe pagesat e tjera sociale u vu në dispozicion të Partisë Socialiste në Qarkun e Gjirokastrës. Ne ju parashtruam se lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u përdorën masivisht nga Partia Socialiste për t'i përkthyer në vota dhe mbështetje për kandidatët e saj. Ne ju parashtruam se Partia Demokratike kishte fotot dhe video të zyrtarëve të Partisë Socialiste që shfaqeshin publikisht duke shpërndarë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor. Ne ju parashtruam se me 20 prill Drejtori i Përgjithshëm i Kadastrës iu deklaronte vartësve të tij se 100 mijë kërkesa për leje legalizimi duhet të mbaheshin në pritje, sepse në qoftë se u thuhej qytetarëve që banesat e tyre do të prishen këto vota do të shkojnë për palën tjetër. Në fakt qytetarët po na dëgjojnë edhe në këto momente,

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

ata e dinë mirë këtë që do të them tani, sepse vetëm gjatë javës së fundit kemi marrë qindra mesazhe apo denoncime se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes Territorit i ka njoftuar për prishjen e banesave apo shtëpive të tyre çka dëshmon se audio i përgjimit i Drejtorit të Kadastrës ishte i vërtetë ashtu siç ishte dhe u përdorën lejet e legalizimit masivisht për të përfituar Partia Socialiste në Qarkun e Gjirokastrës. Krahas 26 provave tona ne ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrni për të vërtetuar pretendimet tona pranë Këshillit Kombëtar të Territorit 61 këshilla bashkiak për lejet e ndërtimit të dhëna në periudhën Dhjetor 2020-Maj 2021. Ne ju parashtruam se në Janar - Mars 2021 u dhanë 10 mijë e 3 leje legalizimi. Dikush këtu ngriti pyetjen sa prej këtyre lejeve u dha në Qarkun e Gjirokastrës dhe kur ne i treguam provën që ai duhet të merrte pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ai i pari refuzoi ta merrte këtë provë. Ju pra i refuzuat këto prova, ju keni refuzuar të bëni transparencë për lejet e ndërtimit dhe lejet e legalizimit, të cilat u shpërndanë masivisht në Qarkun e Gjirokastrës për të përkthyer në vota për Partinë Socialiste. Ne ju parashtruam sesi Shteti vendosi të dhënat e qytetarëve në dispozicion të serverave të Partisë Socialiste...

*Zbardhi materialin audio  
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Ne ju parashtroam se si shteti vendosi të dhënat e qytetarëve në dispozicion të serverave të PS-së, sesi ky model ishte instaluar, jo vetëm në Tiranë ku dolën publikisht të dhënat personale përfshirë kartën e ID, vend banimin, nr e tel dhe bindjet politike të 910 mijë qytetarëve. Kjo skemë ishte instaluar në Shqipëri. Të gjithë ne që jemi këtu kemi sot të ekspozuar të dhëna tona personale, për secilin prej nesh dikush në zyrat e PS-së mblidhte kartat e ID, nr e tel, vendin e punës apo të dhëna të tjera personale përfshirë dhe bindjet politike. Por kjo nuk i shqetësojë anëtarët e KAS-it, nuk i alarmojë ata. Ata nuk u alarmuan për asnjë moment që ta diskutonin këtë pikë që do mjaftonte në vetëvete për të rrëzuar zgjedhjet e 25 prillit. Ne ju paraqitëm prova se si shtetasi Edi Rama, me detyrë Kryetar i PS-së, shtetasi Taulant Balla me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i PS-së, shtetasi Bledar Cuci me detyrë Anëtar i Kryesisë së PS-së, u shfaqën publikisht duke falënderuar patronazhistët që vidhnin të dhënat tona personale për rezultatin, gjoja historik të 25 prillit. Ju vendosët të mos ndaleshit në këtë pikë, se pavarësisht qëndrimeve tuaja, e di se kjo është një shkelje e rëndë jo vetëm e përmasave kombëtare por dhe ndërkombëtare, që do të trondiste themelet e çdo shteti normal kudo që do të kishte ndodhur në botë. Krahas 26 provave tona, ne ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrni për të vërtetuar pretendimet tona pranë prokurisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, lidhur me hetimet e kryera për skandalin e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të paligjshëm të të dhënave personale të qytetarëve por pa asnjë surprizë. Ju keni refuzuar dhe të merrni këtë informacion, ju refuzuat të bëni transparencë për përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale të qytetarëve shqiparë nga PS-ja falë mbështetjes me servera të shtetit shqiptarë. Ne ju parashtroam se vendimin i komitetit teknik të ekspertëve për karantinimin 2 javorë të emigrantëve i marrë vetëm 1 javë përpara zgjedhjeve dhe i shfuqizuar një javë pas zgjedhjeve i hoqi të

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

drejtën për të votuar 500 mijë shtetasve shqiptarë me të drejtë vote që jetojnë dhe punojnë në Greqi apo Maqedoninë e Veriut. Ndërkohë faktet tregojnë dhe kolegu i LSI-së e parashtrijë që ky vendim nuk kishte efekt për gjithë shetasit Shqiptarë por vetëm për votuesit e opozitës pasi votuesit e PS-së, jo vetëm erdhën dhe votuan por ishin edhe komisioner në qendra votimi KZAZ-je apo dhe numëruës në grupe numërimi. Kjo provë e marrë nga vet KQZ-ja vendimi i KZAZ-së 82, Qarku Gjirokastër dëshmon qartë që vendimi për t'u hequr të drejtën 500 mijë shtetasve shqiptarë, kishte një ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin zgjedhor të opozitës bashkuar në këto zgjedhje. Krahas 26 provave tona ne ju treguam provat e tjera që ju kishit detyrimin për t'i marrë për të vërtetuar pretendimet tona pranë Institutit të Statistikave mbi numrin e shtetasve shqiptarë që jetojnë në Greqi apo Maqedoninë e Veriut, me të drejtë vote si dhe pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit mbi numrin e qytetarëve shqiptarë që hyjnë në Shqipëri nga territori i Greqisë apo Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës 19.04.2021 - 25.04.2021. Por edhe këto prova ju i refuzuat. Ju refuzuat të bëni transparencë të plotë mbi vendimin e paligjshëm të Komitetit Teknik të Ekspertëve dhe refuzuat të bëni transparencë për 500 mijë shtetas shqiptarë.

**Z. L. Braho:** Zoti Logu të të ndërpres, nuk jeni këtu për të na bërë gjyq ne, anëtarëve të KAS-it. Jemi këtu për të gjykuar pavlefshmërinë. Ne e dimë se çfarë kërkesash janë rëzuar këtu dhe për këtë arsye ju mund të citoni të gjithë kërkesat që janë rëzuar dhe të bënit pretendimet tuaja për të vërtetuar se çfarë do të provonit me ato prova si dhe me provat e tjera që keni depozituar.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Braho, mendoj që këtë gjë po bëjmë. Kjo seancë këtu, procese nuk bëhen as për ju atje, as për ne këtu, bëhet për ata

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

qytetarët që na ndjekin bëhet për 622 mijë qytetarë që i kanë besur PD-në dhe Aleancës për Ndryshim bëhen për 730 mijë votues të opozitës bashkuar dhe bëhet për 3.5 milion Shqiptarë që kishin të drejtën për të votuar. Prandaj do kërkoja mirëkuptimin tuaj që pretendimet tona përfundimtare t'i drejtojmë, t'i parashtrojmë ashtu siç ne e mendojmë në mënyrën më të mirë të duhur. Faleminderit dhe kërkojmë të mos ndërpritem sepse është e drejta e çdo përfaqësuesi t'i bëjë pretendimet përfundimtare ashtu si ai i mendon në mënyrën më të arsyeshme.

**Z. L. Braho:** Patjetër zoti Logu, po ajo që kërkoja është që të mos bëhet gjyq publik për KAS-in, për anëtarët e KAS-it.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Secili prej nesh i nderuar, është përpara qytetarëve.

**Z. L. Braho:** Mirë është që të vijoni me të gjithë pretendimet tuaja, faleminderit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po nqs ne kemi pretendime, që edhe ju keni vepruar, KAS, kërkojmë ndjesë, ka vepruar në paligjshmëri në disa prej kërkesave tona. Ne kemi detyrimin ligjor ta themi këtë gjë dhe kemi detyrimin para atyre që përfaqësojmë, ta thjemi kete gjë.

**Z. L. Braho:** Je shumë i lirë ta bësh këtë gjë, patjetër që mund ta bësh në rastin hipotetik, të rrëzimit të kërkesës edhe në kolegjin zgjedhor. Pra janë gjithë mekanizmat, mund ta bësh dhe publikisht përpara gjithë anëtarëve të KAS-it.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Braho, kërkojmë që të vijojë me gjithë pretendimet tona përfundimtare, faleminderit. Ne ju parashtruam se vendimi i këtij

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

komisioni bëri që vullneti i 83 mijë zgjedhësve ose 5% e totalit të votuesve të ishte NUL, vetëm në Qarkun e Gjirokastrës pati 2317 fletë votimi të pavlefshme ose 4.8 % e totalit të votuesve nuk u ndalët për asnjë moment për t'a shqyrtuar këtë çështje. Nëse qëndrimin juridik e kishit të qartë, të paktën duhet t'i kërkonte ndjesë 83 mijë qytetarëve që prodhuat atë konfuzion siç thotë raporti i OSBE-ODIHR nuk arritën të shprehën lirisht vullnetin e tyre siç e dëshironin apo siç e mendonin ata. Ne ju parashtruam se strukturat e PD-së sollën denoncime të shumta për rastet e votimit të shumëfishtë, familjar, votimit për të tretët apo fallcifikimit të ID krahas 26 provave tona, ne ju kërkuam të merrni nga Administrata e KQZ-së të dhënat e kryqëzuara nga pajisjet PEI, kjo kërkesë fatmirësisht u pranua. Të jemi të qartë për ju këtu por edhe për publikun që po na ndjek, kjo kërkesë nuk u pranua me votat e të gjithë anëtarëve të këtij komisioni por vetëm me kërkesën e dy anëtarëve, siç përcaktohet nga neni 136, pika 3, e Kodit Zgjedhor. Të dhënat e marra nga pajisjet PEI flasin vet, shenjat e gishtërinjve të 12 personave janë përdorur për identifikimin e 70 zgjedhësve. Ne e pyetëm këtu përpara jush Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, nëse a ekziston mundësia që persona që kanë pasur në dispozicion të tyre një numër të caktuar kartash ID, qofshin këto 3, 4, 7 apo dhe 19, siç ishte një rast konkret të jenë paraqitur në qendra votimi dhe pasi kanë lexuar kartat e ID, pajisjet PEI, të kenë votuar më shumë sesa një herë qoftë ajo 5, 20 apo 30 dhe përgjigjia ishte: Po ekziston kjo mundësi. Do ishte në fakt që qoftë dhe ky fakt i vetëm që ju të konkludoni në pavlefshmërinë e zgjedhjeve, përsëritjen e tyre pasi kjo shkelje e rëndë e legjislacionit zgjedhor e cënon rëndë procesin zgjedhor e për rrjedhojë edhe rezultatin e zgjedhjeve. Të nderuar anëtar të KAS ndoshta gjuha është e ashpër por jemi përpara rasteve flagrante të blerjes së votës nga drejtues të PS-së me individë me rekorde të tmerrshme kriminale, të shkrirjes së shtetit me partinë në një të vetme, të vjedhjes

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

dhe përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale, të mohimit të të drejtës së 500 mijë shtetasve për të votuar, të pavlefshmërisë së vullnetit të 83 mijë zgjedhësve në kutitë e votimit, apo rasteve flagrante të votimit të dyfishtë. Për të provuar secilin prej këtyre krimeve të tmerrshme që kanë ndodhur në periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore ne ju vumë në dispozicion shpjegimet tona në 52 faqe dhe 26 prova, foto, video apo dokumente të tjerë dhe kërkuam nga ana juaj, jo një herë por plot 19 herë që të zbardhit në plotni masakrën zgjedhore të 25 prillit në Qarkun e Gjirokastrës. Ju keni refuzuar 19 herë të drejtën për transparencë të 3.5 milion zgjedhësve në gjithë Shqipërinë, veçanërisht të 123 mijë zgjedhësve në Qarkun e Gjirokastrës. Ne, pra të nderuar e bëmë detyrën tonë jo vetëm para 730 mijë zgjedhësve Shqiptarë, që kanë votuar opozitën e bashkuar në gjithë Shqipëri por edhe përpara 20 mijë zgjedhësve që na kanë votuar në Qarkun e Gjirokastrës e veçanërisht përpara 3.5 milion Shqiptarëve që kishin të drejtën për të votuar. Detyra jonë ishte të zbardhim të plotë masakrën zgjedhore të 25 prillit në Qarkun e Gjirokastrës. Të tregojmë me fakte dhe prova që 25 prilli nuk ishte një ditë zgjedhjesh të lira të ndershme dhe të barabarta por dita kur blerja e votës, kapja e shtetit në çdo qelizë, vjedhja e të dhënave personale, mohimi i të drejtës së emigrantëve për të votuar, paligjshmëria me fletët e votimit dhe votimi 5-6 herë i një personi të vetëm fituan mbi vullnetin e lirë të Shqiptarëve. Sot është dita juaj që të bëni detyrën, sot ju do të vendosni nëse do të silleni ishter të masacrës së 25 prillit në Qarkun e Gjirokastrës apo do të silleni ishter gjyqtarë me integritet personal dhe profesional që nuk mund të lejoni që vullneti i 123 mijë zgjedhësve në Gjirokastrë të diktohet nga krimi dhe paligjshmëria. Vendimi është i juaji dhe cilidoqoftë ai, ne nuk do ndalemi këtu por do shterojmë çdo mjet dhe mundësi për të hedhur dritë mbi historinë e zgjedhjeve. Se ne këtë betejë nuk po e bejmë as për ne këtu as për ju aty por e bejmë për gjithë qytetarët Shqiptarë që janë viktimat e

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

25 prillit 2021. Pretendimet e mija, i nderuar janë dhe të shkruara dhe do preferoja të depozitoja dhe një kopje pranë administratës zgjedhore, falemiderit.

**Z. L. Braho:** Falemiderit, zoti Logu. Viojmë me zotin Merxhani ose përfaqësuesit e autorizuar prej tij.

**Z. K. Merxhani, kandidatë i propozuar nga zgjedhësit:** Faleminderit i nderuar, faleminderit të nderuar anëtarë, është provuar me pamje filmike se anëtarët e grupit të numërit edhe me anëtarë të KZAZ-së veçanërisht nr.79 kanë lejuar numëruesit e tavolinës nr.2, të nderhyjnë në fletën e numërimit duke shënuar me stilolaps në hapësirën e përzgjedhjes së votës dhe duke tjetërsuar kështu vullnetin e votuesit dhe duke konsumuar vepër penale të parashikuar në nenin 326 të Kodit Penal, fallcifikimi i materialit zgjedhor dhe rezulateve të zgjedhjeve. Kjo shkelje vërteton se fletët e votimit janë manipuluar gjatë procesit të numërimit të votave brenda VNV-së si dhe për këtë lloj manipulimi ka ekzistuar një miratim në heshtje mes anëtarëve të grupeve të numërimit dhe anëtarëve të KZAZ-ve dhe nga pamjet filmike kjo është e vërtetuar shumë qartë. Fletëve të votimit që kanë nga një X të dytë apo të tretë shtesë në ato fletë votimi ku është vendosur se ka një x për kandidatin e pavarur. Në kuptimin, pra kemi nderhyrje për të shtuar x për të kthyer atë në të pavlefshme apo për ta çuar atë në drejtim tjetër. Pra në kuptimin dhe në ndërhyrjen e fletës së votimit, të cilën e provuam me prova të cilën ju e keni të bashkangjistura në aneksin nr 1. Pra është e qartë se jemi përpara faktit se fletët e votimit janë deformuar në mënyrë të qëllimshme dhe me paramendim, jo nga qytetarët por nga ata që kanë administruar procesin zgjedhor duke ndikuar drejtpërdrejtë dhe masivisht në rezultatet përfundimtare. Gjithashtu në VNV-në të KZAZ-së nr.80 është provuar me pamje filmike që një anëtarët i grupit të numërit

*Zbardhi materialin audio*

*Silyi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

të tavolinës 2 gjatë procesit të numërimit ka grisur një sasi fletësh votimi, duke konsumuar vepër penale të parashikur nga neni 326/1, dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor, e kryer kjo në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të grupit të numërimit dhe anëtarë të KZAZ-së, të cilët nuk ndërhyjnë apo penguan konsumimin e kesaj veprë. Konsumimi i veprave të tilla penale e minon të gjithë procesin zgjedhor në Qarkun Gjirokastrë, por jo vetëm. Duke rënuar çdo parim dhe standart që lidhet me procesin zgjedhor. Të nderuar anëtarë të KAS-it nëse kjo nuk është një arsye pavlefshmërie, cila mund të ishte tjetër? Shkeljet nuk janë mjaftuar me kaq. Përgjatë procesit zgjedhor janë provuar edhe shkelje të tjera. Ka shkelje që lidhen me pengimin e vëzhguesve brenda vendit të numërimit të votave përgjatë kohës së pranimit të kutive në këto VNV, duke mos lejuar vëzhguesit të monitorojnë procesin e pranimit dorëzimit të kutive në kundërshtim të Kodit Zgjedhor, duke ngritur pikëpyetje serioze mbi të gjithë procesin e pranimit dorëzimit të kutive duke rënë ndesh me Kodin Zgjedhor. Veç të tjerash jam dëshmitar dhe personalisht gjithashtu jam dëshmitar personalisht kur policia e shtetit ka zbatuar urdhra të paligjshme, të dhëna nga kryetarët e KZAZ-ve duke penguar hyrjen në VNV të vëzhguesve dhe të vetë kandidatit, në rastin konkret unë. Duke mos qenë të paanshëm në kryerjen e detyrave për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjitha subjekteve politike. Prania në masë brenda VNV-ve si dhe personave të pa autorizuar mbështetës të kandidateve të shtabeve të subjekteve të tjera zgjedhore edhe nga pamjet filmike është qartësisht dhe lehtësisht e vërtetueshme. Gjithashtu, në këtë proces janë shpallur shumë fletë votimi të pavlefshme pa asnjë arsyetim dhe nuk kemi pak, kemi 2317, gati 5% e të gjithë votave. Mbulimi me gisht i procesit të numërimit i katrorit numër 13 që i përkiste kandidatit të pavarur, haset në mbi 20 rastë të dokumentura nga një hulumtim i 1/30 të video të vëna në dispozicion nga KQZ. Në ekranin e tavolinave të

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

numërimit nuk është vendosur pamja e plotë e fletës së votimit kështu që vështirësohej dhe leximi i plotë i kësaj vote. Refuzimi i kopjeve të procesverbaleve të nënshkurara të rezultateve në qendrat e votimit dhe mosvendosja e këtyre procesverbaleve në hapësirën e përcaktuar nga KQZ-ja, vendosja e subjektit zgjedhor me nr.13 Kandidati i Pavarur Kreshnik Merxhani në tabelën përmbledhëse në tabelën e një KZAZ-je dhe më shumë të cilat në i kemi depozituar dhe ku tablela përfundonte me nr.12 jo se ekzistonte 13-ta dhe nuk isha unë por mbaronte te 12-ta. Në fillime të procesit të numërimit masivisht në KZAZ-në e Qarkut Gjirokastrë nuk janë treguar në kamera ana e fletëve të votimit me vulën, nuk janë thënë me zë si dhe nuk janë paraqitur në kamera grupet e numërimit apo ndonjë formë tjetër e shqeshme. Numri i votuesve të qendres së votimit të fletëve të votimit në kuti apo dhe numri i fletëve të papërdoruar kodet e sigurisë e kshu me radhë...Shumë qytetarë në Qarkun Gjirokastrë i është mohuar e drejta për të votuar që nga karantinimi dhe vecanërisht një çështje që e kemi ngritur dhe ne, infektimi me Covid 19 dhe organet e shetit dhe KQZ-ja nuk ndërmerren masa për t'ja mundësuar votimin ne spitale apo vendet ku ata ishin karantinuar brenda vendit po flas gjithmonë. Qeveria gjithashtu vendosi masën për karantinimin dy javorë për qytetarët që ktheheshin nga Greqia dhe Maqedonia Veriut duke ndikuar negativisht drejtpërdrejt dhe tek e drejta e votës së këtyre qytetarëve. Në qarkun tonë edhe më e ndjeshme siç u parashtrua. Presioni ndaj qytetarëve përmes vjedhjes së të dhënave personale në një databazë duke cënuar parimesh e përgjithshme të zgjedhjeve si dhe duke përbërë një vepër penale që ndikon në procesin zgjedhor. Edhe kjo çështje u shtjellua në këtë proces që ne kemi patur këtu. Qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit, ju mohua e drejta e votës edhe pse kjo është një e drejtë kushteuere dhe ligjore e përcaktuar dhe me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor. Edhe njëherë qytetarët që jetojnë jashtë

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

ngelën të pa përfaqësuar dhe të pa mundësuar për të dhënë mendimin e tyre për mënyrën se si vendi jonë duhet të drejtohet në këto 4 vjet. Keq përdorimi i punësimeve në administratën publike dhe i fondeve publike me synim ndikimi në rezultat zgjedhore ishte një çështje tjetër që ketu u adresua sigurisht dhe nga palët e tjera dhe nuk u morr informacion shterues për këtë çështje, i cili ne besojmë do të kishte ndikuar mjaftueshëm në pretendimet tona. Siç e arsyetuar më sipër shkeljen në procedurën e numërimit, vëzhgimit dhe cënimit të paprekshmërisë së fletës ë votimit, na vendosin përballë degradimit total të procesit zgjedhor, i cili nuk arrin dot të garantojë barazinë midis subjekteve pa prekshmërinë e votës së qytetarëve, mos deformin e vullnetit të zgjedhësve ligjshmërinë e veprimeve të administratës zgjedhore, mos ndëshkueshmërinë e konsumimit të veprës penale. Për të gjitha këto arsye, unë si kandidat i pavarur në datën e sotme 26.04.2021 i kam tërhequr nga VNV-të të gjith vëzhguesit e akredituar të subjekti tim dhe kërkojë midis kësaj ankesë pavlefshmëinë e tabelave përmbledhëse Qarku Gjirokastrë të miratuara me Vendimin 347 datë 4.05.2021 nga KQZ-ja, faleminderit.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Merxhani, subjekti i interesuar përfaqësuesi i PS nuk është. Nuk e di nëse Administrata e KQZ-së foli me zotin Salianji?

**Z. Y. Merkaj:** Po komunikova i thashë por s'më ktheu përgjigje.

**Z. L. Braho:** Mqs subjekti i interesuar nuk shqafi interes për pretendimet përfundimtare e ka mbajtur qëndrimin gjatë shqyrtimit administrativ, do i referohemi të njëjtit qëndrim. Për këtë arsye të shpallim vendimim në zbatim të nenit 143, të Kodit Zgjedhor, KAS do të tërhiqet ne dhomë këshillimi, në lidhje më vendimmarrjen do të presim pak dhe zotin Rusmali që t'a konsultojmë dhe me të

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

kur do e shpallim vendimin. Në parim seanca për shpalljen e vendimit do jetë në orën 13:00, në të kundërt do ju njoftojmë kush nga palët ka interes për shpalljen e vendimit dhe mediat sigurisht në orën 13:00 të jenë këtu, faleminderit. Dhe palët të jenë gati për të vijuar pas vendimmarrjes me Gjirokastrën.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora: 13:02**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Riçelim seancën për shpalljen e vendimit lidhur me Kërkesat Ankimore nr 33, 41 dhe 52. KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër Vendimit të Komisionert Shtetëror të Zgjedhjeve nr.347 datë 4.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Gjirokastrë për subjekte zgjedhore dhe kandidatët për deputet të zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 mbështetur në shkronjën "b", të pikës 1, nenit 30 të Vendimit Komisionit Rregullator, pikën 3, të nenit 21, të Kodit Zgjedhor dhe shkronjës "d", të pikës 1, të nenit 143 të Kodit Zgjedhor. Me shumicë votash, me vota kundër të anëtarëve, Ledio Braho dhe Elvis Çefa vendos:

1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.33 datë 7.05.2021 të paraqitura nga subjekti zgjedhor partia LSI;
2. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.41 datë 9.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor PD - AN
3. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.52 datë 10.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Kandidati i përzgjedhur nga një grup zgjedhësish zoti Kreshnik Merxhani;
4. Lënien në fuqi të Vendimit nr 347 datë 4.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.19.05.2021*

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së;
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- E deklaroj seancën të mbyllur. Në lidhje me Beratin do të rimblidhemi në orën 15:00 për të vijuar me seancën aty ku është lënë për pavlefshmërinë.

**Vendimi nr.86**

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*

